FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 200

Tiranë – E Mërkurë, 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 29.12.2014	Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr.102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".....	11905
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 927, datë 29.12.2014	Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve.....	12026
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 928, datë 29.12.2014	Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për pensionin social.....	12026
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 29.12.2014	Për një shtesë në vendimin nr.561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve".....	12029
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.932, datë 29.12.2014	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015.....	12029
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 29.12.2014	Për miratimin e buxhetit të vitit 2015 për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....	12034
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014	Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".....	12036
Udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 575, datë 31.12.2014	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 15.01.2013 "Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave"……...	12045

VENDIM
Nr. 919, datë 29.12.2014

PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË LIGJIT NR. 102/2014, DATË 31.7.2014, "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 40 deri 42, 47, 119, pika 7, 149, 150 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 161 deri 168, 169,174, 175, 176, 177, 184 e 188, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU 1
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim miratimin e dispozitave, të cilat, në përputhje me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", në vijim "Kodi", përcaktojnë dhe rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me orarin e funksionimit, kompetencat e autoriteteve doganore, operatorët ekonomikë të autorizuar, thjeshtësimet doganore, përjashtimet nga detyrimet e importit dhe kontrollit e analizës së riskut.

Neni 2
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në nenin 6, të Kodit.

2. Termat e përdorur në këtë vendim, të tjerë nga ato të përcaktuar në pikën 1, kanë këto kuptime:

a) "Aplikues", një person i cili aplikon pranë autoriteteve doganore për një vendim.

b) "Aftësi paguese", një gjendje të mirë financiare e cila është e mjaftueshme për të plotësuar detyrimet e aplikuesit, për sa u përket karakteristikave të llojit të aktivitetit të operatorit të interesuar.

c) "OEA", një operator ekonomik të autorizuar sipas përcaktimeve të nenit 40, të Kodit.

ç)"OEAD", një operator ekonomik të autorizuar për thjeshtësime doganore sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit.

d) "OEAS", një operator ekonomik të autorizuar për sigurinë dhe mbrojtjen sipas përcaktimeve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 40, të Kodit.

dh)"OEAP", një operator ekonomik të autorizuar për thjeshtësime doganore dhe për sigurinë dhe mbrojtjen;

e) "Certifikatë OEAD", certifikata që lëshohet në formatin e një certifikate OEA për thjeshtësime doganore.

ë)"Certifikata OEAS", certifikata që lëshohet në formatin e një certifikate OEA për sigurinë dhe mbrojtjen;

f) "Certifikata OEAP", certifikata që lëshohet në formatin e një certifikate OEA për thjeshtësime doganore/sigurinë dhe mbrojtjen;

g) "Mbajtës i vendimit", një person ndaj të cilit aplikohen efektet ligjore të një vendimi.

3. Termat e përdorur në këtë vendim, të tjerë nga ato të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë".

KREU 2
ORARI I FUNKSIONIMIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE, SEKUESTRIMI I SKEDARËVE KOMPJUTERIKË, I REGJISTRAVE ETJ., BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Seksioni 1
Orari i funksionimit

Neni 3
Orari i funksionimit të zyrave doganore

1. Për qëllime të nenit 9, të Kodit dhe pa cenuar dispozitat në fuqi për orarin ditor të punës të administratës publike, në parim, zyrat doganore, kufitare, tokësore e ujore dhe në aeroporte ofrojnë shërbim për të gjitha ditët, duke përfshirë edhe ditët e festave gjatë gjithë harkut kohor 24-orësh, përmes

[1] Rregullorja e Komisioni Nr. 2454/93 e 2 Korrikut 1993 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Rregullores Nr. 2913/92 "Kodi Doganor i Komunitetit". Celex Nr. 31993R2454; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 253, datë. 11.10.1993, faqe 1-766;(e përditësuar), përafrim i pjesshëm; Rregullorja e Këshillit nr. 1186/2009 e datës 16 nëntor 2009 "Për ngritjen e një sistemi të Komunitetit për përjashtimet nga detyrimet doganore"; Celex Nr. 32009R1186; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 324, datë. 10.12.2009, faqe 23 – 57, përafrim i pjesshëm; Direktiva 2007/74 / EC e datës 20 dhjetor 2007 "Mbi përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimin e akcizës të mallrave të importuara nga personat që udhëtojnë nga vendet e treta". Celex Nr. 32007L0074; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 346, datë. 29.12.2007, faqe 6 – 12, përafrim i pjesshëm;

kryerjes të të gjitha kontrolleve dhe formaliteteve të parashikuara nga Kodi.

2. Orari i punës së zyrave të administratës doganore është nga ora 8 deri në orën 18 për ditët nga e hëna deri të premten, duke përjashtuar ditët e festave.

3. Për mbulimin e shërbimeve doganore, duke marrë në konsideratë llojin e trafikut/transportit të mallrave, regjimet doganore nën të cilat vendosen mallrat dhe me qëllim që të mos pengohet dhe të mos vështirësohet trafiku ndërkombëtar i mallrave, drejtori i përgjithshëm mund të caktojë turne pune ose të autorizojë kryerjen e punës nga personeli jashtë orarit normal ditor përmes orëve shtesë.

4. Drejtori i përgjithshëm në bashkëpunim me administratat homologe mund të vendosë një orar pune të ndryshëm ose mund të shkurtojë orarin e mbajtjes hapur të zyrave doganore kur e kërkojnë nevojat e punës.

Seksioni 2

Sekuestrimi, kontrolli dhe analizimi i dokumentacionit dhe i pajisjeve elektronike, konfidencialiteti

Neni 4

Sekuestrimi i skedarëve kompjuterikë, regjistrave, dokumentacionit tjetër të nevojshëm, tregtar apo fiskal

1. Për qëllime të pikës 7, të nenit 10, të Kodit, autoritetet doganore, në rastet e dyshimeve të arsyeshme për tentativë ose për kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të parashikuara nga Kodi, mund të sekuestrojnë dokumente, skedarë kompjuterikë ose regjistrat përkatës, kompjuter, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm tregtar apo fiskal (sende/materiale) të ndodhura në ambientet e operatorëve ekonomikë.

2. Autoritetet doganore, për qëllimin e sekuestrimit, duhet të mbajnë një procesverbal në tri kopje, në të cilin shënohen të gjitha sendet/materialet të cilat po sekuestrohen dhe arsyeja se përse po bëhet ky sekuestrim. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë, të cilët po kryejnë sekuestrimin dhe nga operatori ekonomik ose përfaqësuesi i tij. Një kopje e këtij procesverbali i dorëzohet operatorit ekonomik ose përfaqësuesit të tij. Dy kopjet e tjera administrohen nga autoritetet doganore.

3. Nëse është e mundur, dokumentet origjinale fotokopjohen dhe kopja e vulosur me vulën e doganës i lihet në administrim operatorit ekonomik. Kjo procedurë duhet të përshkruhet edhe në procesverbal.

4. Në mënyrë që të ruhet "integriteti" i tyre, sendet/materialet e sipërpërmendura duhet të trajtohen me kujdes duke u vendosur nga punonjësit doganorë që i sekuestrojnë në një dosje ose kuti mbajtëse etj., në të cilën duhet të shënohen qartë:

a) emri i plotë i operatorit ekonomik të cilit i sekuestrohen sendet/materialet;

b) emri dhe mbiemri i punonjësve që kanë bërë sekuestrimin;

c) data dhe vendi i saktë ku u sekuestrua sendi/materiali;

ç) përshkrimi i përgjithshëm i sendit/materialit të sekuestruar.

5. Dosjet ose kutitë mbajtëse duhet të dërgohen në zyrën doganore mbikëqyrëse, në të cilën punonjësi i autorizuar i inventarizon këto sende/materiale. Para se të transportohet dosja ose kutia, duhet të vuloset me shirita ngjitës ose të plumboset për të shmangur heqjen e sendeve/materialeve të sekuestruara. Sendet/materialet e sekuestruara në vende të ndryshme nuk duhet të vendosen në të njëjtën qese ose kuti.

6. Kur transportohen dhe ruhen sendet/materialet e sekuestruara duhet të tregohet kujdesi i duhur, sipas llojit të tyre, për të shmangur faktorët mjedisorë, si: të nxehtin, të ftohtin dhe lagështirën, të cilat mund të kenë ndikim tek ato.

7. Kompjuterët ose pajisje të tjera elektronike mund të ndryshohen, të fshihen ose të shkatërrohen lehtësisht dhe për sekuestrimin dhe marrjen e tyre duhet të sigurohet që të mos ndryshojë gjendja e pajisjeve elektronike. Kjo do të thotë që nuk duhet të fiket një kompjuter që gjendet në punë dhe që nuk duhet të ndizet një kompjuter ose pajisje elektronike që gjendet e fikur.

8. Përveç mbledhjes së informacionit të përgjithshëm nga personat që janë në vendin që kontrollohet, punonjësit doganorë duhet të përpiqen të marrin edhe informacion specifik mbi sistemet kompjuterike, duke përfshirë:

a) emrat e të gjithë përdoruesve të kompjuterëve dhe të pajisjeve;

b) emrat hyrës dhe fjalëkalimet për përdoruesit e kompjuterit dhe të internetit;

c) emrat hyrës dhe fjalëkalimet e postës elektronike dhe llogarive në internet;

ç) qëllimin e përdorimit të kompjuterëve dhe të pajisjeve;

dh) ekzistencën e serverave ose serverave në distancë;

d) të gjitha fjalëkalimet;

e) aplikime automatike që janë në përdorim;

ë) llojet e aksesit në internet;

f) ofruesin e shërbimit të internetit;

g) mjetet e ruajtjes së informacionit elektronik që mund të ndodhen diku tjetër;

gj) dokumentet e programeve kompjuterike të instaluara;

h) masat e sigurisë që zbatohen për pajisjet;

i) kufizimet për aksesin ndaj të dhënave;

j) të gjitha pajisjet ose programet kompjuterike të instaluara që mund të shkatërrojnë informacionin.

9.Për të parandaluar ndryshimin që mund t'u ndodhë dokumenteve digjitale gjatë marrjes së tyre, punonjësi doganor, së pari duhet:

a) të dokumentojë çdo veprimtari në kompjuter, përbërësit e tij ose në pajisje;

b) të konfirmojë nëse kompjuteri është i ndezur apo jo.

10.Rekomandohet heqja e menjëhershme e energjisë/burimit të ushqimit kur:

a) informacioni në ekran tregon se po fshihen të dhëna ose se mbi të dhënat e vjetra po shkruhen të dhëna të tjera;

b) ka arsye për të besuar se në pajisjet e ruajtjes së të dhënave të kompjuterit po kryhet një proces shkatërrues.

11.Heqja e kabllos së ushqimit nga kompjuteri do të ruajë informacionin e përdoruesit të fundit dhe, në kohën kur ai ka pasur akses, dokumentet e përdorura së fundi, si dhe informacione të tjera të vlefshme.

12. Në situatat e mëposhtme nuk rekomandohet heqja e menjëhershme e kabllos së ushqimit:

a)Kur në ekran janë shfaqur të dhëna që duket se kanë vlerë si dokumente;

b) Kur ka të dhëna se janë aktive ose në përdorim:

i) dhoma *chat-room*;

ii) dokumente të hapura;

iii) pajisje të lëvizshme të ruajtjes të të dhënave;

iv) programe të mesazheve të çastit;

v) dokumente financiare;

vi) kodimi i të dhënave;

vii) veprimtari haptazi të paligjshme.

13.Nëse kompjuteri është i fikur: Për kompjuter tavoline, tover dhe minikompjuterë duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

a) Dokumentohen dhe etiketohen të gjithë kabllot dhe pajisjet e tjera të lidhura në kompjuter, si dhe hyrja përkatëse që zë në kompjuter secili kordon, kabllo, telat përcjellës apo USB-të;

b) Hiqen dhe ruhen kordoni elektrik nga pas kompjuterit dhe nga ushqyesi në mur ose nga zgjatuesi apo bateria;

c)Shkëputen dhe ruhen kabllot, telat përcjellës dhe USB-të nga kompjuteri dhe dokumentohet aparati apo pajisja e lidhur nëpërmjet tyre;

ç) Mbyllet me shirit ngjitës vendi ku vendoset disketa, nëse ka një të tillë;

d) Sigurohet që vendi i CD/DVD-së të jetë i mbyllur, të kontrollohet nëse është bosh, ka disk apo nuk është kontrolluar dhe mbyllet me shirit ngjitës, në mënyrë që të mos hapet;

dh) Sigurohet me shirit ngjitës çelësi i ndezjes/fikjes;

e) Regjistrohen marka, modeli, numrat serialë dhe çdo shenjë apo identifikim të vendosur nga përdoruesi;

ë)Inventarizohen kompjuteri dhe të gjithë kordonët, kabllot, telat përcjellës dhe përbërësit.

14.Gjatë transportimit të provave digjitale punonjësi duhet:

a) të mbajë provat digjitale larg fushave magnetike, si ato të prodhuara nga transmetuesit e radios, magnetet e altoparlantëve dhe dritat e emergjencës, të fiksuara me magnet; rreziqe të tjera të mundshme që punonjësi duhet të ketë parasysh janë ngrohësit e sedileve dhe pajisje apo materiale të tjera që mund të prodhojnë elektricitet statik;

b) të shmangë mbajtjen e provave digjitale në makinë për periudha të gjata kohe, sepse të nxehtët, të ftohtët dhe lagështira mund të dëmtojnë ose të shkatërrojnë provat digjitale;

c) të kujdeset që kompjuterët dhe pajisjet digjitale të paketohen dhe të sigurohen gjatë transportimit për të parandaluar dëmtimin nga tronditjet dhe dridhjet;

ç) të dokumentojë transportimin e provave digjitale dhe të mos shkëpusë zinxhirin e ruajtjes së tyre.

15.Gjatë magazinimit të provave digjitale, punonjësit doganorë duhet:

a)të sigurohen që provat inventarizohen, në përputhje me rregullat e administratës doganore;

b)të sigurohen që provat ruhen në një mjedis të sigurt, me kushte të kontrolluara dhe që nuk preket nga temperatura apo lagështia ekstreme;

c) të sigurohen se provat nuk ekspozohen ndaj fushave magnetike, lagështirës, pluhurit, dridhjeve ose ndonjë faktori që mund t'i dëmtojë ose t'i shkatërrojë.

Neni 5

Kontrolli dhe analizimi i dokumenteve të sekuestruara

1. Pas sekuestrimit, çdo kontroll apo verifikim i dokumenteve duhet të kryhet, në mënyrë që të shmanget humbja ose përzierja e tyre me të tjera dokumente. Nëse është e nevojshme që të hiqet shiriti vulosës për të lejuar kontrollin, duhet që qesja ose kutia të ri vuloset pas shqyrtimit, si dhe të dokumentohet se cili punonjës verifikoi apo kontrolloi dokumentet.

2. Dokumentet origjinale fotokopjohen ose skanohen dhe në të ardhmen punohet vetëm me kopjet.

Neni 6
Kontrolli dhe analiza e pajisjeve dhe dokumenteve elektronike/digjitale

1. Pajisjet dhe dokumentet elektronike duhet të ruhen me kujdes për të shmangur pretendimet se ato janë manipuluar dhe, për këtë qëllim, ato duhet të analizohen vetëm nga persona të trajnuar në mënyrë të posaçme.

2. Punonjësit e përfshirë në analiza dhe kontroll duhet të tregohen të kujdesshëm pasi të dhënat kompjuterike dhe provat e tjera digjitale janë delikate, prandaj punonjësit e patrajnuar dhe pa aftësitë e nevojshme nuk duhet të këqyrin përmbajtjen e tyre ose të përpiqen të rikuperojnë informacion. I vetmi veprim që ata mund të kryejnë është të regjistrojnë atë çka është e dukshme në ekran.

Seksioni 3
Kthimi i sendeve

Neni 7
Kthimi i sendeve të sekuestruara dhe konfidencialiteti

1. Autoritetet doganore, në përfundim të analizës/ekspertizës që i bëjnë dokumentecionit dhe ose pajisjeve, mjeteve të sekuestruara, i përfshijnë rezultatet në raportin përfundimtar të kontrollit, në funksion të të cilit u krye sekuestrimi, dhe sendet/materialet e sekuestruara i dorëzohen përfaqësuesit të operatorit ekonomik me procesverbal.

2. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga autoritetet doganore si rezultat i analizave të sipërpërmendura janë konfidenciale. Çdo punonjës i administratës doganore, që ka akses në këto të dhëna, që është njohur me këto të dhëna gjatë dhe për shkak të kryerjes së detyrave të tij funksionale apo për çfarëdo arsye tjetër, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e tyre përkundrejt çdo personi të tretë.

3. Nëse dokumentecioni dhe/ose pajisjet, mjetet e sekuestruara (sende/materiale) lidhen me një vepër penale dhe mundet të shërbejnë si prova, ato, së bashku me dosjen përkatëse, u dërgohen autoriteteve kopetente proceduese.

KREU 3
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Seksioni 1
Koordinimi, shkëmbimi i informacionit

Neni 8
Koordinimi i procedurave të kontrollit

1. Për qëllime të nenit 10 të Kodit, për të siguruar respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve të tjera kompetente, punonjësit e administratës doganore, në bashkëpunim me këto autoritete, mund të kryejnë kontrolle të përbashkëta periodike duke ndërmarrë masat e nevojshme administrative dhe organizative.

2. Rregullat e bashkëpunimit për zbatimin korrekt të dispozitave në lidhje me kontrollet e përbashkëta do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstitucionale.

Neni 9
Shkëmbimi i informacionit

1. Për qëllime të shkronjës "b", të pikës 11, të nenit 10, të Kodit, për zbatimin korrekt të legjislacionit doganor në fuqi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbledh informacion duke ia kërkuar këtë shoqërive tregtare, institucioneve të kreditimit, administratës postare ose çdo organizmi publik e privat.

2. Shoqëritë tregtare, institucionet e kreditimit, administrata postare apo çdo organizëm publik e privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, vënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuara rast pas rasti sipas kërkesës në formën e kërkuar prej saj. Ky informacion, në rast se kërkohet i tillë, mund të jepet edhe në formën e aksesit në raporte të gatshme informatike periodike. Rregullat e aksesit do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta.

3. Shkëmbimi i të dhënave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, kryhet për arsye verifikimi dhe hetimi në lidhje me import-eksportin e mallrave, për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna lidhur me regjimet e posaçme, operacionet e privilegjuara ose për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna nga vetë operatorët ekonomikë për të përfituar thjeshtësi dhe lehtësi doganore.

4. Të dhënat e shkëmbyera sipas këtij neni janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla.

Neni 10
Aksesi në bazën e të dhënave të administratave të tjera

1. Për qëllime të shkronjës "dh", të pikës 11, të nenit 10, të Kodit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetet doganore autorizohen të kenë akses në bazat e të dhënave të administratave të tjera, përkatësisht:

a) në bazën e të dhënave të personave që hyjnë dhe dalin në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) në bazën e të dhënave të deklarimit të kapitaleve dhe llogarive bankare, për efekt hetimi;

c) në bazën e të dhënave të precedentëve policorë;

ç) në bazën e të dhënave të automjeteve të vjedhura.

2. Autoriteteve doganore u mundësohet akses në kohë reale në bazën e të dhënave, në raportet e krijuara paraprakisht apo përmes ndërveprimit të sistemeve si mënyrë komunikimi dhe shkëmbimi të dhënash, sipas nevojave të autoritetit doganor. Aksesi do të jetë vetëm në cilësinë e leximit dhe printimit pa pasur mundësi për të shtuar apo pakësuar të dhënat. Modalitet teknike për mundësimin e aksesit përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura për këtë qëllim

3. Shkëmbimi i të dhënave sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet për arsye verifikimi dhe hetimi në lidhje me import-eksportin e mallrave, për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna lidhur me regjimet e posaçme, operacionet e privilegjuara ose për arsye të verifikimeve të deklarimeve dhe informacioneve të dhëna nga vetë operatorët ekonomikë për të përfituar thjeshtësi dhe lehtësi doganore.

4. Të dhënat e shkëmbyera sipas këtij neni janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla.

TITULLI II
OPERATORËT EKONOMIKË TË AUTORIZUAR

KREU 1
PROCEDURA PËR DHËNIEN E CERTIFIKATAVE

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 11
Autorizimet OEA

1. Pa cenuar përdorimin e thjeshtësimeve, përveçse kur parashikohet ndryshe sipas rregullave doganore, autoritetet doganore, pas aplikimit të një operatori ekonomik dhe në përputhje me nenin 40, të Kodit, mund të lëshojnë autorizimet e mëposhtme operatorëve ekonomikë të autorizuar, këtej e tutje të përmendur si "Certifikata OEA":

a) Autorizim OEA - thjeshtësime doganore atyre operatorëve ekonomikë që kërkojnë të përfitojnë nga thjeshtësimet e parashikuara sipas rregullave doganore dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 17, 18 dhe 19, të këtij vendimi;

b) Autorizim OEA – sigurinë dhe mbrojtjen atyre operatorëve ekonomikë që kërkojnë të përfitojnë nga lehtësirat e kontrolleve doganore në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose kur mallrat largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 17 deri 21, të këtij vendimi;

c) Autorizim OEA – thjeshtësime doganore/sigurinë dhe mbrojtjen atyre operatorëve ekonomikë që kërkojnë të përfitojnë nga thjeshtësimet e përshkruara në shkronjën "a" dhe nga lehtësirat e përshkruara në shkronjën "b" dhe të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 17 deri 21, të këtij vendimi.

2. Autoritetet doganore duhet të marrin parasysh karakteristikat e veçanta të operatorëve ekonomikë, në mënyrë të veçantë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 12
Përfitimet OEA

1. Nëse mbajtësi i një certifikate OEA i referuar në shkronjën "a" ose "c" të pikës 1 të nenit 11, aplikon për një ose më shumë prej autorizimeve të përmendura në nenet 58, 62, 66, 71 apo autorizime të tjera lidhur me thjeshtësi doganore sipas përcaktimeve të ligjit 8449 datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205 datë 13.04.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, autoritetet doganore nuk do t'i rishqyrtojnë ato kushte të cilat janë shqyrtuar një herë kur është dhënë certifikata OEA.

2. Kur një deklaratë përmbledhëse është depozituar nga mbajtësi i një certifikate OEA i referuar në shkronjën "b" ose "c" të pikës 1 të nenit 11, zyra doganore kompetente si rezultat i analizës së riskut për sigurinë dhe mbrojtjen, mund, të njoftojë operatorin ekonomik të autorizuar që ngarkesa është përzgjedhur për kontroll të mëtejshëm fizik. Ky njoftim do të bëhet vetëm atëherë kur ai nuk rrezikon kontrollin që do të kryhet.

Zyra doganore kompetente megjithatë mund, të kryejë një kontroll fizik edhe atëherë kur një operator

ekonomik i autorizuar nuk ka qenë i njoftuar, për përzgjedhjen e ngarkesës për kontroll të tillë. Kur mallrat dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë zbatohen të njëjtat procedura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

3. Mbajtësit e një certifikate OEA sipas shkronjës "b" ose "c" të pikës 1 të nenit 11, që importojnë ose eksportojnë mallra mund të depozitojnë deklaratat përmbledhëse që përmbajnë kërkesat më të reduktuara të të dhënave të përcaktuara në nenin 110 të vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 205 datë 13.04.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Transportuesit ose agjentët doganorë të cilët janë mbajtës të një certifikate OEA sipas shkronjës "b" ose "c" të pikës 1 të nenit 11 dhe janë të përfshirë në importimin apo eksportimin e mallrave për llogari të mbajtësve të certifikatës OEA të përcaktuar në shkronjën "b" ose "c" të pikës 1 të nenit 11 mund të paraqesin gjithashtu deklarata përmbledhëse, që përmbajnë kërkesat më të reduktuara të të dhënave të përcaktuara në nenin 110 të vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Mbajtësve të një certifikate OEA që janë autorizuar të përdorin kërkesa të reduktuara të të dhënave mund t'u kërkohet të paraqesin elementë shtesë të të dhënave, për të siguruar funksionimin e duhur të sistemeve të përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare me vendet e tjera në lidhje me njohjen reciproke të certifikatave OEA dhe masave në lidhje me sigurinë.

4. Mbajtësi i një certifikate OEA i nënshtrohet më pak kontrolleve fizike dhe dokumenteve sesa operatorët e tjerë ekonomik.

Autoritetet doganore mund të vendosin ndryshe nga sa u përcaktua në paragrafin e parë, në rastet e detyrimeve për kontrolle të përcaktuara dhe në respektim të ligjeve të tjera dhe kur vlerësojnë prezencën e ndonjë kërcënimi të veçantë.

Kur, pas analizave të riskut, një dërgesë e mbuluar nga një deklarim përmbledhës ose nga një deklarim doganor të depozituar nga një Operator Ekonomik i Autorizuar përzgjidhet për shqyrtim të mëtejshëm, autoriteti doganor kompetent, duhet të kryejë kontrollet e nevojshme me përparësi. Në qoftë se OEA e kërkon, dhe merr miratimin e autoritetit doganor në fjalë, këto kontrolle mund të kryhen në një vend të ndryshëm nga vendi i zyrës doganore të përfshirë.

5. Përfitimet e përcaktuara në pikat 1 deri në 4 reflektohen duke i dhënë numrat e nevojshëm në certifikatën OEA.

Seksioni 2
Aplikimi për një certifikatë OEA

Neni 13
Aplikimi

1. Aplikimi për një certifikatë OEA duhet të bëhet me shkrim ose në formë elektronike, në përputhje me specimenin e përcaktuar në aneksin 1.

2. Kur autoriteti doganor konstaton se kërkesa nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara, autoriteti doganor, brenda 30 ditëve nga marrja e aplikimit, i kërkon operatorit ekonomik të plotësojë informacionin e duhur, duke i dhënë arsyet e kësaj kërkese.

Afatet kohore të përmendura në pikën 1, të nenit 22, dhe pikën 2, të nenit 25, fillojnë nga data kur autoriteti doganor e merr gjithë informacionin e nevojshëm për të pranuar aplikimin. Autoritetet doganore duhet të njoftojnë operatorin ekonomik që aplikimi është pranuar dhe datën nga e cila do të fillojnë afatet kohore.

Neni 14
Pyetësori i vetëvlerësimit

1. Aplikimi për marrjen e një certifikate OEA paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave i shoqëruar me pyetësorin e vetëvlerësimit, sipas aneksit 2 "Pyetësori i vetëvlerësimit", të plotësuara në mënyrën e duhur.

2. Aplikuesi duhet të caktojë një pikë qendrore informacioni ose të emërojë një person kontakti brenda administratës së tij, për t'ia bërë lehtësisht të disponueshëm autoritetit doganor të gjithë informacionin e nevojshëm që provon përputh-shmërinë me kërkesat për lëshimin e "Certifikatës OEA".

3. Aplikuesi, për aq sa është e mundur, i paraqet me mjete elektronike të dhënat e nevojshme për autoritetet doganore.

Neni 15
Refuzimi i aplikimit për OEA

1. Aplikimi refuzohet në rastet e mëposhtme, kur:

a) aplikimi nuk është në përputhje me nenet 13 dhe 14;

b) aplikuesi është dënuar për një vepër të rëndë penale, që lidhet me aktivitetin ekonomik të tij ose i nënshtrohet procedurave të falimentimit në kohën e paraqitjes së aplikimit;

c) aplikuesi ka përfaqësues ligjor në çështjet doganore, i cili ka qenë i dënuar për vepër të rëndë penale, që lidhet me shkelje të rregullave doganore dhe tatimore dhe të lidhur me veprimtarinë e tij si përfaqësues ligjor;

ç) aplikimi është paraqitur brenda tre vjetëve pas revokimit të "Certifikatës OEA" të parashikuar nga pika 4, e nenit 31.

2. Refuzimi i një aplikimi për OEA nuk duhet të na çojë në pezullimin ose revokimin automatik të ndonjë vendimi të favorshëm ekzistues të dhënë sipas legjislacionit doganor.

Seksioni 3
Kushtet dhe kriteret për dhënien e "Certifikatës OEA"

Neni 16
Njohja reciproke e operatorëve ekonomikë të autorizuar

Një aplikues nuk është e nevojshme të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kur një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër në të cilin është vendosur operatori ekonomik parashikon njohjen reciproke të certifikatave OEA dhe përcakton masat administrative për kryerjen e kontrolleve të duhura në emër të autoritetit doganor të Republikës së Shqipërisë në qoftë se kërkohet.

Neni 17
Kriteret për pajtueshmëri doganore dhe tatimore

1. Të dhënat/regjistrimet e pajtueshmërisë me kërkesat doganore dhe tatimore të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 41, të Kodit, do të konsiderohen si të përshtatshme në qoftë se gjatë tri viteve të fundit përpara dorëzimit të aplikimit nuk ka kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor, si dhe nuk është proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit ndonjë nga personat e mëposhtëm:

a) aplikuesi;

b) personat e ngarkuar të shoqërisë aplikuese ose që ushtrojnë kontroll mbi menaxhimin e saj;

c) nëse është e zbatueshme, përfaqësuesi ligjor i aplikuesit në çështjet doganore;

ç) personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

Megjithatë, nëse autoritetet doganore kompetente e konsiderojnë ndonjë shkelje me rëndësi të papërfillshme, në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve doganore përkatëse dhe nuk krijojnë dyshime në lidhje me mirëbesimin e aplikuesit, atëherë të dhënat/regjistrimet që provojnë përputhshmërinë me kërkesat doganore dhe tatimore mund të konsiderohen si të përshtatshme.

2. Nëse personat që ushtrojnë kontroll mbi shoqërinë aplikuese janë të vendosur ose kanë vendqëndrimin në një vend jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat doganore dhe tatimore duke u mbështetur në të dhënat/regjistrimet dhe informacionin që disponojnë.

3. Nëse aplikuesi është themeluar si shoqëri tregtare prej më pak se tre vjetësh, atëherë autoritetet doganore vlerësojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat doganore dhe tatimore duke u mbështetur në të dhënat/regjistrimet dhe informacionin që disponojnë.

Neni 18
Kriteret për sistemin e pranueshëm të menaxhimit të regjistrimeve tregtare dhe të transportit

Për t'u mundësuar autoriteteve doganore që të vendosin nëse aplikuesi ka një sistem të pranueshëm të menaxhimit të regjistrimeve tregtare dhe, kur është e nevojshme, të regjistrimeve të transportit, siç përmendet në shkronjën "c", të nenit 41, të Kodit, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë një sistem kontabilizimi i cili është në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilizimit të zbatuara në Republikën e Shqipërisë dhe që do të lehtësojë kontrollet doganore me bazë auditi.

b) T'u lejojë autoriteteve doganore akses fizik ose elektronik në regjistrimet e tij doganore dhe, kur është e nevojshme, në regjistrimet e transportit;

c) Të ketë një sistem logjistik i cili të mundësojë dallimin ndërmjet mallrave shqiptare dhe joshqiptare;

ç) Të ketë një organizim administrativ i cili korrespondon me llojin dhe madhësinë e biznesit dhe që është i përshtatshëm për menaxhimin e fluksit të mallrave dhe të ketë kontroll të brendshëm për zbulimin e transaksioneve të paligjshme ose të parregullta;

d) Kur është e zbatueshme, të ketë procedura të pranueshme për trajtimin e licencave dhe autorizimeve të lidhura me masat e politikave tregtare ose me tregtinë e produkteve bujqësore;

dh)Të ketë procedura të pranueshme për arkivimin e regjistrimeve dhe informacionit të operatorit ekonomik dhe për mbrojtjen nga humbja e informacionit;

e) Të sigurojë që punonjësit të jenë të ndërgjegjshëm për nevojën për informimin e autoritetit doganor kur hasen vështirësi lidhur me

përputhshmërinë dhe të vendosin kontakte të përshtatshme për të informuar autoritetin doganor për të tilla dukuri;

ë) Të ketë masa sigurie të përshtatshme të teknologjisë së informacionit për të mbrojtur sistemin kompjuterik të aplikuesit nga hyrje të paautorizuara dhe për të siguruar dokumentecionin e aplikuesit.

Një aplikuesi që kërkon "Certifikatë OEA", referuar shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 11, nuk duhet t'i kërkohet përmbushja e kërkesave të përmendura në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni.

Neni 19
Kriteret për aftësitë e pagimit

1. Kriteret në lidhje me aftësinë paguese të aplikuesit të përmendur në shkronjën "ç" të nenit 41 të Kodit, konsiderohet se është përmbushur nëse aplikuesi e provon aftësinë e tij për të paguar për tre vitet e fundit.

2. Për qëllime të këtij neni, "aftësi paguese" nënkupton një gjendje të mirë financiare e cila është e mjaftueshme për të plotësuar detyrimet e aplikuesit, për sa u përket karakteristikave të llojit të aktivitetit të biznesit të interesuar.

3. Nëse aplikuesi ka qenë i themeluar prej më pak se tre vjetësh, aftësia paguese e tij do të gjykohet në bazë të të dhënave/regjistrimeve dhe informacionit që disponojnë.

Neni 20
Kriteret për standardet praktike të kompetencës ose kualifikimeve profesionale

Kriteret që kanë të bëjnë me standardet praktike të kompetencës ose kualifikimeve profesionale të lidhura direkt me aktivitetin e kryer, siç përmendet në shkronjën "d", të nenit 41, të Kodit, konsiderohen si të plotësuara nga aplikuesi ose punonjësi/t e tij përgjegjës për çështje doganore apo personi/at e kontraktuar ose punonjësit e tyre për çështje doganore, në qoftë se një nga kushtet e mëposhtme është përmbushur:

a) Për kualifikimet profesionale ka bërë trajnim dhe ka kaluar një provim, në përputhje me nivelin e përfshirjes së tij në aktivitete doganore që mbulon legjislacioni doganor, të mbajtura nga një prej të mëposhtmeve:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

ii) një qendër arsimore e njohur për qëllime të kualifikimeve të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

iii) një shoqatë profesionale ose tregtare e njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose e akredituar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me dispozitat në fuqi;

b) Për standardet praktike të kompetencave ka një minimum prej 3 vjetësh eksperiencë praktike në çështje doganore; Nëse kërkuesi është vendosur për më pak se tre vjet, eksperienca praktike në çështje doganore do të gjykohet duke u mbështetur në të dhënat/regjistrimet dhe informacionin e disponueshëm.

Neni 21
Kriteret dhe kushtet për standardet e sigurisë dhe mbrojtjes

1. Standardet e sigurisë dhe mbrojtjes të aplikuesit të referuara në shkronjën "dh", të nenit 41, të Kodit, konsiderohen si të përshtatshme nëse plotësohen kriteret apo kushtet e mëposhtme:

a) Ndërtesat që përdoren për operacionet e mbuluara nga certifikata, të jenë ndërtuar me materiale të cilat i rezistojnë hyrjes së paligjshme dhe të sigurojnë mbrojtje kundër ndërhyrjeve të paligjshme;

b) Të jenë vendosur masa të duhura kontrolli hyrjeje për të parandaluar hyrje të paautorizuara në zyra, zonat e ngarkimit, doket e ngarkimit, zonat e kargove dhe në vende të tjera përkatëse;

c) Masat për mbajtjen/trajtimin e mallrave të përfshijnë mbrojtjen kundër hyrjes, shkëmbimit ose humbjes së ndonjë materiali dhe ndërhyrjes në njësitë e ngarkesave;

ç) Kur është e zbatueshme, aplikohen procedura për trajtimin e licencave të importit dhe/ose eksportit që kanë të bëjnë me ndalimet dhe kufizimet dhe që bëjnë dallimin e këtyre mallrave nga mallrat e tjera;

d) Aplikuesi ka marrë masa që lejojnë një identifikim të qartë të partnerëve të tij të biznesit me qëllim që të sigurojë zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit;

dh) Aplikuesi, për aq sa e lejon legjislacioni, kryen kontrolle sigurie për transparencën e punonjësve të ardhshëm që do të punojnë në pozicione sensitive sigurie dhe kryen kontrolle periodike të punonjësve ekzistues.

e) Aplikuesi siguron që stafi i tij merr pjesë në mënyrë aktive në programet e ndërgjegjësimit për sigurinë;

2. Nëse aplikuesi i themeluar në Republikën e Shqipërisë është mbajtës, i një certifikate sigurie dhe/ose mbrojtjeje të njohur ndërkombëtarisht e lëshuar duke u mbështetur në konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipëria është palë, kriteret e parashikuara në pikën 1 gjykohen si të plotësuara, deri në shkallën kur kriteret për lëshimin e këtyre certifikatave janë të njëjta ose i korrespondojnë atyre kritereve.

Seksioni 4
Procedura për lëshimin e "Certifikatës OEA"

Neni 22

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet t'i komunikojë aplikimin zyrave doganore brenda 7 ditëve të punës, duke filluar nga data në të cilën ai e ka marrë aplikimin në përputhje me nenin 13, duke përdorur sistemin e komunikimit të përmendur në nenin 33.

2. Kur ndonjë prej zyrave doganore ka informacione të rëndësishme të cilat mund të ndikojnë në dhënien e certifikatës, ia komunikojnë atë informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga data e komunikimit e parashikuar në pikën 1, duke përdorur sistemin e komunikimit të përmendur në nenin 33.

Neni 23
Konsultimi me institucione të tjera

1. Nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen/këshillohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit sa i takon verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 41, të Kodit. Konsultimet kryhen në qoftë se shqyrtimi i një ose më shumë kritereve të përcaktuara në nenet 16 deri 21 nuk mund të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për shkak të mungesës së informacionit apo për pamundësinë e kontrollit të tij. Në këto raste, konsultimet do të bëhen brenda 60 ditëve, duke filluar nga data e komunikimit të informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mënyrë që të lejojnë lëshimin e "Certifikatës OEA" ose refuzimin e aplikimit brenda afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 25.

Nëse institucioni konsultues nuk përgjigjet brenda 60 ditëve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konsideron nën përgjegjësinë e institucionit konsultues se kriteret, për të cilat u kërkua konsultimi/këshillimi/et janë përmbushur. Kjo periudhë mund të zgjatet nëse aplikuesi bën rregullimet me qëllim që të përmbushë këto kritere dhe i komunikon ato tek institucionet konsultuese.

2. Kur pas shqyrtimit të përcaktuar në nenin 24, institucioni i konsultuar/këshilluar vendos që aplikuesi nuk përmbush një ose më shumë kritere, rezultatet e konsultimeve, të dokumentuara në mënyrë të rregullt, do të dërgohen te Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila refuzon aplikimin. Në këtë rast, zbatohen pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 25.

Neni 24
Shqyrtimi i kritereve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shqyrton nëse plotësohen kushtet dhe kriteret për lëshimin e certifikatës të përshkruar në nenet 16 deri 21. Shqyrtimi i kritereve të përcaktuara në nenin 21, kryhet për të gjitha ambientet të cilat janë të lidhura me aktivitetin doganor të aplikuesit. Shqyrtimi, si dhe rezultatet e tij dokumentohen nga autoriteti doganor.

Kur në rastin e një numri të madh ambientesh, periudha kohore për lëshimin e certifikatës nuk lejon shqyrtimin e të gjitha ambienteve përkatëse, por autoriteti doganor nuk ka dyshim se aplikuesi ruan standardet e sigurisë në të gjitha ambientet të cilat janë përdorur zakonisht nga operatori ekonomik, ai mund të vendosë të shqyrtojë vetëm një pjesë përfaqësuese të këtyre ambienteve.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kur e vlerëson të arsyeshme gjatë procesit të shqyrtimit të kushteve dhe kritereve për lëshimin e certifikatës të përshkruar në nenet 16 deri 21, mund të bashkëpunojë me zyrat doganore.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të pranojë konkluzionet e siguruara nga një ekspert i fushave përkatëse të përmendura në nenet 18, 19 dhe 21, për sa u përket kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këto nene. Eksperti nuk duhet të jetë i lidhur me aplikuesin.

Neni 25
Lëshimi i një "Certifikate OEA"

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon "Certifikatën OEA" në përputhje me modelin e përcaktuar në aneksin 3.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon një "Certifikatë OEA" ose refuzon aplikimin brenda 120 ditëve nga data e pranimit të aplikimit në përputhje me nenin 13.

Kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk është në gjendje të respektojë afatin, ky afat mund të zgjatet me një periudhë tjetër 60-ditore. Në raste të tilla, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, para përfundimit të afatit prej 120 ditësh, informon aplikuesin për arsyet e shtyrjes.

3. Afati i parashikuar në pikën 2 mund të zgjatet nëse gjatë shqyrtimit të kritereve aplikuesi bën rregullime me qëllim që të plotësojë këto kritere dhe i komunikon ato te Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. Kur rezultati i shqyrtimit të kryer në përputhje me nenet 22, 23 dhe 24 ka mundësi të çojë në refuzimin e aplikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i komunikon aplikuesit konkluzionet paraprake që mund të çojnë në refuzimin e aplikimit

dhe i jep mundësinë aplikuesit që të përgjigjet brenda 30 ditëve para se të refuzojë aplikimin. Afati prej 120 ditësh i përcaktuar në paragrafin e parë, të pikës 2, pezullohet në përputhje me rrethanat.

5. Refuzimi i një aplikimi nuk duhet të çojë në revokimin automatik të ndonjë autorizimi ekzistues të lëshuar sipas rregullave doganore.

6. Nëse aplikimi është refuzuar, autoriteti doganor do të informojë aplikuesin për arsyet në të cilat është bazuar vendimi. Vendimi për të refuzuar një aplikim do t'i njoftohet aplikuesit brenda afateve kohore të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda pesë ditëve të punës, do të njoftojë zyrat doganore që është lëshuar një "Certifikatë OEA", duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33. Informacioni gjithashtu jepet brenda të njëjtit afat në rast se aplikimi refuzohet.

KREU 2
EFEKTET LIGJORE TË CERTIFIKATAVE OEA

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 26
Vlefshmëria e "Certifikatës OEA"

1. "Certifikata OEA" hyn në fuqi në ditën e dhjetë të punës pas datës së lëshimit të saj.

2. Afati i vlefshmërisë së "Certifikatës OEA" është i pakufizuar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me zyrat doganore monitoron përputhshmërinë e kushteve dhe kritereve që duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë të autorizuar.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kryen rivlerësimin e kushteve dhe kritereve në rastet e mëposhtme:

a) kur ka ndryshime të mëdha në legjislacionin përkatës;

b) kur ka të dhëna të arsyeshme që kushtet dhe kriteret përkatëse nuk vijojnë më të përmbushen nga operatori ekonomik i autorizuar.

Në rastin e një "Certifikate OEA", të lëshuar në favor të një aplikuesi i cili është themeluar në më pak se tre vjet, kontrolli më i afërt do t'i bëhet gjatë vitit të parë pas lëshimit.

Gjithashtu, në procedurën e rivlerësimit, zbatohet edhe pika 2, e nenit 24.

Rezultatet e rivlerësimit u njoftohen zyrave doganore, duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

Seksioni 2
Pezullimi i statusit të operatorit ekonomik të autorizuar

Neni 27
Pezullimi

1. Statusi i operatorit ekonomik të autorizuar pezullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në rastet e mëposhtme:

a) Kur janë zbuluar mospërputhje të kushteve apo kritereve për "Certifikatën OEA";

b) Kur ka arsye të mjaftueshme të besojë se është kryer nga operatori ekonomik i autorizuar një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor.

Megjithatë, në rastin e përmendur në shkronjën "b", Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që të mos e pezullojë statusin e operatorit ekonomik të autorizuar nëse konstaton një shkelje me rëndësi të papërfillshme në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve dhe nuk krijon dyshime që kanë të bëjnë me mirëbesimin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Para marrjes së vendimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i komunikon konstatimet e saj operatorit ekonomik. Operatori ekonomik ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe/ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

Megjithatë, pezullimi bëhet menjëherë, kur e kërkon natyra ose shkalla e rrezikut/kërcënimit ndaj qytetarëve, mbrojtjes dhe sigurisë, shëndetit publik ose mjedisit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informon menjëherë zyrat doganore lidhur me pezullimin, duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33, me qëllim që t'i lejojë ata të marrin masat e duhura.

2. Nëse mbajtësi i "Certifikatës OEA" nuk e rregullon situatën e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, brenda afatit 30-ditor, siç përcaktohet në paragrafin e tretë të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton operatorin ekonomik në fjalë që statusi i operatorit ekonomik të autorizuar është pezulluar për një periudhë prej 30 ditëve, për të mundësuar operatorin ekonomik të marrë masat e nevojshme për të rregulluar situatën. Njoftimi gjithashtu do t'u dërgohet zyrave doganore duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

3. Kur operatori ekonomik nuk ka mundur të rregullojë situatën brenda 30 ditëve sipas përcaktimeve të pikës 2, por siguron që kushtet mund të përmbushen nëse periudha e pezullimit zgjatet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon

statusin e operatorit ekonomik të autorizuar edhe për 30 ditë të tjera.

4. Nëse mbajtësi i "Certifikatës OEA" ka kryer një veprim të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon statusin e operatorit ekonomik të autorizuar gjatë kohëzgjatjes së procedimit penal dhe gjyqësor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton mbajtësin e certifikatës për këtë vendim pezullimi. Njoftimi gjithashtu u dërgohet zyrave doganore duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

Neni 28
Efektet ligjore të pezullimit

1. Pezullimi nuk ndikon në asnjë procedurë doganore të nisur para datës së pezullimit dhe që nuk ka përfunduar ende.

2. Pezullimi nuk ndikon automatikisht në asnjë autorizim, i cili është lëshuar, pa iu referuar "Certifikatës OEA", përveç rasteve kur arsyet për pezullimin gjithashtu ndikojnë për atë autorizim.

3. Pezullimi nuk ndikon automatikisht në asnjë autorizim për përdorimin e një thjeshtësimi doganor i cili është lëshuar në bazë të "Certifikatës OEA", dhe për të cilin janë akoma të përmbushura kushtet/kriteret.

4. Në rastin e një "Certifikate OEA" të referuar në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 11, nëse operatori ekonomik nuk plotëson vetëm kushtet e përcaktuara në nenin 21, statusi i operatorit ekonomik të autorizuar duhet të pezullohet pjesërisht dhe me kërkesë të tij mund të lëshohet një "Certifikatë e re OEA" siç përmendet në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11.

Neni 29
Anulimi i pezullimit ose revokimi

1. Kur operatori ekonomik, për të bindur autoritetet doganore, ka marrë masat e nevojshme në përputhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga një operator ekonomik i autorizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anulon pezullimin dhe informon operatorin ekonomik dhe zyrat doganore. Pezullimi mund të anullohet para përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 2 ose në pikën 3, të nenit 27.

Në situatën e përcaktuar në pikën 4, të nenit 28, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të riaktivizojë certifikatën e pezulluar. Më pas, revokon "Certifikatën OEA" të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11.

2. Nëse operatori ekonomik nuk arrin të marrë masat e nevojshme brenda periudhës së pezullimit të parashikuar në pikën 2 ose në pikën 3, të nenit 27, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave revokon "Certifikatën OEA" dhe njofton menjëherë zyrat doganore, duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

Në situatën e përcaktuar në pikën 4, të nenit 28, certifikata origjinale revokohet dhe është e vlefshme vetëm "Certifikata e re OEA", e lëshuar siç përcaktohet në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11.

Neni 30
Pezullimi me kërkesë

1. Kur një operator ekonomik i autorizuar nuk është në gjendje përkohësisht për të përmbushur ndonjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 11, ai mund të kërkojë pezullimin e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar. Në raste të tilla, operatori ekonomik i autorizuar njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke përcaktuar datën kur ai do të jetë në gjendje për të përmbushur sërish kriteret. Ai gjithashtu njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo masë të planifikuar dhe planin kohor për realizimin e tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dërgon njoftimin te zyrat doganore duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

2. Nëse operatori ekonomik i autorizuar nuk arrin të rregullojë situatën brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e tij, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të japë një shtyrje të arsyeshme, me kusht që operatori ekonomik i autorizuar të ketë vepruar në vullnet të mirë. Kjo shtyrje do t'u komunikohet zyrave doganore duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

Në të gjitha rastet e tjera, "Certifikata OEA" revokohet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton menjëherë zyrat doganore, duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

3. Nëse masat e kërkuara nuk janë marrë brenda afatit të pezullimit zbatohet neni 31.

Seksioni 3
Revokimi i "Certifikatës OEA"

Neni 31
Revokimi

1. "Certifikata OEA" revokohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në rastet e mëposhtme:

a) kur operatori ekonomik i autorizuar nuk merr masat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 29;

b) kur nga operatori ekonomik i autorizuar janë kryer shkelje serioze që kanë të bëjnë me legjislacionin doganor dhe tatimor dhe kur atij i janë shteruar rrugët e ankimit.

c) nëse operatori ekonomik i autorizuar nuk merr masat e nevojshme gjatë periudhës së pezullimit të përmendur në nenin 30;

ç) me kërkesë të operatorit ekonomik të autorizuar.

Megjithatë, në rastin e referuar në shkronjën "b", autoriteti doganor mund të vendosë të mos e shfuqizojë "Certifikatën OEA" nëse vlerëson se shkeljet janë me rëndësi të papërfillshme në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve doganore përkatëse dhe nuk krijon dyshime lidhur me vullnetin e mirë të operatorit ekonomik të autorizuar.

2. Revokimi hyn në fuqi një ditë pas njoftimit të tij.

Në rastin e një "Certifikate OEA", siç përcaktohet në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 11, kur operatori ekonomik nuk arrin të përmbushë vetëm kushtet e parashikuara në nenin 21, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave revokon certifikatën dhe lëshon një "Certifikatë të re OEA" siç përcaktohet në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informon menjëherë zyrat doganore për revokimin e "Certifikatës OEA" duke përdorur sistemin e komunikimit të përcaktuar në nenin 33.

4. Përveç rasteve të revokimit të përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 1, operatori ekonomik nuk lejohet të paraqesë një aplikim të ri për "Certifikatë OEA" brenda tri viteve nga data e revokimit.

KREU 3
SISTEMET DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Seksioni 1
Shkëmbimi i informacionit

Neni 32
Informimi

1. Operatori ekonomik i autorizuar informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të gjithë faktorët që lindin pasi është dhënë certifikata, të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e saj.

2. Gjithë informacioni përkatës në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave vihet në dispozicion të zyrave doganore ku operatori ekonomik i autorizuar kryen veprimet doganore përkatëse.

3. Nëse një zyrë doganore kompetente revokon një autorizim të veçantë të dhënë prej saj në favor të një operatori ekonomik të autorizuar, duke u bazuar në "Certifikatën OEA" për përdorimin e një thjeshtësimi të veçantë doganor, zyra doganore njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave që ka lëshuar certifikatën AEO.

Neni 33
Sistemi i informacionit

1. Sistemi i informacionit dhe komunikimi elektronik përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përdoret për procesin e informacionit dhe të komunikimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe operatorëve ekonomikë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke përdorur sistemin e përmendur në pikën 1, ruan dhe ka akses në të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat e aplikimeve të transmetuara në mënyrë elektronike;

b) certifikatat OEA dhe, kur është e zbatueshme, ndryshimin e tyre, revokimin ose pezullimin e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar;

c) të gjitha informacionet e tjera përkatëse.

3. Zyra e analizës së riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave njoftohet për ndryshimin, revokimin e "Certifikatës OEA" ose pezullimin e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar.

4. Lista e operatorëve ekonomikë të autorizuar publikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në faqen e saj zyrtare të internetit, me miratim paraprak të operatorit të ekonomik autorizuar. Lista duhet të përditësohet.

TITULLI III
KONTROLLET DOGANORE

Seksioni 1
Menaxhimi i riskut

Neni 34
Informacion i përgjithshëm mbi menaxhimin e riskut dhe vlerësimin e riskut

1. Për qëllime të nenit 47 të Kodit, autoritetet doganore kryejnë menaxhim risku për të bërë dallimin ndërmjet niveleve të riskut që lidhen me mallrat, objekt i kontrollit ose mbikëqyrjes doganore, dhe për të përcaktuar nëse mallrat do të jene objekt i kontrolleve të veçanta doganore.

2. Përcaktimi i niveleve të riskut bazohet në vlerësimin e gjasave që një ngjarje me risk të ndodhë dhe ndikimin e saj. Bazat e përzgjedhjes së ngarkesave ose deklarimeve të cilat do të jenë objekt i kontrolleve doganore përfshijnë një element rastësor.

Neni 35
Institucionet publike që shkëmbejnë informacion dhe forma e bashkëpunimit

1. Për të mundësuar zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, si dhe për qëllim të menaxhimit të riskut, administrata doganore shkëmben informacion me institucionet publike të mëposhtme.

a) autoritetet veterinare;

b) autoritetet fitosanitare;

c) autoritetet sanitare;

ç) autoritetet statistikore;

d) autoritetet e tatim-taksave;

dh) autoritetet përgjegjëse për luftën kundër mashtrimit;

e) autoritetet përgjegjëse për ekonominë, politikën tregtare, duke përfshirë autoritetet bujqësore kur duhet;

ë) autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar dhe transportin;

f) autoritetet e pushtetit vendor;

g) autoritetet policore dhe të krimit ekonomik;

gj) autoriteti i parandalimit të pastrimit të parave.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, në rast se konsiderohet e nevojshme për qëllim të menaxhimit të riskut, autoritetet doganore shkëmbejnë informacion edhe me institucione të tjera publike ose private, shqiptare ose të huaja, rast pas rasti lidhur me të dhënat që ato zotërojnë.

Neni 36
Modalitetet e shkëmbimit të informacionit

1. Për qëllim të menaxhimit të riskut, institucionet e përmendura në nenin 35, si dhe organizma të tjerë publikë apo privatë mund të shkëmbejnë periodikisht ose rast pas rasti të dhënat që ato zotërojnë në lidhje me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin, trafikun postar, qarkullimin e mallrave, rezultatet e kontrolleve të kryera etj.

2. Kategoritë e informacionit që do të shkëmbehet, frekuenca e këtij shkëmbimi dhe modalitetet përkatëse përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit, të lidhura për këtë qëllim.

Neni 37
Kushtet për shkëmbimin e të dhënave

Autoritetet doganore shkëmbejnë informacion me autoritetet e përcaktuara në nenin 35, vetëm nëse ky proces është i nevojshëm për plotësimin e detyrimeve të tyre ligjore në lidhje me lëvizjen e mallrave që i nënshtrohen një procedure doganore.

Neni 38
Masat për zbatimin uniform të kontrolleve doganore

Për qëllime të pikës 3, të nenit 47, të Kodit, me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të Doganave, përcaktohen masat që sigurojnë zbatimin uniform të kontrolleve doganore, përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi riskun dhe për rezultatet e analizave të riskut, kriteret dhe standardet e përbashkëta të riskut, masat e kontrollit dhe fushat prioritare të kontrollit.

TITULLI IV
DEKLARATAT DOGANORE STANDARDE, DEKLARATAT DOGANORE TË THJESHTUARA, DEKLARATAT PLOTËSUESE

KREU 1
RREGULLAT PROCEDURALE PËR DEPOZITIMIN E DEKLARATËS DOGANORE

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 39
Përmbajtja e një deklarate doganore standarde

Për qëllime të nenit 149 dhe 150 të Kodit, rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës doganore standarde dhe rregullat procedurale për paraqitjen e dokumenteve shoqëruese përcaktohen në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

Seksioni 2
Dokumentet shoqëruese të autorizuara nga autoritetet doganore

Neni 40
Përkufizime

Për qëllime të pikës 3, të nenit 150, të Kodit, të këtij seksioni dhe të anekseve 4 dhe 5, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Peshues i autorizuar", është çdo operator ekonomik që autorizohet nga një autoritet doganor kompetent për qëllim të peshimit të bananeve;

b) "Regjistrime të aplikuesit" është çdo dokument në lidhje me peshimin e bananeve të freskëta;

c) "Pesha neto e bananeve të freskëta" është pesha e vetë bananeve pa materialet paketuese dhe ambalazhet e çdo lloji;

ç) "Ngarkesë e bananeve të freskëta" është ngarkesa që përfshin sasinë e plotë të bananeve të

freskëta të ngarkuara në një mjet të vetëm transporti dhe të transportuara nga një eksportues i vetëm te një apo më shumë pritës mallrash;

d) "Vendi i shkarkimit" është çdo vend ku një ngarkesë e bananeve të freskëta mund të shkarkohet apo të lëvizet nën një procedurë doganore ose në rastin e trafikut me kontejnerë, ku kontejneri zbritet nga anija apo aeroplani ose nga një mjet tjetër kryesor transporti apo ku kontejneri është shpaketuar.

Neni 41
Dhënia e statusit peshues i autorizuar

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave jep mbi baza aplikimi statusin "peshues i autorizuar" një operatori ekonomik të përfshirë në importimin, transportin, ruajtjen ose trajtimin e bananeve të freskëta, me kusht që të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) aplikuesi të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor;

b) aplikuesi ofron të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen e duhur të peshimit;

c) aplikuesi ka në dispozicion të tij pajisje të përshtatshme peshimi sipas ligjit;

ç) regjistrimet/të dhënat e aplikuesit mundësojnë autoritetet doganore të kryejnë kontrolle efektive.

Autorizimi do të kufizohet vetëm në peshimin e bananeve të freskëta në vende të mbikëqyrura nga zyra doganore kompetente.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave revokon statusin "peshues i autorizuar", nëse mbajtësi i autorizimit nuk përmbush më kriteret e përcaktuara në pikën 1.

Neni 42
Certifikata e peshës së bananeve dhe analiza e riskut

1. Për qëllime të kontrollit të peshës neto të bananeve të freskëta të importuara në Republikën e Shqipërisë të përfshira në kodin e nomenklaturës së mallrave 0803 90 10, deklarata për hedhjen në qarkullim të lirë shoqërohet nga certifikata e peshës së bananeve duke përcaktuar peshën neto të ngarkesës së bananeve të freskëta në fjalë, sipas llojit të paketimit dhe të origjinës.

Certifikata e peshës së bananeve hartohet nga peshuesi i autorizuar, në përputhje me procedurën e vendosur në aneksin 4 dhe në formën që i korrespondon modelit të përcaktuar në aneksin 5.

Sipas kushteve të përcaktuara nga autoritetet doganore, certifikata të tilla mund të depozitohen pranë autoriteteve doganore në formë elektronike.

2. Peshuesi i autorizuar i jep zyrës doganore kompetente njoftim paraprak për peshimin e ngarkesës së bananeve të freskëta me qëllim hartimin e certifikatës së peshës të bananeve duke i dhënë detaje për llojin e paketimit, origjinën, kohën dhe vendin e peshimit.

3. Zyrat doganore kompetente verifikojnë peshën neto të bananeve të freskëta të përcaktuar në certifikatën e peshës së bananeve mbi bazën e analizës së riskut, duke kontrolluar të paktën 5% të numrit të përgjithshëm të certifikatave të peshës së bananeve të paraqitura çdo vit:

a) ose duke qenë të pranishëm në peshimin nga peshuesit e autorizuar të mostrave përfaqësuese të bananeve;

b) ose duke i peshuar ato vete në përputhje me procedurat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të aneksit 4.

Neni 43
Njoftimi i listës së peshuesve të autorizuar

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i komunikon zyrave doganore listën e peshuesve të autorizuar dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të saj.

KREU 2
DEKLARATAT DOGANORE TË THJESHTUARA, DEKLARATAT PLOTËSUESE

Seksioni 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 44
Të përgjithshme

1. Për qëllime të neneve 152 dhe 153, të Kodit, procedura për deklarime të thjeshtuara (paplota) lejon autoritetet doganore të pranojnë, në raste plotësisht të justifikuara, një deklarim i cili nuk përmban të gjitha hollësirat e kërkuara apo i cili nuk shoqërohet nga të gjitha dokumentet e nevojshme për procedurën doganore në fjalë.

2. Procedura e deklarimit të thjeshtuar mundëson mallrat të hyjnë për procedurën doganore në fjalë me paraqitjen e një deklarimi të thjeshtuar, i cili mund të jetë i një natyre të përgjithshme, periodike apo përmbledhëse sipas rastit.

3. Çdo person mund të aplikojë për një autorizim për deklarimin e thjeshtuar, që t'i jepet atij për përdorim vetjak ose për përdorim si një përfaqësues, me kusht që të ketë historik të dhënash/rekordesh të kënaqshme dhe të ekzistojnë procedurat për të lejuar autoritetin doganor autorizues të identifikojë personat e përfaqësuar dhe të kryejë kontrollet e duhura doganore.

4. Përdorimi i një deklarimi të thjeshtuar kushtëzohet me sigurimin e një garancie për detyrimet e importit dhe pagesat e tjera.

5. Mbajtësi i autorizimit përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë kre dhe detyrimet që përcaktohen nga autorizimi, pa cenuar detyrimet e deklaruesit dhe rregullat mbi lindjen e një borxhi doganor.

6. Mbajtësi i autorizimit informon autoritetin doganor që ka lëshuar autorizimin për të gjithë faktorët e dalë pas dhënies së autorizimit të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

7. Një rivlerësim i një autorizimi për një deklarim të thjeshtuar kryhet nga autoriteti doganor që ka lëshuar autorizimin në rastet e mëposhtme:

a) ndryshime të mëdha në legjislacionin përkatës;

b) tregues të arsyeshëm që kushtet përkatëse nuk përmbushen më nga mbajtësi i autorizimit.

Në rastin e lëshimit të një autorizimi për një deklarim të thjeshtuar për një aplikues të themeluar për më pak se tre vjet, një monitorim i detajuar duhet të kryhet gjatë vitit të parë pas lëshimit të tij.

Neni 45
Sistemet kompjuterike

1. Kur aplikohet një procedurë e thjeshtuar duke përdorur sisteme kompjuterike përpunimi të dhënash për paraqitjen e deklarimeve doganore apo duke përdorur një teknikë përpunimi të dhënash, zbatohen dispozitat e referuara në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të e Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" lidhur me këto teknika apo sisteme.

2. Përdorimi i deklarimit të thjeshtuar kushtëzohet me paraqitjen e deklarimeve dhe njoftimeve doganore elektronike.

3. Megjithatë, në rastet kur sistemet e kompjuterizuara të autoriteteve doganore apo operatorëve ekonomikë nuk funksionojnë për depozitimin apo marrjen e deklarimeve doganore të thjeshtuara duke përdorur një teknikë përpunimi të dhënash, autoritetet doganore mund të pranojnë forma të tjera deklarimesh apo njoftimesh, siç përcaktohet nga këto autoritete, me kusht që të kryhen analiza efektive risku.

Seksioni 2
Dhënia, pezullimi, revokimi i autorizimit për deklarimin e thjeshtuar

Neni 46
Aplikimi

1. Aplikimi për autorizimin e deklarimit të thjeshtuar bëhet duke përdorur modelin e aplikimit të përcaktuar në aneksin 6 ose sipas formatit elektronik korrespondues.

2. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton që aplikimi nuk përmban të gjitha hollësirat e kërkuara, duhet që brenda 30 ditësh pas marrjes së aplikimit, t'i kërkojë aplikuesit informacionin përkatës, duke përcaktuar bazën ligjore për këtë kërkesë.

3. Aplikimi nuk pranohet, kur:

a) ai nuk është në përputhje me pikën 1;

b) ai nuk është paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

c) aplikuesi është dënuar për vepra të rënda penale në lidhje me aktivitetin e tij ekonomik;

ç) aplikuesi po u nënshtrohet procedurave të falimentimit në kohën e paraqitjes së aplikimit.

4. Përpara dhënies së autorizimit për deklarim të thjeshtuar, autoritetet doganore auditojnë rekordet/të dhënat e aplikuesit, përveç rasteve kur mund të përdoren rezultatet e një auditi të mëparshëm.

Neni 47
Dhënia e autorizimit

1. Autorizimi për procedurën e deklarimit të thjeshtuar jepet me kusht që të jenë përmbushur detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në:

a) nenin 17, me përjashtim të shkronjës "c", të pikës 1;

b) në shkronjat "ç", "d" dhe "e", të nenit 18;

c) në nenin 19.

Për dhënien e autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave zbaton pikën 2, të nenit 11, dhe përdor formularin e autorizimit të përcaktuar në aneksin 6.

2. Kur aplikuesit ka një "Certifikatë OEA" të referuar në shkronjën "a" ose "c", të pikës 1, të nenit 11, kushtet dhe kriteret e përmendura në pikën 1, të këtij neni, konsiderohen si të plotësuara.

Neni 48
Pezullimi

1. Një autorizim për deklarim të thjeshtuar pezullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kur:

a) zbulohen mospërputhje me kushtet dhe kriteret e përmendura në pikën 1, të nenit 47;

b) autoriteti doganor ka arsye të mjaftueshme të besojë që një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor është kryer nga mbajtësi i autorizimit apo ndonjë person tjetër i referuar në shkronjat "a", "b" ose "ç", të pikës 1, të nenit 17.

2. Megjithatë, në rastin e përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

mund të vendosë që të mos e pezullojë një autorizim për deklarimin e thjeshtuar nëse konstaton një shkelje me rëndësi të papërfillshme në raport me numrin apo madhësinë e operacioneve dhe nuk krijon dyshime që kanë të bëjnë me mirëbesimin e operatorit ekonomik të autorizuar.

3. Para marrjes së vendimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i komunikon konstatimet e saj operatorit ekonomik. Operatori ekonomik ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe/ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

4. Nëse mbajtësi i autorizimit nuk e rregullon situatën e përmendur në shkronjën "a" të pikës 1, brenda 30 ditësh, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton mbajtësin e autorizimit që autorizimi për deklarimin e thjeshtuar pezullohet për një periudhë kohore prej 30 ditësh për t'i mundësuar mbajtësit të autorizimit të marrë masat e kërkuara për të rregulluar situatën.

5. Në rastet e përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon autorizimin deri në fund të procedimit në gjykatë. Ai njofton mbajtësin e autorizimit për këtë qëllim.

6. Kur mbajtësi i autorizimit nuk është në gjendje të rregullojë situatën brenda 30 ditësh, por mund të japë prova që kushtet mund të përmbushen nëse shtyhet periudha e pezullimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon autorizimin për deklarimin e thjeshtuar për një periudhë tjetër prej 30 ditësh kalendarike.

7. Pezullimi i një autorizimi nuk ndikon në asnjë procedurë tjetër doganore që ka filluar përpara datës së pezullimit, por që akoma nuk ka përfunduar.

Neni 49
Heqja e pezullimit

1. Kur mbajtësi i autorizimit vlerësohet se ka marrë masat e nevojshme për të plotësuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për autorizimin e deklarimit të thjeshtuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave heq pezullimin dhe informon mbajtësin e autorizimit. Pezullimi mund të hiqet përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikat 4 ose 6, të nenit 48.

2. Nëse mbajtësi i autorizimit dështon të marrë masat e nevojshme brenda periudhës kohore të pezullimit të parashikuar në pikën 4 ose 6 të nenit 48, aplikohet neni 51.

Neni 50
Pezullimi me kërkesë

1. Kur mbajtësi i një autorizimi nuk është në gjendje të përmbushë përkohësisht ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara për një autorizim për deklarim të thjeshtuar, ai mund të kërkojë pezullimin e autorizimit. Në raste të tilla, mbajtësi i një autorizimi njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke specifikuar datën kur ai do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet dhe kriteret përsëri. Ai, gjithashtu, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për masat e planifikuara dhe afatet e tyre kohore.

2. Nëse mbajtësi i një autorizimi dështon të rregullojë situatën brenda periudhës kohore të përcaktuar në njoftimin e tij, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave mund të autorizojë një shtyrje të arsyeshme, me kusht që mbajtësi i autorizimit të ketë vepruar me vullnet të mirë.

Neni 51
Revokimi

1. Pa cenuar dispozitat mbi vendimet e favorshme, autorizimi për deklarimin e thjeshtuar revokohet nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave në rastet e mëposhtme:

a) kur mbajtësi i autorizimit dështon të rregullojë situatën e referuar në pikën 4, të nenit 48, dhe në pikën 1, të nenit 50;

b) kur janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura në lidhje me legjislacionin doganor nga mbajtësi i autorizimit ose personat e tjerë të përmendur në shkronjat "a", "b" ose "ç", të nenit 17, dhe kur ka shteruar e drejta e ankimimit;

c) me kërkesë të mbajtësit të autorizimit.

2. Megjithatë, në rastin e përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që të mos e revokojë autorizimin për deklarim të thjeshtuar nëse e konsideron shkeljen si të një rëndësie të papërfillshme në krahasim me numrin apo masën e operacioneve doganore në lidhje me atë shkelje dhe nuk krijon dyshime për sa i përket vullnetit të mirë të mbajtësit të autorizimit.

KREU 3
DEKLARIMI PËR ÇLIRIM PËR QARKULLIM TË LIRË

Seksioni 1
Deklarimi i thjeshtuar

Neni 52
Të dhënat e një deklarate të thjeshtuar

1. Nëse kërkohet nga deklaruesi, autoritetet doganore mund të pranojnë deklarimet për çlirim për qarkullim të lirë të cilat nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e vendosura në aneksin 12, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

2. Megjithatë, këto deklarime duhet të përmbajnë të paktën të dhënat për një deklarim të thjeshtuar (paplotë) të përcaktuara në aneksin 7.

Neni 53
Dokumentet shoqëruese të një deklarimi të thjeshtuar

1. Deklarimet për çlirim për qarkullim të lirë, të cilat mund të pranohen nga autoritetet doganore me kërkesë të deklaruesit të pashoqëruara nga disa prej dokumenteve mbështetëse të nevojshme, shoqërohen të paktën nga ato dokumente mbështetëse të cilat krijohen përpara se mallrat e deklaruara të mund të çlirohen për qarkullim të lirë.

2. Duke anashkaluar përcaktimet e pikës 1, një deklarim i pashoqëruar nga një apo më shumë dokumente të kërkuara përpara se mallrat të mund të çlirohen për qarkullim të lirë, mund të pranohet pasi autoritetet doganore janë të bindur që:

a) dokumentet në fjalë ekzistojnë dhe janë të vlefshme;

b) nuk mund t'i bashkëngjiten deklaratës për arsye që nuk varen/kontrollohen nga deklaruesi;

c) çdo vonesë në pranimin e deklarimit do të pengonte çlirimin e mallrave për qarkullim të lirë ose i bën ato t'i nënshtrohen një niveli tarifor më të lartë detyrimi.

Referencat e dokumenteve që mungojnë, në të gjitha rastet, duhet të tregohen në deklaratë.

Neni 54
Afati kohor

1. Afati kohor i lejuar nga autoritetet doganore që deklaruesi të komunikojë të dhënat apo të paraqesë dokumentet që mungonin në momentin e pranimit të deklaratës nuk mund të kalojë 30 ditë nga data e këtij pranimi.

2. Në rastin kur kërkohet depozitimi i një dokumenti me qëllim zbatimin e një detyrimi importi të reduktuar ose zero, nëse autoritetet doganore janë të bindura që mallrat e mbuluara nga deklarata e thjeshtuar mund të përfitojnë një detyrim importi të reduktuar ose zero dhe kur justifikohet nga rrethanat, atëherë me kërkesë të deklaruesit, mund të autorizohet një afat kohor më i gjatë se ai i parashikuar në pikën 1. Ky afat nuk mund të kalojë 120 ditë nga data e pranimit të deklaratës.

3. Kur të dhënat e munguara ose dokumentet plotësuese për t'u depozituar kanë lidhje me vlerën doganore dhe kur kjo është absolutisht e nevojshme, autoritetet doganore mund të shtyjnë afatin kohor të vendosur më parë, por afati kohor në total nuk duhet të kalojë afatin e përcaktuar në pikën 1.

4. Kur zbatohet një detyrim importi i reduktuar ose zero për mallrat e çliruara për qarkullim të lirë brenda kuotave tarifore ose me kusht që vjelja ose aplikimi i detyrimeve normale të importit nuk është rifutur/rifilluar, brenda tavanëve tariforë apo masave të tjera tarifore preferenciale, përfitimi nga kuota tarifore apo masat preferenciale tarifore jepet vetëm pas depozitimit tek autoritetet doganore të dokumentit mbi të cilin mbështetet dhënia e detyrimit të importit të reduktuar ose zero.

Dokumenti duhet të paraqitet në çdo rast përpara shterimit të kuotës tarifore ose në raste të tjera, përpara datës në të cilën rifutet mbledhja e detyrimeve normale të importit.

5. Për qëllime të zbatimit të pikave 1 deri në 4, dokumenti mbi të cilin mbështetet dhënia e një detyrimi importi më të reduktuar ose zero mund të prodhohet pas përfundimit të afatit kohor për të cilin ishte vendosur një detyrim importi i reduktuar ose zero, me kusht që deklarata që i përket mallrave në fjalë të ishte pranuar përpara asaj date.

Neni 55
Çlirimi i mallrave dhe kontabilizimi

1. Pranimi i një deklarate të thjeshtuar nga autoritetet doganore nuk duhet të pengojë apo të vonojë çlirimin e mallrave të deklaruara, përveçse kur ekzistojnë arsye të tjera për ta bërë këtë.

Pa cenuar dispozitat e nenit 92, të këtij vendimi, çlirimi kryhet në përputhje me kushtet e vendosura në pikat 2 deri 5, të këtij neni.

2. Kur paraqitja me vonesë e të dhënave ose e një dokumenti shoqërues që mungonin në momentin e pranimit të deklaratës nuk ndikon në shumën e detyrimeve për t'u paguar që mbulohet nga kjo deklaratë, autoritetet doganore kontabilizojnë menjëherë shumën për t'u paguar.

3. Kur, sipas nenit 52, një deklaratë përmban të dhëna provizore lidhur me vlerën, autoritetet doganore duhet:

a) të kontabilizojnë menjëherë shumën e detyrimeve të përcaktuara duke u mbështetur në këto të dhëna;

b) të kërkojnë, nëse është e nevojshme, depozitimin e një garancie të mjaftueshme për të mbuluar diferencën midis shumës të përllogaritur sipas shkronjës "a" dhe shumës së detyrimit që mund të paguhet në fund për mallrat.

4. Kur, në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 3, paraqitja me vonesë e të dhënave apo të një dokumenti shoqërues që mungon në momentin e pranimit të deklaratës, mund të ndikojë në shumën e detyrimeve për t'u paguar të mallrave të mbuluara nga ky deklarim:

a) nëse paraqitja me vonesë e ndonjë prej të dhënave apo dokumenteve që mungojnë mund të çojë në zbatimin e detyrimit të reduktuar, autoritetet doganore duhet:

i) të kontabilizojnë menjëherë detyrimet e importit për t'u paguar me normën e reduktuar;

ii) të kërkojnë depozitimin e një garancie që mbulon diferencën midis shumës së përllogaritur sipas nënndarjes "i" dhe shumës e cila duhej të paguhej nëse detyrimet e importit për mallrat në fjalë do të përllogariteshin sipas nivelit të detyrimeve doganore bazuar në tarifën bazë;

b) nëse paraqitja me vonesë e ndonjë prej të dhënave apo dokumenteve që mungojnë mund të çojë në pranimin e mallrave me përjashtim të plotë nga detyrimet, autoritetet doganore kërkojnë depozitimin e një garancie që mbulon shumën e cila duhej të paguhej nëse detyrimet do të përllogariteshin sipas nivelit të detyrimeve doganore sipas tarifës bazë.

5. Pa cenuar ndonjë ndryshim që mund të ndodhë, në mënyrë të veçantë si rezultat i përcaktimit përfundimtar të vlerës doganore, deklaruesi ka mundësinë që, në vend që të depozitojë një garanci, të kërkojë kryerjen e pagesës së menjëhershme:

a) kur zbatohet shkronja "b", e pikës 3, ose nënndarja "ii", e shkronjës "a", të pikës 4, për shumën e detyrimit që duhet të paguhet përfundimisht për mallrat;

b) kur zbatohet shkronja "b", e pikës 4, shumën e detyrimit të përllogaritur sipas nivelit të detyrimeve doganore sipas tarifës bazë.

Neni 56
Përfundimi i afatit

Nëse, me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 54, deklaruesi nuk ka dhënë të dhënat e nevojshme për përcaktimin përfundimtar të vlerës doganore të mallrave ose nuk ka arritur të paraqesë informacionin ose dokumentet që mungojnë, autoritetet doganore menjëherë mbajnë/prekin garancinë e dhënë në përputhje me dispozitat e shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 55, nënndarja "ii", e shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 55, ose shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 55.

Neni 57
Plotësimi ose zëvendësimi i deklaratës së thjeshtuar

1. Një deklarim i thjeshtuar/i paplotë i pranuar sipas kushteve të përcaktuara në nenet 52 deri 55 mund të plotësohet nga deklaruesi ose me miratimin e autoriteteve doganore, të zëvendësohet me një deklaratë tjetër e cila përmbush kushtet e parashtruara në nenin 87, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

2. Në të dyja rastet, data për përcaktimin e çdo detyrimi dhe zbatimin e dispozitave të tjera që rregullojnë çlirimin e mallrave për qarkullim të lirë do të jetë data e pranimit të deklarimit të thjeshtuar.

Seksioni 2
Procedura e deklarimit të thjeshtuar

Neni 58
Të përgjithshme

1. Një aplikant, në bazë të një kërkese me shkrim që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, autorizohet në përputhje me kushtet dhe mënyrën e përcaktuar në nenet 59 dhe 60 të bëjë deklarimin për çlirimin për qarkullim të lirë me një formular të thjeshtuar kur mallrat janë paraqitur në doganë.

2. Një deklaratë e tillë e thjeshtuar duhet të përmbajë të paktën të dhënat për një deklarim të thjeshtuar importi të përcaktuar në aneksin 7.

3. Kur rrethanat e lejojnë, autoritetet doganore mund të lejojnë që kërkesa për çlirim për qarkullim të lirë referuar në pikën 1 të zëvendësohet nga një kërkesë e përgjithshme lidhur me operacionet e çlirimit për t'u kryer në një periudhë të dhënë kohe. Një referencë për autorizimin e dhënë në bazë të një kërkese të tillë të përgjithshme duhet të bëhet në dokumentin administrativ ose tregtar të paraqitur në pikën 1.

4. Deklarata e thjeshtuar shoqërohet nga të gjitha dokumentet, paraqitja e të cilave kërkohet për të garantuar çlirimin e mallrave për qarkullim të lirë. Në këto raste, zbatohet pika 2, e nenit 53.

5. Zbatimi i këtij neni nuk duhet të cenojë zbatimin e nenit 67.

Neni 59
Dhënia e autorizimit

1. Autorizimi për përdorimin e procedurës së deklarimit të thjeshtuar i jepet aplikuesit nëse kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 44 deri 47 janë përmbushur.

2. Kur aplikuesi është mbajtës i një "Certifikate OEA" referuar në shkronjën "a" ose "c", të pikës 1, të nenit 11, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave jep autorizimin pasi të jetë realizuar shkëmbimi i nevojshëm i informacionit midis aplikuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Të gjitha kushtet dhe kriteret referuar në pikën 1, të këtij neni, do të konsiderohen të përmbushura.

Neni 60
Të dhënat e autorizimit

1. Autorizimi i referuar në nenin 58 përmban të dhënat e mëposhtme për:

a) zyrën/zyrat doganore kompetente për pranimin e deklaratës së thjeshtuar;

b) mallrat për të cilat zbatohet;

c) një referencë të garancisë që jepet nga aplikuesi për të mbuluar çdo borxh doganor që mund të lindë.

2. Autorizimi duhet të specifikojë gjithashtu edhe formën dhe përmbajtjen e deklarimeve plotësuese dhe të caktojë afatet kohore brenda të cilave ato duhet të depozitohen te zyra doganore kompetente për këtë qëllim.

KREU 4
DEKLARIMET PËR REGJIMET DOGANORE EKONOMIKE

Seksioni 1
Deklarimet e thjeshtuara për hyrjen nën regjimin e magazinimit doganor

Neni 61
Deklarimi i thjeshtuar

1. Me kërkesë të deklaruesit, zyra doganore e hyrjes mund të pranojë një deklarim për hyrjen në regjimin e magazinimit doganor i cili nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara në aneksin 12 të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

Megjithatë, ky deklarim duhet të përmbajë të paktën të dhënat e deklaratës së thjeshtuar sipas aneksit 7.

2. Nenet 53, 54 dhe 57 zbatohen në mënyrë analoge edhe në deklarimin e thjeshtuar për hyrjen nën regjimin e magazinimit doganor.

Neni 62
Procedura e deklarimit të thjeshtuar

1. Autorizimi për procedurën e deklarimit të thjeshtuar i jepet aplikuesit nëse kushtet dhe kriteret e referuar në nenet 44 deri 47 dhe 63 janë përmbushur.

2. Kur kjo procedurë zbatohet në një magazinë të tipit D, deklarimi i thjeshtuar duhet të përfshijë gjithashtu natyrën e mallrave në fjalë, me detaje të mjaftueshme që mundësojnë klasifikimin tarifor dhe vlerën e tyre doganore qartazi dhe në mënyrë të menjëhershme.

3. Procedura e përcaktuar në pikën 1 nuk zbatohet për magazinat e tipit F.

Neni 63
Aplikimi dhe të dhënat e nevojshme për dhënien e autorizimit

1. Aplikimi i referuar në pikën 1, të nenit 62, bëhet me shkrim dhe përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për dhënien e autorizimit.

2. Kur rrethanat e lejojnë, aplikimi i referuar në pikën 1, të nenit 62, mund të zëvendësohet nga një aplikim i përgjithshëm që i korrespondon operacioneve që kryhen në një periudhë të dhënë.

Në këtë rast, aplikimi bëhet dhe dorëzohet me kërkesën për të operuar magazinën doganore ose si ndryshim/modifikim i autorizimit fillestar, tek autoriteti doganor që ka lëshuar autorizimin për regjimin në fjalë.

3. Kur aplikuesi është mbajtës i një "Certifikate OEA" referuar në shkronjat "a" ose "c", të pikës 1, të nenit 11, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, jep autorizimin pasi të jetë realizuar shkëmbimi i nevojshëm i informacionit midis aplikuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Të gjitha kushtet dhe kriteret e referuara në pikën 1, të këtij neni, do të konsiderohen të përmbushura.

Neni 64
Përmbajtja e autorizimit

1. Autorizimi i referuar në pikën 1, të nenit 62, përcakton rregullat specifike për regjimin, duke përfshirë zyrën/zyrat doganore të hyrjes nën regjim.

2. Nuk është e nevojshme dhënia e një deklarate plotësuese.

Seksioni 2
Deklarimet e thjeshtuara për hyrjen nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e lejimit të përkohshëm

Neni 65
Deklarimi i thjeshtuar

1. Me kërkesë të deklaruesit, zyra doganore e hyrjes mund të pranojë deklarime për vendosjen e mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e lejimit të përkohshëm, të cilat nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e përcaktuara në aneksin 12, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, ose që nuk janë të shoqëruara nga dokumentet e referuara në nenet 142 deri 146 të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

Megjithatë, këto deklarime do të përmbajnë të paktën të dhënat e një deklarimi të thjeshtuar, siç përcaktohet në aneksin 7.

2. Nenet 53, 54 dhe 57 zbatohen në mënyrë analoge edhe në deklarimin e thjeshtuar për hyrjen nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

3. Në rastet e hyrjes nën regjim të përpunimit aktiv, sistemi me rimbursim, zbatohen në mënyrë analoge nenet 55 dhe 56.

Seksioni 3
Mallrat e deklaruara për procedurën e përpunimit pasiv

Neni 66
Mallrat nën regjimin e përpunimit pasiv

Nenet 68 deri 71, që zbatohen për mallrat e deklaruara për eksport, zbatohen në mënyrë analoge për mallrat nën regjimin e përpunimit pasiv të deklaruara për eksport.

Seksioni 4
Mbyllja e një regjimi doganor ekonomik

Neni 67
Mbyllja e regjimit

1. Në rastet e mbylljes së një regjimi doganor ekonomik të ndryshëm nga përpunimi pasiv dhe magazinimi doganor mund të zbatohen procedurat e thjeshtuara për çlirim për qarkullim të lirë, eksport dhe rieksport. Në rastin e rieksportit zbatohen dispozitat e neneve 68 deri 71.

2. Procedurat e thjeshtuara referuar në nenet 52 deri 60 mund të zbatohen për të çliruar për qarkullim të lirë mallrat e ndodhura nën regjimin e përpunimit pasiv.

3. Në rastet e mbylljes së regjimit të magazinimit doganor mund të zbatohen procedurat e thjeshtuara për çlirimin për qarkullim të lirë, eksport ose rieksport.

Megjithatë:

a) për mallrat e futura nën regjimin e magazinës të tipit F nuk mund të autorizohet asnjë procedurë e thjeshtuar;

b) për mallrat e futura nën regjimin e magazinës të tipit B do të zbatohet vetëm deklarimi i thjeshtuar dhe procedura e deklarimit të thjeshtuar;

c) lëshimi i një autorizimi për një magazinë të tipit D nënkupton zbatimin automatik të procedurës së zhdoganimit për çlirimin për qarkullim të lirë.

Megjithatë, në rastet kur personi në fjalë dëshiron të përfitojë nga zbatimi i elementeve të taksimit, të cilat nuk mund të kontrollohen pa një shqyrtim fizik të mallrave, kjo procedurë nuk mund të zbatohet.

KREU 5
DEKLARIMET E EKSPORTIT

Neni 68
Formalitetet e eksportit

Formalitetet e eksportit të përcaktuara në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, mund të thjeshtohen në përputhje me këtë kre.

Seksioni 1
Deklarimet e thjeshtuara

Neni 69
Të dhënat e deklaratës së thjeshtuar për eksport

1. Me kërkesë të deklaruesit, zyra doganore e eksportit mund të pranojë deklarata eksporti të cilat nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e përcaktuara në aneksin 12 të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

Megjithatë, këto deklarata duhet të përmbajnë të paktën të dhënat e përcaktuara në aneksin 7 për deklarimet e paplota.

Kur mallrat janë objekt i detyrimeve të eksportit ose të ndonjë mase tjetër të parashikuar, deklaratat e eksportit duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar për zbatimin e detyrimeve ose masave të tilla.

2. Nenet 53 deri 57 zbatohen në mënyrë analoge edhe për deklarimet e eksportit.

Neni 70
Depozitimi i deklarimit plotësues

Deklarata plotësuese depozitohet pranë zyrës doganore të eksportit.

Seksioni 2
Procedura e deklarimit të thjeshtuar

Neni 71
Autorizimi

1. Autorizimi për të përdorur procedurën e deklarimit të thjeshtuar do të jepet në përputhje me kushtet dhe mënyrën e përcaktuar në nenet 44 deri 47, pikën 2, të nenit 59, dhe në mënyrë analoge, zbatohet edhe neni 60.

2. Deklarimi i thjeshtuar duhet të përmbajë të paktën të dhënat e përcaktuara për një deklarim të thjeshtuar në aneksin 7.

3. Nenet 53 deri 57 zbatohen në mënyrë analoge.

TITULLI V
THJESHTËSIME TË TJERA

KREU 1
MALLRA QË KLASIFIKOHEN NË NËNKRERË TË NDRYSHËM TARIFORË TË DEKLARUARA NË NJË NËNKRE, ZHDOGANIMI I CENTRALIZUAR, HYRJA NË REGJISTRIMET E DEKLARUESIT, VETËVLERËSIMI

Seksioni 1
Mallra që klasifikohen në nënkrerë të ndryshëm tariforë

Neni 72
Mallra që klasifikohen në nënkrerë të ndryshëm tariforë të deklaruara në një nënkre

Për qëllim të pikës "1", të nenit 161, të Kodit, kur një ngarkesë përbëhet nga mallra që u përkasin nënkrerëve të ndryshëm tariforë që u nënshtrohen detyrimeve *ad-valorem* dhe specifike ose vetëm detyrimeve specifike, zbatohen të mëposhtmet:

a) Kur të gjitha detyrimet specifike janë të lidhura vetëm me një njësi të masës, deklaruesi duhet të zbatojë detyrimin specifik më të lartë të të gjitha mallrave të ngarkesës që u nënshtrohet detyrimeve specifike. Detyrimi specifik më i lartë i përcaktuar në këtë mënyrë do të konsiderohet shkalla më e lartë e detyrimeve të importit ose të eksportit.

Në rastet kur ka mallra në ngarkesë që u nënshtrohen detyrimeve *ad-valorem*, detyrimi më i lartë specifik do të kthehet në një detyrim *ad-valorem* për çdo mall që i nënshtrohet këtij detyrimi në mënyrë që të përcaktojnë shkallën më të lartë të detyrimeve të importit ose të eksportit. Shkalla më e lartë e detyrimit të përcaktuar kështu do të zbatohet për vlerën e të gjithë ngarkesës.

b) Kur detyrimet specifike janë të lidhura me njësi të ndryshme të masës, deklaruesi duhet të zbatojë detyrimin më të lartë specifik për çdo njësi të masës për të gjitha mallrat në ngarkesë matur në atë njësi dhe që i nënshtrohet detyrimeve specifike. Këto detyrime specifike më të larta konvertohen në detyrime ad-valorem për secilin lloj malli në mënyrë që të përcaktojnë shkallën më të lartë të detyrimeve të importit ose të eksportit. Shkalla më e lartë e detyrimeve e përcaktuar në këtë mënyrë më pas do të zbatohet për vlerën e të gjithë ngarkesës.

Seksioni 2
Zhdoganimi i centralizuar

Neni 73
Kërkesa për autorizim për zhdoganim të centralizuar

1. Për qëllime të nenit 163 të Kodit, kërkesa për dhënien e një autorizimi për zhdoganim të centralizuar mund të bëhet njëkohësisht me aplikimin për një operator ekonomik të autorizuar për thjeshtësime doganore ose një operator ekonomik i autorizuar i plotë. Kjo kërkesë gjithashtu mund të bëhet edhe pas marrjes së autorizimit nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur.

2. Kërkesa depozitohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Mbajtësi i autorizimit duhet të plotësojë kushtet, kriteret dhe detyrimet që rezultojnë nga autorizimi, pa cenuar detyrimet e deklaruesit dhe rregullat që parashikojnë moskrijimin e një borxhi doganor.

Neni 74
Procedurat për të cilat zhdoganimi i centralizuar mund të autorizohet

Zhdoganimi i centralizuar mund të autorizohet për:

a) çlirim për qarkullim të lirë;

b) përdorim të veçantë përfundimtar të mallrave (*end-use*);

c) eksport;

ç) rieksport, në rastet kur janë të zbatueshme dispozitat në lidhje me depozitimin e deklarimit doganor;

d) përpunimipasiv;

dh) përpunim aktiv;

e) magazinim doganor;

ë) lejim të përkohshëm.

Neni 75
Konsultimi/këshillimi

Procedura e konsultimit/këshillimit e parashikuar në nenin 23 mund të zbatohet edhe për autorizimet për zhdoganimin e centralizuar të përcaktuar në nenin 163, të Kodit.

Neni 76
Monitorimi

Institucionet, të cilave Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u është drejtuar për konsultim/këshillim, duhet pa vonesë të informojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo rrethanë që lind pasi autorizimi është dhënë dhe që mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

Neni 77
Shkëmbimi i informacionit

1. Përveç rasteve kur zbatohet paragrafi i dytë, i pikës 3, të nenit 165, të Kodit, deklaruesi duhet të njoftojë zyrën mbikëqyrëse doganore që mallrat janë paraqitur në zyrën doganore të paraqitjes përmes një nga të mëposhtmet:

a) një deklarate standarde doganore;

b) një deklarate të thjeshtuar doganore.

2. Kur zyra doganore mbikëqyrëse e ka pranuar deklaratën doganore, ajo i transmeton zyrës doganore ku janë paraqitur mallrat të dhënat e deklaratës doganore standarde ose të deklaratës së thjeshtuar doganore dhe e informon atë zyrë doganore:

a) se mallrat mund të çlirohen për procedurën përkatëse;

b) për çdo kontroll të kërkuar në përputhje me shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 163, të Kodit.

3. Në rast se zyra doganore mbikëqyrëse kërkon një kontroll ose kur zyra doganore ku janë paraqitur mallrat vendos në përputhje me pikën 5, të nenit 163, të Kodit, të kryejë kontrollet e saj për qëllime sigurie dhe mbrojtjeje, zyra doganore e paraqitjes informon zyrën doganore mbikëqyrëse për rezultatet e kontrollit. Bazuar në këto rezultate, zyra doganore mbikëqyrëse ose lejon çlirimin e mallrave ose kërkon që të merren masa. Kur kërkohet një kontroll, zyra doganore që vendos për një kontroll të tillë informon deklaruesin.

4. Kur çlirimi është dhënë, zyra doganore mbikëqyrëse informon deklaruesin.

5. Në eksport, zyra doganore e daljes i siguron provën e daljes zyrës doganore mbikëqyrëse. Zyra doganore mbikëqyrëse i siguron provën e daljes deklaruesit.

Seksioni 3
Hyrja në regjistrimet e deklaruesit

Neni 78
Kushtet për dhënien e autorizimit

1. Pa cenuar kushtet specifike që lidhen me autorizimet për një procedurë të posaçme, një autorizim për të paraqitur një deklaratë doganore në formën e një hyrjeje në të dhënat e deklaruesit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 165, të Kodit, jepet kur aplikuesi tregon se i plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 41, të Kodit.

2. Dokumentet mbështetëse i jepen autoriteteve doganore kur legjislacioni doganor e kërkon një gjë të tillë.

Neni 79
Fusha e zbatimit

1. Hyrja në të dhënat e deklaruesit mund të autorizohet për ndonjë nga regjimet e mëposhtme doganore:

a) Çlirimin për qarkullim të lirë; megjithatë, autorizimi nuk mund të përdoret për çlirimin në të njëjtën kohë për qarkullim të lirë dhe për përdorim vetjak të mallrave që janë objekt i një furnizimi me TVSH të përjashtuar, në përputhje me ligjin nr. 128/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", dhe kur është e zbatueshme, një pezullim akcize në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Magazinimin doganor;

c) Lejimin e përkohshëm dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use*);

ç) Përpunimin aktiv dhe pasiv; megjithatë, autorizimi nuk mund të përdoren për riimport me çlirim në të njëjtën kohë për qarkullim të lirë dhe për përdorim vetjak të mallrave që janë objekt i një furnizimi të përjashtuar të TVSH-së në përputhje me ligjin nr. 128/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", dhe kur është e zbatueshme, një pezullim akcize në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

d) Eksportit.

2. Kur deklarata doganore merr formën e një hyrjeje në të dhënat të deklaruesit, zyrat doganore kompetente nuk do të heqin dorë nga kërkesa për depozitimin e një deklarate përmbledhëse.

Neni 80
Plani i kontrollit

Autoritetet doganore miratojnë një plan kontrolli për mbikëqyrjen e procedurës doganore të kryer në bazë të një autorizimi të parashikuar në pikën 1, të nenit 165, të Kodit.

Neni 81
Detyrimet e mbajtësit të autorizimit

1. Mbajtësi i autorizimit duhet:

a) të regjistrojë së paku të dhënat e një deklarimi të thjeshtuar doganor dhe çdo dokument mbështetës në regjistrimet elektronike;

b) kur i kërkohet, të paraqesë mallrat në doganë dhe të regjistrojë vendin dhe datën e këtij njoftimi në regjistrimet elektronike;

c) me kërkesë të zyrës doganore mbikëqyrëse, të vërë në dispozicion të kësaj zyre të dhënat e një deklarate të thjeshtuar apo të plotë doganore të regjistruar në regjistrimet elektronike apo çdo dokument mbështetës;

ç) të vërë në dispozicion të zyrës mbikëqyrëse informacionin për mallrat që i nënshtrohen kufizimeve dhe ndalimeve;

d) nëse zbatohet heqja dorë nga detyrimi për të paraqitur mallrat, parashikuar në pikën 3, të nenit 165, të Kodit, t'i sigurojë zyrës doganore të paraqitjes informacionin e nevojshëm që të mbyllë procedurën e mëparshme doganore dhe/ose të përfundojë magazinimin e përkohshëm;

dh) të paraqesë një deklaratë plotësuese, në mënyrë periodike, në zyrën doganore mbikëqyrëse brenda afatit kohor të përcaktuar në autorizim.

Neni 82
Çlirimi i mallrave

1. Zyra doganore mbikëqyrëse njofton mbajtësin e autorizimit për çlirimin e mallrave.

2. Kur autorizimi përcakton një afat kohor për kontroll, mallrat do të konsiderohet se janë çliruar për regjimin përkatës, në përfundim të këtij afati kohor, përveç rasteve kur zyra doganore mbikëqyrëse ka njoftuar gjatë kësaj kohe të kufizuar qëllimin e saj për të kryer një kontroll.

Neni 83
Kuotat tarifore

Kur mallrat, që i nënshtrohen një kuote tarifore sipas parimit "i shërbehet të parit që vjen" (*first-come, first-served*), janë regjistruar në regjistrin elektronik, mbajtësi i autorizimit mund të kërkojë zbatimin e masës së tillë, sipas marrëveshjes me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ose me anë të një njoftimi të veçantë apo me deklaratën doganore periodike.

Neni 84
Hyrja në të dhënat e deklaruesit për regjimin e eksportit

1. Autorizimi për të hyrë në të dhënat/regjistrimet e deklaruesit mund të lejojë një operator ekonomik që të regjistrojë në regjistrat e tij menjëherë çdo operacion eksporti dhe të raportojë në zyrën doganore mbikëqyrëse hollësitë e një deklarate plotësuese periodike.

2. Regjistrimi i mallrave në regjistrat elektronikë të deklaruesit do të konsiderohet si çlirim i mallrave për eksport.

3. Pika 1 aplikohet në rastet e mëposhtme:

a) kur mallrat nuk i nënshtrohen afateve të paranisjes dhe dispozitave të veçanta të një deklarate përmbledhëse të daljes;

b) kur deklarata përmbledhëse e daljes depozitohet në zyrën doganore të daljes;

c) kur zyra doganore e eksportit është e ndryshme nga zyra doganore e daljes,

autoritetet doganore kompetente miratojnë përdorimin e një autorizimi të tillë.

Seksioni 4
Vetëvlerësimi

Neni 85
Kushtet për dhënien e autorizimit

Pa cenuar kushtet e veçanta që lidhen me autorizimet për një regjim transiti, magazinimi doganor dhe zonat e lira, përdorimin e veçantë përfundimtar, regjimin e lejimit të përkohshëm, përpunimin aktiv dhe pasiv, një autorizim për vetëvlerësim i parashikuar në pikën 1, të nenit 167 të Kodit, jepet kur aplikuesi plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Aplikuesi ka marrë masa që lejojnë një identifikim të qartë të partnerëve të tij të biznesit dhe që kontribuojnë në sigurinë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve përkatëse kontraktuale ose masave të tjera të përshtatshme, në përputhje me modelin e biznesit të aplikantit;

b) Aplikuesi ka një sistem të brendshëm ekzistues dhe funksional të kontrollit i cili përfshin kontrollet e brendshme, analiza të riskut të lidhura me pajtueshmërinë doganore dhe monitorimin e sistemit të mjedisit të kontrollit të cilat mbështetin/ndihmojnë funksionimin e sistemit, duke sjellë si rezultat siguri nga rreziqet e lidhura me pajtueshmërinë doganore.

Neni 86
Vetëvlerësimi për procedurat doganore

1. Vetëvlerësimi mund të autorizohet për ndonjë nga regjimet doganore të mëposhtme:

a) çlirimin për qarkullim të lirë; megjithatë, autorizimi nuk mund të përdoret për procedurat e mëposhtme:

i) çlirimin në të njëjtën kohë për qarkullim të lirë dhe për përdorim vetjak të mallrave që janë objekt i një furnizimi me TVSH- të përjashtuar, në përputhje me ligjin nr. 128/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", dhe, kur është e zbatueshme, një pezullim akcize në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

ii) kur kërkohet përfitimi i një kontingjenti tarifor;

b) magazinimin doganor;

c) lejimin e përkohshëm;

ç) përdorimin e veçantë përfundimtar (*end-use*);

d) përpunimin aktiv dhe pasiv; megjithatë, autorizimi nuk mund të përdoren për riimport me çlirim në të njëjtën kohë për qarkullim të lirë dhe për përdorim vetjak të mallrave që janë objekt i një furnizimi të përjashtuar të TVSH-së në përputhje me ligjin nr. 128/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", dhe, kur është e zbatueshme, një pezullim akcize në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

dh) eksportin.

Neni 87
Vetëvlerësimi për formalitetet doganore apo kontrolli

1. Vetëvlerësimi mund të autorizohet për të kryer ndonjë nga formalitetet apo kontrollet e mëposhtme doganore:

a) njoftimin e borxhit doganor, sipas legjislacionit në fuqi;

b) për mallrat e deklaruara për eksport apo rieksport, kryerjen e disa funksioneve për të cilat janë kompetente zyrat e daljes, duke përfshirë edhe konfirmimin e daljes së mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

c) kontrollin e pajtueshmërisë me ndalimet dhe kufizimet, siç përcaktohet në autorizim me kusht që rregullat mbi këto ndalime ose kufizime parashikojnë transferimin e këtyre kontrolleve tek operatorët ekonomikë;

ç) sigurimin e informacionit statistikor autoriteteve kompetente.

2. Një operator ekonomik, i cili merr kontrollin e mallrave nën një kontratë të vetme transporti, për transportin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, mund të autorizohet në bazë të shkronjës "b", të pikës 1, për të kryer ndonjë nga rolet e mëposhtme dhe kompetencat e zyrave doganore të daljes të specifikuara në aplikim:

a) Të informojë zyrën doganore të eksportit për mbërritjen e mallrave në zyrën doganore të daljes me anë të njoftimit të zyrës doganore të eksportit për mallrat që merr nën kontrollin e tij në bazë të autorizimit;

b) Të pranojë paraqitjen e mallrave në zyrën e daljes;

c) Të identifikojë mallrat që u nënshtrohen kontrolleve, sipas kërkesave të autoriteteve doganore në vendin e daljes;

ç) Të ndjekë çlirimin në dalje;

d) Të bëjë regjistrimin e certifikimit të daljes në regjistrat e tij.

3. Kur operatori ekonomik është i autorizuar për të identifikuar mallrat, sipas shkronjës "c", të pikës 2, ai duhet t'u paraqesë mallrat autoriteteve doganore në vendin e daljes me qëllim të këtyre kontrolleve.

Neni 88
Plani i kontrollit

Autoritetet doganore do të miratojnë një plan kontrolli për mbikëqyrjen e regjimeve doganore, formalitetet dhe kontrollet e kryera sipas një autorizimi të parashikuar në pikën 1, të nenit 167, të Kodit, për të siguruar përputhshmërinë e mbajtësit të autorizimit me detyrimet e tij.

Neni 89
Borxhi doganor dhe pagesa të tjera

1. Në fund të një periudhe që nuk i kalon 31 ditë, mbajtësi i autorizimit do të përcaktojë shumën e detyrimeve dhe pagesave të tjera që duhen paguar për atë periudhë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në autorizim.

2. Brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës përmbledhëse, mbajtësi i autorizimit i paraqet zyrës doganore mbikëqyrëse shumën e përcaktuar në përputhje me pikën 1.

Borxhi doganor konsiderohet se është njoftuar në kohën e kësaj paraqitjeje.

3. Mbajtësi i autorizimit paguan shumën e përmendur në pikën 2, brenda afateve të parashikuara.

Neni 90
Statistikat

Mbajtësi i autorizimit duhet të sigurojë në kohë të dhënat statistikore për autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 91
Kontrolli i daljes nën vetëvlerësim

1. Operatori ekonomik i autorizuar për të kryer formalitetet ose kontrollet për të cilat janë kompetente zyrat doganore të daljes, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 87, njofton autoritetet doganore të eksportit, siç është specifikuar në autorizimin lidhur me:

a) datën e daljes aktuale të mallrave;

b) të gjitha ngarkesat që nuk janë larguar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë brenda 14 ditëve pasi janë marrë nën kontrollin e mbajtësit të autorizimit.

2. Operatori ekonomik i autorizuar duhet:

a) të identifikojë menjëherë mallrat e marra nën kontrollin e mbajtësit të autorizimit, të cilat mbulohen nga këto dispozita;

b) të njoftojë zyrën doganore në vendin e daljes së mallrave që mbërritën atje dhe që janë të mbuluara nga autorizimi;

c) të regjistrojë (elektronikisht) detajet përkatëse të deklaratës së eksportit ose rieksportit në lidhje me mallrat;

ç) të sigurojë që të gjitha mallrat që janë identifikuar se kërkojnë kontroll nuk mund të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa lejen e autoriteteve doganore.

TITULLI VI
VERIFIKIMI, KONTROLLI DHE ANALIZIMI I MALLRAVE

Seksion 1
Të përgjithshme

Neni 92
Verifikimi i deklaratave, dokumenteve, mallrave dhe marrja e mostrave

Për qëllime të nenit 169, të Kodit, verifikimi i deklaratave, dokumenteve, mallrave dhe marrja e mostrave do të kryhen në përputhje me dispozitat respektive të vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 93
Çlirimi i mallrave objekt i një kërkese për të përfituar nga një kontingjent tarifor

Për qëllime të pikës 2, të nenit 176, të Kodit, autoritetet doganore mund të mos kërkojnë dhënien e një garancie për mallrat të cilat janë objekt i një kërkese për të përfituar nga një kontingjent tarifor, nëse ato përcaktojnë përpara çlirimit të mallrave, që kuota tarifore nuk është në një pikë kritike.

TITULLI VII
OPERACIONET E PRIVILEGJUARA

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Seksioni 1
Të përgjithshme

Neni 94
Fusha e zbatimit

Mbështetur në nenet 184 dhe 188, të Kodit, ky titull përcakton rregullat procedurale dhe rastet në të cilat, për shkak të rrethanave të veçanta, jepet përjashtimi nga detyrimet e importit kur mallrat çlirohen për qarkullim të lirë.

Neni 95
Përkufizime

Për qëllim të këtij titulli, me termat e mëposhtme nënkuptohen:

a) "Detyrim importi", detyrimi doganor që bazohet në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë;

b) "Sende vetjake", çdo pronë e destinuar për përdorim personal nga personat përkatës apo për plotësimin e nevojave të tyre shtëpiake.

Në veçanti, "Sende vetjake" përbëjnë:

i) sendet shtëpiake;

ii) biçikletat, motomjetet dhe ciklomotorët, automjetet private dhe rimorkiot, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private.

Sende shtëpiake përbëjnë gjithashtu dhe sendet e nevojshme shtëpiake, të cilat plotësojnë nevojat normale familjare, kafshët shtëpiake, manarët dhe kafshët me samar, si dhe instrumentet e mbartshme të arteve të aplikuara, të cilat janë të nevojshme për të ushtruar profesionin apo zanatin e personit përkatës. Prona personale duhet të jetë e tillë që për nga natyra dhe sasia të tregojë se nuk importohet për qëllime tregtare.

c) "Sende shtëpiake", sendet personale, shtresa dhe mbulesa për përdorim shtëpiak, mobilie dhe pajisje për qëllime të përdorimit personal të të interesuarit ose për të plotësuar nevojat e tij shtëpiake;

ç) "Produkte alkoolike", produktet (birrë, verë, aperitivë me përmbajtje vere ose alkooli, konjak ose brendi, liker ose pije të tjera alkoolike etj.), që përfshihen në krerët nga 2203 deri 2208 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

KREU 2
PËRJASHTIMI NGA DETYRIMET E IMPORTIT

Seksioni 1
Sendet vetjake që u përkasin individëve, që ndryshojnë vendqëndrimin (vendbanimin) nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë

Neni 96
Sendet vetjake

1. Në përputhje me nenet 97 deri 104, sendet vetjake që importohet nga individë që ndryshojnë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Në këto raste, do të përdoret formulari i sigurimit të përjashtimit nga detyrimet e importit i përcaktuar në aneksin 8.

Neni 97
Kufizimi në sende vetjake

1. Përjashtimi kufizohet në sende vetjake të cilat:

a) kanë qenë në posedim nga individi i interesuar dhe në rastet e mallrave jo të konsumueshme të jenë përdorur nga individi i interesuar në vendin e mëparshëm të qëndrimit, për të paktën 6 muaj përpara datës në të cilën ai pushon së qeni banor i vendit prej nga është nisur, me përjashtim të rasteve të veçanta të justifikuara nga rrethanat;

b) kanë për qëllim të përdoren për të njëjtat qëllime edhe në vendbanimin e ri.

2. Për automjetet private dhe rimorkiot, motomjetet dhe ciklomotorët, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private, përjashtimi kufizohet nga përmbushja e kushteve të mëposhtme:

a) i interesuari ka qenë pronari i regjistruar për automjetin, motomjetin dhe ciklomotorin, rulotën, mjetin lundrues ose mjetin ajror, në vendet ku zbatohet një regjistrim mjetesh, për të paktën, 12 muaj përpara transferimit të tij në Republikën e Shqipërisë;

b) ka qenë pronë e të interesuarit për të paktën 12 muaj, përpara se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) ka qenë përdorur nga i interesuari në një vend tjetër normalisht për të paktën 12 muaj përpara se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) pasi të importohet duke u përjashtuar nga detyrimet e importit, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose tjetërsohet/transferohen si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, deri në dy vjet pas kryerjes se formaliteteve doganore, përveçse kur paguan detyrimet e importit dhe të gjitha taksat e tjera prej të cilave ishte përjashtuar;

d) përjashtimi nga detyrimet e importit i nënshtrohet depozitimit të një garancie.

Forma dhe shuma e garancisë përcaktohen nga autoritetet doganore kompetente. Garancia çlirohet pas kalimit të dy vjetëve nga momenti i depozitimit të saj në zyrën ku është bërë çlirimi i mallrave mbi bazën e paraqitjes së provave bindëse që personi i interesuar është dhe ka qenë gjatë gjithë kësaj periudhe kohe pronari i regjistruar i automjetit, motomjetit dhe ciklomotorit, ruletës, mjetit të lundrimit, ose mjetit të fluturimit për të cilin është dhënë përjashtimi.

Neni 98
Rastet kur jepet përjashtimi

1. Përjashtimi jepet vetëm për individët të cilët kanë pasur vendbanim të zakonshëm, për të paktën 12 muaj në mënyrë të vazhdueshme, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Megjithatë, autoritetet doganore kompetente mund të lejojnë anashkalim nga rregulli i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, me kusht që synimi i të interesuarit të ketë qenë qartësisht qëndrimi jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për një periudhë të vazhdueshme prej të paktën 12 muajsh.

Neni 99
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk jepet për:

a) produktet alkoolike;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) mjetet tregtare të transportit;

ç) artikujt për përdorim në ushtrimin e një tregtie ose profesioni, të ndryshëm nga instrumentet e mbartshme të arteve të aplikuara ose të lira.

Neni 100
Hedhja në qarkullim të lirë

1. Përveç rasteve të veçanta, përjashtimi jepet vetëm për sendet vetjake të hedhura në qarkullim të lirë brenda 12 muajsh nga data në të cilën individi i interesuari është vendosur në vendbanimin e tij normal në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Sendet vetjake mund të vendosen në qarkullim të lirë, pjesë-pjesë, brenda afatit të përmendur në pikën 1, të këtij neni.

Neni 101
Kushtëzime

1. Me përjashtim të përcaktimit të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 97, sendet vetjake që janë lejuar me përjashtim nga detyrimet e importit, deri në përfundimin e afatit prej 12 muajsh nga data në të cilën është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose transferohen, si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet kompetente doganore për këtë qëllim.

2. Huadhënia, lënia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 sjell si pasojë zbatimin e detyrimeve përkatëse të importit për sendin në fjalë, sipas nivelit të detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhënia, dhënia si garanci, qiradhënia apo tjetërsimi dhe në bazë të llojit të mallrave, si dhe të vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 102
Caktimi i vendbanimit

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 1, të nenit 100, përjashtim mund të jepet për sendet vetjake të hedhura në qarkullim të lirë, përpara se i interesuari të caktojë vendbanimin e tij të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ai të marrë përsipër të caktojë vendbanimin e zakonshëm në Shqipëri, brenda një afati 6-mujor. Marrja përsipër e këtij detyrimi shoqërohet nga dhënia e një garancie, forma dhe shuma e së cilës përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Kur zbatohet pika 1, e këtij neni, afati i përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 97, llogaritet nga data në të cilën sendet vetjake janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 103
Angazhimet profesionale

1. Kur, për shkak të angazhimeve profesionale, individi i interesuar largohet nga vendi ku ka pasur vendbanimin e përhershëm, pa u vendosur në vendbanimin e tij në Republikën e Shqipërisë, edhe pse qëllimi i tij është ta bëjë këtë, autoriteti doganor mund të lejojë përjashtimin nga detyrimet doganore për sendet vetjake të cilat ai i transferon në Republikën e Shqipërisë.

2. Përjashtimi nga detyrimet e importit për sendet vetjake të përmendura në pikën 1 do të lejohet, sipas kushteve të parashikuara në nenet 96 deri 101, me kushtin që:

a) afatet e përcaktuara në shkronjën "a", të nenit 97, dhe të pikës 1, të nenit 100, të llogariten prej datës në të cilën sendet vetjake janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) afati i përcaktuar në pikën 1, të nenit 101, të llogaritet nga data kur individi i interesuar realisht përcakton vendbanimin e tij normal në Republikën e Shqipërisë.

3. Përjashtimi nga detyrimet është subjekt i deklarimit nga individi i interesuar se ai në të vërtetë do të vendoset në Republikën e Shqipërisë, brenda një afati të caktuar nga autoriteti doganor, në përputhje me rrethanat. Autoriteti doganor kompetent mund të kërkojë që deklarimi të shoqërohet me depozitimin e një garancie, forma dhe shuma e së cilës përcaktohen nga këto autoritete.

Neni 104
Rrethanat politike të veçanta

Autoriteti doganor kompetent mund të anashkalojë dispozitat e shkronjave "a" dhe "b", të nenit 97, të shkronjave "c" dhe "ç", të nenit 99, dhe nenit 101, kur një individ transferon vendbanimin e tij nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë, si rezultat i rrethanave politike të veçanta.

Seksioni 2
Mallrat e importuara në raste martese

Neni 105
Përjashtime në raste martese

1. Në përputhje me nenet 106 deri 109, veshjet martesore dhe sendet shtëpiake, të reja ose jo, që i përkasin një individi që me rastin e martesës së tij/saj transferon vendbanimin e tij të zakonshëm nga një vend tjetër, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, importohen duke u përjashtuar nga detyrimet importit.

2. Në të njëjtat kushte, dhuratat e dhëna me rastin e martesës dhe që janë marre nga një individ i cili plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, që e ka vendbanimin e tij të zakonshëm në një vend tjetër, përjashtohen gjithashtu nga detyrimet e importit. Megjithatë, vlera e çdo dhurate që përjashtohet nga detyrimet e importit, nuk duhet të kalojë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 000 euro.

Neni 106
Kushtëzime

Përjashtimi i referuar në nenin 105 mund të jepet vetëm për individë:

a) vendbanimi i zakonshëm i të cilëve ka qenë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për të paktën 12 muaj të vazhdueshëm. Megjithatë,

përjashtime nga ky rregull mund të jepen me kusht që i interesuari të provojë qartë se synonte të qëndronte jashtë territorit doganor të Republikës se Shqipërisë për një periudhë të pandërprerë kohe prej të paktën 12 muajsh;

b) që paraqesin prova të martesës së tyre.

Neni 107
Produktet alkoolike dhe duhani

Asnjë përjashtim nuk duhet të jepet për produktet alkoolike, duhanin dhe produktet e duhanit.

Neni 108
Hedhja në qarkullim të lirë

1. Me përjashtim të rrethanave të jashtë-zakonshme, përjashtimi nga detyrimet e importit jepet vetëm për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë:

a) jo më herët se dy muaj përpara datës së caktuar për martesë (në këtë rast përjashtimi jepet vetëm kundrejt depozitimit të garancisë përkatëse, forma dhe shuma e së cilës caktohet nga autoritetet doganore kompetente);

b) jo me vonë se katër muaj pas datës së martesës.

2. Mallrat e referuara në nenin 105 mund të vendosen në qarkullim të lirë në disa dërgesa të veçanta, brenda afatit të përmendur në pikën 1.

Neni 109
Kushtëzime

1. Mallrat që janë lejuar me përjashtim nga detyrimet e importit në përputhje me nenin 105, deri në përfundimin e afatit prej 12 muajsh nga data në të cilën është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë, nuk mund të jepen hua, vendosen si garanci, jepen me qira ose transferohen, si kundrejt pagesës, ashtu edhe falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet kompetente doganore për këtë qëllim.

2. Huadhënia, dhënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi përpara përfundimit të periudhës 12-mujore bëhet vetëm kundrejt pagesës së detyrimeve përkatëse të importit për mallrat në fjalë, duke zbatuar nivelin e detyrimeve të importit në fuqi në datën në të cilën kryhet huadhënia, lënia si garanci, qiradhënia ose tjetërsimi, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të tyre, të verifikuar apo të pranuar në po atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Seksioni 3
Sendet personale të fituara nga trashëgimia

Neni 110
Sendet personale

1. Në përputhje me nenet 111, 112 dhe 113, sendet personale të fituara nëpërmjet trashëgimisë, nga një individ me vendbanim të zakonshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lejohet të importohen me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Për qëllim të pikës 1, "sende personale" do të thotë gjithë pasuria e referuar në shkronjën "b", të nenit 95, të cilat përbëjnë pasurinë e trashëgimlënësit.

Neni 111
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk jepet për:

a) produktet alkoolike;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) mjetet e transportit tregtar;

ç) artikujt për përdorim gjatë ushtrimit të një tregtie apo profesioni, të ndryshme nga instrumentet e arteve të aplikuara ose të lira, të cilat i nevojiteshin trashëgimlënësit për ushtrimin e tregtisë ose të profesionit;

d) stoqet e lëndëve të para dhe produkteve ose gjysmëprodukteve;

dh) stoqet e produkte bujqësore dhe blegtorale, përfshi bagëtitë, që kalojnë sasitë e përshtatshme për nevoja të përdorimit familjar.

Neni 112
Kufizime

1. Përjashtimi lejohet vetëm për sendet personale të vendosura në qarkullim të lirë jo më vonë se dy vjet nga data në të cilën i interesuari fiton të drejtën e pronësisë mbi këto sende (ndarja përfundimtare e trashëgimisë).

Megjithatë, për raste të veçanta, kjo periudhë mund të zgjatet nga autoritetet doganore kompetente.

2. Sendet personale mund të importohen në disa dërgesa të veçanta brenda afatit të përmendur në pikën 1.

Neni 113
Trashëgimia nga personat juridikë

Nenet 110, 111 dhe 112 zbatohen, rast pas rasti, në mënyrë analoge, për sendet personale të fituara me trashëgimi nga personat juridikë që merren me aktivitet jofitimprurës, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 4
Uniformat shkollore, materialet e studimit dhe pajisjet shtëpiake për përdorim nga nxënës e studentë

Neni 114
Përjashtime për nxënësit dhe studentët

1. Uniformat shkollore, materialet e studimit dhe pajisjet shtëpiake që përbëjnë në vetvete materiale të zakonshme për dhomat studentore dhe që u përkasin nxënësve ose studenteve të huaj që do të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllime studimi dhe u nevojiten atyre për përdorim vetjak gjatë kohës së studimeve të tyre, përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Për qëllim të pikës 1:

a) Nxënës ose student" është çdo person i regjistruar në një institucion edukimi për të ndjekur me kohë të plotë mësimet e ofruara në këtë institucion;

b) "Uniformë" është veshmbathje, shtresa shtëpiake, si dhe veshje, të reja ose jo;

c) "Materiale shkollore" janë sendet dhe instrumentet (përfshirë makinat llogaritëse dhe makinat e shkrimit), që zakonisht përdoren nga nxënësit apo studentët për nevoja të studimeve të tyre.

Neni 115
Kufizim

Përjashtimi lejohet të paktën njëherë për çdo vit shkollor.

Seksioni 5
Dërgesat me vlerë të papërfillshme

Neni 116
Mallra me vlerë të papërfillshme

1. Në përputhje me nenin 117, çdo dërgesë e përberë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër te një marrës në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Për qëllime të pikës 1, "mallra me vlerë të papërfillshme" janë mallra, vlera përmbledhëse e të cilëve nuk duhet të kalojë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 euro.

Neni 117
Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

a) produktet alkoolike;

b) parfumet dhe ujë tualeti;

c) duhanet dhe produktet e duhanit.

Seksioni 6
Dërgesa të dërguara falas nga një individ te një tjetër

Neni 118
Përjashtime për dërgesa të dërguara falas

1. Në përputhje me nenet 119 dhe 120, mallrat që përbëjnë dërgesat që dërgohen nga një individ nga një vend tjetër te një individ tjetër që jeton në territorin doganor të Republikës së Shqipëri përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe nuk janë të natyrës tregtare.

2. Për qëllime të pikës 1, dërgesat e importuara janë "mallra të natyrës jotregtare" nëse ato:

a) janë të një natyre rastësore;

b) përmbajnë mallra që ekskluzivisht janë për përdorim personal të pritësit të dërgesës apo familjes së tij dhe të cilat, sipas natyrës apo sasisë së tyre, nuk lënë dyshim se do të përdoren për qëllime tregtare;

c) i dërgohen pritësit nga dërguesi pa asnjë lloj pagese.

Neni 119
Vlera e dërgesës

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 118, zbatohet për dërgesa, vlera e së cilës nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro, duke përfshirë edhe vlerën e mallrave të përmendura në nenin 120.

2. Kur vlera e përgjithshme për një dërgesë e përbërë prej dy ose më shumë artikujve e kalon shumën e përmendur në pikën 1, përjashtimi deri në atë shumë jepet për këta artikuj, nëse të importuar veçmas do t'u jepej përjashtimi, me kusht që vlera e një artikulli individual nuk mund të ndahet.

Neni 120
Kufizime

Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 118, duhet të kufizohet për dërgesë në sasitë e dhëna për çdo mall të listuar, si më poshtë vijon:

a) Produkte të duhanit:

- 50 cigare;
- 25 cigarillos (puro e hollë e vogël me peshë maksimale deri në tri gramë secila);
- 10 cigare puro;
- 50 gramë duhan për tymosje;
- një përzgjedhje proporcionale nga këto produkte të ndryshme.

b) Alkool dhe pije alkoolike:

- pije të distiluara dhe pije alkoolike me përbërje alkooli mbi 22% të vëllimit; etil alkool jo i denatyruar me vëllim 80% e më tepër: 1 litër; ose
- pije të distiluara dhe pije alkoolike, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, rum, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli që nuk kalon 22% të vëllimit; verëra me gaz, verëra likeri: një litër apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme, dhe
- verë e pagazuar: dy litra;

c) Parfume:
- 50 gramë; ose
- ujëra tualeti: 0,25 litra.

Seksioni 7
Mjetet kryesore të prodhimit dhe pajisjet e tjera të importuara gjatë transferimit të aktiviteteve nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë

Neni 121
Përjashtime për mjetet kryesore të prodhimit dhe pajisjet e tjera

1. Pa cenuar legjislacionin në fuqi lidhur me politikën industriale dhe tregtare dhe në përputhje me nenet 122 deri 126, përjashtohen nga detyrimet e importit mjetet kryesore dhe pajisjet e tjera që u përkasin ndërmarrjeve që përfundimisht mbyllin aktivitetin e tyre në një vend tjetër dhe transferohen në territorin doganor të Republikës së Shqipëri, në mënyrë që të kryejnë një aktivitet të ngjashëm.

Në rastet kur ndërmarrja e transferuar është investim bujqësor, atëherë edhe gjëja e gjallë e cila i përket këtij investimi, po ashtu përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Për qëllime të pikës 1, "ndërmarrje" nënkupton një njësi të pavarur ekonomike që merret me veprimtari prodhuese ose industri shërbimi.

Neni 122
Kufizime

Përjashtimi nga detyrimet e importit kufizohet për mjetet kryesore dhe pajisje të tjera të cilat:

a) përveç rasteve të veçanta që justifikohen nga rrethanat, kanë qenë aktualisht të përdorura në ndërmarrje për një minimum prej 12 muajsh përpara datës në të cilën ndërmarrja pushoi së funksionuari në vendin tjetër nga i cili ka transferuar aktivitetin;

b) janë të destinuara që të përdoren për të njëjtin qëllim pas transferimit;

c) janë të përshtatshme për natyrën dhe madhësinë e ndërmarrjes në fjalë.

Neni 123
Raste kur nuk jepet përjashtimi

Përjashtimi nuk jepet për ndërmarrje, transferimi i të cilave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është rrjedhojë ose ka për qëllim shkrirjen me/ose përthithjen nga një ndërmarrje e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pa vendosur/ngritur/krijuar një aktivitet të ri.

Neni 124
Raste të tjera kur nuk jepet përjashtimi

Përjashtimi nuk do të jepet për:

a) mjetet e transportit që nuk janë të natyrës së instrumenteve të prodhimit apo të industrisë së shërbimit;

b) furnizimet e çfarëdolloji që janë të destinuara për konsum njerëzor apo për ushqim për kafshët;

c) karburantet dhe stokun e lëndës së parë apo të produkteve finale apo gjysmëprodukteve;

ç) gjëja e gjallë në posedim nga tregtarët.

Neni 125
Kufizime lidhur me afatin kohor

Përveç rasteve të veçanta të justifikuara nga rrethanat, përjashtimi i referuar në nenin 121 jepet vetëm për mjete kryesore të prodhimit dhe pajisje të tjera të vendosura në qarkullim të lirë, përpara mbarimit të një afati kohor prej 12 muajsh nga data kur ndërmarrja mbyll aktivitetin e saj në vendin tjetër të nisjes.

Neni 126
Kushtëzime

1. Mjetet themelore dhe pajisjet e tjera të përjashtuara nga detyrimet e importit nuk mund të jepen hua, si garanci, me qira ose të tjetërsohen përpara kalimit të afatit 12-mujor, nga data kur është pranuar deklarata për hedhjen në qarkullim të lirë, pa informuar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

Në rastet e dhënies për përdorim apo transferim, kur ka rrezik për abuzim, ky afat mund të zgjatet deri në 36 muaj.

2. Çdo dhënie hua, si garanci, dhënie në përdorim apo transferim para kalimit të afatit të përmendur në pikën 1, bëhet vetëm kundrejt pagesës së detyrimeve të importit për mallrat përkatëse, sipas normës që zbatohet në datën e dhënies hua, dhënies si garanci, dhënies në përdorim apo transferim, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga autoriteti doganor kompetent.

Neni 127
Transferimi i personave të angazhuar në profesione të lira dhe personave juridikë të angazhuar në aktivitete jofitimprurëse

Nenet 121 deri në 126 zbatohen, rast pas rasti, në mënyrë analoge për mjetet themelore dhe pajisjet e tjera që u përkasin personave të angazhuar në profesione të lira dhe personave juridikë të angazhuar në aktivitete jofitimprurëse që e transferojnë këtë aktivitet nga një vend tjetër për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 8
Produktet e përftuara nga fermerët e Republikës së Shqipërisë në prona të vendosura në vende kufitare me Republikën e Shqipërisë

Neni 128
Përjashtime për produktet bujqësore, blegtorale, të bletarisë, të kopshtarisë dhe pyjeve

1. Në përputhje me nenet 129 dhe 130, produktet bujqësore, blegtorale, të bletarisë, të kopshtarisë dhe pyjeve të përfituara nga prona të vendosura në një vend tjetër fqinj me territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat punohen nga një prodhues bujqësor që ka ndërmarrjen e tij kryesore brenda territorit shqiptar dhe e kryen ketë veprimtari në tokën që është në kufirin ngjitur me vendin tjetër, përjashtohen nga detyrimet doganore.

2. Për të përfituar nga dispozitat e pikës 1, produktet blegtorale duhet të përfitohen nga kafshë të origjinuara në Republikën e Shqipërisë ose që janë vendosur në qarkullim të lirë aty.

Neni 129
Kufizime

Përjashtimi kufizohet për produkte të cilat nuk u janë nënshtruar trajtimeve të tjera përveç atyre që kryhen normalisht pas korrjes/vjeljes apo prodhimit të tyre.

Neni 130
Lejimi

Përjashtimi lejohet vetëm për produkte që janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga prodhuesi bujqësor apo për llogari të tij.

Neni 131
Produktet e peshkimit apo të kultivimit të peshkut

Nenet 128, 129 dhe 130 zbatohen, rast pas rasti, në mënyrë analoge për produktet e peshkimit apo të kultivimit të peshkut, aktivitete të cilat kryhen në liqenet apo lumenjtë e lundrueshëm që kufizojnë një vend tjetër me Republikën e Shqipërinë nga peshkatarë shqiptarë, apo edhe për produktet e aktivitetit të gjuetisë, që zhvillohet në liqene apo lumenj të tillë nga gjahtarët për sport të Shqipërisë.

Seksioni 9
Farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave, të importuara nga prodhuesit bujqësorë të vendeve të tjera, për përdorim në pronat fqinje me këto vende

Neni 132
Përjashtime për farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave

Në përputhje me nenin 133, farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të mbjellave, të destinuara për t'u përdorur në prona të vendosura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, fqinj me një vend tjetër dhe e cila punohet nga një prodhues bujqësor që ka ndërmarrjen e tij kryesore brenda këtij vendi tjetër dhe në kufi ngjitur me territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 133
Kufizime

1. Përjashtimi kufizohet për ato sasi farash, plehrash dhe produkte të tjera që nevojiten për punimin e pronës.

2. Përjashtimi jepet vetëm për ato fara, plehra apo produkte tjera të importuara drejtpërdrejt për në territorin doganor të Republikës së Shqipëri nga prodhuesi bujqësor apo për llogari të tij.

3. Këshilli i Ministrave mund të vendosë kushte për përjashtimin bazuar në parimin e reciprocitetit.

Seksioni 10
Mallrat që gjenden në bagazhin personal të udhëtarit

Neni 134
Mallrat që gjenden në bagazhin personal

1. Në përputhje me nenet 134 deri 141, mallrat që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve, që vijnë nga një vend tjetër, përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe të jenë të natyrës jotregtare.

2. Për qëllime të këtij seksioni:

a) "Bagazh personal" është tërësia e bagazhit që udhëtari u paraqet autoriteteve doganore me mbërritjen e tij në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo bagazh që u paraqitet këtyre

autoriteteve në një datë të mëvonshme, me kusht që të paraqiten prova që ditën e largimit të udhëtarit ishte regjistruar si bagazh shoqërues, në momentin e nisjes, pranë shoqërisë që ka siguruar transportin nga vendi i nisjes për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Karburanti, i ndryshëm nga ai i referuar në nenin 139, nuk përbën bagazh personal;

b) "Importe me natyrë jotregtare" janë importe, të cilat:

i) kanë natyrë rastësore; dhe

ii) përbëhen vetëm prej mallrash për përdorim vetjak të udhëtarëve ose familjeve të tyre ose prej mallrave për dhurata.

Lloji dhe sasia e mallrave nuk duhet të jetë e tillë që të tregojë se kanë për qëllim përdorimin tregtar.

c) "Udhëtar ajror" dhe "udhëtar detar" janë çdo pasagjer që udhëton në rrugë ajrore apo detare, ndryshe nga fluturimi privat për argëtim apo udhëtimi detar për argëtim.

ç) "Fluturim privat për argëtim" dhe "udhëtim detar për argëtim" nënkupton përdorimin e një mjeti ajror apo një mjeti ujor nga pronari ose personi fizik ose juridik i cili ka të drejtën e përdorimit qoftë nëpërmjet qirasë ose me çdo mjet tjetër, për qëllime të ndryshme nga ato tregtare dhe në mënyrë të veçantë të ndryshme nga transporti i udhëtarëve ose mallrave ose për furnizimin e shërbimeve për qëllime të autoriteteve publike;

d) "Zonë kufitare" është: pa cenuar konventat ekzistuese në këtë fushë, një zonë, shtrirja e së cilës në vijë të drejtë ajrore nuk i kalon 10 km nga kufiri.

dh) "Punonjës zone kufitare" nënkupton çdo person aktiviteti normal i të cilit kërkon që ai të shkojë në anën tjetër kufitare gjatë ditëve të punës.

Neni 135
Kufijtë monetarë

1. Përjashtimet e parashikuara në nenin 134 jepen për mallra, vlera e përgjithshme e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 300 euro për çdo udhëtar, për mallra të ndryshme nga ato të renditura në nenet 136 dhe 137.

Në rastin e udhëtarëve me rrugë ajrore dhe rrugë detare, shuma e përmendur në paragrafin e parë do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 430 euro.

2. Për udhëtarët nën 15 vjeç, kjo shumë reduktohet në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 euro.

3. Për qëllime të zbatimit të kufirit monetar të sipërpërmendur, vlera e një artikulli të veçantë nuk mund të ndahet.

4. Vlera e bagazhit personal të udhëtarit, që është importuar përkohësisht ose është riimportuar pas eksportit të përkohshëm, dhe vlera e produkteve mjekësore të nevojshme për të përmbushur nevojat personale të udhëtarit nuk merren në konsideratë për qëllime të zbatimit të përjashtimit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2.

Neni 136
Kufijtë sasiorë për produktet e duhanit

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 134, për produktet e duhanit, zbatohet në varësi të kufizimeve sasiore në jo më shumë se:

a) 200 cigare;

b) 100 cigarillo;

c) 50 puro;

ç) 250 gram duhan.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" deri "ç", për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e duhanit.

Cigarillo janë cigare, pesha maksimale e të cilave është 3 gram secila.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të duhanit, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individi të mos kalojë 100%.

Neni 137
Kufijtë sasiorë për produktet e alkoolit dhe pijet alkoolike

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 134, për alkoolin dhe pijet alkoolike, ndryshe nga verërat e qeta dhe birra, zbatohet mbi bazën e kufizimeve sasiore të mëposhtme:

a) 1 litër alkool dhe pije alkoolike me fortësi alkoolike më të lartë se 22% ndaj volumit, ose alkool etilik i padenatyruar me fortësi alkoolike 80% ndaj volumit dhe më shumë;

b) 2 litra: alkool dhe pije të distiluara me fortësi alkoolike që nuk e kalon 22% ndaj volumit.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" dhe "b", për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e alkoolit dhe pijeve alkoolike.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të alkoolit dhe pijeve alkoolike të përcaktuara në pikën 1, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individi të mos kalojë 100%.

3. Përjashtohen nga detyrimet e importit edhe 2 litra verë e qetë dhe 10 litra birrë.

Neni 138
Udhëtarët nën moshën 17 vjeç

Nuk jepet përjashtim për mallrat e përmendura në nenet 136 dhe 137, për udhëtarët nën moshën 17 vjeç.

Neni 139
Karburanti që ndodhet në serbatorë

Përjashtohet nga detyrimet e importit, për çdo mjet transporti motorik, karburanti që ndodhet në serbatorë/depozita standard, si dhe jo më shumë se 10 litra karburant në serbatorë të lëvizshëm.

Neni 140
Vlera e mallrave që nuk do të merren në konsideratë

Vlera e mallrave e përmendur në nenet 136, 137 ose 139 nuk do të merret në konsideratë për qëllime të zbatimit të përjashtimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 135.

Neni 141
Raste të veçanta

1. Ministri i Financave, me urdhër, mund të zvogëlojë kufijtë monetarë ose kufizimet sasiore, apo të dyja, në rastet e udhëtarëve sipas kategorive të mëposhtme:

a) personave që banojnë në një zonë kufitare;

b) punonjësve të zonës kufitare;

c) ekuipazheve e mjeteve të transportit të përdorura për të udhëtuar nga një vend tjetër.

2. Pika 1 nuk zbatohet kur një udhëtar i njërës prej kategorive të mësipërme provon që po kalon përtej zonës kufitare të Republikës së Shqipërisë ose nuk po kthehet nga një zonë kufitare e një vendi fqinj.

Megjithatë, pika 1 zbatohet kur punonjësit e zonave kufitare apo ekuipazhi i mjeteve të transportit të përdorur në udhëtim ndërkombëtar, importojnë mallra kur bëjnë udhëtime gjatë punës së tyre.

Seksioni 11
Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore; instrumentet dhe aparaturat shkencore

Neni 142
Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore të listuara në aneksit 9, përjashtohen nga detyrimet e importit, pavarësisht se cili është pranuesi i dërgesës apo për çfarë qëllimi mund të përdoren këto materiale.

Neni 143
Kushtëzime

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore të listuara në aneksin 10, përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që ato të kenë për qëllim të përdoren nga:

a) institucione apo organizata publike arsimore, shkencore apo kulturore, ose

b) institucione apo organizata që u përkasin kategorive të specifikuara në kolonën e tretë të aneksit 10, me kusht që ato të jenë të miratuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë artikuj të tillë me detyrime importi të përjashtuara.

Neni 144
Instrumentet dhe aparatet shkencore

1. Në përputhje me nenet 145 deri 149, instrumentet dhe aparatet shkencore, të cilat nuk janë përfshirë në nenin 143, përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse ato importohen ekskluzivisht për qëllime jotregtare.

2. Përjashtimi sipas pikës 1, kufizohet për instrumentet dhe aparatet shkencore, të cilat kanë për qëllim të përdoren nga:

a) institucione/ente publike që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore dhe për ato departamente të institucioneve publike, që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore;

b) institucione private që merren kryesisht me arsimimin apo kërkime shkencore dhe të miratuara nga autoritetet kompetente për të marrë artikuj të tillë me detyrime importi të përjashtuara.

Neni 145
Pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse

Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 144, zbatohet, gjithashtu, për:

a) Pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse që i përshtaten posaçërisht instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse apo pjesë ndihmëse të importohen në të njëjtën kohë me instrumentet apo aparatet e tilla ose, nëse ato importohen më pas, me kushtin që ato të mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuara për instrumentet apo aparatet të cilat:

i) janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importit, me kusht që këto instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet përjashtimi për pjesët përkatëse këmbimi/rezervë, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse, ose;

ii) të cilat do të përjashtoheshin në momentin kur kërkohet një përjashtim i tillë për pjesët rezervë përkatëse, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse;

b) Veglat që përdoren për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjtën kohë me instrumentet apo

aparatet e tilla ose nëse ato importohen më pas, me kusht që ato të mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuara për instrumentet apo aparatet të cilat:

i) janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importit, me kusht që këto instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet përjashtimi për veglat ose;

ii) të cilat do të përjashtoheshin, në momentin kur është bërë kërkesa për përjashtim për veglat.

Neni 146
Përkufizime

Për qëllime të neneve 144 dhe 145:

a) "instrumente apo aparate shkencore" nënkuptohet çdo instrument apo aparat i cili, për shkak të karakteristikave objektive teknike të tij dhe për shkak të rezultateve që arrihen me të, është kryesisht apo ekskluzivisht i përshtatshëm për veprimtari shkencore;

b) "të importuara për qëllime jotregtare" nënkuptohen instrumentet apo aparatet shkencore që destinohen për t'u përdorur për kërkime shkencore apo qëllime edukative jofitimprurëse.

Neni 147
Mospërjashtimi nga detyrimet e importit

Nëse është e nevojshme, disa instrumente apo aparate mund të mos përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse vërtetohet se përjashtimi nga detyrimet e importit dëmton interesat e industrisë së vendit, në sektorin përkatës të prodhimit.

Neni 148
Kushtëzime

1. Artikujt e përcaktuar në nenin 143 dhe instrumentet apo aparatet shkencore të cilat janë përjashtuar nga detyrimet e importit në përputhje me kushtet e parashikuara me nenet 145, 146 dhe 147, nuk mund të huazohen, të jepen në shfrytëzim apo të transferohen, qoftë me apo pa pagesë, pa njoftuar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

2. Nëse, një artikull huazohet, jepet në përdorim apo transferohet në një institucion apo organizatë që përfiton nga përjashtimi sipas nenit 143 ose pikës 2, të nenit 144, përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që institucioni apo organizata ta përdorë atë artikull, instrument apo aparat për qëllime për të cilin është dhënë përjashtimi.

Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo transferimi kërkon pagesën paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e huazimit, dhënies në përdorim apo transferimit, në bazë të llojit të mallit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Neni 149
Ndërprerja e përmbushjes së kushteve

1. Institucionet apo organizatat e përmendura në nenet 143 dhe 144, të cilat nuk përmbushin më kushtet mbi bazën e të cilave kanë fituar të drejtën e përjashtimit, apo synojnë t'i përdorin artikujt e përjashtuar nga detyrimet e importit, për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga dispozitat e këtij seksioni duhet të njoftojnë autoritetin doganor kompetent.

2. Artikujt që mbesin në posedim të institucioneve apo organizatave të cilat ndërpresin përmbushjen e kushteve për përfitimin e përjashtimit, do t'u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën, në të cilën ndërpritet përmbushja e atyre kushteve, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

3. Artikujt e përdorur nga institucionet ose organizatat përfituese të përjashtimit, për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 143 dhe 144, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, që zbatohen në datën kur ato janë vënë në një përdorim tjetër, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Neni 150
Kushtëzime të tjera

Nenet 147, 148 dhe 149 zbatohen rast pas rasti në mënyrë analoge për produktet e referuara në nenin 145.

Neni 151
Pajisje të importuara për qëllime jotregtare

1. Pajisjet e importuara për qëllime jotregtare nga apo në emër të një institucioni a organizate për kërkime shkencore të vendosur jashtë Shqipërisë përjashtohen nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi do të lejohet, me kusht që pajisjet:

a) janë të destinuara për t'u përdorur nga apo me miratimin e pjesëtarëve ose përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në kontekst dhe brenda kufijve të marrëveshjeve për bashkëpunim shkencor, qëllimi i të cilave është të kryhen programe kërkimesh shkencore ndërkombëtare në institucione për kërkime shkencore të bazuara dhe të vendosura në Shqipëri.

b) mbeten pronë e personit fizik apo juridik me vendqëndrim jashtë Shqipërisë, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Shqipëri.

3. Në kuptim të këtij neni dhe të nenit 152:

a) "pajisje" janë instrumentet, aparatet, makinat dhe pjesët e tyre, përfshirë pjesët e këmbimit/rezervë dhe veglat e projektuara posaçërisht për mirëmbajtjen, kontrollimin, kalibrimin apo riparimin e tyre, që përdoren për nevoja kërkimi shkencor;

b) pajisjet e destinuara për t'u përdor për qëllime të kërkimeve shkencore të kryera për qëllime jofitimprurëse, konsiderohen se janë "të importuara për qëllime jotregtare".

Neni 152
Kushtëzime

1. Pajisjet e përjashtuara nga detyrimet e importit në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 151, të këtij ligji, nuk mund të huazohen, të jepen për përdorim apo të transferohen, me pagesë ose jo, pa lajmëruar paraprakisht autoritetin doganor kompetent.

2. Nëse pajisjet huazohen, jepen në përdorim apo transferohen në një institucion apo organizatë që përfiton nga përjashtimi sipas nenit 151, përjashtimi vazhdon të jepet me kusht që institucioni apo organizata ta përdorë atë artikull, instrument apo aparat për qëllime, për të cilin është dhënë përjashtimi.

Në raste të tjera dhe pa cenuar nenet 144 dhe 145 huazimi, dhënia në përdorim apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e huazimit, dhënies në përdorim apo transferimit, në bazë të llojit të pajisjeve dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Institucionet apo organizatat e referuara në pikën 1, të nenit 151, të cilat nuk i përmbushin më kushtet për përjashtim, apo të cilat synojnë t'i përdorin pajisjet e përjashtuara nga detyrimet e importit për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga ky nen, duhet të njoftojnë për këtë autoritetin doganor kompetent.

4. Pajisjet e përdorura nga institucionet ose organizatat të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar nga përjashtimi, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën në të cilën ndërpritet përmbushja e atyre kushteve, në bazë të llojit të artikullit dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore.

Pa rënë ndesh me nenet 144 dhe 145, pajisjet e përdorura nga institucionet apo organizatat përfituese të përjashtimit për qëllime tjera nga ato të parashikuara me nenin 151, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit që zbatohen në datën në të cilën ato janë përdorur për një qëllim tjetër, në bazë të llojit të pajisjes dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Seksioni 12
Kafshët laboratorike dhe lëndët biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime

Neni 153
Kafshët laboratorike dhe lëndët biologjike

1. Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet për:

a) kafshët e posaçme për përdorim laboratorik;

b) lëndët biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime, të cilat importohen ekskluzivisht për qëllime jotregtare.

2. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 kufizohet për kafshët dhe lëndët biologjike ose kimike, të cilat destinohen për:

a) institucione publike që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe ato departamente a institucione publike të cilat merren kryesisht me arsimim apo kërkime shkencore; ose

b) institucione private që merren kryesisht me arsimim ose kërkime shkencore dhe të autorizuara nga autoritetet kompetente doganore të Republikës së Shqipërisë të marrin artikuj të tillë, me përjashtim nga detyrimet e importit.

3. Lëndët e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, mund të përfshijnë vetëm lëndët biologjike ose kimike për të cilat nuk ekziston prodhimi ekuivalent në Shqipëri dhe të cilat, për arsye të specifikimit ose shkallës së pastërtisë, kryesisht ose ekskluzivisht janë të përshtatshme për kërkime shkencore.

Seksioni 13
Substanca terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagjentët për analizat e gjakut e ato të indeve

Neni 154
Substanca terapeutike dhe reagjentët

1. Në përputhje me nenin 155, të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) substancat terapeutike me origjinë njerëzore;

b) reagjentët për përcaktimin e grupit të gjakut;

c) reagjentët për përcaktimin e përbërjes së indeve.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni me termat e mëposhtëm kuptojmë:

a) "substanca terapeutike me origjinë njerëzore", gjaku i njeriut dhe derivatet e tij (gjaku i njeriut në gjendje të natyrshme, plazmë e tharë, albumina dhe solucione të qëndrueshme të proteinave plazmatike njerëzore, imunoglobulin dhe fibrinogjeni i njeriut);

b) "reagjentët për përcaktimin e grupit të gjakut", të gjithë reagjentët, qofshin të origjinës njerëzore, shtazore, bimore ose të ndonjë origjine tjetër, që përdoren për përcaktimin e grupit të gjakut dhe për zbulimin e anomalive të gjakut;

c) "reagjentët për përcaktimin e përbërjes së indeve", të gjithë reagjentët, qofshin të origjinës njerëzore, shtazore, bimore apo të një origjine tjetër që përdoren për përcaktimin e përbërjes së indeve të njeriut.

Neni 155
Kufizime

Përjashtimi kufizohet për produkte të cilat:

a) destinohen për institucione ose laboratorë, të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, për t'u përdorur ekskluzivisht për qëllime jotregtare mjekësore ose shkencore;

b) shoqërohen nga një certifikatë e konformitetit e lëshuar nga organi i autorizuar në vendin e nisjes;

c) janë të vendosura në enë, me etiketë të veçantë identifikuese.

Neni 156
Paketimi

Përjashtimi nga detyrimet e importit përfshin paketimin special të domosdoshëm për transportin e substancave terapeutike me origjinë njerëzore apo të reagjentëve për përcaktimin e grupeve të gjakut ose të përbërjes së indeve dhe, gjithashtu, çdo tretës e aksesor të nevojshëm për përdorimin e tyre, që mund të përfshihen në dërgesë.

Seksioni 14
Instrumentet dhe aparaturat e destinuara për kërkime mjekësore, për përcaktimin e diagnozës mjekësore ose për kryerjen e trajtimeve mjekësore

Neni 157
Instrumentet dhe aparaturat e destinuara për kërkime, diagnozë ose trajtime mjekësore

1. Përjashtohen nga detyrimet e importit, instrumentet dhe aparaturat që destinohen për kërkime mjekësore, për përcaktim diagnoze ose kryerje të trajtimit mjekësor, të cilat u dhurohen nga një organizatë filantropike ose bamirëse apo nga një individ privat, autoriteteve të shëndetësisë, spitaleve ose institucioneve kërkimore mjekësore të miratuara nga autoritetet kompetente doganore të marrin këta artikuj, me përjashtim të detyrimeve të importit, ose pajisje e instrumente të blera nga këto autoritete shëndetësore, spitale a institucione kërkimore mjekësore krejtësisht me fonde të dhuruara nga organizata bamirësie apo filantropike ose me kontribute vullnetare, me kusht që gjithmonë të provohet se:

a) dhurimi i instrumenteve ose aparateve në fjalë nuk fsheh në vetvete asnjë synim tregtar nga ana e dhuruesit; dhe

b) dhuruesi nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me prodhuesin e instrumenteve ose aparateve për të cilat kërkohet përjashtim.

2. Përjashtimi zbatohet gjithashtu, duke iu nënshtruar të njëjtave kushte, për:

a) pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse ose aksesorët e përshtatshëm pikërisht për instrumentet ose aparatet e përmendura më sipër, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse ose pjesë ndihmëse të importohen në të njëjtën kohë me ato instrumente apo aparate, ose kur janë importuar më vonë, të mund të identifikohen se destinohen për instrumente apo aparate të importuara më parë me përjashtim nga detyrimet e importit;

b) veglat që përdoren për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin ose riparimin e instrumenteve apo aparateve, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjtën kohë me instrumentet ose aparatet në fjalë, ose kur importohen më pas, të mund të identifikohen si vegla që destinohen për instrumente ose aparate të importuara më parë me përjashtim nga detyrimet e importit.

Neni 158
Të tjera

Për qëllim të nenit 157 dhe posaçërisht në lidhje me instrumentet apo aparatet dhe subjektet përfituese të përmendura më lart, zbatohen nenet 147, 148 dhe 149, rast pas rasti në mënyrë analoge.

Seksioni 15
Substancat referuese për kontrollin e cilësisë së produkteve mjekësore

Neni 159
Substancat referuese

Përjashtohen nga detyrimet e importit dërgesat të cilat përmbajnë mostra të substancave referuese, të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, për kontrollin cilësor të materialeve të përdorura në prodhimin e produkteve mjekësore dhe të cilat u adresohen pritësve të autorizuar nga autoritetet doganore kompetente të Republikës së Shqipërisë për të marrë të tilla dërgesa.

Seksioni 16
Produktet farmaceutike për t'u përdorur në veprimtari sportive ndërkombëtare

Neni 160

Përjashtohen nga detyrimet e importit produktet farmaceutike për përdorim mjekësor njerëzor apo veterinar, nga personat ose kafshët që vijnë nga vende të tjera për të marrë pjesë në aktivitete sportive ndërkombëtare, të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të arsyeshëm për të plotësuar kërkesat gjatë gjithë qëndrimit në këtë territor.

Seksioni 17
Mallra për organizata bamirësie ose filantropike; artikuj të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara

Nënseksioni 17.1
Për qëllime të përgjithshme

Neni 161
Mallra për organizata bamirësie ose filantropike

1. Në përputhje me nenet 163 dhe 164, të këtij ligji, importohen me përjashtim nga detyrimet e importit, për aq sa të mos krijojnë mundësi për abuzime ose shtrembërime të konkurrencës:

a) mallra të nevojave bazë, të importuara nga institucione shtetërore, organizata bamirëse, filantropike ose fetare, të miratuara nga autoritetet doganore kompetente për t'iu shpërndarë falas personave në nevojë;

b) mallra të çfarëdolloj përshkrimi, të dërguara falas nga një person apo organizatë e vendosur në një vend jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për qëllime jotregtare nga ana e dërguesit, për institucione shtetërore apo organizata të tjera bamirëse, filantropike ose fetare, të miratuara nga autoritetet doganore kompetente për t'u përdorur për mbledhje fondesh në evente/ngjarje të posaçme bamirësie, për personat në nevojë;

c) materiale dhe pajisje zyre të dërguara falas, nga një person ose një organizatë e vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe pa qëllime tregtare nga ana e dërguesit, për institucione shtetërore, organizata bamirëse, filantropike ose fetare, të miratuara nga autoritetet doganore kompetente, mallra këto për t'u përdorur vetëm për të plotësuar nevojat e ushtrimit të aktivitetit të tyre bamirës apo filantropik;

ç) materiale dhe pajisje për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve fetare të kultit, të institucioneve me karakter fetar, dhe mallra të tjera, të nevojshme për t'u përdorur nga këto institucione vetëm për zhvillimin e veprimtarive fetare;

d) materiale dhe pajisje për ndërtimin, rikonstruksionin e ujësjellësve, centraleve elektrike, shkollave, spitaleve, që financohen nga institucionet fetare.

2. Për qëllim të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, "nevoja bazë" nënkupton ato mallra që nevojiten për të plotësuar nevojat elementare të qenieve njerëzore, si për shembull: ushqime, barna, veshje dhe shtresa ose mbulesa krevati.

Neni 162
Mallra për të cilat nuk jepet përjashtim

Nuk jepet përjashtim për:

a) produktet e alkoolit;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) kafen dhe çajin;

ç) automjetet që janë të ndryshme nga ambulancat.

Neni 163
Kushtëzime

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat që kanë procedura kontabiliteti, të cilat i lejojnë autoritetet doganore kompetente të mbikëqyrin veprimtarinë e tyre dhe që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme.

Neni 164
Kushtëzime të tjera

1. Organizatat që përfitojnë nga përjashtimi nuk mund të japin hua, me qira, të tjetërsojnë, falas ose kundrejt pagesës, mallrat apo pajisjet e referuara në nenin 161, për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 161, të këtij ligji, pa njoftuar më parë autoritetet doganore kompetente.

2. Në rast se mallrat dhe pajisjet e përmendura me sipër i jepen hua, me qira apo i tjetërsohen një organizate që ka të drejtë të përfitojë përjashtim sipas neneve 161 dhe 163, përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që organizata e fundit të përdorë mallrat dhe pajisjet për qëllime që përputhen me arsyen e dhënies së përjashtimit.

Në rast të kundërt, huadhënia, qiradhënia apo tjetërsimi bëhet vetëm pas pagesës së detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën e dhënies hua, dhënies me qira apo tjetërsimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose të pranuar nga autoritetet doganore kompetente në atë datë.

Neni 165
Mospërmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Organizatat e përmendura në nenin 161, të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar përjashtimin, ose të cilat propozojnë përdorimin e mallrave dhe pajisjeve të përjashtuara nga detyrimet e importit, për qëllime të ndryshme nga ato të përshkruara në nenin në fjalë, duhet të njoftojnë për këtë qëllim autoritetet doganore kompetente.

2. Mallrat dhe pajisjet që mbeten në posedim të organizatave të cilat nuk përmbushin më kushtet për të përfituar përjashtim, janë objekt i pagesës së detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën në të cilën kushtet pushuan së ekzistuari, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar ose pranuar nga autoritetet kompetente doganore në atë datë.

3. Mallrat dhe pajisjet e përdorura nga organizatat që përfitojnë nga përjashtimi, për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 161, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën në të cilën ato janë vendosur në një përdorim tjetër, mbi bazën e llojit të mallrave dhe pajisjeve, si dhe të vlerës doganore të verifikuar ose pranuar në datën në fjalë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 17.2
Në dobi të personave me aftësi të kufizuara

I. Për qëllime të nënseksionit 17.2, dispozitat e mëposhtme janë për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë.

Neni 166
Artikujt për përdorim nga të verbrit

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 11, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 167
Kushtëzime

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 12, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga:

a) vetë personat e verbër për nevojat e tyre; ose

b) institucione apo organizata që merren me edukimin apo dhënien e ndihmës për persona të verbër, të autorizuara nga autoritetet doganore kompetente të marrin këta artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1, zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse përkatëse të artikujve në fjalë dhe për veglat që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse, pjesë ndihmëse apo vegla të jenë importuara në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato mund të identifikohen se të jenë të destinuara për artikujt që janë lejuar më parë me përjashtim nga detyrimet e importit, apo të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtim i tillë kërkohet për pjesët specifike të këmbimit/rezervë, komponentët apo pajisjet ndihmëse dhe veglat në fjalë.

II. Për qëllime të nënseksionit 17.2, dispozitat e mëposhtme janë për kategorinë e personave të tjerë me aftësi të kufizuara.

Neni 168
Artikujt për përdorim të personave të tjerë me aftësi të kufizuara

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për arsimim, punësimin apo për zhvillim shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, pa përfshirë personat e verbër, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga:

a) vetë personat me aftësi të kufizuara për nevojat e tyre personale; ose

b) institucione apo organizata të angazhuara kryesisht me edukimin apo dhënien e ndihmës për personat me aftësi të kufizuara, të autorizuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë këta artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.

2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse posaçërisht për artikujt në fjalë dhe për veglat, që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse, pajisje ndihmëse apo vegla të jenë importuar në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato të mund të identifikohen se janë të destinuara për artikujt që janë përjashtuar më parë nga detyrimet e importit, apo të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtimi i tillë kërkohet për pjesë këmbimi/rezervë, komponentë apo pajisje ndihmëse dhe vegla specifike në fjalë.

Neni 169
Mbrojtja e interesave të industrisë

Nëse është e nevojshme, disa artikuj mund të përjashtohen nga e drejta për përjashtim, nëse vërtetohet se përjashtimi i këtyre artikujve nga detyrimet është i dëmshëm për interesat e industrisë së Shqipërisë, për sektorin përkatës të prodhimit.

III. Për qëllime të nënseksionit 17.2, dispozitat e mëposhtme janë të përbashkëta.

Neni 170
Statusi i personave të verbër ose me aftësi të kufizuara

Dhënia e përjashtimit të drejtpërdrejtë për personat e verbër apo për persona të tjerë me aftësi të kufizuara, për përdorimin e tyre personal, siç është përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 167, dhe në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 168, do t'i nënshtrohet kushteve të legjislacionit në fuqi për përcaktimin statusit të tyre si persona të verbër ose me aftësi të kufizuara që i jep të drejtën për një përjashtim të tillë.

Neni 171
Kushtëzime

1. Artikujt e importuar me detyrime importi të përjashtuara nga një person i përmendur në nenet 167 dhe 168, të këtij ligji, nuk mund të huazohen, jepen me qira apo të transferohen, me apo pa pagesë, pa i njoftuar paraprakisht autoritetet doganore kompetente.

2. Nëse një artikull jepet hua, me qira apo transferohet te një person, institucion apo organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi në përputhje me nenet 167 dhe 178, atëherë përjashtimi jepet me kusht që personi, institucioni ose organizata ta përdorë artikullin për qëllime që i japin të drejtën për një përjashtim të tillë.

Në raste të tjera huazimi, dhënia me qira apo transferimi do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, në nivelin tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferim, në bazë të llojit të mallrave apo pajisjeve dhe vlerës doganore të verifikuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 172
Kushtëzime të tjera

1. Artikujt e importuar nga institucionet ose organizatat të autorizuara për përjashtim nga detyrimet e importit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 167 dhe 168, mund të huazohen, jepen me qira apo të transferohen, me pagesë ose jo, nga këto institucione ose organizata jofitimprurëse te personat e verbër ose me aftësi të kufizuara me të cilët ato kanë lidhje, pa paguar detyrimet përkatëse të importit.

2. Asnjë huadhënie, dhënie me qira apo transferim nuk mund të jepet nën kushte të tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nëse nuk janë informuar më parë autoritetet kompetente doganore.

Nëse një artikull që huazohet, jepet me qira apo transferohet te një person, institucion ose organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi, sipas pikës 1, të nenit 167, ose pikës 1, të nenit 168, përjashtimi jepet me kusht që personi, institucioni ose organizata ta përdorë artikullin për qëllime që i japin të drejtën për një përjashtim të tillë.

Në raste të tjera, huadhënia, dhënia me qira apo transferimi do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor të zbatuar në datën e huadhënies, dhënies me qira ose transferimit, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve, si edhe vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 173
Mospërmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Institucionet apo organizatat e përmendura në nenet 167 dhe 168, të cilat nuk përmbushin më kushtet që u japin të drejtën për përjashtim, ose që synojnë të përdorin artikujt e pranuar pa detyrime importi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga këto nene, duhet të informojnë autoritetet kompetente doganore.

2. Artikujt që mbeten në posedim të institucioneve apo organizatave të cilat pushojnë së përmbushuri kushtet për përfitimin e përjashtimit do t'u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën kur nuk plotësohen më kushte, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore, të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Artikujt e përdorur nga institucioni apo organizata përfituese nga përjashtimi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në nenet 167 dhe 168, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, sipas normës që zbatohet në datën kur ato janë vendosur për një përdorim tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të verifikuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Nënseksioni 17.3
Në dobi të viktimave të fatkeqësive

Neni 174
Mallra në dobi të viktimave të fatkeqësive

1. Në përputhje me nenet 175 deri 180, mallrat e importuara nga institucionet publike ose institucionet buxhetore shtetërore apo nga organizata të tjera bamirëse, filantropike ose fetare, të miratuara prej autoriteteve doganore kompetente, për këtë qëllim, përjashtohen nga detyrimet e importit, kur destinohen:

a) për shpërndarje falas viktimave të fatkeqësive, që godasin territorin doganor të Republikës së Shqipërisë; ose

b) për t'ua vënë në dispozicion falas të viktimave të fatkeqësive të tilla, ndonëse mbeten pronë e organizatave në fjalë.

2. Mallrave të importuara për qarkullim të lirë nga agjencitë, shoqatat apo strukturat e miratuara që ndihmojnë për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë, për plotësimin e nevojave të tyre gjatë periudhës së veprimtarisë, gjithashtu do t'u jepet përjashtimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, nën të njëjtat kushte.

Neni 175
Kufizime

Asnjë përjashtim nuk do të jepet për materiale dhe pajisje që kanë për qëllim rindërtimin e zonave të fatkeqësive.

Neni 176
Dhënia e përjashtimit

Dhënia e përjashtimit për qëllime të nënseksionit 17.3 do të jetë objekt i një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Ky vendim, sipas nevojës, përcakton qëllimin dhe kushtet e përjashtimit.

Neni 177
Procedurat e kontabilitetit

Përjashtim përfitojnë vetëm organizatat që përdorin procedura kontabiliteti të cilat i lejojnë autoritetet doganore kompetente të mbikëqyrin veprimtarinë e tyre dhe që ofrojnë të gjitha garancitë që konsiderohen të nevojshme.

Neni 178
Kushtëzime

1. Organizatat që përfitojnë nga përjashtimi nuk mund të huazojnë, japin me qira apo transferojnë, me apo pa pagesë, mallrat e referuara në pikën 1, të neni 174, në kushte të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 174, pa njoftuar më parë autoritetet kompetente doganore.

2. Nëse mallrat jepen hua, me qira apo transferohen te një organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga përjashtimi sipas nenit 174, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që kjo organizatë t'i përdorë mallrat për të njëjtin qëllim për të cilin jepet e drejta e përjashtimit.

Në raste të tjera, dhënia hua, me qira apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 179
Kushtëzime të tjera

1. Mallrat e referuara në shkronjën "b", pika 1, të nenit 174, në momentin që nuk përdoren më nga të dëmtuarit në katastrofa, nuk mund të jepen hua, me qira apo të transferohen me pagesë apo falas, pa njoftuar paraprakisht autoritetet doganore kompetente.

2. Nëse mallrat jepen hua, me qira apo i transferohen organizatës e cila vetë gëzon të drejtën e përfitimit të përjashtimit sipas nenit 174 ose, sipas rastit, i jepet organizatës e cila gëzon të drejtën e përfitimit të përjashtimit sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 161, përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që organizatat e tilla t'i përdorin ato për të njëjtat qëllime për të cilat jepet përjashtimi.

Në rastet të tjera, huazimi, dhënia me qira apo transferimi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e dhënies hua, me qira apo të transferimit në bazë të llojit të mallrave dhe të vlerës doganore të konstatuar apo të pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Neni 180
Mospërmbushja e kushteve për të përfituar përjashtim

1. Organizatat e përmendura në nenin 174, të cilat nuk vazhdojnë të përmbushin kushtet për të përfituar përjashtim apo të cilat dëshirojnë të përdorin mallrat e përjashtuara nga detyrimet e importit për qëllime tjera nga ato të parashikuara nga ai nen, duhet të njoftojnë për këtë autoritetet doganore kompetente.

2. Mallrat që mbeten në posedim të organizatave të cilat nuk vazhdojnë t'i plotësojnë kushtet e përfitimit të përjashtimit, kur këto mallra transferohen te një organizatë, e cila, po ashtu, gëzon të drejtën e përjashtimit sipas nenit 174 ose, sipas

rastit, te një organizatë që gëzon të drejtën e përjashtimi në zbatim të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 161, të këtij ligji, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet, me kusht që kjo organizatë t'i shfrytëzojë mallrat për ato qëllime për të cilat ajo gëzon të drejtën e përjashtimit. Në raste të tjera mallrat do t'i nënshtrohen pagesës së detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën kur kushtet e tilla nuk vazhdojnë të përmbushen, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

3. Mallrat e përdorura nga organizata që kanë përfituar nga përjashtimi për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në nenin 174, u nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, sipas nivelit tarifor të zbatuar në datën në të cilën ato janë vendosur për një përdorim tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar ose pranuar në atë datë nga autoritetet doganore kompetente.

Seksioni 18
Dekoratat apo çmimet e nderit

Neni 181
Kufizime

Përjashtohen nga detyrimet e importit, nëse paraqiten prova të mjaftueshme pranë autoritetit doganor kompetent nga personat përkatës dhe me kusht që veprimet e përfshira të mos jenë në ndonjë mënyrë të karakterit tregtar:

a) dekoratat e dhëna nga qeveritë e huaja për ata persona vendqëndrimi (vendbanimi) i të cilëve është në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tërësisht simbolike, të cilat u janë dhënë shpërblim jashtë Republikës së Shqipërisë, personave që kanë vendqëndrimin (vendbanimin) në Republikën e Shqipërisë, si shenjë nderi për veprimtarinë e tyre në fushën e artit, shkencës, sportit apo shërbimeve publike apo si një mirënjohje për suksesin e arritur në një ngjarje të veçantë, të cilat importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vetë ata persona;

c) kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tërësisht simbolike, të cilat jepen falas nga autoritete apo persona jashtë Republikës së Shqipërisë, për t'u prezantuar në Shqipëri për të njëjtat qëllime si ato të përcaktuara në shkronjën "b", të këtij neni;

ç)çmime, trofe dhe dhurata të një natyre simbolike dhe me vlerë të kufizuar të destinuara për shpërndarje falas personave me vendbanim normal jashtë Republikës së Shqipërisë, në konferenca biznesi ose aktivitete të ngjashme ndërkombëtare; natyra, vlera për njësi ose karakteristika të tjera e të cilave, nuk duhet të jenë të tilla që mund të tregojnë se ato janë importuar për arsye tregtare.

Seksioni 19
Dhurata të marra në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare

Neni 182
Përjashtimi për dhurata në kuadrin e marrëdhënieve Ndërkombëtare

Kur është rasti, pa cenuar nenin 134, dhe në përputhje me nenet 183 dhe 184 , përjashtimi jepet për mallra të cilat:

a) janë importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona që kanë bërë një vizitë zyrtare në një vend tjetër dhe të cilët i kanë marrë ato mallra si dhurata nga autoritetet mikpritëse;

b) janë importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga persona që vijnë për vizitë zyrtare në Shqipëri dhe që kanë për qëllim t'i ofrojnë mallrat si dhurata për autoritetet mikpritëse;

c) janë dërguar si dhuratë, në shenjë të miqësisë apo të vullnetit të mirë, nga një organ zyrtar apo autoritet publik, që kryen një aktivitet në interes të publikut, i cili është vendosur në një vend tjetër, për një organ zyrtar ose autoritet publik që kryen një aktivitet në interes të publikut, i cili ndodhet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga autoritetet kompetente doganore për të marrë artikuj të tillë me përjashtim nga detyrimet e importit.

ç)janë dërguar si dhuratë për përdorim nga njësitë ushtarake të Forcave të Armatosura dhe strukturave të Policisë së Shtetit, si: instrumente, aparate dhe pjesët e tyre, veshmbathje, si dhe materiale logjistike, shëndetësore, makineri dhe pajisje.

Neni 183
Produkte që nuk përfitojnë përjashtim

Nuk përfitojnë përjashtim produktet e alkoolit, duhani apo produktet e duhanit.

Neni 184
Kushtëzime

Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet vetëm nëse:

a) artikujt e destinuar si dhurata ofrohen mbi baza rastësore;

b) artikujt nuk pasqyrojnë qoftë për nga natyra, vlera apo sasia e tyre, ndonjë interes tregtar;

c) artikujt nuk përdoren për qëllime tregtare.

Seksioni 20
Mallra për t'u përdorur nga personalitetet e larta të shtetit

Neni 185
Përjashtimi për personalitetet e larta të shtetit

1. Do të përjashtohen nga detyrimet e importit;
a) dhurata për krerët e shtetit;
b) mallra për t'u përdorur apo konsumuar nga monarkët në pushtet dhe Krerët e Shtetit të vendeve të tjera, ose persona që zyrtarisht përfaqësojnë ata, gjatë qëndrimeve të tyre zyrtare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, përjashtimi mund të bëhet në varësi të parimit të reciprocitetit.
2. Përcaktimet e pikës 1, janë gjithashtu të zbatueshme për personat që gëzojnë privilegje në nivele ndërkombëtare analoge me ato që gëzojnë monarkët në pushtet ose Krerët e Shtetit.

Seksioni 21
Mallra të importuara me qëllim nxitjen e tregtisë

Nënseksioni 21.1
Mostra të mallrave me vlerë të papërfillshme

Neni 186
Mostrat e mallrave

1. Pa cenuar shkronjën "a" të pikë 1 të nenit 190, mostrat e mallrave të cilat janë të një vlerë të papërfillshme dhe të cilat mund të përdoren vetëm për të nxitur porosinë e mallrave të llojit që ato përfaqësojnë, me qëllim të importimit të tyre në Shqipëri, do të përjashtohen nga detyrimet e importit.
2. Autoriteti doganor kompetent, mund të kërkojnë që disa artikuj, për t'u përjashtuar sipas këtij neni, të bëhen përgjithmonë të papërdorshme, duke u grisur, shpuar, apo duke vendosur shenja të qarta dhe që nuk hiqen, ose me ndonjë proces tjetër, me kusht që këto veprime nuk dëmtojnë karakteristikat thelbësore të mostrave.
3. Për qëllime të pikës 1, "mostra të mallrave" janë çdo artikull që përfaqëson një lloj malli, që nga mënyra e prezantimit dhe sasia e tyre, për mallra të njëjtë ose cilësi njëjtë, nuk mundëson përdorimin e tyre për asnjë qëllim tjetër përveç asaj të nxitjes së porosive për atë mall.

Nënseksioni 21.2
Material i shtypur/printuar dhe ai reklamues

Neni 187
Materialet e shtypura reklamuese

Në përputhje me nenin 188, materialet e shtypura/printuara reklamuese, siç janë: katalogët, listat e çmimeve, udhëzimet për përdorim apo broshurat do të përjashtohen nga detyrimet e importi, me kusht që ato të kenë lidhje me:
a) mallrat për shitje apo dhënie me hua; ose
b) shërbimet e transportit, sigurimit tregtar apo shërbime bankare, që ofrohen nga një person i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 188
Kufizime

Përjashtimi i parashikuar me nenin 187, kufizohet për materialet reklamuese të shtypura që plotësojnë kushtet në vijim:
a) materiali i shtypur të paraqesë në mënyrë të qartë emrin e ndërmarrjes e cila prodhon, shet apo jep me qira mallrat, apo e cila ofron shërbimet që u referohet;
b) secila dërgesë nuk duhet të përmbajë më tepër se një dokument ose një kopje të secilit dokument nëse përbëhet nga disa dokumente; dërgesat që përmbajnë disa kopje të të njëjtit dokument, po ashtu përjashtohen, nëse pesha e përgjithshme e tyre, nuk është më e madhe se një kilogram;
c) materiali i shtypur nuk duhet të jetë pjesë e dërgesave në grup nga i njëjti dërgues për të njëjtin pranues.

Neni 189
Artikujt për qëllime reklamuese

Artikujt për qëllime reklamuese, që nuk kanë një vlerë të vërtetë tregtare dhe që dërgohen falas nga furnitorët për klientët e tyre, të cilat, përveç funksionit reklamues nuk mund të shfrytëzohen për diçka tjetër, përjashtohen nga detyrimet e importi.

Nënseksioni 21.3
Produktet e përdorura apo të konsumuara në një panair tregtar apo në ngjarje të ngjashme

Neni 190
Përjashtime për panaire tregtare apo në ngjarje të ngjashme

1. Në përputhje me nenet 191 deri 194, përjashtohen nga detyrimet e importit:
a) mostra të vogla përfaqësuese të mallrave të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së

Shqipërisë, që destinohen për panaire tregtare apo për ngjarje të ngjashme;

b) mallrat e importuara vetëm për t'u demonstruar apo për të demonstruar makineritë dhe aparaturat e prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të ekspozuara në një panair tregtar apo në një ngjarje të ngjashme;

c) lëndë të ndryshme të një vlere të vogël siç janë ngjyrat, bojërat, letër muri etj., që përdoren për ndërtimin, rregullimin dhe dekorimin e stendave, ku janë vendosur përfaqësuesit e huaj në një panair tregtar apo një ngjarje të ngjashme, të cilat shkatërrohen duke u përdorur;

ç) material i shtypur, katalogë, prospekte, lista çmimesh, afishe reklame, kalendarë, me ilustrime apo jo, fotografi pa korniza, si dhe artikuj të tjerë të ofruar falas për reklamimin e mallrave të prodhuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të ekspozuara në një panair tregtar apo në një ngjarje të ngjashme.

2. Për qëllime të pikës 1, "panair tregtar apo ngjarje e ngjashme", nënkupton:

a) ekspozita, panaire, shfaqje dhe ngjarje të ngjashme që kanë të bëjnë me tregtinë, industrinë, bujqësinë apo artizanatin;

b) ekspozita dhe ngjarje që mbahen kryesisht për arsye bamirësie;

c) ekspozita dhe ngjarje që mbahen kryesisht për arsye shkencore, teknike, artizanati, artistike, edukative ose kulturore, apo sportive, për arsye fetare apo kulti, aktivitete të sindikatave apo për turizëm, apo me qëllim të promovimit të njohjes ndërkombëtare;

ç) takime të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare apo organeve kolegjiale;

d) ceremoni dhe mbledhje zyrtare ose përkujtimore.

Nuk përfitojnë ekspozita për qëllime private në dyqanet apo objektet tregtare për të shitur mallra të vendeve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 191
Kufizime

Përjashtimet e parashikuara me shkronjën "a" pika 1 e nenit 190, kufizohen në mostra të cilat:

a) janë importuar pa pagesë si të tilla nga vende të tjera apo janë përfituar në ekspozitë nga mallra të importuara me shumicë nga ato vende;

b) ekskluzivisht shpërndahen falas për publikun nëpër ekspozita për përdorim apo konsumim nga personat të cilëve u janë ofruar;

c) janë të identifikueshme si mostra reklamuese me vlera të ulëta për njësi;

ç) nuk tregtohen lehtë dhe, kur paraqitet rasti, paketohen në atë mënyrë që sasia e artikullit përkatës është më e ulët se sasia më e vogël e të njëjtit artikull që shitet në treg;

d) në rastin e ushqimeve dhe pijeve që nuk janë të paketuara në mënyrën e përmendur në shkronjën "ç", konsumohen aty për aty në ekspozitë;

dh) për nga vlera dhe sasia e përgjithshme e tyre, i përshtaten natyrës së ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrjeve në ekspozitë.

Neni 192
Kufizime të tjera

Përjashtimet e përcaktuara në shkronjën "b" pika 1 e nenit 190, do të kufizohen për mallra, të cilat:

a) janë konsumuar apo shkatërruar në ekspozitë; dhe

b) janë të përshtatshme, për nga vlera totale dhe sasia, natyra e ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 193
Kufizime

Përjashtimet e parashikuara në shkronjën "ç", pika 1 e nenit 190, kufizohen për materialet e shtypur dhe artikujt për qëllime reklamimi, të cilat:

a) ekskluzivisht kanë për qëllim që të shpërndahen falas për publikun në vendin ku mbahet ekspozita;

b) për nga vlera dhe sasia totale e tyre, i përshtaten natyrës së ekspozitës, numrit të vizitorëve dhe kapacitetit të pjesëmarrësve në ekspozitë.

Neni 194
Ndalime

Përjashtimet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 190, nuk lejohen për:

a) produktet e alkoolit;

b) duhanin dhe produktet e duhanit;

c) karburantet, qoftë në gjendje të ngurtë, lëngët apo të gaztë.

Seksioni 22
Mallrat e importuara për qëllime ekzaminimi, analizash ose testi

Neni 195
Përjashtime për mallrat të cilat i nënshtrohen ekzaminimeve, analizave apo testeve

Në përputhje me nenet 196 deri 201, mallrat të cilat i nënshtrohen ekzaminimeve, analizave apo testeve për të përcaktuar përbërjen, cilësinë apo karakteristikat e tjera teknike të tyre për qëllime informimi apo për kërkime industriale ose tregtare përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 196
Kushtëzime

Pa cenuar nenin 199, përjashtimet e përcaktuara në nenin 195, jepen vetëm me kusht që mallrat që do të ekzaminohen, analizohen apo testohen do të shfrytëzohen apo shkatërrohen plotësisht gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit.

Neni 197
Mallra që nuk përjashtohen

Mallrat e përdorura gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit të cilat në vetvete paraqesin qëllimin e promovimit të shitjes, nuk përjashtohen.

Neni 198
Kushtëzime për sasinë e mallrave

Përjashtimi jepet vetëm për ato sasi mallrash të cilat janë në mënyrë strikte të nevojshme për qëllimin për të cilin importohen. Këto sasi do të përcaktohen për secilin rast nga autoritetet doganore, duke marrë parasysh qëllimin në fjalë.

Neni 199
Kushtëzime të tjera

1. Përjashtimet e përcaktuara në nenin 195, përfshijnë mallrat të cilat nuk janë konsumuar tërësisht apo shkatërruar gjatë ekzaminimit, analizës apo testimit, me kusht që produktet e mbetura, me marrëveshje dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore kompetente:

a) janë shkatërruar krejtësisht apo janë bërë të pavlefshme nga ana tregtare me përfundimin e ekzaminimit, analizës apo testimit; ose

b) janë dorëzuar pranë Rezervave të Shtetit pa shkaktuar ndonjë shpenzim; ose

c) janë eksportuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në rrethana tërësisht të justifikuara.

2. Për qëllime të pikës 1, "produktet e mbetura" nënkuptohen produktet që rezultojnë nga ekzaminimi, analiza apo testimi apo mallrat që nuk janë përdorur.

Neni 200
Produktet e mbetura pas përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit

1. Me përjashtim të rasteve kur zbatohet pika 1 e nenit 199, produktet e mbetura pas përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit të referuara në nenin 195, janë objekt i detyrimeve përkatëse të importit sipas nivelit tarifor që zbatohet në datën e përfundimit të ekzaminimit, analizës apo testimit, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar dhe pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente.

2. Megjithatë, pala e interesuar me marrëveshje dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore kompetente mund t'i shndërrojë produktet e mbetura në mbeturina apo skrap. Në këtë rast, detyrimet e importit janë ato që zbatohen për mbeturina të tilla ose skrap në momentin e shndërrimit.

Neni 201
Afatet kohore

Afatet kohore brenda së cilës duhet të kryhen ekzaminimet, analizat apo testet, si edhe të përfundohen formalitetet administrative, për të garantuar përdorimin e mallrave për qëllimet e destinuara, përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente në autorizimin përkatës.

Seksioni 23
Dërgesat për organizatat që mbrojnë të drejtat e autorit ose patentës industriale dhe tregtare

Neni 202
Përjashtimi për markat tregtare, modelet, disenjot dhe dokumentet shoqëruese të tyre

Markat tregtare, modelet apo disenjot, si dhe dokumentet shoqëruese të tyre, si edhe aplikimet për patentë për shpikje apo të ngjashme me të, që i dorëzohen organeve kompetente për mbrojtën e të drejtave të autorit apo për mbrojtjen e të drejtave të patentave industriale apo tregtare, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Seksioni 24
Botimet informuese me karakter turistik

Neni 203
Përjashtimi për botimet informuese me karakter turistik

Pa cenuar nenet 142 deri 150, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) Dokumentacioni (fletëpalosjet, broshurat, librat, revistat, librat udhëzues, posterat/afishet në kornizë ose jo, fotografitë pa kornizë dhe zmadhimet fotografike, hartat të ilustruara apo jo, letrat transparente për xhamat/dritaret dhe kalendarë të ilustruar) për t'u shpërndarë falas dhe qëllimi kryesor i të cilëve është të nxisë publikun të vizitojë vende të tjera, veçanërisht për të ndjekur takime ose aktivitete kulturore, turistike, sportive, fetare ose tregtare apo profesionale, me kusht që një literature e tille të mos përmbajë më shumë se 25% reklamë tregtare private, duke përjashtuar gjithë reklamën private tregtare për shoqëritë e Republikës së Shqipërisë, dhe që nga vetë

natyra e këtyre aktiviteteve të pasqyrohet dukshëm qëllimi i nxitjes së tregtisë;

b) Lista hotelesh të huaja dhe vjetar të botuar nga agjenci turistike zyrtare, ose nën kujdesin e tyre, orari për shërbimin e huaj të transportit, kur një literature e tillë destinohet të shpërndahet falas dhe nuk përmban më shumë se 25% reklamë private tregtare, duke përjashtuar gjithë reklamat tregtare për shoqëritë e Republikës së Shqipërisë;

c) Materiale reference të paraqitura nga përfaqësues të akredituar ose korrespondentë të emëruar nga agjenci turistike kombëtare zyrtare, të cilat nuk destinohen për shpërndarje, si p.sh. vjetarë, listat e abonentëve telefonikë ose teleksit, lista e hoteleve, katalogët e panaireve, modele të mallrave të artizanatit me vlerë të papërfillshme, dhe literaturë mbi muzetë, universitetet, qendrat termale ose institucione analoge.

Seksioni 25
Dokumente dhe artikuj të ndryshëm

Neni 204
Përjashtime për artikuj të ndryshëm

Përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) dokumentet e dërguara falas për institucionet publike të Republikës së Shqipërisë;

b) publikime të qeverive të huaja dhe publikime zyrtare të institucioneve ndërkombëtare, për t'u shpërndarë falas;

c) fletë votime për zgjedhje të organizuara nga institucione të ngritura në vende të tjera;

ç) objekte për t'u paraqitur si provë ose për qëllime të ngjashme në gjykata dhe agjenci të tjera zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

d) modele nënshkrimesh dhe qarkore që kanë të bëjnë me nënshkrimet e dërguara si pjesë e shkëmbimeve të zakonshme të informacionit midis shërbimeve publike ose institucioneve bankare;

dh) materiale zyrtare të shtypura që i dërgohen Bankës së Shqipërisë;

e) raporte, deklarata, shënime, prospekt, formularë aplikimesh dhe dokumente të tjera të hartuara nga shoqëri të regjistruara në vende të tjera dhe të dërguara mbajtësve ose nënshkruesve të titujve të lëshuar prej këtyre shoqërive;

ë) regjistrimet mediatike (skeda me vrima, regjistrime zanore, mikrofilma etj.) të përdorura për transmetimin e informacionit të dërguar falas pritësve, me kusht që përjashtimi nga detyrimet e importit nuk krijon mundësi për abuzime ose shtrembërime të mëdha të parimeve të konkurrencës;

f) fashikuj, arkiva, formularë të shtypur dhe dokumente të tjera për t'u përdorur në mbledhje, konferenca ose kongrese ndërkombëtare dhe raporte mbi këto mbledhje;

g) plane, skica teknike, disenjo në kalk, përshkrime dhe dokumente të tjera të ngjashme, të importuara për të tërhequr ose kryer porosi në vende të tjera ose për të marrë pjesë në kohë të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

gj) dokumente që përdoren gjatë provimeve të organizuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga institucione me qendër në vende të tjera;

h) formularë të shtypur për t'u përdorur si dokumente zyrtare në qarkullimin ndërkombëtar të automjeteve ose mallrave, në kuadrin e konventave ndërkombëtare;

i) formularë, etiketa, bileta dhe dokumente të ngjashme të dërguara nga agjenci transporti ose nga sipërmarrje të industrisë së hotelerisë në një vend tjetër për agjenci udhëtimi të krijuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

j) formularë dhe bileta, dokumente transporti (*bill of lading ose way-bills*) dhe dokumente të tjera tregtare ose zyrtare, të përdorura;

k) formularë zyrtare të shtypur nga një vend tjetër ose nga autoritete ndërkombëtare, dhe materiale të shtypura në përputhje me standardet ndërkombëtare, të dërguara për shpërndarje nga shoqata të vendeve të tjera në adresë të shoqatave homologe që gjenden në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

l) fotografi, diapozitivë dhe kartonë për matrica fotografish, që mund të përmbajnë edhe udhëzime të dërguara nga agjenci shtypi ose agjenci botuese gazetash dhe revistash;

ll) pulla takse dhe pulla të ngjashme që tregojnë pagimin e detyrimeve në vende të tjera;

m) kartëmonedha dhe monedha në përdorim, që i dërgohen bankave ose organeve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Seksioni 26
Materiale të ndryshme, për të fiksuar dhe ruajtur mallrat gjatë transportit të tyre

Neni 205
Përjashtime për materialet që përdoren për ruajtjen e mallrave gjatë transportit

Përjashtohen nga detyrimet e importit materialet e ndryshme, të tilla si: litarë, kashtë, copa tekstili, letër dhe karton, lëndë drusore dhe plastike, të cilat përdoren për sistemimin dhe mbrojtjen, përfshirë këtu edhe mbrojtjen nga nxehtësia, për mallrat gjatë transportit, nga një vend tjetër, për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, të pa ripërdorshme.

Seksioni 27
Shtrojet, foragjeret dhe ushqimet që nevojiten gjatë transportit të kafshëve

Neni 206
Përjashtime për shtrojet, foragjeret dhe ushqimet që nevojiten gjatë transportit të kafshëve

Përjashtohen nga detyrimet e importit shtrojet, foragjeret dhe ushqimet për kafshët, të çdo lloji, të cilat janë ngarkuar në mjetin e transportit që përdoret për transportimin e kafshëve nga një vend tjetër për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, për t'u përdorur/konsumuar gjatë udhëtimit.

Seksioni 28
Karburanti dhe lubrifikantët në depozitën e mjeteve motorike tokësore, si dhe në depozita për përdorim të veçantë

Neni 207
Përjashtime për karburantin dhe lubrifikantët

1. Në përputhje me nenet 208, 209 dhe 210, përjashtohen nga detyrimet e importit:

a) karburanti që mbahet në serbatorët e zakonshëm të:

i) automjeteve tregtare apo private, dhe motoçikletave;

ii) depozitave të posaçme,

që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

b) karburanti që mbahet në serbatorë të lëvizshëm, që transportohen nga automjete private dhe motoçikleta, me një maksimum prej 10 litra për mjet dhe pa cenuar legjislacionin në fuqi lidhur me mbajtjen dhe transportin e karburantit.

2. Për qëllime të pikës 1:

a) "automjet tregtar" është çdo automjet rrugor i motorizuar (përfshirë traktorët rrugorë me ose pa rimorkio), i cili nga vetë lloji i ndërtimit dhe i pajisjeve që ka është i projektuar dhe është në gjendje për transportim, me ose pa pagesë, të:

i) më shumë se nëntë persona, përfshirë shoferin;

ii) mallrave,

si dhe çdo automjet rrugor për qëllime të posaçme, që në thelb është i ndryshëm nga një transport i tillë;

b) "automjet privat" është çdo automjet, përveç atyre të cilët përfshihen në përkufizimin e referuar në shkronjën "a";

c) "serbatorë të zakonshëm" janë:

i) serbatorët e vendosur në mënyrë të përhershme nga prodhuesi te të gjitha automjetet e të njëjtit lloj me automjetin në fjalë dhe ndërtimi i të cilëve lejon përdorimin e drejtpërdrejtë të karburantit, si për lëvizjen e automjeteve, ashtu edhe kur është rasti, për funksionimin, gjatë transportit, të sistemeve të ftohjes dhe të sistemeve të tjera;

ii) serbatorët e gazit të vendosur në automjete të projektuara për përdorimin direkt të gazit si karburant, si dhe serbatorët që i përshtaten sistemeve të tjera, me të cilat është pajisur automjeti,

iii) serbatorët e vendosur në mënyrë të përhershme nga prodhuesi te të gjithë mbajtësit e të njëjtit lloj me mbajtësin në fjalë dhe vendosja e përhershme e të cilit mundëson përdorimin e drejtpërdrejtë të karburantit, gjatë transportit, të sistemeve të ftohjes dhe të sistemeve të tjerë me të cilët mbajtësi i posaçëm është pajisur;

ç) "depozitë e posaçme", është çdo mbajtës i pajisur me aparate veçanërisht të disenjuara për sistemet e ftohjes, sistemet e oksigjenimit, sistemet e termike të izolimit ose sisteme të tjera.

Neni 208
Kufizime

Për sa i përket karburantit që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, me urdhër të ministrit të Financave mund të kufizohet zbatimi i përjashtimit deri në kufirin 200 litra për automjet, depozitat e posaçme dhe për çdo udhëtim.

Neni 209
Kufizime të tjera

Me urdhër të ministrit të Financave mund të kufizohet sasia e karburantit të lejuar me përjashtim, në rastin e:

a) automjeteve tregtare që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër zonën e tyre kufitare me thellësi maksimale prej 15 km në vijë ajrore, me kusht që udhëtimet të kryhen nga banues të zonës kufitare;

b) automjete private që i përkasin banuesve të zonës kufitare.

Neni 210
Karburantet e përjashtuara që nuk mund të përdoren

1. Karburantet e përjashtuara nga detyrimet e importit, në bazë të neneve 207, 208 dhe 209, nuk mund të përdoren në një automjet të ndryshëm prej atij në të cilin gjendeshin kur u importuan, as të transferohen nga ai automjet dhe të ruhen në vend tjetër, me përjashtim të rasteve kur duhen kryer riparime të nevojshme në atë automjet, dhe as nuk mund të transferohen nga vetë personi që përfiton prej përjashtimit, si kundrejt pagesës ashtu edhe falas.

2. Mosrespektimi i kësaj dispozite sjell zbatimin e detyrimeve të importit lidhur me produktet në fjalë, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën kur ndodhi mosrespektimi, llojit të mallrave dhe vlerës doganore të konstatuar ose pranuar prej autoriteteve doganore kompetente në atë datë.

Neni 211
Vajrat lubrifikuese

Përjashtimi i referuar në nenin 207, zbatohet edhe për vajrat lubrifikues që gjenden në automjete dhe nevojiten për funksionimin normal të tyre gjatë udhëtimit.

Seksioni 29
Materiale për ndërtimin, mirëmbajtjen apo zbukurimin e përmendoreve apo varrezave të viktimave të luftës

Neni 212
Përjashtimet për viktimat e luftës

Përjashtohen nga detyrimet e importit mallrat e çdo lloji, të importuara nga organizma të autorizuar për këtë qëllim nga autoritetet doganore kompetente, për t'u përdorur për ndërtimin, mirëmbajtjen ose zbukurimin e varrezave, varreve, si dhe përmendoreve për të rënët në luftë të vendeve të tjera, të cilët janë varrosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 30
Arkivole, urnat funerale dhe artikujt dekorativë për funerale

Neni 213
Përjashtimet për funeralet

Përjashtohen nga detyrimet e importit artikujt e mëposhtëm:

a) Arkivolet që mbajnë trupa dhe urnat me hirin e të vdekurve, si dhe lulet, zbukurimet funerale dhe objekte të tjera zbukurimi që i shoqërojnë;

b) Lulet, kurorat dhe objekte të tjera dekorative të sjella nga persona banues në vendet e tjera që marrin pjesë në një funeral, ose të ardhura për të dekoruar varret në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto importe nuk kanë, për nga natyra dhe sasia e tyre, qëllime tregtare.

Seksioni 31
Përjashtime të tjera sipas ligjeve të veçanta

Neni 214
Përjashtime për deputetët

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 184 të Kodit, në përputhje me nenet 215 dhe 216 deputeti, vetëm në një rast gjatë mandatit të tij, gëzon të drejtën e përjashtimit nga detyrimet e importit, për mjetet e punës që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet.

2. Për qëllime të pikës 1, mjete pune janë:

a) automjeti;
b) kompjuteri;
c) faksi;
ç) telefoni;
d) projektori;
dh) fotokopja;
e) diktofoni;
ë) mobile dhe ndriçues zyre.

Neni 215
Procedura e përjashtimit

E drejta e përjashtimit për mjetet e punës, që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet fitohet pas paraqitjes pranë autoriteteve doganore kompetente, të kërkesës për përjashtim të shoqëruar me dokumentin e ushtrimit aktualisht të mandatin si deputet.

Neni 216
Kushtëzime

1. Deputeti që përfiton nga përjashtimi nuk mund ta huazojnë, japi me qira apo transferojë, me apo pa pagesë, automjetin e përjashtuar nga detyrimet e importit sipas nenit 214.

2. Nëse automjeti jepet hua, me qira apo transferohen te një deputet tjetër apo person që gëzon të drejtën e përjashtimit nga detyrimet e importit sipas Kodit, atëherë përjashtimi vazhdon të jepet.

3. Nëse automjeti jepet hua, me qira apo transferohet te një person tjetër i cili nuk përjashtohet nga detyrimet e importit, automjeti i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas nivelit tarifor që zbatohet në ditën e dhënies hua, me qira apo transferimit, në bazë të llojit të automjetit dhe vlerës doganore të konstatuar apo pranuar në atë ditë nga autoritetet doganore kompetente. Pas pagimit të detyrimit të importit, deputeti fiton të drejtën e përjashtimin nga detyrimi i importit për automjetin tjetër.

4. Deputeti nuk mund të ketë, brenda një mandati, më shumë se një automjet, të përjashtuar nga detyrimet e importit.

KREU 3
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 217
Të përgjithshme

Titulli VII, zbatohet si për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë që vijnë direkt nga vendet e tjera, ashtu edhe për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë pasi i janë nënshtruar një regjim tjetër doganore.

Neni 218
Masat e nevojshme

Autoritetet kompetente doganore, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, kur përjashtimi nga detyrimet e importit është dhënë me kusht të vendosjes së mallrave në një përdorim të veçantë nga marrësi, të mos përdoren për qëllime të tjera pa paguar më parë detyrimet e importit, përveçse kur një përdorim i ndryshëm përputhet me kushtet e përcaktuara në këtë vendimi.

Neni 219
Plotësimi i kushteve njëkohësisht nga i njëjti person

Kur i njëjti person në të njëjtën kohë plotëson kushtet e përcaktuara për dhënien e përjashtimit nga detyrimet e importit, në bazë të më shumë se një dispozite të këtij vendimi, këto të fundit zbatohen njëkohësisht.

Neni 220
Provat e mjaftueshme për plotësimin e kushteve

Në rastet kur ky vendim parashikon që përjashtimi përfitohet kundrejt plotësimit të kushteve të caktuara, personi i interesuar duhet të paraqesë prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi plotësimin e këtyre kushteve.

Neni 221
Kursi i këmbimit/konvertimit

Në rast të importimit me përjashtim nga detyrimet e importit, që jepet brenda vlerës ekuivalente në lekë të shumës të përcaktuar në Euro, autoritetet kompetente doganore rrumbullakosin shumën e dalë nga këmbimi/konvertimi i asaj shume në lekë.

Kursi i këmbimit aplikohet në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

TITULLI VIII
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Seksioni 1

Neni 222
Akte nënligjore

Drejtori i përgjithshëm i doganave, mbështetur në parimet e përcaktuara në kod, mund të miratojë, udhëzime, rregullore apo manuale udhëzuese, për zbatimin në praktikë apo në sistemin kompjuterik /elektronik doganor të këtij vendimi, lidhur me orarin e funksionimit, koordinimin e procedurave të kontrollit, aksesin, sistemet dhe shkëmbimin e informacionit, kontrollet doganore, verifikimin dhe analizimin e mallrave, operatorët ekonomik të autorizuar, deklarimin standard dhe të thjeshtuar, si dhe dokumentet plotësuese, procedurat e thjeshtuara dhe operacionet e privilegjuara.

Neni 223
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pika 2 e nenit 12; neni 14, nenet 477 deri 560, aneksi 56, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Neni 224
Institucionet zbatuese

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 225
Dispozita kalimtare

1. Procedurat doganore të përjashtimit të cilat kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi duhet të përfundojnë sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave këto procedura kanë filluar.

2. Udhëzimet e drejtorit të përgjithshëm që rregullojnë elementët procedural të dhënies së përjashtimit nga detyrimet e importit, për aq sa nuk bien ndesh me përcaktimet e këtij vendimi, zbatohen deri në shfuqizimin e tyre në mënyrë nominative me akt të posaçëm.

Neni 226
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2015 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1

Aplikimi për një Çertifikatë OEA

[përmendur në pikën 1 të nenit 13 të këtij vendimi]

Shënim: Ju lutemi referojuni shënimit shpjegues kur plotësoni formularin

1. **Aplikuesi**	Rezervuar për qëllime doganore
2. **Statusi ligjor i aplikuesit**	3. **Data e themelimit**
4. **Adresa e vendit ku është i vendosur aplikuesi (operatori ekonomik)**	
5. **Vendndodhja e përheshme e biznesit**	
6. **Personi i kontaktit** **(emri, telefoni, faksi, e-mail)**	7. **Adresa e korrespondencës**
8. **Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS (NIPT)**	**9. Numër identifikimi** **(tjetër nëse ka të tillë)**
10. **Lloji i Çertifikatës së kërkuar** ☐ Çertifikatë OEAD– Thjeshtësime Doganore ☐ Çertifikatë OEAS – Siguria dhe Mbrojtja ☐ Çertifikatë OEAP – Thjeshtësime Doganore / Siguria dhe Mbrojtja	
11. **Sektori ekonomik i aktivitetit**	12. **Zyrat doganore ku kryhen aktivitete doganore**

13. **Informacioni i kalimit kufitar.**	14. **Thjeshtësime ose lehtësira të dhëna aktualisht.**
15. **Zyra ku mbahet dokumentacioni doganor:**	
16. **Zyra përgjegjëse për sigurimin e të gjithë informacionit doganor:**	
17. **Zyra ku mbahet kontabiliteti:**	
18. **Nënshkrimi:** ……. **Emri:** …… **Pozicioni:** ..... **Numri i anekseve**: ..... **Data:** …….	

SHËNIME SHPJEGUESE
(për aneksin 1)

1. Aplikuesi:

Shënoni emrin e plotë të operatorit ekonomik aplikues.

2. Statusi ligjor i aplikuesit:

Shënoni statusin ligjor, siç përmendet në dokumentin e themelimit.

3. Data e themelimit:

Shënoni – me numra – ditën, muajin dhe vitin e themelimit.

4. Adresa e vendit ku është i vendosur aplikuesi (operatori ekonomik):

Shënoni adresën e plotë të vendit ku biznesi tuaj është themeluar.

5. Vendndodhja e përhershme e biznesit:

Shënoni adresën e plotë të vendndodhjes së përhershme të biznesit tuaj, aty ku kryhen aktivitetet kryesore.

6. Personi i kontaktit:

Shënoni emrin e plotë, numrat e telefonit, faksit dhe adresën e e-mail-it të personit të kontaktit të caktuar nga ju brenda kompanisë suaj, për t'u kontaktuar nga autoritetet doganore kur shqyrtojnë aplikimin.

7. Adresa e korrespondencës:

Plotësojeni vetëm kur ndryshon nga adresa e juaj e themelimit.

8 dhe 9. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS (NIPT) dhe Numri i identifikimit (nëse ka një të tillë):

Vendos numrat e kërkuar.

Numrin unik të identifikimit të operatorit ekonomik siç është në dokumentin e regjistrimit.
Numrin e identifikimit tjetër të operatorit ekonomik (nëse ka një të tillë).

10. Lloji i Çertifikatës së kërkuar:

Shënoni një kryq në kutinë përkatëse.

11. Sektori ekonomik i aktivitetit:

Përshkruaj aktivitetin tënd.

12. Zyrat doganore ku kryhen aktivitete doganore:

Shënoni emrat e zyrave doganore ku kryeni aktivitetet doganore dhe kodin/et përkatëse të këtyre zyrave.

13. Informacioni i kalimit kufitar:

Shënoni emrat e zyrave doganore që përdoren rregullisht për kalim kufitar.

14. Thjeshtime ose lehtësira të dhëna aktualisht:

Në rastin e thjeshtimeve të dhëna aktualisht, tregoni llojin e thjeshtësimit, proçedurën doganore përkatëse, dhe numrin e autorizimit.

Në rastin kur aplikuesi është mbajtës i një çertifikate të barazvlefshme të OEA të lëshuar në një vend tjetër, tregoni numrin e asaj çertifikate dhe vendin lëshues duke përdorur kodin vendit lëshues.

15, 16 & 17. Zyrat për dokumentacionet/informacion /kontabilitetin:

Shënoni adresat e plota të zyrave përkatëse. Nëse zyrat kanë të njëjtën adresë, plotësoni vetëm kutinë 15.

18. Emri, data dhe nënshkrimi i aplikuesit:

Nënshkrimi: nënshkruesi duhet të plotësoje pozicionin e tij pranë aplikuesit

Nënshkruesi duhet të jetë gjithmonë personi i cili përfaqëson në tërësi aplikuesin.

Emri: emri i aplikuesit dhe vula e aplikuesit.

Numri i anekseve: aplikuesi jep informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

1. Vështrim të përgjithshëm mbi aksionerët/pronarët kryesorë, duke dhënë emrat, adresat dhe interesat proporcionale të tyre. Vështrim i përgjithshëm mbi anëtarët e bordit të drejtuesve ose organi tjetër ekzekutiv. A njihen pronarët nga autoritetet doganore për sjellje jo të denjë të mëparshme?

2. Personin përgjegjës në administratën e aplikuesit për çështjet doganore.

3. Përshkrim të aktiviteteve të aplikuesit.

4. Specifikimin e detajeve të vendndodhjes të ambjenteve të ndryshme të aplikuesit dhe përshkrim i shkurtër i aktiviteteve në çdo ambjent. Specifikimin nëse aplikuesi dhe çdo ambjent vepron dhe funksionon brenda zinxhirit të furnizimit në emër dhe në interes të tij, ose kur vepron dhe funksionon në emër të tij dhe në interes të një personi tjetër, ose kur vepron dhe funksionon në emër dhe në interes të një personi tjetër.

5. Specifikimin nëse mallrat janë sjellë nga dhe/ose siguruar për shoqëri të cilat janë të bashkuara/të lidhura me aplikuesin.

6. Përshkrimin e strukturës së brendshme organizative të aplikuesit. Ju lutem bashkëlidhni, në qoftë se egziston, dokumentacionin për funksionet/kompetencat për çdo departament dhe/ose funksion.

7. Numrin e punonjësve në total për çdo sektor/ndarje.

8. Emrat e zyrtarëve kryesorë (drejtorët menaxhues, shefat e sektorëve, menaxherët e kontabilitetit, shefin e sektorit doganor, etj.) Përshkrimi i rutinave të miratuara në situata kur punonjësi kompetent nuk është i pranishëm, përkohësisht ose përherë.

9. Emrat dhe pozicionet brenda organizatës së aplikuesit të cilët kanë ekspertizë specifike doganore. Vlerësimi i nivelit të njohurive të këtyre personave në lidhje me përdorimin e teknologjisë IT në proçeset doganore dhe tregtare dhe çështje të përgjithshme tregtare.

10. Pranimin ose mospranimin e publikimit të informacionit në çertifikatën OEA në listën e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, të përmendur në pikën 4 të nenit 33 të këtij vendimi.

Aneksi 2

Pyetësori i Vetë-vlerësimit

0.1	Shënim, rekomandohet që të lexoni Udhëzimin e Ministrit të Financave per OEA përpara aplikimit për statusin e OEA. Informacion lidhur me këtë akte mund të gjeni në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
0.2	Cilët sektorë/departamente keni përfshirë në proces për të përgatitur shoqërinë (kompaninë) tuaj për aplikim për OEA duke përfshirë dhe menaxhimin?
1.	**Informacion i kompanisë**
1.1.	**Informacion i përgjithshëm i kompanisë**
1.1.1.	Ju lutem jepni emrin, adresën, datën e themelimit dhe formën ligjore të organizimit të kompanisë aplikuese. Ju lutem përfshini dhe URL e adresës së internetit të kompanisë tuaj, nëse është rasti. Nëse kompania juaj është pjesë e një grupi, ju lutem tregoni nëse ndonjë nga njësitë e tjera në grup: a) ka aktualisht një certifikatë të OEA; ose b) ka aplikuar për statusin e OEA dhe janë aktualisht nën auditim nga autoriteti doganor.
1.1.2.	Ju lutem jepni detajet e mëposhtme (në qoftë se janë pjesë e formës ligjore të kompanisë tuaj): a) Detaje të plota rreth aksionerëve duke përfshirë përqindjet e tyre b) Detaje të plota rreth anëtarëve të bordit dhe/ose menaxherëve c) Detaje të plota rreth bordit këshillues dhe nëse ka, rreth bordit të drejtorëve. Detajet duhet të përfshijnë emrin dhe adresën e plotë, datën e lindjes dhe Numrin e Identifikimit (p.sh. numrin e kartës së identitetit (letërnjoftimit) ose numrin e sigurimeve).
1.1.3	Ju lutem tregoni emrin e personit përgjegjës për çështje doganore në administratën e aplikuesit. Detajet duhet të përfshijnë emrin dhe adresën e plotë, datën e lindjes dhe Numrin të Identifikimit (p.sh. numrin e kartës së identitetit (letërnjoftimit) ose numrin të sigurimeve)
1.1.4.	Ju lutem përshkruani shkurtimisht aktivitetin tuaj tregtar dhe theksoni pozicionin tuaj në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit (p.sh. prodhues, eksportues, spedicioner, mbajtës magazine doganore, agjent doganor, transportues, importues). Në qoftë se keni më shumë se një pozicion përfshijini të gjitha.
1.1.5.	Ju lutem specifikoni ambjentet, listoni adresat, emrin, numrat e telefonit dhe e-mail e pikave të kontaktit dhe një përshkrim të shkurtër të veprimeve të kryera më poshtë: a) ambjentet individuale të kompanisë tuaj si një njësi ligjore (ju lutem tregoni numrin e punonjësve në çdo departament) dhe b) ambjentet kur një palë e tretë kryen aktivitete të jashtme për kompaninë tuaj.
1.1.6.	Bleni nga/shisni tek bizneset me të cilat jeni të bashkuar? Po/Jo

1.1.7.	Përshkruani strukturën organizative të brendshme të kompanisë tuaj/përgjegjësitë e cdo departamenti.
1.1.8.	Ju lutem jepni emrat e menaxherëve të lartë:(Drejtorët, shefat e departamentave, shefin e financës/kontabilitetit, shefin e departamentit doganor dhe kështu me rradhë) të kompanisë dhe përshkruani shkurtimisht rregullat.
1.1.9.	Sa punonjës keni në biznesin tuaj?
1.1.10.	a) Ju lutem jepni emrat dhe pozicionin e personave brenda kompanisë tuaj të cilët kanë ekspertizë specifike doganore. b) Ju lutem detajoni shkurtimisht nivelin e njohurive të këtyre personave për sa i përket përdorimit të teknologjisë së IT në proceset doganore dhe tregtare dhe në përgjithësi në çështjet doganore.
1.1.11.	Unë këtu miratoj botimin e informacionit në certifikatën e OEA në listën e operatorëve ekonomikë të autorizuar të përmendur në pikën 3 të nenit 14 të këtij vendimi. Po/Jo Nëse po Firma…… Pozicioni i Nënshkruesit…… (Pyetësori i plotësuar duhet të nënshkruhet nga një Drejtor/Partner Menaxhues/Pronar i Vetëm sipas rastit, por në këtë rast rekomandohet që miratimi të jepet nga një nënshkrues i autorizuar) Data:……

Unë këtu miratoj shkëmbimin e informacionit në autorizimin e OEA për të garantuar implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me vendet e tjera për njohjen reciproke të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe masat në lidhje me sigurinë:

Po/Jo

Nëse po

Firma……

Pozicioni i Nënshkruesit……

(Pyetësori i plotësuar duhet të nënshkruhet nga një Drejtor/Partner Menaxhues/Pronar i Vetëm sipas rastit, por në këtë rast rekomandohet që miratimi të jepet nga një nënshkrues i autorizuar)

1.1.12 Data:……."

Në rast se ju keni miratuar njohjen reciproke në kutinë 1.1.12, ju lutem jepni dhe informacionin e mëposhtëm:

Emrin me gërma kapitale:……

Rrugën dhe numrin me gërma kapitale:……

Kodin postar dhe qytetin me gërma kapitale:……

1.1.13 Vetëm karakteret në latinisht duhet të përdoren.

1.2.	**Vëllimi i biznesit**
1.2.1.	a) Jepni xhiron vjetore për tre vitet e fundit sipas kontabilitetit të plotë vjetor. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A.(e pa aplikueshme) b) Jepni fitimet neto vjetore ose humbjet për tre vitet e fundit sipas kontabilitetit të plotë vjetor. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. (e pa aplikueshme)
1.2.2.	Nëse përdorni ambjente magazinimi dhe ju nuk jeni pronar i tyre, ju lutem tregoni nga kush i keni marrë me qera këto ambjente.
1.2.3.	Për secilën nga të mëposhtmet jepni një numër dhe vlerë të përafërt të deklarimeve që ju keni bërë në tre vjetët e fundit. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. (e pa aplikueshme) • Import • Eksport/Ri-eksport • Tranzit
1.2.4.	Për secilën nga të mëposhtmet jepni një shumë totale të përafërt që ju keni paguar në tre vjetët e fundit. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A (e pa aplikueshme) • Detyrim doganor • Detyrim akcize • TVSH importi
1.2.5.	a) Parashikoni ndryshime strukturale në kompaninë tuaj në 2 vitet e ardhëshme? Po/Jo. Nëse Po përshkruani shkurtimisht ndryshimet. b) Parashikoni ndryshime të mëdha në zinxhirin e furnizimit tuaj në kompani në 2 vitet e ardhëshme? Po/Jo. Nëse Po përshkruani shkurtimisht ndryshimet.
1.3.	**Informacion dhe Statistika për cështje doganore**
1.3.1.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Kryeni formalitete doganore në emrin tuaj dhe për llogari tuajën? b) Përfaqësoheni nga dikush tjetër në lidhje me formalitetet doganore, nëse po nga kush dhe si (direkt apo indirekt)? Ju lutem përfshini emrin, adresën dhe numrin NUIS (NIPT) të përfaqësuesit. c) Përfaqësoni persona të tjerë në formalitetet doganore? Nëse po, kë dhe si (direkt apo indirekt)? (Jepni emrat e kompanive më thelbësore)
1.3.2.	a) Si dhe nga kush vendoset klasifikimi tarifor i mallrave? b) Cfarë masash garancie/sigurie ju merrni për të garantuar që klasifikimet tarfiore janë të sakta (p.sh. verifikime, kontrolle të besueshmërisë, udhëzime të brendshme pune, trajnime të rregullta)? c) Mbani shënime për këto masa garancie/sigurie? d) Monitoroni rregullisht efektivitetin e masave tuaja të garancisë së sigurisë? e) Cfare burimesh përdorni për klasifikimin tuaj tarifor (p.sh. bazë të dhënash për të dhënat për mallrat)?

1.3.3.	a) Si dhe nga kush përcaktohet vlera doganore? b) Cfarë masash garancie/sigurie ju merrni për të garantuar që vlera doganore është përcaktuar sic duhet (p.sh. verifikime, kontrolle të besueshmërisë, udhëzime të brendshme pune, trajnime të rregullta, mjete të tjera)? c) Monitoroni rregullisht efektivitetin e masave tuaja të garancisë/sigurisë? d) Mbani shënime për këto masa garancie/sigurie?
1.3.4.	a) Jepni një vështrim të përgjithshëm mbi origjinën preferenciale ose jopreferenciale të mallrave të importuara. b) Cfare masash të brendshme keni implementuar për të verifikuar që vendi i origjinës i mallrave të importuara është deklaruar saktë? c) Përshkruani si lëshoni provën e preferencave dhe certifikatave të origjinës për eksportim.
1.3.5.	Merreni me mallra objekt të detyrimeve anti-dumping ose detyrime të masave kundërbalancuese? Po/Jo. Nëse po, jepni detaje rreth prodhuesit apo vendeve jashtë R.SH. mallrat e të cilave janë objekt i detyrimeve të mësipërme.

2.	**Pajtueshmëria/përputhshmeria e rregjistrime/të dhënave**

2.1.	a) Janë zbuluar shkelje të legjislacionit doganor dhe tatimor brenda kompanisë tuaj ose nga autoritetet doganore në tre vitet e fundit? Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A. Nëse po, përshkruani shkurtimisht shkeljet. b) Ja keni njoftuar shkeljet autoriteteve përkatëse kopetente dhe cfarë masash garantuese keni marrë për të shmangur shkelje të tilla në të ardhmen? Mbani shënime për këto masa garantuese?
2.2.	Ju janë refuzuar aplikime për autorizime/ëertifikata apo ju janë pezulluar apo revokuar autorizime egzistuese për shkak të shkeljeve të legjislacionit doganorë dhe tatimore në tre vitet e fundit? Po/Jo. Nëse jeni biznes i ri, theksoni N/A Mbani shënime për këto masa garantuese?

3.	**Sistemi i kontabilitetit dhe logjistik**
3.1.	**Gjurmët e auditit**

3.1.1.	Mundëson sistemi juaj i kontabilitetit një gjurmim të plotë auditimi të aktiviteteve tuaja doganore dhe tatimore ose lëvizjeve përkatëse të mallrave ose hedhjeve në kontabilitet? Nëse po, ju lutem përshkruani karakteristikat kryesore të këtij gjurmimi auditimi.

3.2.	**Sistemi i kontabilitetit**

3.2.1.	Çfare sistemi kompjuterik (hardëare/softëare) përdorni në përgjithësi në biznesin tuaj dhe për çështjet doganore në veçanti? Jepni informacion për të mëposhtmet: - ndarjen e funksioneve ndërmjet zhvillimit, testimit dhe operimit - ndarjen e funksioneve ndërmjet përdoruesve - aksesin tek kontrollet (cilat/për kë) - gjurmueshmërinë midis sistemit të biznesit dhe sistemit të deklarimit
3.2.2.	Janë sistemet tuaja të kontabilitetit të afta për të dalluar mallrat shqiptare nga ato Jo-shqiptare ? Po/Jo Nëse po, jepni detajet.
3.2.3.	a) Në cfarë ambienti ndërmerren veprimet tuaja kompjuterike? b) Keni aplikime kompjuterike nga burime të jashtme? Nëse po, në cilën kompani të jashtme janë këto aplikime dhe si i menaxhoni kontrollet e aksesit për aplikimet e jashtme?

3.3.	**Sistemi i brendshëm i kontrollit**

3.3.1.	Keni në kompani udhëzime për sistemin e kontrollit të brendshëm në departamentin e kontabilitetit, departamentin e blerjes, departamentin e shitjes, departamentin doganor, prodhim, menaxhimin e materialeve dhe tregtisë dhe logjistikën? Po/Jo. Nëse po përshkruajeni shkurtimisht dhe se si ato përditësohen. P.sh. masat si udhëzime pune, trajnim të punonjësve, udhëzime për verifikimin e gabimeve, dhe mekanizëm për leximin e provave.
3.3.2.	A kanë qënë proçeset tuaja të brendshme të kontrollit objekt i ndonjë auditi te brendshëm/ të jashtëm? Po/Jo. Përfshihet këtu dhe rutina juaj doganore? Po/Jo. Nëse po, jepni një kopje të raportit tuaj më të fundit të auditit.
3.3.3.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për verifikimin e dosjeve kompjuterike (standing data) apo dosjet kryesore? Nga këndvështrimi juaj, si i mbulojnë këto procedura rreziqet e mëposhtme : a) Rregjistrim i pasaktë dhe/ose i paplotë i transaksioneve në sistemin e kontabilitetit. b) Rregjistrimi i të dhënave të pasakta ose të vjetra të tilla si numri i artikujve dhe kodet tarifore. c) Kontroll i papërshtatshëm i proçeseve të kompanisë brenda biznesit të aplikuesit.

3.4.	**Fluksi i mallrave**
3.4.1.	Përshkruani shkurtimisht procedurën e rregjistrimit (fizikisht dhe në rregjistra) për fluksin e materialeve, magazinimin nga prodhimi në transportim. Kush i mban rregjistrimet dhe ku ruhen ato?
3.4.2.	Përshkruani shkurtimisht procedurat në vend për verifikimin e niveleve të inventarit, duke përfshirë frekuencën e këtyre verifikimeve dhe sesi trajtohen mospërputhjet (p.sh. Marrje në dorëzim dhe inventari)?
3.5.	**Rutinat doganore**
3.5.1.	Keni procedura të dokumentuara për verifikimin e saktësisë së deklarimeve doganore, duke përfshirë ato të paraqitura në emrin tuaj nga, p.sh. agjenti doganor ose spedicioneri? Po/Jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat. Nëse jo, verifikoni saktësinë e deklarimeve doganore? Po/Jo. Nëse po në cfarë mënyre?
3.5.2.	a) Ka kompania juaj udhëzime apo instruksione për njoftimin e parregullsive tek autoritetet kompetente (p.sh. dyshime për vjedhje, grabitje apo kontrabandë në lidhje me mallrat që kanë të bëjnë me doganat)? Janë të dokumentuara këtu instruksione (p.sh. instruksione pune, manuale, dokumente të tjerë udhëzimi)? b) Gjatë vitit të kaluar, keni zbuluar parregullsi (ose parregullsi të prezumuara) dhe ja keni njoftuar ato autoriteteve kompetente? Po/Jo.
3.5.3.	Tregtoni mallra që janë objekt i licensave tregtare ekonomike p.sh.mbetje, mallra me përdorim të dyfishtë? Po/Jo Nëse po, ju lutem përshkruani shkurtimisht procedurat për administrimin e licensave në lidhje me importin dhe/ose eksportin e këtyre mallrave.
3.6.	**Procedurat për mbështetje (back-up), rikuperimin dhe fallback dhe arkivimin**
3.6.1.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për mbështetje (back-up), rikuperim, fallback, arkivim dhe korrigjim të rregjistrimeve të biznesit tuaj.
3.6.2.	Për sa kohë ruhen të dhënat në sistemin e prodhimit dhe për sa kohë arkivohen këto të dhëna?
3.6.3.	A ka kompania një plan emergjence në rast ndërprerje/dështimi të sistemit? Po/Jo

3.7.	**Mbrojtja e sistemeve kompjuterike**
3.7.1.	a) Përshkruani shkurtimisht masat që ju keni marrë për të ruajtur sistemin kompjuterik nga ndërhyrje të paautorizuara (Fireëall, programe antivirus, ruajtje të fjalëkalimit/passëord ...)? b) Keni kryer ndonjë testim ndërhyrje, cilat ishin rezultatet dhe keni marrë masa korrigjimi?
3.7.2.	a) Përshkruani shkurtimisht sa të drejta aksesi për sistemet kompjuterike keni lëshuar? b) Kush është përgjegjës për funksionimin dhe mbrojtjen e sistemit kompjuterik?
3.7.3.	a) Ku vendoset serveri juaj kryesor? b) Jepni detaje se si është siguruar serveri juaj kryesor.
3.8.	**Siguria dokumentare**
3.8.1.	Përshkruani shkurtimisht masat që ju keni marrë për të ruajtur (p.sh. të drejtat e kufizuara të aksesit, krijimin e mbështetjes/backup elektronikë) informacionin/dokumentet nga akseset e paautorizuara, abuzimi, shkatërrimi i qëllimshëm dhe humbja?
3.8.2.	Keni pasur në vitin e kaluar ndonjë rast të aksesit të paautorizuar tek dokumentat, dhe nëse po çfarë masash keni marrë për të parandaluar të ndodhte përsëri?
3.8.3.	Ju lutem përgjigjuni shkurt pyetjeve të mëposhtme: a) Cilët kategori punonjësish kanë akses tek të dhënat e detajuara rreth fluksit të materialeve dhe mallrave? b) Cilët kategori punonjësish janë të autorizuar për të ndryshuar këto të dhëna? Janë të dokumentara tërësisht ndryshimet?
3.8.4.	Përshkruani shkurtimisht cfarë kërkesash në lidhje me sigurinë&mbrojtjen kërkoni nga partnerët tuaj të biznesit dhe persona të tjerë kontakti për të shmangur abuzimin me informacionin (p.sh. rrezikimin e zinxhirit të furnizimit nëpërmjet transferimit të paautorizuar të detajeve të transportit)?
4.	**Aftësia paguese financiare**
4.1.	Kane filluar proçedime rreth aftësisë tuaj paguese financiare në lidhje me asetet e kompanisë gjatë tre vjetëve të fundit? Po/Jo. Nëse po jepni detajet.
4.2.	Ka kompania tuaj një situatë financiare të mirë dhe të vazhdueshme brenda kuptimit të nenit 19 të këtij vendimi, të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare, gjatë tre vjetëve të fundit? Nëse po, jepeni këtë provë me anë të një letre nga auditorët tuaj ose si një raport auditi, një kopje të llogarive tuaja finale (në qoftë se ato nuk janë audituar), provë nga banka ose institucion financiar. Nëse jo, ju lutemi jepni detajet e plota.

4.3.	Nëse jeni një biznes i ri jepni të gjitha rregjistrimet dhe informacionin në lidhje me statusin tuaj financiar, p.sh. fluksin e fundit në cash, bilancin dhe parashikimet e fitimeve dhe humbjeve të miratuara nga drejtorët/partnerët/pronari i vetëm.
4.4.	Ka ndonjë gjë që ju jeni i ndërgjegjshëm që mund të ketë ndikim në aftësinë tuaj paguese në një të ardhme të parashikueshme? Po/Jo. Nëse po, jepni detajet.
5.	**Kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes**
5.1.	**Vetë vlerësimi**
5.1.1.	a) Keni kryer vlerësim të riskut dhe kërcënimit për biznesin tuaj? Po/Jo b) Ka plan sigurie për çdo ambjent (sipas rastit)? Po/Jo Sa shpesh rishikohen dhe përditësohen këto dokumente?
5.1.2.	Përshkruani shkurtimisht çfarë rreziqesh sigurie (brenda kompanisë ose në biznesin tuaj në lidhje me klientët, furnizuesit dhe shërbimet e jashtëme) keni identifikuar në lidhje me kriteret e sigurisë të OEA?
5.1.3.	Si janë implementuar dhe koordinuar masat e sigurisë në kompaninë tuaj dhe kush është përgjegjës për ato?
5.1.4.	Nëse keni disa ambjente të kompanisë tuaj, janë implementuar masat e sigurisë të harmonizuara në të gjitha këto ambjente? Po/Jo
5.1.5.	a) Keni udhëzime për sigurinë? Si ja komunikoni ato stafit tuaj dhe vizitorëve të ambjenteve të kompanisë tuaj? b) Si janë ato të dokumentuara (manual, udhëzim pune, broshurë, etj.)?
5.1.6.	a) Keni pasur incidente gjatë vitit të kaluar? Po/Jo. Nëse po, ju lutem jepni një përshkrim të shkurtër të incidenteve dhe çfarë masash keni marrë që të mos ndodhin përsëri? b) Mbani rregjistrime të incidenteve të ndodhura dhe masave të marra? Po/Jo
5.1.7.	a) Jeni çertifikuar nga ndonjë agjensi apo autoritet tjetër publik për qëllime sigurie (transport)? Po/Jo. Nëse po, ju lutem jepni një kopje të çertifikatës dhe jepni detajet e ambjenteve të cilat mbulohen nga kjo çertifikatë. b) Jepni një listë të standardeve/liçensave/autorizimeve të akredituara në mënyrë të pavarur tek të cilat ju aderoni dhe specifikoni cfarë kontrollesh/auditesh i janë nështruar këto.
5.1.8.	Ka kërkesa të vecanta sigurie dhe mbrojtje për mallrat që ju importoni/eksportoni?
5.1.9.	a) Përdorni shërbime të një kompanie sigurie? Nëse po, cfarë kompanie përdorni. b) Ka bërë kjo kompani një vlerësim të rrezikut të kompanisë tuaj? Nëse po, përshkruani shkurtimisht çfarë rreziqesh sigurie ka identifikuar në lidhje me kriteret e sigurisë së OEA.

5.1.10.	Ju imponojnë klientët apo kompanitë e siguracioneve ndonjë kërkesë sigurie dhe mbrojtje? Po/Jo. Nëse po, jepni detajet.

5.2.	**Aksesi tek ambjentet**

5.2.1.	a) Përshkruani shkurtimisht si është rregulluar proçesi i aksesit/hyrjes në ambjentet e tuaja (ndërtesat, zonat e prodhimit, magazinat, etj.) për stafin, vizitorët, personat e tjerë, makinat dhe mallrat? b) Kush kontrollon përputhshmërinë me proçedurat e parashikuara?
5.2.2.	a) Përshkruani procedurat që ndiqen kur zbulohet një person/mjet i paautorizuar në ambjentet e kompanisë (sheshe apo ndërtesa)? b) Si i komunikohen këto procedura stafit (p.sh. plan veprim, manual, udhëzime pune, trajnim)?
5.2.3.	Paraqitni një plan të ambjentit për çdo vendndodhje të kompanisë tuaj që përfshihen në aktivitete në lidhje me doganat (p.sh. planimetri, projekt plan) nga i cili mund të identifikohen kufijtë, rrugët e aksesit dhe vendndodhja e ndërtesave, nëse është rasti.
5.2.4.	Jepni emrat - nëse është rasti - e kompanive (p.sh. kompani të jashtme, pjesë të kompanive të jashtme) që ndodhen në ambjentet tuaja për çdo vendndodhje.

5.3.	**Siguria fizike**

5.3.1.	a) Jepni një përshkrim të shkurtër sesi sigurohen kufijtë e jashtëm të kompanisë. Si kontrollohet përputhshmëria me këto procedura? b) Si, nga kush dhe në çfarë intervalesh kryhen kontrolle tek kangjellat dhe ndërtesat? Si janë këto kontrolle dhe si rregjistrohen? c) Si raportohen incidentet me sigurinë dhe si mereni me ato?
5.3.2.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Cfarë mundësish aksesi hyrje-dalje egzistojnë? b) Si mbikqyren këto? Ka kufizime gjatë orarit të punës për çdo akses hyrje-dalje ?
5.3.3.	Janë të ndricuara mjaftueshëm ambjentet (p.sh. dritë e vazhdueshme, sensorë lëvizjesh, drita të ndjeshme)?
5.3.4.	Si kryhet administrimi i celsave në kompani (p.sh. ambjenteve, aksesi, logging)? Ka dokumentim me shkrim për këtë? Po/Jo

5.3.5.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Lejohet parkimi i makinave private në ambjente? b) Nëse po, për cilët persona? c) Kush jep miratimin? d) Kontrollohen makinat (në hyrje të ambjenteve apo në hyrjen në zonën e parkimit)? Egzistojnë rregullore të shkruara? Po/Jo

5.4.	**Njësitë e kargos (si konteinerë, rama, kuti transporti)**

5.4.1.	I nështrohet aksesi tek njësitë e kargos rregullave/kufizimeve? Po/Jo Nëse po, si zbatohen këto kufizime?
5.4.2.	Përshkruani shkurtimisht çfarë masash ekzistojnë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar dhe ndërhyrjet tek njësitë e kargos (vecanërisht në zona të hapura magazinimi) (p.sh. mbikqyrje e vazhdueshme, trajnim i stafit dhe bërja e tyre e ndërgjegjshme ndaj rreziqeve, plumbcet, udhëzime për procedurat e ndjekura në rast hyrje të paautorizuar)?
5.4.3.	a) Përdorni plumbçe për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara tek mallrat? Nëse po, cfarë lloji? Përmbushin këto plumbce ndonje standard specifik (p.sh. ISO)? b) Si e garantoni që nuk ndërhyet tek mallrat nëse nuk përdoren plumbçet?
5.4.4.	Cfarë masash kontrolli përdorni për të kontrolluar njësitë e kargos (p.sh. procesin e inspektimit shtatë-pikësh: pjesa ballore, ana e majtë, ana e djathtë, dyshemeja, mbulesa/tavani, dyert e jashtme/të brendshme, jashtë/shasitë)?
5.4.5.	Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: a) Kush është pronari/operatori i njësive të kargos? b) Kush mirëmban/riparon njësitë e kargos? c) Ka plane të rregullta mirëmbajtje ? Kontrollohen punët e mirëmbajtjes nga jashtë?

5.5.	**Proceset logjistike**

5.5.1.	a) Cfarë mjetesh transporti përdoren normalisht nga kompania tuaj? b) E kryen vetë kompania të gjithë transportin apo përdor gjithashtu shërbime të jashtme (p.sh. spedicionerë/transpotues)? c) Si e përcaktoni nëse spedicioneri/transportuesi i përmbush standardet e sigurisë të kërkuara (p.sh. me anë të një certifikate sigurie, deklarate apo marrëveshje)? d) Merrni masa të tjera për transportin e jashtëm me vështrim ndaj përmbushjes së standardeve të sigurisë? Nëse është rasti, ju lutem jepni natyrën dhe qëllimin e këtyre masave.

5.6.	**Kërkesa jofiskale**
5.6.1.	a) Merreni me mallra me përdorim të dyfishtë dhe/ose mallra për të cilat kërkohet licensë importi apo mallra që i nënshtrohen kufizimeve të eksportit apo embargove ose kërkesave të tjera jofiskale? Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat që ju përdorni për të garantuar përputhjen me dispozitat përkatëse në lidhje me këto mallra (p.sh. menaxhimi i licensave, autorizimeve, përgjegjësive të vecanta, staf i trajnuar vecanërisht, etj.)? b) Ka udhëzime të vecanta pune, manuale apo udhëzime të tjera në kompani rreth këtyre mallrave? Po/Jo
5.7.	**Hyrja e mallrave**
5.7.1.	a) Përshkruani shkurtimisht procedurën për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes për mallrat që hyjnë? b) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.7.2.	Janë të informuar punonjësit tuaj rreth marrëveshjeve të sigurisë me furnizuesit dhe sesi garantohet kjo përputhshmëri?
5.7.3.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi kryhen kontrollet për integritetin e plumbçeve tek mallrat që hyjnë? b) Janë të plumbosura mallrat që hyjnë, sipas rastit? Po/Jo Nëse po, cfarë rutine/masash keni?
5.7.4.	Shënohen mallrat që hyjnë në mënyrë uniforme apo magazinohen në vende të vecanta? Po/Jo Nëse po, si shënohen/ku magazinohen?
5.7.5.	Përshkruani shkurtimisht procesin për numërimin dhe peshimin e mallrave që hyjnë?
5.7.6.	Përshkruani shkurtimisht sesi, kur dhe nga kush kontrollohen mallrat që hyjnë përkundrejt dokumentave shoqëruese dhe sesi hidhen në rregjistra?
5.7.7.	a) Janë sektorët të ndarë qartë për blerjen e mallrave, marrjen e mallrave dhe administrimin e përgjithshëm? Po/Jo b) Egziston mekanizëm i brendshëm kontrolli ndërmjet sektorëve? Po/Jo. Nëse po, si kryhen ato?
5.8.	**Magazinimi i mallrave**
5.8.1.	Ju lutem përshkruani shkurtimisht në cilat ambjente ju keni zona të mënjanuara për magazinimin e mallrave?
5.8.2.	a) Ju lutem përshkruani shkurtimisht rutinën për caktimin e ambjentit të magazinimit për mallrat që hyjnë.

	b) Keni ambjente magazinimi të hapura? Po/Jo. Nëse po, ju lutem përshkruajini ato shkurtimisht.
5.8.3.	Keni procedura të dokumentuara për inventarizimin dhe që merren me parregullsitë gjatë inventarizimit? Po/Jo Nëse po, ju lutem përshkruani shkurtimisht ato.
5.8.4.	Magazinohen vecmas mallrat me nivele të ndryshme risku? Po/Jo a) Ju lutem përshkruani kriteret për cdo magazinim të vecantë (p.sh. mallra të rrezikshme, mallra me vlerë të lartë, kimikate, armë)? b) Ju lutem përshkruani sesi ju garantoni që mallrat rregjsitrohen menjëherë në llogaritë logjistike/inventarët?
5.8.5.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi mbrohen mallrat ndaj hyrjeve të paautorizuara në ambjentet e magazinimit? b) Përshkruani shkurtimisht si kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.8.6	Nëse magazinoni mallrat jashtë tek një palë e tretë/shërbim i jashtëm, ju lutem përshkruani shkurtimisht si dhe ku magazinohen mallrat dhe masat e juaja të kontrollit që përdorni për mbikqyrjen e trajtimit të mallrave.
5.9.	**Prodhimi i mallrave**
5.9.1.	a) Përshkruani shkurtimisht çfarë ambjentesh/zona përcaktoni për prodhimin e mallrave? b) Nëse prodhimi kryhet nga një partner i jashtëm (p.sh. punë përpunimi, dërgesa), përshkruani shkurtimisht sesi garantoni integritetin e mallrave (p.sh. marrëveshje kontraktuale)?
5.9.2.	Keni masa sigurie për mbrojtjen e mallrave ndaj hyrjeve të paautorizuara në zonën e prodhimit? Po/Jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht cfarë masash janë dhe nëse egzistojnë me shkrim. Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.9.3.	Përshkruani shkurtimisht procedurat për produktet e paketuara dhe nëse egzistojnë me shkrim.
5.9.4.	Nëse produkti final paketohet në një palë të tretë, përshkruani shkurtimisht sesi garantoni integritetin e mallrave?
5.10.	**Ngarkimi i mallrave**
5.10.1.	a) Përshkruani shkurtimisht si menaxhohet ngarkimi i mallrave në kompaninë tuaj (p.sh. caktimi i përgjegjësive, kontrolli i mallrave dhe mjeteve të transportit, rregjistrimi i rezultateve, sigurimi i informacionit, etj.)? b) Ka udhëzime me shkrim sesi të organizohet procesi? Po/Jo

5.10.2.	a) Plumbosen mallrat apo mjetet që dalin? Po/Jo? Nëse po, si, nga kush dhe cfarë lloj plumbçesh përdoren? b) Përmenden numrat e plumbçeve në dokumentat shoqëruese të mallrave? Po/Jo c) Si mbani rregjistrimet e plumbçeve tuaja?
5.10.3.	Përshkruani shkurtimisht sesi garantoni përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë së klientëve për ngarkimin e mallrave?
5.10.4.	Përshkruani shkurtimisht rregullimet që keni të cilat garantojnë që mallrat ngarkohen dhe proceset e ngarkimit nuk lihen të pambikqyrura.
5.10.5.	Kontrollohen mallrat që dalin për plotësinë e tyre (p.sh. të numëruara, të peshuara)? Po/Jo Nëse po, si dhe nga kush?
5.10.6.	Përshkruani shkurtimisht si, kur dhe nga kush kontrollohen mallrat që dalin ndaj porosive dhe listave të ngarkimit dhe c'rregjistrimi nga inventari?
5.10.7.	Përshkruani shkurtimisht çfarë mekanizmash kontrolli keni për zbulimin e parregullsive në lidhje me ngarkimin e mallrave?
5.11.	**Kërkesa sigurie për partnerët e biznesit**
5.11.1.	a) Përshkruani shkurtimisht çfarë kërkesash sigurie dhe mbrojtje aplikoni kur zgjidhni partnerët tuaj të biznesit (p.sh. deklarata sigurie, kërkesa kontraktuale, partnerë tregtarë me status të OEA)? b) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.11.2.	Përshkruani shkurtimisht sesi kompania tuaj identifikon partnerët tregtarë për të siguruar zinxhirin e furnizimit (kërkim informacioni përpara pranimit të porosive apo dhënies së porosive).
5.11.3.	Gjatë vitit të kaluar, keni zbuluar ndonjë shkelje të marrëveshjeve të sigurisë me partnerët tuaj? Po/Jo. Nëse po, çfarë masash keni marrë?
5.12.	**Siguria e personelit**
5.12.1.	a) Përshkruani shkurtimisht sesi politika tuaj e punësimit merret me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes? Kush është përgjegjës për këtë fushë? b) Rregjistrohen procedurat e sigurisë me shkrim? Po/Jo. c) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me këto procedura?
5.12.2.	Në çfarë mase janë objekt i kontrolleve të sigurisë grupet e mëposhtëm të punonjësve (p.sh. verifikime policore për të konfirmuar nëse ai/ajo ka kryer vepra penale): a) punonjësit e rinj që do punojnë në fusha sigurie-sensitive b) punonjës egzistues që transferohen në fusha sigurie-sensitive.

	Si garantohet që kur largohet stafi ata të mos kenë më akses fizik apo elektronik në ambjentet apo të dhënat e kompanisë?
5.12.3.	Jepet trajnim për punonjësit në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen? Po/Jo. Nëse po: a) Cila është frekuenca e trajnimve të sigurisë dhe mbrojtjes? b) Keni freskime të përvitshme të trajnimeve? Po/Jo. c) Ky trajnim është i brendëshëm apo sigurohet nga jashtë? d) Ka rregjistrime me shkrim për trajnimet? Po/Jo.
5.12.4.	Ju lutem përgjigjuni me shkrim pyetjeve të mëposhtme: a) Specifikoni fushat ku përdoren punonjës të përkohshëm? b) Kontrollohen rregullisht këta punonjës në përputhje me standardet e sigurisë? Nëse po, si dhe nga kush? Keni gjithashtu udhëzime sigurie për këta punonjës?

5.13.	**Shërbime të Jashtme**

5.13.1.	Përdorni "shërbime të jashtme" me kontratë, si transportim, roje sigurie, pastrim, furnizime, mirëmbajtje etj.? Po/Jo. Nëse po: a) Përshkruani shkurtimisht çfarë shërbimesh ju sigurojnë ato dhe në çfarë mase (për ato që nuk janë shpjeguar në seksionet e mëparshme). b) Keni marrëveshje me shkrim me siguruesit e shërbimeve të jashtme që përmbajnë kërkesa sigurie? Po/Jo. c) Përshkruani shkurtimisht sesi kontrollohet përputhshmëria me procedurat e përfshira në këto marrëveshje?

5.14	**Standarted praktike dhe profesionale**

a) Përshkruani shkurtimisht se si politika e punësimit merret me kërkesat për standartet dhe kualifikimet profesionale. Kush është përgjegjës për këtë fushë?
b) Cili është programi i trajnimit i ndjekur, testimi i dhënë, insticioni apo qëndra arsimore/shoqata profesionale që e ka dhënë këtë trajnim?
c) Numri i punonjësve, emrat dhe pozicioni i punës aktual?
d) Dëshmitë e marra dhe kopje të tyre.

Shënimet shpjeguese për Pyetësorin e Vetë-Vlerësimit të OEA

Qëllimi i Aneksit 2, "Pyetësori i Vetë-vlerësimit" është për të mundësuar vlerësimin e kërkesave në lidhje me përfitimin e statusit të OEA dhe për t'i dhënë Autoriteteve Doganore informacion rreth jush dhe biznesit tuaj që hidhet në aplikim. Informacioni i dhënë në Pyetësorin e Vetë-vlerësimit për OEA nga operatori ekonomik gjithashtu do të përdoret në proçeset e dhënies së autorizimeve të tjera në të cilat është e nevojshme për të qenë në përputhje me disa apo të gjitha kriteret e OEA. Këto udhëzime ju japin drejtimin sesi t'i përgjigjeni pyetjeve si edhe informacionin për standardet që Autoritetet Doganore presin që Ju të arrini dhe të demonstroni për të fituar autorizimin e OEA.

1. Pyetësori i vetëvlerësimit është ndërtuar mbi dispozitat e Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikes së Shqipërisë", thjeshton dhe përshpejton proçesin e aplikimit për OEA.

   Për këtë arsye administrata doganore kërkon që operatorët ekonomikë të përdorin këtë pyetësor për të verifikuar gadishmërinë e tyre për të përmbushur kriteret e OEA.

   Kjo gjithashtu lejon Administratën Doganore të marrë një informacion të përgjithshëm për aplikuesin së bashku me aplikimin dhe kjo do të çojë në përshpejtimin e proçesit. Operatoret ekonomik janë të ftuar të plotësojnë saktësisht pyetësorin dhe t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve përkatëse për biznesin e tyre.

   Ju mund të gjeni informacion shtesë rreth OEA në faqen e internetit të administratës doganore.

   Ju lutem, keni kujdes që është e rëndësishme të lexoni legjislacionin e zbatueshëm përpara fillimit të proçesit të aplikimit.

2. Pyetesori duhet të dorëzohet së bashku me aplikimin për një çertifikatë OEA sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 1 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (mënyra e dorëzimit varet nga mënyrat që përdor D.P.D.).

   Rekomandohet që të kontaktohet D.P.D. nëse keni pyetje apo shënime rreth pyetësorit ose aplikimit përpara dorëzimit të tyre.

3. Pyetësori përmban çështjet më të rëndësishme që mund të përdoren nga administrata doganore për çdo seksion. Megjithatë, disa nga çështjet ndikojnë vetëm në aktorë të caktuar të zinxhirit të furnizimit. Pyetjeve që nuk i përkasin biznesit tuaj nuk është e nevojshme t'i përgjigjeni. Kjo gjithashtu mund të ndryshojë në varësi të llojit të çertifikatës që aplikoni. Ju lutem përgjigjuni këtyre çështjeve me "E paaplikueshme(N/A)" me një koment të shkurtër pse është e paaplikueshme. Ju mund gjithashtu të bëni referim p.sh. tek pjesa e zinxhirit të furnizimit që jeni përfshirë ose për llojin e çertifikatës që aplikoni.

   Nëse ju keni aktualisht thjeshtime doganore ose autorizime të tjera doganore që demonstrojnë që një apo më shumë kritere të OEA përmbushen, atëhere është e mjaftueshme t'u referoheni këtyre thjeshtimeve apo autorizimeve.

Nëse kompania juaj ka çertifikata, raporte ekspertësh ose përfundime të tjera të nxjerra nga ekspertë (p.sh. komente ekonomike, çertifikata ndërkombëtare, etj. Për më shumë referenca shikoni seksionin korrespondues në Udhëzimet për OEA), të cilat mbulojnë pjesërisht ose plotësisht kritere të caktuara, ju lutem tregojeni këtë në përgjigjet e pyetjeve përkatëse. Ju lutem kini kujdes se kjo nuk është e nevojshme, por nëse keni ndonjë prej tyre ky mund të jetë informacion i dobishëm për doganat dhe mund të çojë në përshpejtimin e proçesit.

4. Duhet të vihet re që përgjigjet individuale të pyetjeve nuk konsiderohen të veçuara, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm në lidhje me kriterin. Një përgjigje e pakënaqshme e një pyetje të vetme nuk mund të çojë në refuzimin e statusit të OEA, nëse kriteri tregohet i plotësuar në një vend tjetër gjatë proçesit (në terma të përgjithshëm).

5. Kushtet dhe kriteret për një çertifikatë OEA janë të gjitha të njëjta për të gjithë operatorët. Megjithatë, doganat do të marrin në konsideratë madhësinë e kompanisë (SMEs – ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme), statusin ligjor të kompanisë, strukturën, partnerët kyçë të biznesit dhe gjithashtu degët. Kjo nënkupton që implementimi i masave për të plotësuar kriteret mund të ndryshojë për shembull nga një operator në një operator tjetër në varësi të madhësisë, pa anashkaluar pajtueshmërinë me kërkesat.

6. Një çertifikatë OEA mbështetet mbi të njëjtat parime si të gjitha standardet e tjera ndërkombëtare dhe nëse standardet e brendshme të sigurimit të cilësisë janë duke u zbatuar nga kompania. Ju jeni përgjegjës për të patur procedura të sigurimit të cilësisë në ambjentet tuaja për çështje doganore, si edhe të sigurisë dhe mbrojtjes (nëse është rasti). Në vizitat në terren kompania tuaj duhet t'i tregojë administratës doganore që ju keni procedura të brendshme të përshtatshme në vend për të menaxhuar çështjet doganore dhe/ose të sigurisë dhe mbrojtjes, si edhe kontrolle të duhura të brendshme për të garantuar që këto procedura funksionojnë siç duhet. Politikat e brendshme dhe/ose udhëzimet duhet të dokumentohen elektronikisht ose në letër. Ato duhet të njihen brenda kompanisë, të jenë në dispozicion të të gjithë përdoruesve dhe sigurisht të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme.

   Për këtë, hapi i parë ka lidhje me standardet e brendshme të sigurisë së cilësisë. Përgjigjet në pyetësor së bashku me aplikimin e dorëzuar duhet të jenë një përmbledhje e procedurave dhe udhëzimeve të brendshme që ju keni për t'i dhënë administratës doganore një vështrim të përgjithshëm të biznesit tuaj. Për t'ju përgjigjur pyetësorit dhe për t'u përgatitur për auditimin e proçesit të OEA, të gjitha departamentet kryesore të biznesit tuaj të përfshira në zinxhirin e furnizimit (doganat, logjistika, financa/kontabiliteti, kompjuterizimi, blerjet, shitjet, siguria, departamenti i cilësisë, etj.) duhet të përfshihen në proçes.

7. Politikat e brendshme të kompanisë dhe udhëzimet në lidhje me çështjet doganore dhe/ose të sigurisë dhe mbrojtjes mund të referohen në përgjigjet e pyetësorit. Nëse veproni kështu, ju lutem specifikoni emrin ose numrin e dokumentit dhe mbaheni gati për auditimin në terren nga administrata doganore. Për të përshpejtuar proçesin është gjithashtu e mundur të dorëzoni dokumentat (mënyra e dorëzimit do të varet nga mënyrat që përdor D.P.D.) së bashku me pyetësorin.

8. Pyetësori i plotësuar së bashku me dokumentat mbështetëse të kërkuara duhet t'i vihet në dispozicion D.P.D. në mënyrë elektronike (e preferueshme) ose me shkrim.

9. Informacioni i dërguar brenda proçesit të aplikimit është sipas legjislacionit të sigurisë së të dhënave dhe do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

Seksioni 1 Informacioni i kompanisë

Ky seksion është kryesisht për t'i dhënë Autoritetit doganor një vështrim të përgjithshëm mbi kompaninë. Informacioni i kërkuar mund të jepet në mënyrë të përgjithshme dhe shërben si pasqyrë në datën e aplikimit. Në qoftë se informacioni i kërkuar është tashmë në dispozicion të

Autoritetit Doganor, atëhere tregojeni atë në formular ose jepni referencë të kohës kur është dhënë informacioni.

Nën-seksioni 1.1 Informacion i përgjithsëm i kompanisë

1.1.1 Për pyetjet a dhe b, ju lutem tregoni referencat e çertifikatës dhe aplikimit (emri dhe numri NIPT, autoritetin lëshues dhe numri i rregjistrimit).

1.1.2 Për pyetjen a, përfshini vetëm aksionerët që janë të përfshirë në punën/vendim-marrjen e përditshme të kompanisë.

1.1.3 Personi përgjegjës për çështje doganore është:

a) një person i punësuar direkt ose i emëruar nga ju, p.sh. agjent doganor për t'ju përfaqësuar në formalitete doganore, ose

b) person apo persona përgjegjës për t'ju përfaqësuar ju (përfaqësues ligjor) në çështje ku përfshihet ligji doganor; ata janë avokatë, juristë, etj të cilët mund të punësohen ose emërohen direkt nga ju për t'ju përfaqësuar në çështje ligjore doganore.

1.1.4 Jepni, kur është e mundur, kodin e klasifikimit statistikor të aktiviteteve ekonomike, të aktiviteteve tuaja tregtare. Përkufizimi i zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit jepet tek Udhëzimi i Ministrit të Financave për OEA.

1.1.5 Jepni detaje të ambjenteve të përfshira në aktivitetet doganore (nëse keni më shumë se pesë ambjente të përfshira në aktivitetet doganore, ju lutem jepni detajet e pesë ambjenteve kryesore të përfshira në aktivitetet doganore) dhe adresat e ambjenteve që mbeten të përfshira në këtë aktivitet.

Në rast të ambjenteve të reja të përfshira në aktivitete doganore gjatë proçesit të aplikimit për OEA, ju duhet të jepni detaje të plota të tyre.

1.1.6 Kjo është për të përcaktuar nëse ju tregtoni apo jo mallra (jo shërbime) me bizneset tuaja të lidhura. Për shembull, të gjitha blerjet janë nga kompania mëmë në SHBA ose ju importoni në emer të kesaj kompanie dhe shpërndani tek bizneset e lidhura jashtë vendit. Ju duhet të jepni detaje të plota gjatë proçesit të autorizimit.

1.1.7 Një skemë organizative të detajuar duke përfshirë fushat/departamentet/sektorët e biznesit tuaj, funksionet/përgjegjësitë e tyre dhe zinxhiri i menaxhimit mund të jepet në këtë drejtim.

1.1.8 Nëse nuk përmendet në pyetjet 1.1.2 b dhe c, ju lutem tregoni emrin dhe adresën e plotë, datën e lindjes dhe Numrin Identifikimit (p.sh. numrin e kartës së identitetit/letërnjoftimit ose numrin e sigurimeve).

Procedurat duhet të përshkruajnë masat që kanë të bëjnë me mungesat e përkohshme ose me afat të shkurtër të stafit kyç p.sh. menaxheri për doganat, zyrtari për importin duke përfshirë sesi mbulohen përgjegjësitë e tyre normale dhe nga kush.

1.1.9 Jepni numrin (e përafërt) të ditur në momentin e dorëzimit të aplikimit tuaj.

1.1.10 Nëse nuk keni departament doganor apo ekspert doganor brenda kompanisë tuaj, theksoni "i paaplikueshëm (N/A)". Shikoni Pyetjen 1.1.3 që mbulon gjithashtu këtë çështje.

1.1.11 Miratimi për të hedhur detajet e OEA në faqen e internetit të D.P.D.

Nëse dëshironi që emri juaj të përfshihet në listën e OEA të botuar në faqen e internetit të D.P.D., atëhere kërkohet miratimi juaj me shkrim. Ky miratim zbatohet për të gjitha llojet e çertifikatave. Nëse nuk jepni miratimin tuaj, ju përsëri merrni përfitimet e statusit OEA por emri juaj nuk do të mund të shihet nga publiku në listën që botohet në faqen e D.P.D. Nëse ju e jepni miratimin tuaj ju keni të drejtën t'a tërhiqni atë në çdo kohë, nëse ju kërkoni heqjen nga lista atëherë ju hiqeni automatikisht nga kjo listë e përmendur më lart. Ju gjithashtu keni të drejtë të jepni miratimin tuaj duke dërguar një kërkesë me shkrim tek D.P.D. në çdo kohë edhe pasi çertifikata është lëshuar. Ndryshimet në miratimin tuaj mund të bëhen duke informuar me shkrim D.P.D. Firma e vetme e pranueshme për keto qëllime është ajo e personit me autoritetin për të firmosur në emër të operatorit ekonomik.

1.1.12 Miratimi për të shkëmbyer detajet e OEA

Miratimi për njohje reciproke vlen vetëm për Çertifikatat AEOP ose AEOS.

Që njohja reciproke të funksionojë është shumë e rëndësishme që Shërbimet Doganore të palëve të kenë informacion për OEA- të e njëra-tjetrës. Shkëmbimi i disa të dhënave në lidhje me OEA-të është thelbësor, si p.sh vlefshmëria e statusit OEA është një pjesë e nevojshme e shkëmbimit të informacionit dhe të dhënat që do të shkëmbehen do të jenë rigorozisht për qëllim të zbatimit të programeve të njohjes reciproke

Miratimi juaj për të shkëmbyer informacione mbi OEA-të me Shërbimet Doganore të vendeve të tjera për njohjen reciproke do të jetë e përgjithshme, jo e lidhur me vende specifike.

Megjithatë sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, autoritetet doganore mund të shkëmbejnë informacionin tuaj të OEA-së pas një vlerësimi të nivelit të mbrojtjes së të dhënave në vendin tjetër për t'u siguruar që ai siguron një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave.

Nëse ju preferoni të mos e jepni miratimin, të dhënat tuaja të OEA-së nuk do të shkëmbehen me vendet partnere të njohjes reciproke dhe ju nuk do të mund të merrni përfitimet që parashikojnë marrëveshjet e njohjes reciproke.

Nëse ju jepni miratimin tuaj ju gjithashtu keni të drejtë të tërhiqeni në çdo kohë duke u dërguar një kërkesë me shkrim autoriteteve doganore kopetente. Megjithatë, tërheqja e miratimit për shkëmbimin e të dhënave të OEA-së do të sjellë gjithashtu heqjen e përfitimeve që lidhen me njohjen reciproke. Tërheqja gjithashtu do të jetë e përgjithshme, që do të thotë se ne nuk do të shkëmbejmë të dhënat tuaja të OEA-së me asnjë nga vendet partnere të njohjes reciproke. Ju keni gjithashtu të drejtën e tërheqjes në çdo kohë pasi Çertifikata të jetë lëshuar

Ju duhet të jepni dy miratime eksplicite të veçanta, njërën për publikimin e të dhënave tuaja në internet dhe tjetra për njohjen reciproke. Firma për qëllim të këtij miratimi do të jetë firma e personit që ka autoritetin të firmosë në emër të operatorit ekonomik.

1.1.13 Për të mundësuar shkëmbimin e informacionit mbi OEA-të, kur është e nevojshme, informacioni përkatës i OEA-së të shkruhet me shkronja të thjeshta të alfabetit me 26 shkronja (Latin 1). Juve do t'u duhet të njoftoni partnerët tuaj të biznesit në këto vende partnere të shkruajnë emrin dhe adresën e kompanisë tuaj në këtë mënyrë në kontaktet e tyre(deklarimet doganore) me administratën doganore Shqiptare. Disa vende nuk mund të përdorin të njëjtin set karakteresh që përdoret në Shqipëri. Shkronjat cirilike, karakteret e veçantë me theksin mbi ose nën shkronjë, ose shkronjat që nuk gjenden në alfabetin 26 shkronjësh (Latin 1) nuk mund të futen në sistemet e Teknologjisë së

Komunikimit dhe Informacionit.

Ju lutem vendosni me shkronja latine emrin, rrugën, numrin, kodin postar dhe qytetin në këtë kuti. Nëse ju nuk jepni miratimin për shkëmbimin e të dhënave OEA ose aplikoni vetëm për Çertifikatën OEA-C, nuk ka nevojë të plotësoni këtë kuti.

Nënseksioni 1.2 Vëllimi i biznesit

1.2.1 Nëse ju jeni biznes i ri dhe keni më pak se tre deklarata vjetore financiare të plota (tre vitet e fundit), jepni informacion për ato të cilat janë plotësuar. Nëse nuk punoni prej një kohe të mjaftueshme për të prodhuar ndonjë deklaratë vjetore financiare të përfunduar, shënoni "i paaplikueshëm (N/A)".

1.2.2 Ju lutem tregoni vendodhjen e këtyre ambjenteve magazinimi (nëse keni më shumë se pesë ambiente magazinimi tregoni 5 ambientet kryesore, numrin total të ambienteve të magazinimit).

1.2.3 Për agjentët doganore përfshini të gjitha deklarimet të bëra në emrin tuaj dhe në emër të të tjerëve.

Një shembull:
L = tregon leke;
m= milion

	Impor		Export		Tranzi	
	Numri	**vlera**	**Numri/**	**vlera**	**Numri**	**vlera**
2007	2200	L9.6 m	400	L2.6 m	150	L0.8 m
2008	2500	L10.3 m	350	L2.2 m	100	L0.4 m
2009	2400	L10.2 m	340	L2.1 m	100	L0.5 m

1.2.4 Për agjentët doganor, përfshini shumat e paguara prej llogarive tuaja ose të klientëve tuaj.

Një shembull:

	Det. doganore	Det.Akcize	T.V.SH.
2007	L300 m	L1.75m	L2.32m
2008	L400m	L1.87m	L2.12m
2009	L380m	L1.85m	L2.10m

1.2.5 Ndryshime të ardhshme të njohura që mund të ndikojnë në organizimin e kompanisë, përmbushjen e kritereve të OEA-së ose vlerësimit të rriskut të zinxhirit të furnizimit. Kjo mund të përfshijë ndryshime të personelit kyç, ndryshime në sistemin e kontabilitetit, hapjen e pikave të reja, kontrata te reja logjistike etj.

Nënseksioni 1.3 Informacioni dhe statistika per ceshtje doganore

1.3.1 Për pyetjet b dhe c, nëse partneri/partnerët tuaj po i nënshtrohen aktualisht një auditimi OEA, ju lutem tregoni çertifikatën dhe referencat e aplikimit (emrin dhe numrin e NIPT-it, autoritetin doganor që e ka lëshuar dhe numrin e regjistrimit).

1.3.2 Për pyetjen a, ju lutem tregoni emrin dhe pozicionin e anëtarit të stafit përgjegjës për klasifikimin e mallrave tuaj ose nëse përdorni një palë të tretë për këtë qëllim përfshini emrin/emrat e tyre.

Për pyetjet b dhe d, veçanërisht nëse përdorni një palë të tretë, si siguroheni që puna është kryer siç duhet dhe sipas udhëzimeve tuaja?

Për pyetjen b, tregoni nëse ju mbani një dosje të produktit ku çdo artikull është i lidhur me një kod malli me detyrimin përkatës dhe përqindjen e TVSH-së.

Për pyetjen c, nëse masat e garantimit të cilësisë janë vendosur siç duhet, ju duhet të jepni prova gjatë vizitës së audituesve të doganës se ju i kontrolloni rregullisht dhe në mënyrë të plotë ato, dokumentoni çdo ndryshim dhe vini në dijeni stafin që preket për ndryshimet.

Për pyetjen d, tregoni si, nga kush dhe sa shpesh bëni rishikimin e klasifikimeve dhe bëni përditësimin e dosjes së produktit dhe çdo regjistrim tjeter që ka lidhje me këto si edhe njoftimin e personave që preken nga ndryshimet p.sh agjentin, stafin që bën blerjet etj.

Për pyetjen e, tregoni gjithashtu nëse përdorni ndonjë ITD (Informacion Tarifor të Detyrueshëm)

Gjatë proçesit të auditimit ju mund të vini në dispozicion:

– Detaje/lista ose dosje prodhimi të produkteve tuaja dhe kodin përkatës të mallit dhe normën e detyrimit.
– Burimet/informacionin psh. tarifën e përditësuar, informacionin teknik që përdorni zakonisht për klasifikimin e mallrave.

1.3.3. (a) Tregoni emrin dhe pozicionin e personit përgjegjës në stafin tuaj për vlerësimin e mallrave ose nëse përdorni një palë të tretë për këtë qëllim, përfshini emrin/emrat e tyre.

1.3.3. (b) dhe (d), nëse përdorni një palë të tretë, si siguroheni që kjo punë është bërë në mënyrë të saktë dhe sipas udhëzimeve tuaja?

1.3.3. (b) Masat e garantimit të cilësisë duhet të përfshijnë, për shembull,

- metodat e përdorura për vlerësimin,
- si plotësohen dhe paraqiten deklaratat e vlerësimit kur kërkohet,
- si përcaktohen vlerat doganore dhe TVSH,
- si llogariten kostot e siguracionit dhe transporti,
- pagesat dhe tarifat e liçensës të lidhura me mallrat e importuara të pagueshme drejtpërdrejt ose tërthorazi nga blerësi si kusht për shitjen,
- marrëveshje sipas të cilave pjesa e të ardhurave nga rishitja, tjetërsimi/asgjësimi apo përdorimi i mëpasshëm i paguhet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit,
- kosto që shkaktohen nga blerësi (por që nuk janë përfshirë në çmim) që lidhen me komisionet ose agjensitë (përveç komisioneve të blerjes) ose
- kosto që shkaktohen në lidhje me ambalazhet dhe paketimet, mallrat dhe /ose shërbimet e kryera nga blerësi pa pagesë ose me kosto të reduktuar për përdorim në lidhje me prodhimin dhe shitjen për eksport të mallrave të importuar.

1.3.3. (c), Nëse masat e garantimit të cilësisë janë vendosur siç duhet, ju duhet të siguroni prova, gjatë vizitës së auditorëve doganorë, se ju rregullisht dhe tërësisht rishikoni proçedurat tuaja, dokumentoni çdo ndryshim dhe njoftoni stafin që preket nga ndryshimet.

1.3.4 Për pyetjen b, masat e brendshme përfshijnë normalisht ato masa që garantojnë se:

- Vendi eksportues gëzon të drejtën e dhënies së preferencës dhe mallrat përfitojnë detyrim preferencial;

- Plotësohen kërkesat për transportin e drejtpërdrejtë/ të pamanipuluar;
- Një Çertifikatë e vlefshme dhe origjinale ose një deklaratë faturë të jetë e disponueshme kur pretendohet preferenca;
- Çertifikata dhe deklarimi faturë është i duhuri për dërgesën dhe rregullat e origjinës plotësohen
- Nuk ka mundësi të përdorë dy herë deklaratën faturë/çertifikatën
- Preferenca në import e pretenduar brenda periudhës kohore të vlefshmërisë së çertifikatës/deklaratës faturë, dhe
- Çertifikatat/deklaratat faturë origjinale ruhen si pjesë e gjurmimit të auditimit në mënyrë të sigurtë dhe të mbrojtur.

Për pyetjen c, përqasja juaj duhet marrë në konsideratë mënyrën për të garantuar që:

- Mallrat kualifikohen për preferencën në eksport p.sh. përmbushin rregullat e origjinës;
- Të gjitha dokumentet/përllogaritjet/kostot/përshkrimet e nevojshme të proçeseve në mbështetje të origjinës preferenciale dhe lëshimi i një çertifikate/deklaratrë faturë ruhen si pjesë e gjurmimit të auditimit në mënyrë të sigurtë dhe të mbrojtur;
- Dokumentet përkatës si p.sh çertifikata ose deklarata faturë firmosen dhe lëshohen në kohë nga një anëtar i autorizuar i stafit;
- Deklaratat faturë nuk lëshohen për dërgesa me vlerë mesatare dhe të lartë përveçse kur keni miratimin e autoritetit doganor për të vepruar kështu;
- Çertifikatat e papërdorura ruhen në vende të sigurta dhe të mbrojtura,dhe
- Çertifikatat paraqiten kur kërkohen nga dogana në eksport.

1.3.5 Jepni sipas rastit:

- Emrat e vendeve të tjera dhe/ose
- Emrat dhe adresat e prodhuesve për mallrat e të cilëve ju duhet të paguani detyrime antidumping ose kundërbalancuese.

Seksioni 2 Pajtueshmëria/përputhshmeria e rregjistrime/të dhënave doganore dhe tatimore

Shënim: Sipas nenit 17 të kësaj VKM, të dhënat/regjistrimet e pajtueshmërisë doganore e tatimore të kompanisë tuaj dhe personave të identifikuar në pyetjet 1.1.2, 1.1.3 dhe 1.1.8 do të mbështetet në tre vitet e fundit përpara aplikimit. Gjata kësaj periudhe kohore ju nuk duhet të keni kryer asnjë shkelje të rëndë ose të përsëritur të legjislacionit doganor dhe tatimor. Megjithatë, të pajtueshmëria e të dhënave/regjistrimeve mund të konsiderohen si të pranueshme nëse shkeljet janë të një rëndësie të vogël ose të papërfillshme në lidhje me numrin ose madhësinë e operacioneve/aktiviteteve doganore dhe tatimore nuk lënë vend për dyshime për sa i përket nivelit të përgjithshëm të përpuethshmërisë.

Në këtë mënyrë, dogana do të marrë në konsideratë:

- parregullsitë/gabimet në tërësi dhe të akumuluara
- shpeshtësinë e tyre për të përcaktuar nëse ka një problem sistematik
- nëse ka pasur synime mashtrimi apo neglizhencë
- nëse ju i keni njoftuar autoritetet doganore vullnetarisht për gabimet/parregullsitë që keni zbuluar
- nëse ju keni marrë masa korigjuese për parandalimin ose minimizimin e gabimeve në të ardhmen.

2.1 a) Shembuj të shkeljeve të zbuluara të ligjit doganor:

1. Mars deri Shtator 2010 – përdorim të kursit të pasaktë të monedhës për importet nga Kina që rezultoi në një mbideklarim të detyrimeve doganore dhe TVSH-së me L5500.

2. Dhjetor 2010 – mos përmbushje e detyrimit për deklarimin përmbledhës tre mujor në Regjimin e Përpunimit Aktiv.

Nëse ka disa, jepni një numër totaI dhe një përmbledhje të shkurtër për arësyet kryesore të gabimeve.

2.1 b) Shembuj të masave për garantimin e cilësisë të aktivitetit të shoqërisë lidhur me aspektetet doganore të marra nga ju duke u nisur nga 2 rastet e dhëna në 2.1a) më sipër:

1. 6.10.2010 – Ndërrim i sistemit kompjuterik për të parandaluar që hedhjet në sistem të mbyllen deri sa të bëhet kontrolli për monedhën e deklaruar.

2. Rishikim i proçedurës të regjimit të përpunimit aktiv, për këtë tre mujor dhe dhënia e tyre stafit përkatës.

Masat për garantimin e cilësisë të aktivitetit të shoqërisë lidhur me aspektetet doganore normalisht përfshijnë:

- Caktimin e personit të kontaktit brenda biznesit tuaj përgjegjës për të zbuluar gabimet/parregullsitë duke përfshirë dyshimin për kryerjen e një aktiviteti kriminal përkundrejt doganave apo institucioneve të tjera shtetërore,
- Kërkesa, përfshirë shpeshtësinë, për kontrollet që do të kryen dhe dokumentohen mbi saktësinë, gjithpërfshirjen dhe përshtatshmërinë e regjistrimeve dhe mbajtjen e tyre p.sh. deklarimet/kthimet e pagesave që i janë bërë doganës e autoriteteve të tjera, përmbushja e kushteve të autorizimeve/lejeve,
- Përdorimi i burimeve të auditit të brendshëm për të testuar/përftuar sigurinë e procedurave tuaja,
- Si njoftohet stafi mbi kërkesat/ndryshimet,
- Shpeshtësia e rishikimeve të ardhshme,
- Kontrolle të menaxhimit për t'u siguruar mbi ndjekjen e proçedurave.

2.2 Për shembull:

Maj 2010 – Refuzim i zbatimit te magazinimit doganor për shkak të mungesës së nevojës ekonomike.

Refuzimi/heqja/pezullimi i çdo autorizimi/miratimi doganor nuk do të sjellë domosdoshmërisht refuzimin e kërkesës tuaj për statusin OEA.

Seksioni 3 Sistemi i kontabilitetit dhe logjistik

Me qëllim përmbushjen e kritereve të përmendura në nenin 18 gërmat "a" dhe "b" të këtij vendimi, ju duhet të mbani një sistem kontabiliteti i cili mundëson kontrollet doganore të mbështetura në auditim. Për t'u mundësuar doganës zbatimin e kontrolleve të nevojshme, ju duhet t'i lejoni doganës akses fizik ose elektronik në regjistrat tuaj. Aksesi elektronik nuk është një parakusht për të përmbushur këtë kërkesë.

Me qëllim përmbushjen e kritereve të përmendura në nenin 18 gërma "c" të këtij vendimi, ju gjithashtu duhet të keni një sistem ose procese që bëjnë dallimin midis mallrave shqiptare dhe jo shqiptare, sepse ky kusht nuk është i duhur në rastin e Çertifikatës OEA-Siguri dhe Mbrojtje. Duhet të theksohet se ky është i vetmi ndryshim në kërkesat për një autorizim për Siguri dhe Mbrojtje dhe një autorizim për Thjeshtime Doganore/Siguri dhe Mbrojtje.

Nënseksioni 1: Gjurmimi i auditimit

Shumë biznese dhe organizata kërkojnë një gjurmim auditimi në sistemet e tyre të automatizuara për arsye sigurie. Gjurmimi i auditimit është një proçes ose një rast i referimit të çdo hyrje në regjistër deri në burimin e saj në mënyrë që të kontrollohet saktësia. Një gjurmim i plotë auditimi do t'ju mundësojë të gjurmoni aktivitetet operacionale që nga fluksi i mallrave dhe produkteve që hyjnë, deri te përpunimi dhe dalja e tyre. Një gjurmim i plotë auditimi gjithashtu mban një regjistër të historikut që ju mundëson gjurmimin e një të dhëne nga momenti që ajo futet në dosje deri në kohën që del.

Sistemi i kontabilitetit normalisht do të përfshinte:

- Regjistrin e përgjithshëm
- Regjistër i shitjeve
- Regjistër i blerjeve
- Asetet
- Llogaritë e menaxhimit

Sistemi logjistik normalisht do të përfshinte:

- Përpunimi i porosive në shitje
- Përpunimi i porosisë në blerje
- Prodhimi
- Inventari – ruajtja, magazinimi
- Dërgimi/transporti
- Furnizuesi/listat e klientëve

3.1 Gjurma juaj e auditimit duhet të përfshijë:

- Shitjet
- Blerjet dhe porositë e blerjeve
- Kontrollin e inventarit
- Magazinimin (dhe lëvizjet midis ambjenteve të magazinimit)
- Prodhimin
- Shitjet dhe porositë e shitjeve
- Deklarimet doganore dhe dokumentacionin
- Dërgimin
- Transportimin
- Kontabilitetin p.sh faturimin, shenimet e debitit dhe kreditit, transfertat/pagesat

Nënseksioni 3.2: Sistemi i kontabilitetit

3.2.1 Tregoni nëse përdorni:

a) Hardëare si:

- Kompjuter personal (PC) i vecuar (të palidhur në rrjet),
- PC që janë të lidhur në rrjet bashkë
- Një sistem kompiuterik i mbështetur tek serveri
- Një sistem i mbështetur tek njësia qëndrore
- Të tjera

b) Softëare si programe kompiuterik që i lejojnë kompjuterit të vënë në funksion dhe egzekutojë aplikime (Softëare) që mbështesin biznesin p.sh. Kurs ëindoës, UNIX, etj.

c) Sisteme si (jepni emrin e furnizuesit):

- Një zgjidhje plotësisht të integruar Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes (ERP)
- Një kombinim i aplikimeve të Softëare të kontabilitetit dhe logjistikes
- Një zgjidhje Softëare për biznesin e fokusuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
- Një zgjidhje Softëare e zhvilluar nga/ose për biznesin tuaj.

Shënim: gjatë proçesit të autorizimit do t'ju duhet të demonstroni:

- *Shkallën e kompjuterizimit*
- *Platformën Hardëare që dispononi dhe sistemin operues që funksionon në të*
- *Ndarjen e funksioneve të zhvillimit, testimit dhe operacioneve*
- *Ndarja e funksioneve midis përdoruesve*
- *Si kontrollohet aksesi për në pjesë të ndryshme të sistemit*
- *Nëse ka patur përshtatje të paketës standarte*
- *Listën e regjistrave të llogarive*
- *Nëse sistemi verifikon llogarite e përkohshme*
- *Si hidhen në regjistër pagesat doganore/detyrimet e akcizës/TVSH*
- *Nëse ju operoni me lote (sete, grupe)*
- *Nëse regjistrat tuaj financiar dhe të inventarit janë të lidhur*
- *Si i administroni regjistrat tuaj kur ato ruhen nga një palë e tretë si ofrues i këtij shërbimi*

3.2.3 Nëse aktivitetet, si për shembull përcaktimi i të dhënave kryesore ose hedhja e të dhënave kryen në më shumë se një vend, informo se cilat aktivitete kryen në secilin vend.

Nënseksioni 3.3 Sistemi i brendshëm i kontrollit

Sipas nenit 18 të këtij vendimi, ju duhet të keni një sistem i cili i korrespondon llojit dhe madhesisë së biznesit tuaj dhe që është i përshtatshëm për administrimin e fluksit të mallrave dhe që ka kontrolle të brendshme në gjendje të zbulojnë transaksione të parregullta ose të paligjshme.

3.3.1 Gjatë vizitës së audituesve, ju duhet të siguroni prova se i rishikoni rregullisht dhe tërësisht procedurat tuaja, dokumentoni çdo ndryshim dhe njoftoni stafin që preket nga ndryshimet.

3.3.2 Shembuj të kontrolleve të auditimit:

- Auditim i brendshëm nga brenda kompanisë tuaj ose nga kompania mëmë;

- Auditim i jashtëm nga klientët, financierë/auditorë të pavarur, dogana ose institucione të tjera shteterore.

Ju gjithashtu do t'ju duhet të bëni të disponueshëm çdo raport kur dogana viziton ambjentin tuaj si edhe prova të veprimeve të ndërmarra për korrigjimin e mangësive të gjetura.

3.3.3 Standing data ose dosjet kryesore nënkuptojnë informacion kyç të biznesit tuaj p.sh. emrat dhe adresat e klientëve, furnizuesit, dosje të produktit që përmbajnë informacion mbi përshkrimin e mallrave, kodin dhe origjinën e mallit etj.

Nënseksioni 3.4 Fluksi i mallrave

3.4.1 Procedurat tuaja të regjistrimit gjatë mbërritjes së mallrave duhet të përfshijnë:
- Procedurat e porositjes së blerjes
- Konfirmimin e porosisë
- Dërgimin/transportimin e mallrave
- Kërkesa për dokumentacionin mbështetës
- Transportin e mallrave nga kufiri për në ambjentet e klientit tuaj
- marrjen e mallrave në ambjentet tuaja ose të klientit
- Pagesat/marrëveshjet
- Si, kur dhe kush i regjistron mallrat në regjistrin e inventarit

Gjatë magazinimit të mallrave,
- Përcaktim i qartë i vendit për magazinim
- Magazinim i sigurtë për mallrat e rrezikshme/të dëmshme
- Nëse stoku regjistrohet sipas vlerës dhe/ose sasisë
- Egzistenca dhe shpeshtësia e inventarizimit
- Nëse përdorni ambjentet e një pale të tretë për magazinimin e mallrave, marrëveshjet që rregullojnë përputhshmërinë e regjistrave tuaj të stokut me ato të palës së tretë
- Nëse përdoret një ambjent i përkohshëm për magazinimin e mallrave,

Gjatë proçesit të prodhimit të mallrave,
- Hartimi i porosive të punës
- Kërkesa për artikuj stok dhe dërgimi nga magazina
- Proçesi i prodhimit, përgjegjësitë e stafit dhe ruajtja e regjistrimeve
- Kodet e recetave
- Regjistrimi i produktit të prodhuar dhe stokut të papërdorur në regjistrat e inventarit
- Përdorimi i metodave standarte në prodhim

Dhe gjatë procesit të dërgimit të mallrave,
- Marja e porosisë së klientit dhe hartimi i porosisë së punës ose blerjes
- Informimi i magazinës për porosinë/çlirimin e blerjes së mallrave
- Udhëzimet për palën e tretë nëse mallrat janë magazinuar diku tjetër
- Marja e mallrave
- Procedurat e paketimit
- Si, kur dhe kush i përditëson regjistrat e inventarit

3.4.2 Procedurat tuaja të kontrollit të mallrave dhe cilësisë duhet të përfshijnë, gjatë mbërritjes së mallrave:
- Pajtueshmëri midis porosisë së blerjes dhe mallrave të marra
- Marrëveshjet për kthimin/refuzimin e mallrave
- Marrëveshjet për regjistrimin dhe raportimin e dërgesave me tepricë ose mangësi

- Marrëveshjet për identifikimin dhe korigjimin e të dhënave të pasakta të hedhura në regjistrin e inventarit
- Identifikimin e mallrave jo shqiptare brenda sistemit,

Gjatë magazinimit të mallrave,
- Regjistrimi dhe kontrolli i stokut.
- Identifikimi i mallrave shqiptare dhe jo shqiptare (nuk nevojitet për Çertifikata të Sigurisë dhe Mbrojtjes).

- Lëvizja dhe regjistrimi i mallrave midis vendndodhjeve në të njëjtat ambjente ose në pjesë të ndryshme ambjentesh.
- Marrëveshjet për trajtimin dëmtimeve, thyerjeve ose shkatërrimin e mallrave, humbjeve dhe devijimet e stokut.

Gjatë proçesit të prodhimit,
- Monitorimin dhe administrimin e kontrolleve të proçeseve të prodhimit p.sh. koefiçentin e shfrytëzimit.
- Si i trajtoni parregullsitë, devijimet, mbetjet, nënproduktet dhe humbjet në proçesin e prodhimit.
- Kontrollet e cilësisë të mallrave të prodhuar dhe regjistrimi i rezultateve.
- Largimi i sigurtë i mallrave të rrezikshëm,

Dhe, gjatë proçesit të dërgimit të mallrave,
- Shënimet e nisjes/marrjes së mallrave.
- Transporti i mallrave për tek klienti ose për në kufi për (Ri-)eksport.
- Bërja e faturave të shitjes.
- Instruksionet për agjentin për (Ri-)eksport dhe pregatitja/disponueshmëria/kontrolli i dokumentacionit mbështetës.
- Njohja e marrjes/evidenca e dërgimit të mallrave
- Mallrat e kthyera – kontrolli, numërimi dhe regjistrimi në inventar.
- Shënime të pagesës dhe kreditit.
- Trajtimi i parregullsive, dërgesa të mangëta dhe devijimeve.

Nënseksioni 3.5 Rutina Doganore

Me qëllim përmbushjen e kritereve të përmendur në nenin 18, shkronja "d", të këtij vendimi, ju duhet kur është e zbatueshme, të keni procedura të kënaqshme për liçensat dhe autorizimet në lidhje me masat e politikës tregtare ose bujqësore;

Me qëllim përmbushjen e kritereve të përmendur në nenin 18, shkronja "e" të këtij vendimi, ju duhet të siguroheni se punonjësit kanë dijeni të nevojës së informimit të autoritetit doganor kurdo që ka vështirësi në përmbushjen e detyrimeve dhe të vendosin kontaktet e përshtatshme për të informuar doganën në raste te tilla.

3.5.1 Si importues, eksportues, mbajtës i magazinës, procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- Si ju siguroheni për plotësimin dhe saktësine e deklarimit doganor që ju bëni vetë, duke përfshirë edhe kryerjen e kontrolleve të menaxhimit.
- Paraqitjen ose disponueshmërinë e dokumentacionit mbështetës.
- Detaje të përditësuara (emra dhe adresa) të agjentëve/palëve të treta të përdorur.
- Si caktohen agjentët p.sh.kontrollet e besueshmërisë dhe përshtatmërisë që ju kryeni përpara se ti caktoni.
- Rrethanat në të cilat ata përdoren.
- Kontrata që detajojnë përgjegjësitë, duke përfshirë llojin e përfaqësimit nga agjenti p.sh. i drejtpërdrejtë, i tërthortë.

- Mënyra se si ju i jepni agjentit tuaj udhëzime të qarta.
- Si ju i siguroni dokumente mbështetës agjentit tuaj (p.sh liçensa, çertifikata etj), duke përfshirë paraqitjen dhe mbajtjen/kthimin.
- Çfarë duhet të bëjë agjenti nëse udhëzimet nuk janë të qarta.
- Kontrolli/verifikimi nga ju i saktësisë së punës dhe korrektësisë të agjentit tuaj.
- Si e njoftoni agjentin tuaj në lidhje me gabimet/ndryshimet në lidhje me zhdoganimet.

- Trajtimi i parregullsive.
- Paraqitja vullnetare e gabimeve tek autoritetet doganore.

Si përfaqësues i palës së tretë, procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- Kontrata të detajuara për përgjegjësitë, duke përfshirë llojin e përfaqësimit që do të bëni p.sh. i drejtpërdrejtë, i tërthortë.
- Si siguroheni që deklarimet e bëra nga ju të jenë të plota, të sakta dhe në kohë, duke përfshirë kryerjen e kontrolleve të menaxhimit.
- Paraqitje korrekte ose disponueshmëri të dokumentacionit mbështetës.
- Sa është i informuar stafi juaj për kërkesat e klientëve dhe të kontratave.
- Çfarë bëni në rastet kur udhëzimet e klientëve janë të paqarta ose informacioni i dhënë është i pasaktë.
- Çfarë bëni në rastet kur zbuloni gabime/ndryshime në lidhje me zhdoganimet.
- Informim vullnetar i doganës për gabimet.

3.5.2 Kur këto udhëzime janë të dokumentuara, duhet të siguroni prova, gjatë vizitës së auditorëve doganor, që ju rregullisht dhe në mënyrë të plotë i rishikoni procedurat tuaja, dokumentoni çdo ndryshim dhe njoftoni për këto stafin që preket nga ndryshimet.

3.5.3 Nëse keni procedura për trajtimin e liçensave dhe autorizimeve, duhet të siguroni. prova, gjatë vizitës së auditorëve doganor, që ju rregullisht dhe në mënyrë të plotë i rishikoni procedurat tuaja, dokumentoni çdo ndryshim dhe njoftoni për këto stafin që preket nga ndryshimet.

Nënseksioni 3.6 Procedurat për back-up, rekuperimin, proceduren rezerve (fallback) dhe arkivimin

Me qëllim përbushjen e kritereve të përmendur në nenin 18, shkronja "dh", të këtij vendimi, ju duhet të keni procedura bindëse për arkivimin dhe nxjerrjen e të dhënave dhe informacionit dhe mbrojtje ndaj humbjes së informacionit.

3.6.1 Procedurat tuaja duhet të përfshijnë mënyrën/instrumentat ku ruhen të dhënat, në cilin format Softëare të dhënat ruhen dhe nëse këto të dhëna grupohen (ngjeshen) dhe në çfarë mase. Nëse përdoret një palë e tretë, ju lutem tregoni marrëveshjet, shpeshtësinë dhe vendndodhjen e informacionit të arkivuar dhe back-up.

3.6.2 Nëse po, tregoni si ju garantoni cilësinë teknike afatgjatë të regjistrimeve dhe disponueshmërinë e Hardëare-it dhe kodit të programit.

Nënseksioni 3.7 Mbrojtja e sistemeve kompjuterike

Me qëllim përbushjen e kritereve të përmendur në nenin 18, shkronja "ë", të këtij vendimi, ju duhet të keni masat e duhura të sigurisë për teknologjinë e informacionit, p.sh. fireëall-et dhe mbrojtjen antivirus, me qëllim mbrojtjen e sistemit tuaj kompjuterik

nga hyrja e paautorizuar dhe sigurimin e dokumentacionit.

3.7.1 Për pyetjen a, veprimet tuaja duhet të marrin në konsideratë:

- Një plan të përditësuar të sigurisë ku përshkruhen masat e marra për mbrojtjen e sistemit tuaj kompjuterik nga hyrja e paautorizuar si dhe shkatërrimin dhe humbjen e qëllimshme të informacionit.
- Detaje nëse ju operoni sisteme të shumëfishta në ambjente të shumëfishta dhe si i kontrolloni ju këto.
- Kush është përgjegjës për mbrojtje dhe funksionimin e sistemit kompjuterik të kompanisë (përgjegjësia nuk duhet të kufizohet vetëm te një person i vetëm por te disa persona të cilët të monitorojnë veprimet e njëri – tjetrit).
- Detaje për fireëall-et dhe mbrojtjen antivirus.
- Një plan biznesi vazhdimësie/disaster recovery në rastet e incidenteve.
- Back-up rutinë për rastet kur sistemi nuk funksionon, përfshirë kthimin e të gjitha të dhënave dhe programeve përkatëse.

Për pyetjen b, tregoni shpeshtësinë e testimit të sistemit tuaj kundër hyrjes së paautorizuar, regjistrimin e rezultateve, dhe si i trajtoni rastet e incidenteve kur sistemi është kompromentuar.

3.7.2 Procedurat tuaja të dhënies së të drejtës së hyrjes në sistem duhet të përfshijnë:

- Si lëshoni autorizimin për të drejtës e hyrjes dhe niveli i kësaj të drejte në sistemin kompjuterik. (Aksesi në informacionin sensitiv duhet të kufizohet vetëm tek stafi i autorizuar për zbatimin e ndryshimev/shtesave në informacion).
- Formati për vendosjen e fjalëkalimeve, shpeshtësia e ndryshimit dhe kush i jep fjalëkalimet, dhe
- Fshirja/mirëmbajtja/përditësimi i detajeve të përdoruesit

Nënseksioni 3.8 Siguria dokumentare

3.8.1 Veprimet tuaja normalisht do të përfshinin:

- Regjistrimin dhe mbështetja (back up) e dokumentacionit duke përfshirë skanimin dhe mikrofishat dhe aksesin e kufizuar.
- Një plan sigurie i përditësuar ku përshkruhen masat për mbrojtjen e dokumentacionit nga hyrja e paautorizuar si dhe nga shkatërrimi ose humbja e qëllimtë.
- Vendosja në dosje dhe ruajtja e sigurtë dhe mbrojtur e dokumenteve duke përfshirë përgjegjësitë për trajtimin e tyre.
- trajtimi i incidenteve të cilët kompromentojnë sigurinë e dokumenteve.

3.8.2 Masat tuaja duhet të përfshijnë:

- Testimin e sitemit tuaj kundër hyrjes së paautorizuar dhe regjistrimi i rezultateve
- Një plan biznesi vazhdimësie/disaster recovery.
- Veprimet e ndërmarra për rekuperimin e dokumentacionit në rast incidentesh.

Sesioni 4 Aftësia paguese financiare

Aftësi paguese do të thotë gjendje e mirë financiare e mjaftueshme për të përmbushur angazhimet tuaja duke patur parasysh karakteristikat e aktivitetit tuaj të biznesit dhe do të mbështetet në tre vitet e fundit. Nëse ju keni kryer aktivitet për më pak se tre vjet, atëherë aftësia paguese do të gjykohet duke u mbështetur te regjistrat dhe informacioni i disponueshëm (shih pyetjen 4.3). Këto regjistrime duhet të lidhen me personin juridik i

cili po bën aplikimin OEA. Çdo informacion i njohur që mund të ndikojë në aftësin tuaj paguese në të ardhmen duhet të jepet në pyetjen 4.4.

4.1 Ju lutem jepni informacion për çdo proçes paaftësie paguese, falimtimi ose likuidimi të ndërmarrë ndaj kompanisë tuaj ose asetet e saj në tre vitet e fundit.

4.2 Provat ose informacioni i kërkuar mund të ketë të bëjë gjithashtu me përgjegjësitë ose kushte, pozicionin aktual neto të aseteve ose pozicionin neto të aseteve dhe masën e aseteve të paprekshme.

Në disa rrethana mund të jetë praktikë normale për një biznes të ketë asete neto negative p.sh. kur një kompani është ngritur nga mëma e saj për qëllime kërkimi dhe zhvillimi dhe detyrimet janë financuar nga një borxh/kredi nga kompania mëmë ose një institucion financiar. Në këto rrethana asetet neto negative nuk mund të jenë tregues nëse një biznes është në gjendje të paguajë borxhet ligjore por ne mund të kërkojmë prova të tjera siç mund të jenë marrja përsipër nga huadhënësi, referenca te përdorimi i garancisë nga kompania mëmë ose një letër nga banka për të plotësuar këtë kërkesë ose, nëse ju jeni pronari ose ortaku i vetëm, një listë e të gjitha aseteve personale që përdoren për të mbështetur aftësinë paguese të biznesit.

Shënim: Për të përcaktuar aftësinë tuaj paguese dogana mund të kërkojë paraqitjen e llogarive tuaja vjetore të përditësuara. Dogana mund të ketë nevojë të kontrollojë të gjitha kopjet ose deklaratat financiare të plota të llogarive tuaja vjetore për tre vitet e fundit. Dogana gjithashtu mund të kërkojë të shohë gjithashtu llogaritë më të fundit të drejtuesve për të përcaktuar gjendjen tuaj financiare të momentit.

Seksioni 5 Kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes

Shënim: Ky seksion ka të bëjë me kriteret e Sgurisë&Mbrojtjes për OEA-të. Ai duhet të plotësohet vetëm nëse ju po aplikoni për një Çertifikatë Siguri&Mbrojtje (OEA S) ose një Çertifikatë e kombinuar Thjeshtime Doganore dhe Siguri & Mbrojtje (OEAP). Vetëvlerësimi për këtë kërkesë do të përfshijë të gjitha ambjentet që kanë lidhje me aktivitetet doganore të aplikuesit.

Ju duhet të demostroni një nivel të lartë ndërgjegjësimi për masat e sigurisë dhe mbrojtjes, brenda dhe në aktivitetin tuaj të biznesit me klientët, furnizuesit dhe ofruesit e jashtëm të shërbimeve, duke patur parasysh rolin tuaj në zinxhirin e furnizimit.

Ju duhet të mos ngatërroni këtë me kërkesat për shëndetin dhe sigurine (ju lutem shikoni udhëzimin per OEA).

Ne normalisht presim që secila nga procedurat e përmendura në këtë seksion te jetë e një standardi të kënaqshëm dhe e detajur për (a) identifikimin e qartë të personit përgjegjës dhe zëvendësit/zëvendësve të tij dhe (b) t'i mundësojë zëvendësit të veprojë në mënyrën e caktuar nga personi përgjegjës.

Të gjitha procedurat duhet të dokumentohen dhe të bëhen të disponueshme për doganat gjatë auditimin tone për kriteret e OEA-së dhe gjithmonë do të kontrollohen në vend.

Dokumentet që duhet të përgatisni, në mënyrë të veçantë tek 5.1.1(a) & (b), duhet të pasqyrojnë:

- rolin tuaj në zinxhirin e furnizimit;

- natyrën dhe madhësinë e biznesit tuaj; dhe
- rreziqet dhe kërcënimet e biznesit tuaj.

5.1 Vetë Vlerësimi

5.1.1 (a) Autoritetet Doganore presin një vlerësim risku të dokumentuar që të jetë kryer nga ju ose një kompani sigurimi, nëse ju pëdorni një të tillë. Dështimi për bërjen e një vlerësimi të tillë gjatë vizitës tonë mund të çojë në refuzimin e aplikimit.
Vlerësimi i riskut dhe kërcënimit duhet të mbulojë ambjentet që janë relevante për aktivitetet e juaja doganore. Qëllimi i vlerësimit është të identifikojë riskun dhe kërcënimet të cilat mund të ndodhin në atë pjesë të zinxhirit të furnizimit në të cilin ju operoni dhe të vështrojë masat në vend për të minimizuar rreziqet dhe kërcënimet. Ai duhet gjithashtu të mbulojë të gjitha rreziqet në sigurinë e rolit tuaj në zinxhirin e furnizimit dhe duhet të përfshije, për shembull:

- kërcënimet fizike për ambjentet dhe mallrat;
- kërcënimet fiskale;
- marrëveshjet kontraktuale me partnerët e biznesit në zinxhirin tuaj të furnizimit;

Ky vlerësimi duhet t'u adresohet si mëposhtë:

- mallrave me të cilat ju merreni/tregtoni
- ambjenteve dhe ndërtesave për magazinim, prodhim dhe kështu me rradhë
- stafit duke përfshirë rekrutimin, përdorimin e stafit të përkohshëm, nën-kontraktorët
- transportin e mallrave, ngarkimin dhe shkarkimin
- sistemit kompjuterik, dokumentave dhe rregjistrimeve të kontabilitetit
- incidenteve të sigurisë të raportuara së fundmi në ndonjë nga fushat e mësipërme.

Ju duhet gjithashtu të keni prova se sa shpesh është riparë dhe përditësuar dokumenti dhe procedurat duhet të përfshijnë si të raportoni incidentet dhe frekuencën e rishikimeve në të ardhmen. Doganat duhet gjithshtu të kërkojnë prova se si dhe kur i komunikohen procedurat e tuaja stafit dhe vizitorëve.

5.1.1 (b) Dështimi për bërjen e një Plani Sigurie ose një vlerësimi të riskut dhe kërcënimeve gjatë vizitës tonë mund të çojë në përfundimin para kohe të vizitës ose refuzimin e aplikimit.

Një program rishikimi duhet të jetë në vend për Planin e Sigurisë i cili duhet të përfshijë rregjistrime të ndryshimeve të cilat janë nënshkruar dhe më datë nga personi përgjegjës.

5.1.2 Ju duhet të përfshini një përshkrim të pesë rreziqeve më të larta që ju perceptoni që keni identifikuar. Ne presim që ju t'i keni vlerësuar dhe përfshirë ato në vlerësimin tuaj të riskut dhe kërcënimit, duke mbuluar gjasat për të ndodhur, pasojat dhe masat kundervepruese. Shembuj të këtyre mund të jenë:

- kontrabandimi i mallrave të paligjshme;

- helmimi i produkteve;
- ngatërrime me mallra për eksport;
- akses i paautorizuar etj.

5.1.3 Përshkruani shkurtimisht vendosjen e masave të sigurisë, implementimin, monitorimin dhe rishikimin e tyre. Juve ju nevojitet të identifikoni personin përgjegjës. Ai duhet të jetë një person në nivelin e duhur brenda organizatës me përgjegjësi të përgjithshme për të gjitha masat e sigurisë dhe me autoritetin e nevojshëm për të zbatuar masat e duhura të sigurisë kur kërkohet.

Nëse përdoren shërbime sigurie të jashtme, personi përgjegjës duhet të menaxhojë kontratën dhe të garantojë një marrëveshje niveli shërbimi të duhur në vend në përputhje me kërkesat e OEA siç tregohen në këtë Seksion.

Personi përgjegjës duhet të jetë i aftë të shpjegojë dhe të ketë procedurat e duhura në vend për krijimin, rishikimin dhe përditësimin e të gjitha masave të sigurisë. Ky person normalisht duhet të jetë përgjegjës për përgatitjen e dokumentave të kërkuara në pyetjen 5.1.1 (a) & (b).

Ne presim që procedurat të jenë të mjaftueshme për të mundësuar çdo person që përfaqëson personin përgjegjës të marri përgjegjësitë dhe të kryejë detyrat e kërkuara.

5.1.4 Megjithëse në shumë raste masat e sigurisë kanë gjasa të jenë specifike për ambjentin ku do kryhen procedurat, vendosja, implementimi, monitorimi dhe rishikimi i këtyre masave mund të harmonizohet në të gjitha ambjentet. Kur masat nuk janë të harmonizuara kjo mund të rrisë numrin e vizitave në terren nga dogana.

5.1.5 (a) & (b) Ju duhet të keni procedura të dokumentuara në vend për të mundësuar dhe inkurajuar stafin dhe vizitorët të raportojnë çdo incident sigurie, p.sh. hyrje e paautorizuar, vjedhje, përdorim nga personel i paverifikuar. Kjo duhet të përfshijë sesi kryhet, nga kush dhe ku vendosen. Procedurat tuaja duhet gjithashtu të detajojnë si hetohen incidente të tilla, ku raportohen dhe tek kush raportohen.
Nëse ju jeni përgjigjur "Jo" – ju lutem tregoni se si keni ndërmend ta adresoni këtë dhe të tregoni shkallën e kohës.

Një "Po" duhet të shoqërohet nga shpjegimi tuaj se si i komunikohen udhëzimet e mbrojtjes stafit dhe të përfshijnë detajet se si i shikon stafi juaj këto. Ju duhet gjithashtu të shpjegoni se si udhëzimet e sigurisë vihen në vëmendje të vizitorëve.

Shikoni gjithashtu pyetjen 5.2.2.

Referenca për udhëzimet e "Sigurisë" nuk duhet të ngatërrohet me udhëzimet e kerkuara për arsye sigurie&shëndeti dhe t'u bëhen të qarta vizitorëve dhe stafit.

5.1.6 (a) & (b) Kjo pyetje ka lidhje me sigurimin e zinxhirit të furnizimit dhe jo me incidente të Shëndetit & mbrojtjes. Për shembull:

- humbje në magazinë;

- plumbçe të thyera;
- dëmtim të pajisjeve;

Nëse keni patur incidente ne presim që ju t'i keni rishikuar dhe ndryshuar procedurat e sigurisë dhe mbrojtjes për të kryer korrigjimet. Provë do të kërkohet gjithashtu edhe se si këto ndryshime i ishin komunikuar më pas stafit dhe vizitorëve. Nëse ju keni rishikuar procedurat e sigurisë dhe mbrojtjes, keni bërë ndonjë ndryshim, këto duhet të rregjistrohen me datë dhe të referohen pjesët e rishikuara.

5.1.7 (a) & (b) Ju duhet të garantoni që mbani dokumentat origjinale sepse kjo mund t'ju kërkohet nga dogana. Vërtetimi përkatës do të merret në konsideratë nga dogana kur të kryejë auditin.

Për shembull:

- Agjent i Rregullt (çertifikatë dhe raport vlerësimi);
- TAPA (çertifikatë dhe raport vlerësimi);
- ISO (çertifikatë dhe manual cilësie);

5.1.8 Përgjigja juaj duhet të përfshijë detaje për kimikate të rrezikshme, mallra me vlerë të lartë ose mallra akcize dhe shpjegoni nëse këto janë në baza të rregullta apo jo.

Për shembull:

- paketime speciale;
- kërkesa magazinimi specifike;

Shikoni gjithashtu 5.5.1 (proçeset logjistike).

5.1.9 (a) & (b) Përgjigja juaj duhet të përfshijë emrin dhe adresën e kompanisë dhe të tregojë Se sa vjet ata janë punësuar nga ju si kompani sigurimi/ruajtje dhe nëse ato ju sigurojnë shërbime të tjera.

Nëse kompania ka bërë një vlerësim rreziku, përgjigja tuaj duhet të konfirmojë nëse ndonjë nga rreziqet e identifikuara është inkorporuar brenda vlerësimit tuaj të riskut dhe kërcënimit të mbuluar nga pyetja 5.1.1 (a).

Dokumentet duhet të tregojnë datën kur ishte kryer vlerësimi dhe implementimi i rekomandimeve të bëra. Dokumenti duhet të vihet në dispozicion gjatë vizitës tonë.

5.1.10 Përgjigja duhet të japë një tregues të kërkesave të klientëve të ndryshëm/kompanisë së Sigurisë dhe nëse mallrat janë ndikuar nga kërkesa të veçanta, p.sh. paketim i veçantë ose kërkesa magazinimi.

Nëse keni një shkallë të gjerë produktesh dhe kërkesash, është e mjaftueshme t'i përmblidhni ato. Ato do të shqyrtohen në detaje gjatë vizitës tonë.

5.2 Aksesi tek ambjentet

5.2.1 (a) & (b) Ju duhet të përshkruani shkurtimisht proçesin duke e bërë të qartë kur është e nevojshme nëse në ndonjë ambjent përfshihen proçese specifike. Për një aplikim të multi-ambjenteve mund të jetë i dobishëm një vështrim i përgjithshëm mbi ambjentet. Procedurat tuaja duhet të dokumentojnë kush ka të drejtë hyrje, në cilat zona, ndërtesa, dhoma dhe si kontrollohet kjo, me çelësa apo kartë hyrje. Kufizimet e hyrjes duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e riskut dhe kërcënimit tek 5.1.1a. Sistemet tuaja duhet të jenë në gjendje të identifikojnë përpjekjet e hyrjeve të paautorizuara dhe t'i monitorojnë ato. Përshkruani sistemin e përdorur për të identifikuar stafin, p.sh. kartat e identitetit.

5.2.2 (a) & (b) Përgjigja juaj duhet të konfirmojë detajet duke ju referuar vlerësimit të riskut dhe kërcënimit të përshkruar tek 5.1.1 (a) & (b). Ju duhet të përfshini detaje të çdo bashkëpunimi me organizata të tjera sigurie/ligjzbatuese me të cilat ndani njohuritë në të tilla çështje.
Ju lutem referojuni gjithashtu përgjigjes së dhënë tek 5.1.5 dhe shënimeve shpjeguese atje.

5.2.3 Një planimetri duhet t'i vihet në dispozicion doganës. Përderisa plani nuk është i detyrueshëm, ndonjë ilustrim do të na ndihmonte në përgatitjen për auditim dhe mund të zvogëlojë kohën e nevojshme në vizitën e ambjenteve. Plani mund të jetë ose të përfshijë imazhe satelitore/interneti të ambjentit nëse janë të disponueshme.
Çdo plan apo imazh i paraqitur duhet të ketë datën e prodhimit dhe të identifikohet në mënyrë unike duke formuar një gjurmë auditimi për aplikimin për OEA.

5.2.4 Ju duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë çdo kompanie në ambjentet tuaja të cilat janë vetëm qiramarrëse dhe jo të përfshira në bërjen e furnizimeve tek ose për ju. Qiramarrësit mund të paraqesin çështje të veçanta sigurie dhe çdo marrëveshje si p.sh. hyrja e tyre e përbashkët me ju dhe okupimi në zonën tuaj duhet të përshkruhen shkurtimisht.

Ju lutem referojuni gjithashtu 5.13.

5.3 Siguria fizike

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronja "a" të këtij vendimi, ju duhet të garantoni që ndërtesat e përdorura në lidhje me operacionet të jenë të mbuluara nga çertifikatë që tregon se materialet e përdorura i rezistojnë hyrjeve të paligjshme dhe garantojnë mbrojtje kundra këtyre hyrjeve. Masa kontrolli të përshtatshme duhet të jenë në vend për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në ambjente, zonat e prodhimit, zonat e ngarkimit, zonat kargo dhe zyrat. Këto masa varen nga madhësia dhe lloji i biznesit, lloji i mallrave, etj.

5.3.1 (a) (b) & (c) Kjo ka te beje me rastet kur ju keni kufi të jashtëm te dukshem të ambjenteve tuaja, p.sh. kangjella dhe porta. Ne presim që të gjitha dritaret e brendshme dhe të jashtme, portat dhe kangjellat të jenë të siguruara me, p.sh. mjete kyçje, masa alternative aksesi monitorimi ose kontrolli, të tilla si sisteme alarmi kundra vjedhjeve ose CCTV, (Closed Circuit TV systems).

(a)-(c) Detaje se si verifikohet përputhja me këto procedura, frekuenca e kontrolleve në ndërtesa dhe kangjella, raportimi i incidenteve dhe trajtimi i tyre duhet të jenë brenda dokumentit të kërkuar në përgjigjet e 5.1.1.(a) ose (b). Këtu jepni referencë të paragrafit të duhur, seksionit ose faqes të këtij dokumenti.

5.3.2 (a) & (b) Ju duhet të listoni të gjitha pikat e hyrjes, preferohet me planimetri; duke përfshirë shkallët e daljes në rast zjarri; dallimin ndërmjet hyrjeve të hartuara për ngarkimin/shkarkimin e ngarkesave, sportelet për publikun, zonat e parkimit të makinave; theksoni vendndodhjen/vendqëndrimin e rojeve të sigurisë.

Përshkrimi se si vëzhgohen këto duhet të përfshijë kur është rasti llojin e CCTV(Closed Circuit TV systems). (p.sh. kamera statike apo pan tilt dhe zmadhim), si kontrollohen dhe nëse imazhi përdoret në mënyrë ndërvepruese apo reaguese.

Si plotësim të kontrolleve të hyrjeve të jashtme ju duhet të përshkruani gjithashtu kontrollin e hyrjeve të brendshme, duke përfshirë kur është rasti, hyrjet e brendshme brenda së njëjtit ambjent.

Konfirmoni nëse ambjentet funksionojnë 24/7 (p.sh. me turne) apo orët normale të zyrës.

5.3.3 Kur është rasti përfshini gjithashtu detaje të gjeneratorëve për mbështetje (back-up) apo pajisjeve në vend që garantojnë ndriçim të vazhdueshëm kur ka ndërpreje të energjisë dhe si mirëmbahen ato.

5.3.4 Si identifikohen çelsat dhe cilat janë procedurat në vend për të parandaluar keqpërdorimin dhe trajtimin në rast humbje?

Procedura duhet të egzistojnë vetëm për personelin e autorizuar për të patur akses për çelsa në ndërtesat e mbyllura, ambjentet, zonat e sigurisë, kabinetet e dosjeve, makineritë dhe makinat. Procedurat tuaja duhet gjithashtu të përfshijnë:

- vendin e caktuar veçanërisht për mbajtjen e çelsave
- personin përgjegjës për kontrollin e sigurisë së çelsave
- rregjistrimet kur merren çelsat, nga kush, pse dhe kthimin e tyre
- trajtimin e humbjeve të tyre, dështimin për t'i kthyer.

Jepni detaje për procedurat e kyçjeve dhe kur është rasti, cilët janë mbajtësit kryesorë të çelsave përgjegjës për mbylljen e ambjenteve gjatë natës dhe ri-hapjen e tyre gjatë ditëve të punës.

Jepni detaje për pajisje të tjera "kyçje" si "radio keys" (që përdoren për shembull për të ngritur traun e parkimit) në përdorim dhe kujt i janë dhënë ato.

5.3.5 (a) (b) (c) & (d) Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- si kontrolloni/rregjistroni vizitorët me makina private që vijnë në ambjentet tuaja

- si kontrolloni makinat e stafit në ambjentet tuaja

- zona të caktuara të veçanta parkimi për vizitorët dhe stafin të cilat nuk janë afër zonave të sigurisë, p.sh. vende ngarkimi për të shmangur mundësinë e vjedhjeve, dëmtimeve apo ndërhyrjeve.
- verifikime që respektohen kërkesat mbi parkimin.

(a) Shpjegoni nëse makinat e vizitorëve ndahen nga makinat e stafit. Ju duhet të përfshini detaje të makinave të tjera të cilat kanë akses të përkohshëm në ambjentet tuaja, si p.sh. taksi apo autobuzë për stafin.

(b) Ju duhet të garantoni që ka procedura në vend që sigurojnë rishikimin dhe përditësimin e rregullt të autorizimit duke marrë në konsideratë ndryshimet e makinave të stafit. Jepni detaje nëse stafi ka leje parkimi dhe mekanizëm për hyrjen/daljen në zonën e parkimit, p.sh. një kartë për hapjen e trarit.

(c) Përshkruani çdo proçes apo procedurë që kryen kontrollin e makinave, p.sh. nëse gjatë orëve të pikut nuk vihen pengesa duke garantuar kontrollin e duhur të të gjitha mjeteve.

(d) Përshkruani çdo rregullore me shkrim që mbulon parkimin e makinave dhe se si i komunikohen ato stafit. Konfirmoni nëse rregullore të tilla janë të përfshira në vlerësimin e sigurisë.

5.4 Njësitë e kargos

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronja "c" të këtij vendimi, duhet të merren në vend masat për trajtimin e mallrave duke përfshirë mbrojtjen kundra ndërhyrjeve, shkëmbimit apo humbjes të çdo materiali dhe ngatërresat në njësitë e kargos.

Njësitë e kargos përfshijnë konteinerë, çisterna, kamionë, mjete transporti, tubacione dhe kështu me rradhë në të cilat transportohen mallra.

Procedurat duhet të egzistojnë për të shqyrtuar integritetin e njësisë së kargos përpara ngarkimit. Detajet rreth pronarëve/furnizuesve të njësive të kargos duhet të vihen në dispozicion gjatë vizitës tonë.

5.4.1 Integriteti i njësive të kargos duhet të garantohet, p.sh. duke i vendosur ato nën monitorim të vazhdueshëm apo duke i ruajtur ato në një zonë të sigurtë, të kyçur ose duke i inspektuar përpara përdorimit. Akses tek njësitë e kargos duhet të kenë vetëm persona të identifikuar dhe të autorizuar siç duhet. Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- si kontrollohet aksesi tek zona ku mbahen njësitë e kargos;

- se si kanë akses vetëm personat e autorizuar;

- si bëhet monitorimi i njësive gjatë gjithë kohës, p.sh. stafi përgjegjës dhe zevëndësit e tyre.

5.4.2 Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- kush është personi përgjegjës ku raportohen incidentet;

- si raportohen dhe rregjistrohen incidentet;
- çfarë masash duhet të merren, duke përfshirë raportimin tek menaxherët e lartë ose të ligjzbatimit;
- rishikimi dhe ndryshimi i procedurave egzistuese;
- njoftimi i stafit për çdo ndryshim.

Ne presim të shikojmë prova të këtyre kontrolleve gjatë vizitës.

5.4.3 (a) & (b) Përshkruani llojin e plumbçeve të përdorura dhe çdo standard të kënaqshëm nga përdorimi i këtyre plumbçeve. Jepni emrin e prodhuesit, procedurën për lëshimin e plumbçeve dhe rregjistrimin e lëshimit të tyre, përdorimin dhe heqjen.

Dokumentim i procedurave që merren me plumbçet e thyera dhe të cënuara.

5.4.4 Në varësi të njësisë së kargos së përdorur, proçesi i inspektimit shtatë-pikësh duhet të kryhet (duke përfshirë dhe njësinë kokë-trailer gjithashtu):

- pamje ballore;
- ana e majtë;
- ana e djathtë;
- dysheme;
- tavan/çati;
- dyer të brendshme/të jashtme;
- jashtë/shasitë.

5.4.5 (a) (b) & (c) Mirëmbajtja duhet të bëhet në mënyrë rutinë dhe jo vetëm në rast dëmtimi apo incidentesh. Nëse mirëmbajtja është bërë jashtë mbikqyrjes së stafit tuaj, atëhere integriteti i njësisë kargo duhet të inspektohet në momentin e kthimit tek ju. Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- kërkesat ndaj stafit tuaj për verifikimin e njësive kur kthehen
- çfarë verifikimesh duhet të kryhen, kur dhe nga kush
- si i komunikohen stafit procedurat

- verifikimet e menaxhimit dhe frekuenca e tyre për të garantuar që njësitë janë ri-shqyrtuar.

Shpjegoni nëse ju në mënyrë rutinë kontrolloni të gjitha njësitë kargo si përpara marrjes së ngarkesës dhe përpara ngarkimit të mallrave për dërgesë dhe nëse keni procedura për këtë brenda dokumentave të përmendura tek 5.1.1 (a) (b).

5.5 Proceset logjistike

5.5.1 (a) (b) (c) & (d) Keto pyetje kane te bejne me lëvizjen e mallrave të importuara dhe eksportuara ndërmjet ambjenteve tuaja dhe kufirit, brenda Shqipërisë dhe pjesë të ndryshme të ambjenteve.

Ju duhet të listoni të gjitha mënyrat e transportit që përdoren duke filluar apo duke përfunduar tek ambjentet tuaja dhe vazhdojnë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit. Shpjegoni mënyrën e transportit të përdorur.

Nëse përdorni shërbime të jashtme transporti, ju lutem referojuni pikës 5.13 (Shërbime të jashtme).

5.6 Kërkesa jofiskale

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronja "ç" të këtij vendimi, kur është rasti, duhet të vendosen procedura për trajtimin e liçensave të importit dhe/ose eksportit në lidhje me ndalimet dhe kufizimet dhe për t'i dalluar këto mallra nga mallrat e tjera.

5.6.1 (a) & (b) Ky seksion plotëson 3.5.3 dhe mbulon kërkesat jofiskale.

Dokumentoni proçesin dhe procedurat për identifikimin e personit përgjegjës që garanton nëse janë liçensat në vend dhe masat kur ato mungojnë.

Përshkruani çdo masë shtesë sigurie që juve mund t'ju nevojitet për të mbuluar mallrat me përdorim të dyfishtë.

5.7 Hyrja e mallrave

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronja "b" të këtij vendimi, masa kontrolli të përshtatshme për aksesin duhet të vendosen për të parandaluar aksesin e paautorizuar në zonat e transportit, doket e ngarkimit dhe zonat kargo.

5.7.1 (a) & (b) Këto procedura duhet të fillojnë nga momenti i dhënies së porosisë për dërgesën në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Procedura të dokumentuara duhet të tregojnë fluksin e mallrave dhe dokumentat që kanë lidhje me ato, si edhe të përfshijnë palët e tjera të përfshira të tillë si furnizuesit, paketuesit, transportuesit, etj.

5.7.2 Kur egzistojnë marrëveshje për masa sigurie me furnizuesit vendas dhe/ose të vendeve të tjera, stafi duhet të jetë i ndërgjegjshëm për këto marrëveshje dhe të përcaktohen procedura për të verifikuar përkushtimin ndaj tyre. Ju duhet të përshkruani proçesin nga i cili informohen punonjësit rreth sigurisë, frekuencës se ri-trajnimeve dhe merreni këtë në konsideratë për t'ja treguar doganës dhe për çdo rishikim të OEA.

Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- përcaktimin e stafit përgjegjës për pritjen e shoferit dhe mallrave në mbërritje;
- mbajtjen e një plani për mbërritjet e pritshme;
- trajtimin e mbërritjeve të papritura;
- rregjistrimin e dokumentave të transportit dhe dokumentave doganore që shoqërojnë mallrat;
- krahasimin e mallrave me dokumentat shoqëruese të transportit dhe dokumentat doganore
- verifikimin e integritetit të plumbçeve;
- rregjistrimin e përfundimit dhe rezultatet e çdo kontrolli;
- informimin e doganave siç kërkohet për mbërritjen e mallrave për t'i mundësuar ato të kryejnë kontrollet;
- peshimin/numërimin dhe përcaktimin e mallrave përkundrejt listës së përzgjedhjes/urdhërit të blerjes;
- testimin e cilësisë;
- nëse mallrat janë shënuar siç duhet përpara se të shkojnë në magazinë për të mundësuar identifikimin;
- identifikimin dhe raportimin e mospërputhjeve apo dështimet e kontrollit të cilësisë;
- informimin e departamentit të blerjes dhe administratës për marrjen e mallrave.

Për shembull, kjo mund të varet nëse ju merreni me mallra me vlerë/risk të lartë. Marrëveshjet mund të jenë që mallrat:

- duhet të mbërrijnë në të njëjtat kushte si kur dolën nga furnizuesi;
- të jenë të plumbosura gjatë gjithë kohës;
- nuk kanë shkelur kërkesat e sigurisë ose mbrojtjes;

Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- komunikimin e këtyre marrëveshjeve tek stafi përgjegjës për pritjen e mallrave në mënyrë që ata të jenë të ndërgjegjshëm se çfarë të bëjnë në veçanti nëse zbulohen parregullsi;
- rishikimin dhe përditësimin e këtyre procedurave në baza të rregullta;
- kontrolle menaxhimi/mbikqyrje për të garantuar që stafi i ndjek këto kërkesa.

5.7.3 (a) and (b) Në mbërritjen e njësisë së kargos të plumbosur, duhet të jenë marrë masa për të garantuar trajtimin korrekt të plumbçeve. Kjo mund të përfshijë një inspektim vizual për të garantuar a) që plumbçja është e paprekur dhe b) nuk ka provë për ndërhyrje. Pasi të jeni të kënaqur me inspektimin vizual personi i autorizuar mund të vazhdojë më pas me testin fizik të plumbçes duke aplikuar presionin e duhur për të garantuar që ajo është akoma e paprekur.

5.7.4 Nuk nevojitet shënim.

5.7.5 Në varësi të natyrës së mallrave që ju merreni, numërimi, peshimi apo sasia nuk mund

të përcaktohen siç duhet. Një mënyrë alternative për përllogaritjen e mallrave që hyjnë duhet të përshkruhet dhe se si provohet përputhshmëria.

5.7.6 Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- si dhe mbi cilat dokumenta, kur dhe nga kush mallrat e mbërritura hidhen në inventar;
- verifikimin e mallrave përkundrejt listës së ngarkimit dhe urdhërave të blerjes;
- rregjistrimin e mallrave në inventar sa më shpejt të jetë e mundur pasi ato mbërrijnë.

5.7.7 (a) & (b) Duhet të egzistojë një ndarje detyrash ndërmjet porosisë së mallrave (blerjes), marrjes (magazinimit), hyrjes së mallrave në sistem (administrata) dhe pagesës së faturave. Kjo është në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të biznesit.

5.8 Magazinimi i mallrave

Ky nën-seksion mbulon vetëm magazinimin e mallrave që janë pjesë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit.

5.8.1; 5.8.; 5.8.3; 5.8.4 & 5.8.5

Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

një zonë të përcaktuar për magazinimin e mallrave e cila të jetë si e sigurtë dhe e mbrojtur dhe e ditur qartë nga stafi kontrollues.

- zonë magazinimi e aksesueshme vetëm për stafin e autorizuar;
- marrjen e rregullt në magazinë;
- kontrollin e mallrave që hyjnë, transferimin në ambjente të tjera, lëvizjet e përhershme dhe të përkohshme;
- masat që merren kur identifikohen parregullsi, mospërputhje, humbje apo vjedhje;
- trajtimin dhe përpunimin e mallrave dhe kthimi i tyre në magazinë;
- ndarjen e llojeve të ndryshme të mallrave, sipas rastit, p.sh. mallra shqiptare, joshqiptare, me vlerë të lartë, të rrezikshme;
- mbajtjen dhe përditësimin e rregjistrimeve në magazinë në kohën e duhur duke përfshirë vendndodhjen e mallrave;
- adresimin e të gjitha aspekteve të sigurisë fizike të magazinës.

Standardet e sigurisë varen nga lloji i mallrave, madhësia dhe kompleksiteti i biznesit i cili mund të variojë nga një dhomë e vetme në një bllok të zyrave në një biznes me ambjente shumë të mëdha që operon në gjithë territorin.

5.9 Prodhimi i mallrave

Ky nën-seksion mbulon vetëm prodhimin e mallrave që formojnë pjesë të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit.

Plotësoni vetëm pyetjet 5.9.1 – 5.9.4 sipas biznesit tuaj. Prodhimi në këtë kontekst mund të përfshijë një gamë aktivitetesh të tilla si prodhimi nga lënda e parë nëpërmjet bashkimit nga pjesë të blera.

5.9.1 (a) & (b) Përshkruani nëse stafi që punon në zonën e prodhimit është me kohë të plotë apo i përkohshëm. Përshkruani vendndodhjen e prodhimit brenda ambjenteve tuaja dhe nëse është e mundur, jepeni këtë vendndodhje në kopjen e planimetrisë. Ju lutem gjithashtu referojuni shënimeve 5.2.3.

5.9.2 Mbështetini përgjigjet tuaja duke ju referuar sipas rastit vlerësimit të riskut dhe kërcënimit të përshkruar tek pyetjet 5.1.1 (a) & (b). Çdo kontroll përputhshmërie duhet të mbështetet nga prova përkatëse me datë dhe e firmosur.

5.9.3 Përfshini ndonjë referencë të ndihmesës teknologjike gjatë integritetit të paketimit (p.sh. kontroll i peshës apo mbikqyrje me CCTV etj). Gjithashtu përshkruani proçesin e sigurimit si të paketimeve individuale dhe se si konsolidohen ambalazhet, p.sh. paletizimi. Jepni detaje deri në ç'pikë njihet pritësi i mallrave (adresa/vendi) dhe se si kontrollohet kjo njohuri.

5.9.4 Përshkrimi juaj duhet të përfshijë çdo marrëveshje kontraktuale dhe/ose shërbimi me një palë të tretë. Dogana do të dëshirojë t'i shikojë këto.

Kjo përfshin gjithashtu ku mund të konsolidohen ambalazhet.

5.10 Ngarkimi i mallrave

5.10.1 (a) & (b) dhe **5.10.2** (a) (b) & (c)

Personeli duhet të caktohet për të mbikqyrur ngarkimin e mallrave për të mos harruar apo parandaluar mosngarkimin e tyre të pambikqyrur. Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- emërimin e stafit përgjegjës për pritjen e shoferit dhe ngarkimin e mallrave;
- stafi i caktuar të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës;
- procedura nëse stafi nuk është i disponueshëm, p.sh. caktimi i zëvëndesave;

- ngarkimi të bëhet vetëm në prani të stafit të autorizuar;

- peshimin, numërimin, korrespondimin dhe shënimin i mallrave;
- trajtimin e mospërputhjeve/parregullsive;
- aplikimin e plumbçeve dhe hedhjen e tyre në dokumenta/rregjistër, për të garantuar që plumbçet janë përdorur siç duhet për mallrat, përmbushin standardet e caktuara dhe aplikohen në përputhje me kërkesat ligjore;
- rregjistrimin e transportit dhe dokumentave doganorë që shoqërojnë mallrat në rregjistrat tuaj;
- krahasimin e mallrave me dokumentat shoqëruese të transportit dhe doganore;
- rregjistrimin e përfundimit dhe rezultateve të kontrollit;
- informimin e doganave siç kërkohet për nisjen e mallrave për t'i mundësuar ato të kryejnë kontrollet;
- informimin e departamentit/administratës së shitjes për nisjen e mallrave;
- si (në cilat dokumenta), kur dhe nga kush hidhen në inventar mallrat e ngarkuara;
- verifikimin e mallrave përkundrejt listave të ngarkimit dhe porosive të shitjes;
- rregjistrimin e mallrave kur dalin nga inventari sapo nisen;
- njoftimin e marrjes së mallrave dhe çdo parregullsi nga klientët tuaj;
- provën e eksportit kur është rasti.

5.10.3 Kjo aplikohet vetëm nëse klientët tuaj kanë rënë dakort me ju për kërkesat specifike, p.sh. të gjitha mallrat të jenë të plumbosura, të ambalazhuara dhe me etiketë në mënyrë të tillë për të përmbushur kërkesat me rreze-X. Nëse po, stafi duhet të jetë i ndërgjegjshëm për këto marrëveshje dhe procedurat tuaja duhet të përfshijnë kontrolle menaxhimi/mbikqyrje për të garantuar që stafi i ndjek këto kërkesa. Këto procedura duhet të rishikohen dhe përditësohen në baza të rregullta.

Shikoni gjithashtu përgjigjen 5.1.10.

5.10.7 Prova për të mbështetur këtë seksion duhet t'i referohet fushës së duhur në vlerësimin e riskut dhe kërcënimit të përshkruar tek P. 5.1.1. (a) & (b).

Parregullsitë mund të përfshijnë kthime nga klientët, shoferë të paautorizuar, pajisje të thyera.

5.11 Kërkesa sigurie për partnerët e biznesit

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronja "d" të këtij vendimi, ju duhet të implementoni masa që lejojnë identifikim të qartë të partnerëve tuaj të biznesit për të siguruar zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Partnerët e Biznesit mund të jenë ofrues (të mallrave ose shërbimeve) apo klientë.

5.11.1 (a) & (b), Ju do të jeni përgjegjës vetëm për pjesën tuaj të zinxhirit të furnizimit dhe për mallrat nën kontrollin tuaj. Vetëm nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale ndërmjet partnerëve të biznesit mund të sigurohet zinxhiri i furnizimit.

Kërkesat e furnizuesve tuaj mund të përfshijnë p.sh. që të gjithë mallrat të jenë shënuar, plumbosur, paketuar, me etiketë në mënyrë të tillë që të kontrollohen me rreze-X dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kur egzistojnë kërkesa të tilla, procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- kur është e mundur vizita të rregullta në ambjentet e furnizuesve për të verifikuar respektimin e kërkesave;
- komunikimin e këtyre marrëveshjeve tek stafi juaj për të verifikuar përputhshmërinë në mbërritjen e mallrave;
- marrëveshje me stafin për të raportuar parregullsitë/incidentet;
- kontrolle menaxhimi/mbikqyrje për të garantuar që stafi i ndjek këto kërkesa;
- masat e marra si rezultat i identifikimit të shkeljeve të këtyre marrëveshjeve;
- rishikimin dhe përditësimin e këtyre procedurave mbi baza të rregullta.

Dogana do të presë të shikojë çdo lloj dokumenti provë që ju keni për të mbështetur përgjigjen. Këto dokumente duhet të përfshijnë rregjistrimet e kontrolleve të kryera. Kjo duhet të jetë e disponueshme gjatë vizitës.

5.11.2 Përgjigja juaj duhet të mbështet me provë dokumentare. Dogana do të presë të shikojë çdo lloj dokumenti provë që ju keni për të mbështetur përgjigjen. Këto dokumente duhet të përfshijnë rregjistrimet e kontrolleve të kryera. Kjo duhet të jetë e disponueshme gjatë vizitës.

5.11.3 Përgjigja juaj duhet të mbështet me provë dokumentare. Dogana do të presë të shikojë çdo lloj dokumenti provë që ju keni për të mbështetur përgjigjen. Këto dokumente duhet të përfshijnë rregjistrimet e kontrolleve të kryera. Kjo duhet të jetë e disponueshme gjatë vizitës.

Ne presim që ndonjë shkelje e tillë të reflektohet në dokumentat e identifikuara tek 5.1.1 (a) & (b) së bashku me një rishikim të duhur dhe masat kundravepruese shtesë.

5.12 Siguria e personelit

Për të plotësuar kriterin e përmendur në nenin 21, pika 1 shkronjat "dh" dhe "e", të këtij vendimi, ju duhet:

a) të keni bërë, për aq sa e lejon legjislacioni, vëzhgime sigurie për punonjësit që punojnë në pozicione sensitive sigurie dhe të kryeni periodikisht kontrolle të historikut të tyre;
b) të garantoni që stafi në fjalë të marrë pjesë aktivisht në programe ndërgjegjësimi.

5.12.1 (a) (b) (c) Politika tuaj e punësimit duhet të reflektojë kërkesat e sigurisë të mbështetura në vlerësimin e riskut. Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- kryerjen e kontrolleve të historikut të punonjësve të rinj dhe egzistues të cilët do punojnë apo do çohen në pozicione sigurie sensitive;
- kërkimin dhe marrjen e referencave për rekrutim;
- identifikimin e posteve kritike të sigurisë dhe kryerjen e kontrolleve të nevojshme për dënime të kryera apo të pakryera;
- kërkesën që stafi të njoftojë drejtuesit e tyre për kushtet të vendosura nga policia, prokuroria apo gjykata, vendime gjyqësore për pezullimin e ushtrimit të një detyre të caktuar, procese gjyqësore në vijim, dënime nga gjykata etj;
- heqjen e së drejtës në kompjuter, kthimin e kartës së sigurisë kur stafi largohet apo pushohet;
- fshehjen nga stafi të ndonjë punësimi tjetër.

Çdo verifikim përputhshmërie duhet të provohet siç duhet duke përmendur fillimin dhe datën e kontrolleve të kryera në rregjistra të përshtatshëm.

5.12.2 (a) & (b) Procedurat duhet të egzistojnë tek dokumentat e përmendur në 5.1.1. (a) & (b). Këto duhet të mbulojnë se si punonjësit e mundshëm kontrollohen përpara ofrimit të punës; proçesi i prezantimit dhe trajnimit duhet të përfshijë udhëzimet e sigurisë së kompanisë. I gjithë stafi i ri duhet të tregojë që i kupton këto çështje. Procedurat duhet gjithashtu të përfshijnë çfarë masash janë marrë në raste kur punonjësit egzistues janë transferuar në zona sensitive sigurie.

5.12.3 (a) (b) (c) & (d) I gjithë stafi duhet të marrë trainimin e duhur për sa i kërket kërkesave të sigurisë dhe mbrojtjes, të tilla si protokolle sigurie, zbulim të ndërhyrjeve/cënimeve dhe raportim të incidenteve si edhe të rreziqeve në lidhje me zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit. Një njësi/sektor apo grup personash (të brendshëm apo të jashtëm) duhet të jenë përgjegjës për trainimin e stafit. Trainimi duhet të përditësohet kur ka ndryshime dhe duhet të ruhet një regjistër për të gjitha trainimet e kryera.

Për çdo shërbim të jashtëm duhet të jepet Marrëveshja për nivelin e shërbimit. Ju lutem referojuni gjithashtu 5.13.1.

5.12.4 (a) & (b) Kompania duhet të ketë kërkesa sigurie në rast se përdor staf të përkohshëm. Procedurat tuaja duhet të përfshijnë:

- kontratat me agjensitë e punësimit duke detajuar nivelet e kontrolleve të sigurisë që kryhen për stafin përpara dhe pas takimit;
- përdorimin e vetëm agjensive të njohura që përmbushin këto kërkesa;
- standarde sigurie të ngjashme për stafin e përkohshëm dhe të përhershëm (shikoni shënimin tek 5.12.1). Ju duhet t'i vini në dispozicion të gjitha këto kontrata gjatë vizitës tonë.;
- Ne presim që gjithë stafi i përkohshëm të verifikohet me të njëjtat standarde si stafi i përhershëm. Meqënëse është e zakonshme që një staf i tillë prokurohet nga agjensi të jashtme që merren me staf të përkohshëm, këto agjensi duhet t'i nënshtrohen marrëveshje të nivelit të shërbimit (shikoni gjithashtu 5.13) dhe duhet të egzistojnë procedura që garantojnë se standardet e këtyre marrëveshjeve ruhen nga kompania dhe hidhen në rregjistra.

5.13 Shërbime të jashtme

Në qoftë se keni shërbime të jashtme, p.sh. transport, roje sigurimi, pastrim dhe mirëmbajtje, kërkesat e sigurisë duhet të inkorporohen në marrëveshjet kontraktuale të bëra me kontraktorë të jashtëm.

5.13.1 (a) (b) and (c)

(a)-(b) Ju duhet të keni gati gjatë vizitës tonë të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e nivelit të shërbimit që mbulojnë kontrolle identiteti për punonjësit dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me këto shërbime të jashtme. Ju lutem na jepni një listë të të gjitha kompanive dhe tregoni shërbimet e tyre gjatë vizitës tonë.

(c) Përshkruani se si monitoroni kontratën, trajtimin e parregullsive dhe rishikimin e procedurave. Mbështesni përgjigjet tuaja me referencë, kur është rasti, tek vlerësimi i riskut dhe kërcënimit të përshkruar tek pyetja 5.1.1 (a) & (b). Çdo verifikim përputhshmërie duhet të mbështetet me provën e duhur të firmosur dhe datë.

15.14 Standartet praktike dhe profesionale

(a) (b) (c) & (d) aplikuesi ose punonjësi(t) e tij përgjegjës për çështje doganore apo personi(at) e kontraktuar ose punonjësit e tyre për çështje doganore, duhet të kenë marrë trajnimet e duhura profesionale për çështjet doganore që lidhen me aktivitetin e tij dhe që mundësojnë arritjen e standarteve praktike të kompetencave apo kualifikimeve.

Këto trajnime duhet të jenë marrë në institucione shtetërore si autoritetet doganore apo organizma të tjerë të njohur prej këtyre të fundit (p.sh. një qendër arsimore e njohur për qëllime të kualifikimeve, një shoqatë profesionale ose tregëtare e akredituar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me dispozitat në fuqi;

Në përfundim të trajnimit personeli i trajnuar duhet ti nënshtrohet një provimi specifik të cilin duhet ta kalojë për të vërtetuar në këtë mënyrë kualifikimin e tyre profesional.

Procesi i trajnimit duhet të jetë i evidentuar në regjistra specifikë të operatorit ekonomik, të cilët duhet të përmbajnë të dhëna mbi emrin e punonjësit të trajnuar dhe testuar, rezultatet e testimit, kohën kur është kryer trajnimi, temat e trajnimit, sektori ku është i punësuar punonjësi i trajnuar, frekuenca e veprimeve dhe bashkëpunimit të tij me autoritetet doganore.

Planifikimi për punësime të reja dhe strategjia për trajnimin e punonjësve të rinj që mendohet të rekrutohen për arritjen e këtyre standarteve praktike dhe kualifikimeve.

Aneksi 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

ÇERTIFIKATA

OPERATOR EKONOMIK I AUTORIZUAR (OEA)

	..... (Numri i çertifikatës)
1. **Mbajtësi i Çertifikatës të OEA**	2. **Autoriteti lëshues**

Mbajtësi i përmendur në kutinë 1 është një:

Operator Ekonomik i Autorizuar

_ - Thjeshtësime Doganore

- Siguria dhe Mbrojtja

_ - Thjeshtësime Doganore / Siguria dhe Mbrojtja

3. Data nga e cila Çertifikata hyn në fuqi:

SHËNIME SHPJEGUESE

(Për aneksin 3)

Numri çertifikatës

Numri i Çertifikatës fillon gjithmonë me kodin AL, të ndjekur me një nga shkronjat e mëposhtme:

- OEAD për Çertifikatë të OEA - Thjeshtësime Doganore
- OEAS për Çertifikatë të OEA - Siguria dhe Mbrojtja
- OEAP për Çertifikatë të OEA – Thjeshtësime Doganore / Siguria dhe Mbrojtja

Shkronjat e përshkruara më lart duhet të ndiqen nga numri i Çertifikatës.

1. **Mbajtësi i Çertifikatës OEA**

Emri i plotë i mbajtësit duhet të përmendet, siç tregohet në Kutinë 1 të formatit të Aplikimit në Aneksin 1, si edhe numrin e identifikimit (NUIS/NIPT), siç tregohet në Kutinë 8 të formularit të Aplikimit dhe nëse është e nevojshme (nëse ka një të tillë) numrin e identifikimit të tregtarit siç tregohet në Kutinë 9 të formularit të Aplikimit.

2. **Autoriteti lëshues**

Emri i titullarit, nënshkrimi, firma dhe vula

Referenca ndaj llojit të Çertifikatës

Bëni një shënim me "x" ose "+" ose "√", në kutinë/të përkatëse.

3. Data nga e cila Çertifikata hyn në fuqi

Shënoni datën, muajin dhe vitin, në përputhje me pikën 1 të nenit 26 të këtij vendimi.

Aneski 4

Proçedura e përcaktuar në nenin 42 të këtij vendimi

Për qëllime të nenit 42, pesha neto e çdo "ngarkese bananesh të freskëta" përcaktohet nga peshuesit e autorizuar në çdo vend shkarkimi të mbikqyrur nga autoritetet doganore, në përputhje me proçedurën e mëposhtme:

1. Për secilin lloj paketimi dhe për çdo origjinë përzgjidhet një mostër e njësive të bananeve të ambalazhuara. Mostra e njësive të bananeve të paketuara që do të peshohet përbën mostrën përfaqësuese të ngarkesës së bananeve të freskëta. Ajo duhet të përmbajë të paktën sasitë që tregohen më poshtë:

Numri i njësive të bananeve të paketura (sipas llojit të paketimit dhe origjinës)	Numri i njësive të bananeve të paketuara që do të kontrollohen
— deri në 400	5
— nga 401 deri në 700	7
— nga 701 deri në 1 000	10
— nga 1 001 deri në 2 000	13
— nga 2 001 deri në 4 000	15
— nga 4 001 deri në 6 000	18
— më shumë se 6 000	21

2. Pesha neto përcaktohet si vijon:

a) duke peshuar çdo njësi bananesh të paketuar që do të kontrollohen (pesha bruto);

b) me hapjen e të paktën një njësie bananesh të paketuara, pastaj me llogaritjen e peshës së paketimit;

c) pesha e këtij paketimi pranohet për të gjithë paketimin e të njëjtit lloj dhe origjine dhe zbritet nga pesha e të gjitha njësive të bananeve të paketuara të peshuara;

ç) pesha neto mesatare për njësi e bananeve të paketuara e përcaktuar kështu për secilin lloj dhe origjinë, bazuar në peshën e mostrave të kontrolluara, pranohet si bazë për përcaktimin e peshës neto të ngarkesës së bananeve të freskëta;

3. Kur autoriteti doganor nuk i kontrollon duke qënë i pranishëm (njëkohësisht), çertifikatat e peshës së bananeve, pesha neto e deklaruar në çertifikata të tilla pranohet nga autoritetet doganore me kusht që ndryshimi ndërmjet peshës neto të deklaruar dhe peshës neto mesatare të përcaktuar nga autoritetet doganore të mos jetë më e madhe ose më e vogël se 1%;

4.Çertifikata e peshës së bananeve duhet të paraqitet në zyrën doganore në të cilën është paraqitur deklarata e çlirimit për qarkullim të lirë. Autoritetet doganore duhet të aplikojnë rezultatet e mostrave që jepen në çertifikatën e peshës së bananeve për të gjithë ngarkesën e bananeve të freskëta me të cilën lidhet kjo çertifikatë.

Aneksi 5

Forma e çertifikatës së peshës së bananeve
(sipas pikës 1 të nenit 42 të këtij vendimi)

ÇERTIFICATA E PESHËS SË BANANEVE	
1. Emri i peshuesit të autorizuar	2. Data dhe numri i lëshimit të çertifikatës së peshës
	3. Referenca e operatorit ekonomik
4. Identiteti i mjetit të transportit në mbërritje	5. Vendi i origjinës
6. Numri dhe lloji i paketimitt	7. Pesha neto totale e përcaktuar
8. Marka -at	

9. Njësitë e kontrolluara të bananeve të paketuara (Shkruani peshën bruto për çdo njësi të peshuar)

1		8		15	
2		9		16	
3		10		17	
4		11		18	
5		12		19	
6		13		20	
7		14		21	

10. Pesha bruto totale e njësive të kontrolluara të bananeve të paketuara: _____

11. Numri i njësive të bananeve të paketuara të kontrolluara: _____

12. Pesha bruto mesatare: _____

13. Tara _____

14. Pesha neto mesatare për njësi bananesh të : _____

15. Nënshkrimi dhe vula e peshuesit të autorizuar

16. Vendi dhe data:

Aneksi 6

APLIKIMI DHE FORMA AUTORIZIMIT

Aplikimi për autorizim për përdorim të procedurave të thjeshtuara

ORIGJINAL	1. **Aplikuesi** Jo-konfidenciale	Reservuar për qëllime doganore
	1.a. Numri i Identifikimit të Operatorit	**1.b. Numri Referues**
	1.c. Informacionet e kontaktit	
	1.d Depozitimi i deklaratës ☐ Në emër dhe për ☐res të tij Si përfaqësues i drejtëpërdrejt ☐ Si përfaqësues i tërthortë	
	2. Procedurat e Thjeshtuara Jo-Konfidenciale	
	Procedura deklarimit të thjeshtuar ☐ *Import* ☐ Qarkullim i lirë ☐ Magazinimi doganor ☐ Përpunimi aktiv ☐ Lejimi i përkohshëm ☐ Qarkullim të lirë dhe për përdorim të veçantë përfundimtar (end use) ☐ Përpunimi nën kontroll doganor ☐ *Eksport* ☐ Eksporti ☐ Ri-eksporti ☐ Eksport për përpunim pasiv	
	3. Tipi i Autorizimit (vendosni kodin) : ☐	
	4.a. Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA) ☐ PO NR. ☐ ☐ JO	
	4.b. Autorizimi/et për procedurat doganore për të cilat do të përdoren procedura të thjeshtuara Tipi | Numri referues | Data përfundimit	
	5. Llogaritë kryesore	
	5.a. Vendi ku mbahen llogaritë kryesore	
	5.b. Tipi i llogarive kryesore	
	6. **Formulari Plotësues**	

Aplikimi për autorizim për përdorimin procedura të thjeshtuara
Formulari vijues – IMPORT

ORIGJINAL	**7. Regjistrimet/të dhënat për procedurë**	
	7. a Vendi ku mbahen të dhënat	
	7. b Tipi i të dhënave	
	7.c Informacione të tjera të rëndësishme	
	8.Lloji i mallrave	
	8.a NK-kod/Kapitulli i nomenklatures së kombinuar	Përshkrimi
	8.b Sasia totale e vlerësuar	8.c Numri i vlerësuar i transaksionive
	8.d Vlera totale doganore e vlerësuar	8.e. Mesatarja e shumës së detyrimit
	8.f Kursi i këmbimit ☐ Unë aplikoj të përdor një normë të vetme të kursit të këmbimit, si të aplikueshme në ditën e 1 të periudhës së mbuluar nga deklarata, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999	
	9. Regjime doganore	Jo-konfidenciale
	10. Zyra doganore e importit (deklarimi i thjeshtuar)	
	a.Kodi _____	b. Zyra Doganore (emri dhe adresa) Jo-konfidenciale
	11. Zyra mbikëqyrse	
	12. Tipi i deklarimit të thjeshtuar ☐ Dokumenti Vetëm Administrativ (DAV) ☐ Deklarimi Elektronik ☐ Dokument tregtare apo të tjera për të specifikuar	
	13. Informacion shtesë/Kushtet	
	14. Vendi Data	**Emri, Firma, vula**

Aplikimi për autorizim për përdorimin procedura të thjeshtuara
Formulari vijues - EKSPORT

ORIGJINAI	**7.të dhënat për procedure**	
	7.a Vendi ku mbahen të dhënat	
	7.b Tipi i të dhënave	
	7.c. Informacione të tjera të rëndësishme	
	8.Lloji i mallrave	
	8.a CN-kod/Kapitulli i nomenclatures	Përshkrimi
	8.b Sasia totale e vlerësuar	8.cNumri i vlerësuar i transaksioneve
	8.d Vlera totale doganore e vlerësuar	
	9. Regjime doganore	Jo-konfidenciale
	10. Zyra doganore e eksportit (deklarimi i thjeshtuar)	
	a.Kodi _____ _____	b. Zyra Doganore (emri dhe adresa) Jo-konfidenciale _____ _____ _____ _____ _____
	11. Zyra mbikqyrëse	
	12. Tipi i deklarimit të thjeshtuar ☐ Dokumenti Vetëm Administrativ (DAV) ☐ Deklarimi Elektronik ☐ Dokument tregtare apo të tjera për të specifikuar	
	13.Informacion shtesë/Kushtet	
	14. **Vendi Data**	**Emri, Firma, vula**

Autorizimi për përdorimin e procedurave të thjeshtuara

ORIGJINAL	**1.Mbajtësi i autorizimit** **Nr.**	Numri i autorizimit _____ Autoriteti Lëshues

1.a Ky vendim I referohet aplikimit tuaj:
Nr.:_____.

1.b Mbajtësi i këtij autorizimi vepron:

- ☐ Në emër dhe për interes të tij
- ☐ Si përfaqësues i drejtëpërdrejt
- ☐ Si përfaqësues i tërthortë

2.Procedurat e thjeshtuara

Procedura deklarimit të thjeshtuar

☐ *Import*

- ☐ Qarkullim i lirë
- ☐ Magazinimi doganor
- ☐ Përpunimi aktiv
- ☐ Lejimi i përkohshëm
- ☐ Qarkullim të lirë dhe për përdorim të veçantë përfundimtar (end use)
- ☐ Përpunimi nën kontroll doganor

☐ *Eksport*

- ☐ Eksporti
- ☐ Ri-exporti
- ☐ Eksport për përpunim pasiv

3. **Tipi i Autorizimit (vendosni kodin) :** ☐

4.Tipi dhe numri i autorizimi/et për procedurat doganore për të cilat do të përdoren procedura të thjeshtuara

Tipi	Numri referues

5.Llogaritë kryesore

5.a. Vendi ku mbahen llogaritë kryesore

5.b. Tipi i llogarive kryesore

6. **Formularë plotësues**

Autorizimi për përdorimin e procedurave të thjeshtuara
Formulari vijues - IMPORT

	Numri i autorizimit

ORIGJINAL

7.Të dhënat për procedurën	
7.a Vendi ku mbahen të dhënat	
7.b Tipi i të dhënave	
8.Lloji i mallrave	
8.a NK-kod/Kapitulli i nomenklatures	Përshkrimi
8.b Sasia totale e vlerësuar	8.c Numri i vleresuar i transaksioneve
8.d Vlera totale doganore e vlerësuar	8.e. Mesatarja e shumës së detyrimit
8.f Kursi i këmbimit ☐ Shumat e monedhës së huaj të shprehura në faturë do të konvertohet me kursin e këmbimit të aplikueshme në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999.	
9. Regjime doganore	Jo-konfidenciale
10. Zyra doganore e importit (deklarimi i thjeshtuar)	
a.Kodi ____	b. Zyra Doganore (emri dhe adresa) _____ _____ _____ _____ _____
11. Zyra mbikëqyrëse	
12. Tipi i deklarimit të thjeshtuar ☐ Dokumenti Vetëm Administrativ (DAV) ☐ Deklarimi Elektronik ☐ Dokument tregtare apo të tjera për të specifikuar	
13.Informacion shtesë/Kushtet	
14.Vendi Data	**Titullari, Firma dhe vula**

Autorizimi për përdorimin e procedurave të thjeshtuara
Formulari vijues –EKSPORT

Numri i autorizimit

ORIGJINAL	**7.Të dhënat për proceduren**	
	7.a Vendi ku mbahen të dhënat	
	7.b Tipi i të dhënave	
	7.c Informacione të tjera të rëndësishme	
	8.Lloji i mallrave	
	8.a NK-kod/Kapitulli i nomenklaturës së kombinuar	Përshkrimi
	8.b Sasia totale e vlerësuar	8.c Numri i vlerësuar i transaksioneve
	8.d Vlera totale doganore e vlerësuar	
	9. Regjime doganore	
	10. Zyra doganore e eksportit (deklarimi i thjeshtuar)	
	a.Kodi ____	b. Zyra Doganore (emri dhe adresa) _____ _____ _____ _____ _____
	11. Zyra mbikëqyrse	
	12. Tipi i deklarimit të thjeshtuar ☐ Dokumenti Vetëm Administrativ (DAV) ☐ Deklarimi Elektronik ☐ Dokument tregtare apo të tjera për të specifikuar	
	13.Informacion shtesë/Kushtet	
	14.Vendi Data	**Titullari, Firma dhe vula**

SHËNIME SHPJEGUESE PËR FORMULARËT E APLIKIMIT PËR PROCEDURA TË THJESHTUARA

Pjesa 1

Të dhënat që futen në kutitë e ndryshme të formularit të aplikimit

Vërejtje e përgjithshme:

Nëse është e nevojshme, informacioni i kërkuar paraqitet në një aneks të veçantë në formularin e aplikimit, duke iu referuar kutisë së formularit në fjalë.

Administrata Doganore mund të kërkojë informacion shtesë.

1. Shkruani emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit. Aplikuesi është personi të cilit i lëshohet autorizimi.

1.a Shkruani numrin identifikues tregtar.

1.b Shkruani, nëse zbatohet, numrin e brendshem të references, të këtij aplikimi që i referohet autorizimit.

1.c Shkruani informacionin e duhur të kontaktit (personin e kontaktit, adresën e kontaktit, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e-mail)

1.d Shënoni llojin e përfaqësimit në depozitimin e deklaratës duke vendosur 'X' në kutinë e duhur.

2. Tregoni llojin e procedurës së thjeshtuar dhe rregjimin doganor (për import dhe / ose eksport) që aplikohet duke vendosur 'X' në kutinë e duhur.

2.a dhe b Lidhur me regjimin e përpunimit aktiv, shkruani kodin 1 për sistemin me pezullim dhe kodin 2 për sistemin me rimbursim. Për sa i përket ri-eksportit, procedurat e thjeshtuara aplikohen për deklaratën doganore kur kërkohet.

3. Vendosni kodin përkatës:
1. Aplikimi i parë për një autorizim
2. Aplikim për një ndryshim autorizimi apo ripërtëritje (gjithashtu shenoni numrin e autorizimit përkatës)

4.a Tregoni nëse statusi i operatorit të autorizuar ekonomik është çertifikuar; nëse "PO", shkruani numrin përkatës.

4.b Shkruani tipin, referencën dhe - nëse zbatohet - datën e mbarimit të autorizimit/meve përkatës për të cilin aplikohet përdorimi i procedurë të thjeshtuar; në rastet kur sapo është aplikuar për autorizimin, shkruani llojin e autorizimit për të cilin aplikohet dhe datën e aplikim.

Kodi	Rregjimi i Autorizuar
1	Magazinë Doganore
2	Përpunim aktiv
3	Lejimi i përkohshëm
4	Përdorim i veçantë përfundimtar (end use)
5	Përpunimi nën kontrollin doganor
6	Përpunimit pasiv

5. Informacion mbi llogaritë kryesore.
- Tregtare, fiskale apo llogari të tjera kontabiliteti.

5.a Shkruani adresën e plotë të vendndodhjes ku janë mbajtur llogaritë kryesore.

5.b Shkruani llojin e llogarive (të mbajtura në mënyrë elektronike ose në letër, dhe llojin e sistemit dhe softëare në përdorim).

6. Shkruani numrin e formularëve plotësues bashkangjitur kësaj kërkese.

Pjesa II

Të dhënat që shkruhen në kutitë e ndryshme të formularit vijues për Importet dhe Eksportet

7. Informacion mbi regjistrat (llogaritë lidhur me procedurat doganore).

7.a Shkruani adresën e plotë të vendndodhjes ku mbahen të dhënat.

7.b Shkruani llojin e të dhënave (elektronike ose në letër, dhe llojin e sistemit dhe softëare në përdorim).

7.c Shkruani, nëse zbatohet, informacione të tjera përkatëse në lidhje me të dhënat

8. Informacion në lidhje me llojin e mallrave dhe transaksionet.

8.a Shkruani, nëse zbatohet, kodin përkatës të NK-së; në të kundërt vendosni të paktën kapitujt e NK dhe përshkrimin e mallrave.

8.b-e Shkruani informacionin e duhur për çdo muaj.

8.f Në import, aplikuesi ka mundësi të tregoj se ai dëshiron të përdorë kursin e këmbimit të vlefshëm në ditën e parë të periudhës së deklarimit, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999.

Vendosni një 'X' në kutinë e duhur, nëse kjo kërkohet.

9. Shkruani kodet përkatëse për regjimet doganore.

10 . Shkruani zyrën doganore përkatëse doganore ku depozitohet deklarata e thjeshtuar.

11. Shkruani emrin e zyrës doganore mbikqyrëse.

12. Tregoni, duke shkruar një 'X' në kutinë e duhur, llojin e deklaratës e thjeshtuar; në rast të përdorimit të dokumenteve tregtare apo të tjera dokumentave administrativ, lloji i dokumenteve në përdorim duhet të specifikohet.

13. Shkruani, nëse zbatohet, informacionin shtesë apo kushtet të cilat janë të rëndësishme për procedurën e thjeshtuar në fjalë, të tilla si rregjimet dhe afatet për depozitimin e deklaratës plotësuese.

Të dhënat jo-konfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do ti jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar numrit në kuti në formularin e aplikimit):

- Numri i autorizimit i dhënë nga autoriteti doganor;
- Kodi i rregjimin, (kutia 9);
- Tregues nëse procedura e thjeshtuar është dhënë për import ose eksport (kutia 2.a ose 2.b);
- Kodi i zyrës doganore (kutia 10a);

Aneksi 7

TË DHËNAT PËR NJË DEKLARIM TË THJESHTUAR (PAPLOTË)
(për qëllime të nenit 52 të këtij vendimi)

1. Përshkrim i përgjithshëm

Formulari i deklaratës së thjeshtuar plotësohet dhe përdoret duke ju referuar rast pas rasti dispozitave të përgjithshme të përcaktuara në Kreun I, të Aneksit 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave 205, datë 13.04.1999, të ndryshuar.

2. Të dhëna të kërkuara dhe lista e kutive që duhen përdorur

Formularët e deklaratës përmbajnë një numër kutish, prej të cilave vetëm një pjesë duhen përdorur, në varësi të regjimit ose regjimeve doganore në fjalë. Referencat e dokumenteve që mungojnë, në të gjitha rastet, duhet të tregohen në deklaratë.

Pa rënë ndesh me zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me secilën kuti të Kreut II apo III, të Aneksit 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave 205, datë 13.04.1999, të ndryshuar, në vijim është dhënë lista e kutive të DAV që plotësohen për secilin regjim për të cilin mundet të aplikohet një deklaratë e thjeshtuar.

a) Kutia 1, ndarja e parë në varësi të regjimit dhe ndarja e dytë ku shënohet tipi i deklaratës që në rastin konkret është e thjeshtuar.

b) Kutitë 2, 3, 4, 5, 6, 8, 17, 18, 21, 31, 32, 35, 38, 40, 44, 47, 49, 50, 52, 55 dhe 56.

3. Afati kohor

Sipas përcaktimeve në autorizim, në formularin e deklaratës së thjeshtuar duhet të tregohet gjithashtu edhe afati kohor brenda të cilit duhet të depozitohen tek zyra doganore kopetente të dhënat, dokumentat dhe deklarimi plotësues për mbylljen e deklaratës së thjeshtuar.

Aneksi 8

PËRJASHTIM NGA DETYRIMET E IMPORTIT PER SENDET VETJAKE QË U PËRKASIN INDIVIDËVE QË NDRYSHOJNE VENDQËNDRIMIN

FORMULARI I SIGURIMIT

Data: _____

TË DHËNA PERSONALE	Emri dhe Mbiemri	Numri i letërnjoftimit
	Adresa	
	Kodi postar	Nr. telefonit
VENDBANIMI NË NJË VEND TJETER	**ALTERNATIVA A** Përjashtim nga detyrimet e importit për mallra, të ndryshme nga automjetet private dhe rimorkiot, motomjetet dhe ciklomotorët, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private, sipas nenit 96 deri 104 të këtij vendimi. Unë po transferoj vendbanimin(vendqëndrimin) tim të zakonshëm nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë. Vendbanimi im i zakonshëm ka qënë në një vend tjetër për një periudhë pa ndërprerje për të paktën 12 muaj. Data e transferimit Nga vendi Unë vërtetoj se mallrat e dhëna më poshtë kanë qënë në posedimin time dhe janë përdorur nga unë ose anëtarë të familjes në vendin e mëparshëm të qëndrimit për të paktën 6 muaj përpara datës në të cilën kam pushuar së qëni banor i vendit prej nga jam nisur ose para ditës në të cilën mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë (në zhdoganim). Kuptoj se mallrat e ndryshme nga automjetet private dhe rimorkiot, motomjetet dhe ciklomotorët, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private, për të cilat është dhënë përjashtim nga detyrimet e importit nuk mund të jepen hua, si garanci, me qira, ose të transferohen brenda 12 muajsh nga data e deklarimit për vendosje në qarkullim të lirë, pa paguar më parë detyrimet e importit dhe tatimet apo taksat e tjera. Emri, Mbiemri, Firma _____	
	ALTERNATIVA B Përjashtim nga detyrimet e importit për automjetet private dhe rimorkiot, motomjetet dhe ciklomotorët, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private, sipas nenit 96 deri 104 të këtij vendimi. Unë po transferoj vendbanimin(vendqëndrimin) tim të zakonshëm nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë. Vendbanimi im i zakonshëm ka qënë në një vend tjetër për një periudhë pa ndërprerje për të paktën 12 muaj. Data e transferimit Nga vendi Unë vërtetoj se automjeti privat dhe rimorkio, motomjeti dhe ciklomotori, ruloti për kamping, barka/jahti privat (familjar) apo për argëtim dhe mjeti ajror privat, i përshkruar në faqen e pasme përmbush kushtet e mëposhtmë: a) Unë kam qënë pronari i regjistruar i automjetit privat dhe rimorkio, motomjeti dhe ciklomotori, ruloti për kamping, barka/jahti privat (familjar) apo për argëtim dhe mjeti ajror privat, kur zbatohet një regjistrim i tillë, për të paktën 12 muaj përpara transferimit në Republikën e Shqipërisë; b) më përket mua për të paktën 12 muaj para se te sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë; c) është përdorur prej meje normalisht në një vend tjetër për të paktën 12 muaj para se të sillej në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;dhe kuptoj se u është dhënë përjashtim nga detyrimet e importit me kushtin që nuk mund të jepen hua, si garanci, me qira, ose të transferohen brenda 12 muajsh nga data e deklarimit për vendosje në qarkullim të lirë, pa paguar më parë detyrimet e importit dhe taksat e tjera për të cilat është dhënë përjashtimi. Emri, Mbiemri, Firma _____	
SENDE VETJAKE (Në qoftë se kërkohet përjashtim nga detyrimet e importit për një automjet privat dhe rimorkio, motomjet dhe ciklomotor, rulot për kamping, barkë/jaht privat (familjar) apo për argëtim dhe mjet ajror privat,	Data e importimit	
	Dërgesa përfshin pije alkolike (alkole, verëra, birrë), produkte duhani dhe produkte të tjera objekt i kufizimeve te veçanta të importit ☐ JO ☐ PO	
duhet të plotësohet seksioni "MJETI VETJAK I TRANSPORTIT" në faqen e dytë)	SPECIFIKIME TË MALLRAVE NË DËRGESË Mallra për të cilat është kërkuar përjashtim nga detyrimet doganore	

	Mallrat e renditura më sipër dhe për të cilat është kërkuar përjashtim (Lutemi shënoni të gjitha kushtet që plotësohen) ☐ më përkasin mua ☐ përbëjnë nevojë për mua dhe familjen time ☐ janë pajisje shtëpie, të përdorura në një vend tjetër nga unë ose pjestarë të familjes sime ☐ do të përdoren në Republikën e Shqipërisë nga unë ose pjestarë të familjes sime

SENDE VETJAKE	Lloji	Marka	Model i vitit
MJETI VETJAK I TRANSPORTIT (automjet privat dhe rimorkio, motomjet dhe ciklomotor, rulot për kamping, barkë/jaht privat (familjar) apo për argëtim dhe mjet ajror privat)	Ngjyra	Shasia, numri i serisë, motori dhe nr. i fabrikimit	
	Shitësi/Furnizuesi (emri dhe adresa)		
	Data e dërgimit	Vendi i dërgimit	Çmimi i blerjes
	Data e regjistrimit	Kodi i kombësisë dhe nr. i targave	Regjistrim i vlefshëm deri
	Kilometrazhi para dërgimit km/milje	Kilometrazhi aktual km/milje	Siguracion ☐ JO ☐ PO / Kohzgjatja
ZBATOHET PËR ALTERNATIVËN B	Gjatë tre viteve të fundit, Unë ☐ Nuk kam deklaruar automjet privat dhe rimorkio, motomjet dhe ciklomotor, rulot për kamping, barkë/jaht privat (familjar) apo për argëtim dhe mjeti ajror privat, për clirim në doganë dhe ☐ Nuk kam marrë përjashtim nga detyrimet e importit për mallra të tilla si send vetiak i individit që ndryshon vendqëndrimin. ☐ Kam deklaruar automjet privat dhe rimorkio, motomjet dhe ciklomotor, rulot për kamping, barkë/jaht privat (familjar) apo për argëtim dhe mjeti ajror privat, të mëposhtëm për çlirim në doganë dhe kam marrë përjashtim nga detyrimet e importit për mallra të tilla si send vetiak i individit që ndryshon vendqëndrimin. Lloji Data Zyra doganore		
	Të dhëna të mëtejshme		
TË DHËNA TË VECANTA DHE KËRKESA	Përjashtim nga detyrimet e importit për sendet vetjake për llogari të transferimit tim ☐ nuk është marrë më parë data zyra doganore ☐ është marrë më parë		
	Të dhena të mëtejshme		
GARANCIA DHE FIRMA	Unë verifikoj se të gjitha të dhenat e paraqitura në këtë formular janë të plota dhe të vërteta Data Firma personale	Firma dëshmohet nga: Adresa Kodi postar	
VETËM PËR PËRDORIM ZYRTAR	Dokumenti i identitetit, vërejtje	Nënshkrimi përfaqësuesit donaor Vula	

Aneksi 9

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore

A. Libra, publikime dhe dokumente

Kodi NK	Përshkrimi
3705	Pllakat dhe filma fotografike, të ekspozuara dhe të zhvilluar, përveçse filmat kinematografike:
ex 3705 90 10	– Mikrofilma të librave, libra me fotografi për fëmijë dhe libra me vizatime apo piktura, fletore pune shkollore, libra me fjalëkryqe, gazeta dhe botime periodike, dokumente të shtypura apo raporte të karakterit jo-komercial, fleta të ilustrimeve, faqe të shtypura dhe kopje riprodhuese për botimin e librave
ex 3705 10 00	– Filma riprodhues për botimin e librave
ex 3705 90 90	
4903 00 00	Libra me fotografi, vizatime apo për ngjyrosje për fëmijë
4905	Harta dhe skica hidrografie ose të ngjashme e të gjitha llojeve, duke përfshirë atlaset, hartat e murit, planet topografike dhe globet, të shtypura:
	– Te tjera:
ex 4905 99 00	– – Te tjera:
	– Harta, skica dhe diagrame në interesin e fushave të tilla shkencore si gjeologji, zoologji, botanikë, mineralogji, paleontologji, arkeologji, etnologji, meteorologji, klimatologji dhe gjeofizikë
ex 4906 00 00	Plane dhe projekte arkitekturale, industriale apo inxhinierike dhe kopje të tyre
4911	Materiale të tjera të shtypura, duke përfshirë pikturat dhe fotografitë:
4911 10	– Material për reklamim profesioni, katalogë tregtar e të ngjashëm:
ex 4911 10 90	– – Te tjera:
	– Katalogë të librave dhe publikimeve, libra dhe publikime të ofruara në shitje nga botuesit apo nga librashitësit të vendosur jashtë Shqipërisë
	– Katalogë të filmave, materiale të incizuara apo materiale të tjera pamore dhe dëgjimore të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor
	– Afishe për promovim turizmi dhe publikime turistike, broshura, udhërrëfyes, orare, pamflete dhe publikime të ngjashme, me ose pa ilustrime, duke përfshirë ato të botuara nga kompani private, të bëra me qëllim të inkurajimit të publikut për të udhëtuar jashtë Shqipërisë, duke përfshirë mikro-kopje të këtyre artikujve
	– Material informativ bibliografik për shpërndarje falas (1)
	– Te tjera:
4911 99 00	– – Te tjera:
	– Fleta të ilustruara, faqe të shtypura dhe kopje të riprodhuara për t'u përdorë për botimin e librave, përfshirë edhe mikro-kopje të këtyre artikujve (1)
	– Mikrokopje të librave, librave me fotografi për fëmijë, librave për vizatim apo ngjyrosje, fletore pune shkollore, librave me fjalëkryqe, gazetave dhe botimeve periodike dhe të dokumenteve apo raporteve të karakterit jo-komercial (1)
	– Publikime të bëra me qëllim të inkurajimit të publikut për të studiuar jashtë Shqipërisë, përfshirë mikro-kopje të këtyre publikimeve (1)
	– Diagrame meteorologjike dhe gjeofizike
9023 00	Instrumente, aparatura dhe modele, të krijuara për qëllime demonstrative (për shembull në arsim apo ekspozita), të papërshtatshme për përdorim tjetër:
ex 9023 00 80	– Te tjera:
	– Harta dhe skica në interesin e fushave të tilla shkencore si në gjeologji, zoologji, botanikë, mineralogji, paleontologji, arkeologji, etnologji, meteorologji, klimatologji dhe gjeofizikë
(1) Megjithatë, përjashtimi nuk vlen për artikuj në të cilët reklamat mbulojnë më tepër se 25 % të sipërfaqes. Në rast të publikimeve dhe afisheve për promovim të turizmit, kjo përqindje ka të bëjë vetëm me reklama private tregtare.	

B. **Materiale pamore dhe dëgjimore të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor**

Artikujt e radhitur në Aneksin II (A) të prodhuara nga Kombet e Bashkuara apo nga një nga agjencitë e tyre të specializuara.

Shënim: me ex kuptohet se përmbajtja e këtij kodit vjen pjesërisht nga kode të mëparshëm.

Aneksi 10

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore që përjashtohen nga detyrimet e importit me kusht

A. **Materiale pamore dhe dëgjimore të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor**

Kodi NK	Përshkrimi	Inst itucioni apo organizata përfituese
3704 00	Pllaka fotografike, filma, letër, karton dhe tekstil, të ekspozuara por jo të zhvilluara:	Të gjitha organizatat (duke përfshirë organizatat transmetuese dhe televizive), institucionet apo shoqatat e aprovuara nga autoritetet kompetente, me qëllim të lejimit të këtyre mallrave të liruara nga detyrimet e importit
ex 3704 00 10	– Pllaka dhe filma:	
	– Filma kinematografik, pozitivë, të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor	
ex 3705	Pllakat dhe filma fotografike, të ekspozuara dhe të zhvilluar, përveçse filmat kinematografike:	
	– Të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor	
3706	– Të një gjerësie prej 35 mm apo meë shumë:	
	– – Të tjera:	
ex 3706 10 99	– – – Pozitivet e tjerë:	
	– Kronika (me ose pa kolonë zanore) ku përshkruhen ngjarje me vlerë të lajmeve aktuale në momentin e importimit, dhe të importuara deri në dy kopje nga secila temë për qëllime kopjimi	
	– Materiale filmike të arkivit (me ose pa kolonë zanore) të destinuara për përdorim në lidhje me kronika	
	– Filma rekreativ veçanërisht të përshtatura për fëmijë dhe të rinj	
	– Filma tjerë të karakterit edukativ, shkencor ose kulturor	
3706 90	– Te tjera:	
	– – Te tjera:	
	– – – Pozitivet e tjere:	
ex 3706 90 51	– Kronika (me ose pa kolonë zanore) ku përshkruhen ngjarje me vlerë të lajmeve aktuale në momentin e importimit, dhe të importuara deri në dy kopje nga secila temë për qëllime kopjimi	
ex 3706 90 91		
ex 3706 90 99		
	– Materiale filmike të arkivit (me ose pa kolonë zanore) të destinuara për përdorim në lidhje me kronika	
	– Filma rekreativ veçanërisht të përshtatura për fëmijë dhe të rinj	
	– Filma tjerë të karakterit edukativ, shkencor ose kulturor	
4911	Artikuj të tjerë të shtypur, përfshirë pikturat dhe fotografitë e shtypura:	
	– Të tjera:	
ex 4911 99 00	– – Të tjera:	
	– Mikro-karta apo mjete të tjera për ruajtje të informatave që nevojiten në shërbimet e kompjuterizuara informative dhe dokumentare të karakterit edukativ, shkencor apo kulturor	
	– Harta të murit të dizajnuara vetëm për demonstrim dhe edukim	
ex 8523	Disqe, shirita, pajisjet ruajtese, kartat smart dhe mjetet e tjera për regjistrimin e tingujve ose fenomeneve, nëse janë ose jo të regjistruara, përfshi matricat dhe klishetë për prodhimin e disqeve, por duke përjashtuar produktet e kapitullit 37 :	
	– Të një karakteri edukativ, shkencor apo kulturor	
ex 9023 00	Instrumentat, aparatet dhe modelet, e projektuara për qëllime demonstrative (psh, në shkollim ose ekspozitë), të papërshtatshme për përdorime të tjera:	

	– Mostra, modele dhe harta muri të karakterit edukativ, shkencor apo kulturor, të projektuara vetëm për demonstrim dhe edukim	
	– Maket apo paraqitje figurative të koncepteve abstrakte, siç janë strukturat molekulare apo formulat matematikore	
Të ndryshme	Holo-grame për projektime laserike	
	Pajisje për multi-media	
	Materiale për udhëzime të programuara, duke përfshirë materialet në formë seti me materialet e shtypura korresponduese	

B. **Objekte të koleksionistëve dhe punime arti me karakter edukativ, shkencor apo kulturor**

Kodi NK	Përshkrimi	Institucioni apo organizata përfituese
Të ndryshme	Objekte të koleksionistëve dhe punime arti, që nuk janë në shitje	Galeritë, muzetë dhe institucionet tjera të aprovuara nga Ministria përkatës, me qëllim të lejimit të këtyre mallrave pa detyrime importi

Shënim: me ex kuptohet se përmbajtja e këtij kodit vjen pjesërisht nga kode të mëparshëm.

Aneksi 11

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër

Kodi NK	Përshkrimi
4911	Artikuj të tjerë të shtypur, përfshirë pikturat dhe fotografitë e shtypura:
4911 10	– Materiale tregtare reklamuese, katallogjet tregtare dhe të ngjashmet e tyre:
ex 4911 10 90	– – Të tjera:
	– Për të lehtësuar të verbërit dhe pjesërisht të verbërit
	– Të tjera:
ex 4911 91 00	– – Piktura, vizatime dhe fotografi:
	– Për të lehtësuar të verbërit dhe pjesërisht të verbërit
ex 4911 99 00	– – Të tjera:
	– Për të lehtësuar të verbërit dhe pjesërisht të verbërit

Shënim: me ex kuptohet se përmbajtja e këtij kodit vjen pjesërisht nga kode të mëparshëm.

Aneksi 12

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër me kusht

Kodet NK	Përshkrimi
4802	Letër dhe karton i pa mbështjellë, i llojit që përdoret për shkrime, stampim apo qëllime tjera grafike, dhe letër-karton me vrima dhe shirita letre me vrima, në rulon apo në fletë drejtkëndëshe (duke përfshirë edhe fletët katrore) të çfarëdo madhësie, të ndryshme nga letra e kreut nr 4801 ose 4803; letër dhe karton të punuara me dorë:
	– Lloje të tjera të letrës dhe kartonit, që nuk përmban fibra të përfituara nga proceset mekanike apo kimiko-mekanike apo nga të cilat jo më tepër se 10% e peshës se përbërjes totale të fibrave janë fibra të tilla:
ex 4802 55	– – Me peshë 40 g/m^2 ose më tepër por jo më shumë se 150 g/m^2
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 4802 56	– – Me peshë 40 g/m^2 apo më shumë, por jo më shumë se 150 g/m^2, në fletë, me një anë që nuk e kalon 435 mm dhe në anën tjetër që nuk e kalon 297 mm në gjendje të shpalosur
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 4802 57 00	– – Të tjera, me peshë 40 g/m^2 ose më tepër por jo më shumë se 150 g/m^2
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 4802 58	– – Me peshë më tepër se 150 g/m^2:
	– Letër Braille (për të verbërit)
	– Tjetër letër dhe karton në të cilën më shumë se 10% e peshës totale te fibrave përbëhet nga fibra të përftuara nga një proces mekanik ose kimik-mekanik:
ex 4802 61	– – në role
ex 4802 61 80	– – – Të tjera
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 4802 69 00	– – Të tjera
	– Letër Braille (për të verbërit)
4805	Leter dhe karton tjeter i paveshur, në role apo në fleta, jo me tej të punuara apo të procesuara sesa siç është specifikuar në Shënimin 3 të këtij Kapitulli:
	– Të tjera:
ex 4805 91 00	– – Me peshë specifike jo më shumë se 150 g/m^2
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 4805 92 00	– – Me peshë specifike me shume se 150 g/m^2 , por më pak se 225 g/m^2
	– Letër Braille (për të verbërit)
4805 93	– – Me peshë 225 g/m^2 , ose më shumë:
ex 4805 93 80	– – – Të tjera:
	– Letër Braille (për të verbërit)
4823	Tjetër letër, karton, mbushje celulozike dhe tekstile të fibrave celulozike, të prera në madhësi apo formë; artikuj të tjerë të brumit të letrës, letër, karton, mbushje celulozike apo tekstileve prej fibrave celulozike:
	– Tjetër letër dhe karton, të llojit që përdoret për shkrim, shtypje apo qëllime tjera grafike:
4823 90	– Të tjera:
ex 4823 90 40	– – Leter dhe karton, për t'u përdorur për shkrime, shtypshkrime ose qëllime të tjera grafike
	– Letër Braille (për të verbërit)
ex 6602 00 00	Bastunet, bastunet mbështetës, kamzhiqet, artikujt për gjueti dhe të ngjashmet e tyre:
	– Shkop i bardhë për të verbërit dhe pjesërisht të verbër
ex 8469	Makina shkrimi dhe makina për proçesimin e fjalëve:
	– Shkop i bardhë për të verbërit dhe pjesërisht të verbër
ex 8469	Makina shkrimi dhe makina për procesimin e fjalëve:
	– Të përshtatura për t'u përdorë nga persona të verbër apo pjesërisht të verbër
ex 8471	Makina automatike për procesim të dhënash dhe njësi të tyre; lexues magnetikë apo optikë, makina për transkriptim të të dhënave në mjete komununikimi të të dhënave në formë të koduar dhe makina për procesim të atyre të dhënave, që nuk janë specifikuar apo përfshirë diku tjetër:
	– Pajisje për prodhimin mekanik të materialit Braille dhe të regjistruar për të verbërit
ex 8519	Aparate për regjistrimin ose riprodhimin e zërit:
	– Gramafon dhe kasetofon të projektuar apo përshtatur enkas për persona të verbër dhe pjesërisht të verbër

ex 8523	Disqe, shirita, pajisjet ruajtese, kartat smart dhe mjetet e tjera për regjistrimin e tingujve ose fenomeneve, nëse janë ose jo të regjistruara, përfshi matricat dhe klishetë për prodhimin e disqeve, por duke përjashtuar produktet e kapitullit 37 :
	– Libra që flasin
	– Regjistruar magnetike dhe kaseta për prodhim të Braille dhe të librave që flasin
9013	Mjete kristalore të lëngshme që nuk përmbajnë artikuj të paraqitur më detalisht në krerët tjerë; laserë, të ndryshme nga diodat laserike; pajisje dhe instrumente tjera optike, që nuk janë specifikuar apo përfshirë diku tjetër në këtë kapitull:
ex 9013 80	– Paisje, mjete dhe instrumenta te tjera:
	– Zmadhues televiziv për personat e verbër dhe pjeserisht te verbër
9021	Aparate ortopedike, përfshirë patericat, rripat dhe lidhëset kirurgjike; rripa metalikë dhe pajisje tjera për fraktura; pjesë artificiale të trupit; aparate për dëgjim dhe pajisje tjera të cilat barten në trup, ose të transplantuara në trup, për të kompensuar ndonjë defekt apo paaftësi:
9021 90	– Të tjera:
ex 9021 90 90	– – Të tjera:
	– Orientues elektronike dhe pajisje per detektimin e pengesave për të verbërit dhe pjesërisht të verbërit
	– Zmadhues televiziv për personat e verbër dhe pjeserisht të verbër
	– Makina lexuese elektronike për personat e verbër dhe pjeserisht të verbër
9023 00	Instrumentat, aparatet dhe modelet, e projektuara per qëllime demonstrative (p.sh., në shkollim ose ekspozitë), të papershtatshme për përdorime të tjera:
ex 9023 00 80	– Të tjera:
	– Mjete mesimore dhe aparate të projektuara për personat e verbër dhe pjeserisht të verbër
ex 9102	Oret e dores, oret e xhepit dhe orë të tjera, përfshi kronometrat, të ndryshme nga ato të kreut 9101:
	– Orë Braille (për të verbër) me kapakë që nuk janë nga metalet e çmueshme
9504	Artikuj për parqe të lojërave, për lojëra të tavolinës dhe të dhomës, duke përfshirë bilardo, tabelat speciale për lojërat kazino dhe pajisjet automatike për lojën me birila:
9504 90	– Të tjera:
ex 9504 90 90	– – Të tjera:
	– Lojëra tavoline dhe pjesë ndihmëse për to të adaptuara enkas për t'u përdorur nga personat e verbër dhe pjeserisht të verbër
Të ndryshme	Të gjithë artikujt tjerë të dizajnuar enkas për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër dhe pjesërisht të verbër

Shënim: me ex kuptohet se përmbajtja e këtij kodit vjen pjesërisht nga kode të mëparshëm.

VENDIM
Nr. 927, datë 29.12.2014

PËR KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË BAZËS SË VLERËSUAR PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika "1", të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2015 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për pagat referuese, deri më 1.1.1994 8.59
Për pagat e vitit 1994 8.59
Për pagat e vitit 1995 6.92
Për pagat e vitit 1996 5.37
Për pagat e vitit 1997 5.37
Për pagat e vitit 1998 4.48
Për pagat e vitit 1999 3.64
Për pagat e vitit 2000 3.31
Për pagat e vitit 2001 2.83
Për pagat e vitit 2002 2.62
Për pagat e vitit 2003 2.34
Për pagat e vitit 2004 2.13
Për pagat e vitit 2005 1.93
Për pagat e vitit 2006 1.76
Për pagat e vitit 2007 1.67
Për pagat e vitit 2008 1.48
Për pagat e vitit 2009 1.36
Për pagat e vitit 2010 1.30
Për pagat e vitit 2011 1.25
Për pagat e vitit 2012 1.20
Për pagat e vitit 2013 1.16
Për pagat e vitit 2014 1.00

2. Në vitin 2015 dhe në vazhdim, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, pas indeksimit të tyre vit pas viti, me koeficientët vjetorë të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

a) trefishi i pagës minimale të indeksuar, të vitit përkatës, për pagat nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale, e përcaktuar për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2014 e në vazhdim, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2015 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 582, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet, vetëm për pensionet me datë fillimi deri në 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 928, datë 29.12.2014

PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR PENSIONIN SOCIAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret e përfitimit dhe masa e pensionit social

Për përfitimin e pensionit social duhet të zbatohen këto kritere:

a) Përfiton të drejtën për të kërkuar trajtimin financiar me pension social shtetasi shqiptar i cili ka plotësuar moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë

vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për pension dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social;

b) Masa mujore e pensionit të plotë social të jetë e barabartë me shumën e pensionit të pjesshëm të pleqërisë të datës 31.12.2014, përllogaritur për 15 vite vjetërsi pune të siguruara kundrejt pagës minimale, shtuar me kompensimet për rritjen e çmimeve dhe për pensionistët me të ardhura minimale, sipas masës dhe kritereve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", nr. 471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", nr. 401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr. 763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr. 415, datë 27.4.2009, "Për rritjen e pensioneve", dhe nr. 474, datë 30.6.2010, "Për rritjen e pensioneve";

c) Duke filluar nga data 1.1.2015, masa e pensionit të plotë social të jetë 6 750 lekë në muaj. Pensioni social i përcaktuar të indeksohet çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të indeksit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve;

ç) Personat që kanë plotësuar moshën 70 vjeç, si dhe ata që janë rezidentë në Shqipëri në 5 vitet e fundit, kanë të drejtën e përfitimit të një pensioni social të pjesshëm, i cili është sa diferenca midis pensionit të social të plotë dhe të ardhurave mujore të deklaruara dhe të vlerësuara e të pranuara nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore.

2. Procedura e kërkesës, vlerësimit të dokumenteve dhe caktimit të pensionit social

Për përfitimin e pensionit social, duhet të ndiqet kjo procedurë:

a) Shtetasi që plotëson kriteret për trajtimin financiar me pension social, paraqet kërkesën për përfitim dhe dokumentacionin e parashikuar, pranë agjencisë lokale të sigurimeve shoqërore, ku ka vendbanimin;

b) Agjencia lokale e sigurimeve shoqërore shqyrton dokumentacionin e deklaruar, kërkon nga institucionet përgjegjëse konfirmimin e të dhënave dhe, pas konfirmimit, dërgon dosjen me dokumentacionin përkatës në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore;

c) Pensionet sociale caktohen dhe dërgohen për pagesë nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore. Vendimi i caktimit të pensionit social nënshkruhet nga inspektori përpunues, kryetari i degës së përfitimeve, kryetari i degës se financës dhe drejtori i drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore. Afatet e caktimit dhe të pagesës së pensionit social janë të njëjta dhe ndjekin të njëjtat rregulla, si dhe për pensionet e pleqërisë;

ç) Dokumentacioni i përfitimit dhe vendimet e drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore për caktimin dhe pagimin e pensionit social, auditohen çdo vit nga auditët e specializuar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Certifikimi i dosjeve të përfitimeve të caktuara për herë të parë, si dhe të përfitimeve të rishqyrtuara, të kryhet i plotë për secilën dosje përfituesi.

d) Në rastet kur kërkuesit janë në kushtet e përfitimit, të përcaktuara në pikën 4, të kreut të parë, të këtij vendimi, masa e pensionit që i caktohet kërkuesit është diferenca midis pensionit social të plotë me të ardhurat që kërkuesi ka nga burimet e tjera. Vlerësimi i të ardhurave do të bëhet në të njëjtën mënyrë dhe bazuar në të njëjtin legjislacion që përdoret edhe për përcaktimin e masës së ndihmës ekonomike. Të ardhurat individuale të kërkuesit përllogariten në raport me pjesëtarët;

dh)Në rastet kur kërkuesi ka të ardhura individuale nga burime të tjera më të larta se masa e pensionit social e përcaktuar për vitin përkatës, pensioni social nuk caktohet. Dokumentet mbahen në dosjen e çelur për këtë qëllim, në të cilën bashkëlidhet edhe njoftimi zyrtar me arsyet dhe argumentet e moscaktimit të këtij përfitimi;

e) Vendimi për caktimin e masës së pensionit social dhe gjithë dokumentacioni në të cilin është bazuar llogaritja e pensionit, regjistrohen në regjistrin e posaçëm për pensionet sociale dhe arkivohen në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore.

3. Dokumentacioni për përfitimin e pensionit social

a) Për të përfituar pensionin social, kërkuesi, së bashku me kërkesën personale, duhet të paraqesë edhe këto dokumente:

- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Certifikatën familjare;
- Deklaratën për gjendjen e tij social-ekonomike;
- Vërtetimin nga zyra e gjendjes civile, që është banor në Shqipëri për të paktën 5 vite, nga koha kur paraqet kërkesën për pension;
- Vërtetimin e drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore, që nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni;
- Vërtetimin nga organet tatimore, nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomike sipas kuptimit të saj, përcaktuar në pikën 20, të nenit 4, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore";
- Certifikatë pronësie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Vërtetim nga zyrat rajonale të SHSSH-së (nëse personi merr ndihmë ekonomike në përbërje të familjes së tij që përfiton ndihmë ekonomike);
- Aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, apo certifikatën e pronësisë mbi tokën;
- Deklaratë nëse është ose jo aksionar apo bashkëpronar në aktivitete ekonomike ose pasuri të patundshme, të dhëna për qëllime të nxjerrjes së të ardhurave.
- Deklarata për gjendjen e të ardhurave dhe dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi verifikohet dhe dokumentohet nëse është i saktë dhe, pas këtij procesi, caktohet masa mujore e pensionit social.
- Një herë në vit përfituesi i pensionit social paraqet deklaratën e re për gjendjen e tij social-ekonomike, e cila, pasi verifikohet nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, shërben si dokument për vazhdimin e përfitimit, rillogaritjen ose ndërprerjen e tij.

b) Përfituesi i pensionit është i detyruar të njoftojë agjencinë lokale të sigurimeve shoqërore ku ka dorëzuar kërkesën, sa herë që ndryshojnë të ardhurat dhe, mbi këtë bazë, drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore rillogarit masën e pensionit.

4. Pagesa dhe ndërprerja e pensionit social

a) Pensioni social duhet të tërhiqet nga përfituesi çdo muaj.

b) Pagesa e pensionit social ndërpritet në rast se përfituesi nuk e tërheq atë nga qendrat e përcaktuara të pagesës, brenda fundit të muajit të krediturar për pagesë. Në këto raste, parashkruhet vetëm pagesa për muajin e patërhequr.

c) Pensioni social mbyllet kur konstatohet se, për përfitimin e tij, janë kryer veprime spekulative të dhurimit apo të pakësimit të kapitalit që ishte burim i të ardhurave.

ç) Kësti mujor i pensionit social nuk ndërpritet në rastet kur përfituesi kurohet në spital ose është i sëmurë nga sëmundje që nuk mundësojnë lëvizjen apo nuk është i aftë nga ana mendore, të vërtetuara këto me raport mjekësor.

5. Zyra e Tatim-Taksave, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Zyra e Regjistrimit të Automjeteve, zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe organet e qeverisjes vendore janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore për informacion, lidhur me kërkuesit e pensionit social, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunojnë për vlerësimin e gjendjes ekonomike të përfituesit të pensionit social. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë të detyruara që, përveç verifikimeve të veçanta gjatë vitit, brenda muajit janar të viti përkatës të verifikojnë të ardhurat e përfituesit.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi llogariten në shumën 372 (treqind e shtatëdhjetë e dy) milionë lekë dhe parashikohen brenda buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2015.

8. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzime dhe të hartojnë dokumentacionin model sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 929, datë 29.12.2014

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 561, DATË 12.8.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE REFERUESE PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Paga referuese, për periudhën e sigurimit të ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, para datës 1.1.1994, të jetë 1 619 (një mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj.".

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 932, datë 29.12.2014

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve të dhënë në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Ministria e Shëndetësisë, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra dhe shërbime.

4. Spitali e ushtron veprimtarinë në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës dhe të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

5. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore që ofron çdo spital bëhet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Një fond jo më i madh se 20% për qind e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për t'ua rishpërndarë spitaleve gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për:

a) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore publike e private, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) nevoja të spitaleve gjatë vitit;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, të ofruara prej tyre. Në kontratën dypalëshe, ndër të tjera, përcaktohen:

a) shërbimet e parashikuara për çdo spital;

b) mënyrat e mbajtjes të të dhënave dhe të raportimit;

c) mënyrat e pagesës së spitalit;

ç)treguesit e cilësisë dhe të performancës;

d) mënyrat e ushtrimit të kontrollit nga Fondi;

dh)sistemi i referimit dhe mënyra e identifikimit të të siguruarve;

e) mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

7. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë. Spitalet mund të kryejnë investime edhe nga burime të tjera.

8. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet totalisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, sipas udhëzimit të miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

9. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

10. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë.

11. Ministria e Shëndetësisë auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj, si dhe për mënyrën e përdorimit të buxhetit total të spitalit.

12. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, të ndryshuar.

13. Spitalet janë të detyruara të llogaritin shpenzimet faktike të çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Shpenzimet mujore dhe progresive raportohen nga spitalet në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i cili bën monitorimin e tyre.

14. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me metodën e buxhetimit me zëra shpenzimesh dhe me buxhetim global.

a) Buxheti i kontraktuar i spitalit për pjesën e buxhetimit me zëra shpenzimesh mbulon:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxheti i kontraktuar i spitalit për pjesën e buxhetimit global mbulon pagesën për paketat e shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Spitali përdor pjesën e kostos së paketës për mbulimin e shpenzimeve sipas shkronjës "a". Detajimi i shpenzimeve për këto paketa dhe mënyra e financimit të tyre bëhet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Spitali mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Rishpërndarja e buxhetit midis spitaleve mund të bëhet vetëm brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

16. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Numri pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

18. Vendimi nr. 1, datë 8.1.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, shfuqizohet.

19. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse të buxhetit, nga Ministria e Shëndetësisë.

20. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I.SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
a) Hemodinamika;
b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencës së sëmundjeve të brendshme;
10. Shërbimi i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë;
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
20. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
21. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
22. Shërbimi i urologjisë;
23. Shërbimi i djegie-plastikës;
24. Shërbimi i neurologjisë dhe neurofiziologjisë;
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë+kirurgjia onkologjike:
a) Statistika onkologjike (regjistri i kancerit);
b) Laboratori histopatologjik onkologjik;
c) Laboratori klinik-biokimik onkologjik.
27. Shërbimi i rrezatim-kobaltit;
28. Shërbimi infektiv;
29. Shërbimi i pediatrisë së përgjithshme:
a) Urgjenca pediatrike;
b) Fizioterapia pediatrike.
30. Shërbimi i pediatrisë së specialiteteve;
31. Shërbimi i pediatrisë infektive;
32. Shërbimi i kirurgjisë infatile;
33. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;

34. Shërbimi i reanimacionit pediatrik; 35.Shërbimiilaboratorëve(klinikë-biokimikë,mikrobiologjikë,imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laboratori i mjekësisë nukleare);
36. Shërbimi i imazherisë;
37. Shërbimi i fizioterapisë;
38. Shërbimi i statistikave;
39. Shërbimi i pneumologjisë;
40. Kirurgjisë torakale;
41. Shërbimi i ftiziatrisë;
42. Shërbimi i gjinekologjisë;
43. Shërbimi i obsetrikës;
44. Shërbimi i patologjisë së barrës;
45. Shërbimi i neonatologjisë;
46. Shërbimi i farmacisë;
47. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatore;
48. Shërbimi i toksikologjisë;
49. Shërbimi i koordinimit të urgjencave;
50. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
51. Kontrolli i infeksioneve spitalore.

II.SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të qarkut ofrojnë shërbimet:

1. e urgjencës;
2. e mjekësisë se përgjithshme;
3. e kirurgjisë se përgjithshme, ortopedi-traumatologji, urologji, ORL, okulistikë angiologji, max-facial;
4. obstetrike-gjinekologjisë;
5. neonatologji;
6. pediatrisë;
7. radiologjisë;
8. fizioterapisë;
9. anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;
11. anestezi-reanimacionit;
12. farmacia;
13. shërbimin e onkollogjisë, kimioterapisë[2], kujdesin paljativ;
14. kontrolli i infeksioneve spitalore;
15. shërbime psikosocial;
16. këshillimit ambulator, për te gjitha specialitetet e mësipërme;
17. banka e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE (RRETHI)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë shërbimet:

1. e urgjencës;
2. e mjekësisë se përgjithshme;
3. e kirurgjisë se përgjithshme;
4. e pediatrisë dhe obstetrike-gjinekologjisë, neonatologji;
5. e radiologjisë;
6. e laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;

[2] Kimio do të jetë në pesë spitale: Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"

7. e anestezi-reanimacionit;
8. e farmacisë;
9. shërbimin ambulator të specializuar;
10. banka e gjakut.

IV. SPITALET DITORE

1. ndihmë e pare mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA 2

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2015

000 lekë

nr	Spitalet	Nr. punonjë sve	Paga e shtesa (600)	Sig. shoqërore e	Mallra e Shërbime (602)	Paketat e kontraktuara (604)	Rezervë	TOTALI
1	BERAT	393	230,590	38,500	160,000			429,090
2	BULQIZË	105	58,620	9,790	20,000			88,410
3	DELVINË	32	20,490	3,420	5,000			28,910
4	DEVOLL	57	33,465	5,590	7,000			46,055
5	DIBËR	384	219,500	36,655	100,000			356,155
6	ELBASAN	658	361,625	35,320	160,000			556,945
7	FIER	527	296,200	49,465	180,000			525,665
8	GRAMSH	164	97,370	16,260	30,000			143,630
9	GJIROKASTËR	261	155,535	26,000	76,470			258,005
10	HAS	43	25,930	4,330	10,000			40,260
11	KAVAJË	169	95,180	15,895	34,000			145,075
12	KOLONJË	135	74,310	12,400	20,000			106,710
13	KORÇË	590	333,730	55,730	190,000			579,460
14	KRUJË	177	104,640	17,470	30,000			152,110
15	KUÇOVË	77	47,050	7,850	11,000			65,900
16	KUKËS	324	182,000	30,390	90,000			302,390
17	KURBIN	99	56,870	9,500	26,000			92,370
18	LEZHË	280	162,660	27,150	95,000			284,810
19	LIBRAZHD	209	121,700	20,300	44,000			186,000
20	LUSHNJË	312	181,440	30,300	105,000			316,740
21	M.MADHE	17	11,905	1,990	5,000			18,895
22	MALLAKASTËR	39	23,000	3,840	7,000			33,840
23	MAT	203	111,690	18,650	46,000			176,340
24	MIRDITË	153	88,980	14,855	30,000			133,835
25	PEQIN	30	20,360	3,400	5,000			28,760
26	PËRMET	134	75,965	12,685	26,000			114,650
27	POGRADEC	255	146,050	24,390	71,000			241,440
28	PUKË	155	87,050	14,535	33,000			134,585
29	SARANDË	200	119,140	19,890	57,500			196,530
30	SKRAPAR	145	81,910	13,670	17,000			112,580
31	SHKODËR	795	434,050	72,535	132,000			638,585
32	TEPELENË	171	96,930	16,180	20,000			133,110
33	QSUT	2,798	1,488,700	249,660	2,659,400			4,397,760
34	MATERNITETI 1	379	230,130	38,430	190,000			458,560
35	MATERNITETI 2	286	182,180	30,420	150,000			362,600
36	SANATORIUMI	347	192,610	32,160	215,000			439,770
37	TROPOJE	163	91,540	15,285	30,000			136,825
38	VLORE	585	323,520	54,020	180,000			557,540
39	SU TRAUMA	332	221,230	36,945	310,000			568,175
	Rezerva						382,250	382,250
	paketat privat					2,332,680		2,332,680
	trajtime VKM						50,000	50,000
	TOTALI	12,183	6,885,845	1,125,855	5,577,370	2,332,680	432,250	16,354,000

SHTOJCA NR. 3

LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore;
8. Njësia e Transportit me Helikopterë.

VENDIM
Nr. 935, datë 29.12.2014

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2015 PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "b", të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2015, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e buxhetit për programin e Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2015, sipas tabelave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca nr. 1

PEMA E PROGRAMIT TE ZRPP PER VITIN 2015

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së sherbimeve ne permjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit te sistemit te regjistrimit te pasurive te paluajtshme, me qellim automatizimin e sherbimeve, perditesimin e te dhenave dixhitale te karteles dhe hartes treguese te regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIIVI 1: Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme

OBJEKTIVI 2: Përmirësim përditësimi i të dhënave në ZVRPP

OBJEKTIVI 3: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

OBJEKTIVI 4: Menaxhimi me efektivitet dhe Sigurimi i Shërbimeve të përgjithshme për të mbështetur një administrim të mirë të ZRPP, nëpërmjet kthimit të përgjigjeve ndaj klientëve të 800 527 kërkesave për shërbime

- Përmirësimi i të dhënave të Administrimit të Tokës (LADI)
  - Prod. 1; Përmirësimi dhe përditësimi i te dhënave ne 2 ZK pilot
  - Prod 2: Vlerësimi i Produktit të Regjistrimit në zonën e Bregdetit te Jugut
- Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme npm ZRPP
  - Prod 1: Përfundimi i Procesit të Regjistrimit Fillestar në zonat e mbetura nga Projekti LAMP
- Automatizim i sistemit te regj të pasurive
  - Prod 1: Zyra të automatizuara
- Përmirësim Përditesimi i të dhënave
  - Prod 1:Përmiresim Përditesimi i të dhënave në 7 ZVRPP (21 ZK)
  - Prod 1: Zyra të pajisura me orendi zyre
- Ndërtimi i infrastrukturës së ZRPP npm kompletimit të zrpp me pajisje elektronike, orendi, dhe rikonstruksionit të ambjenteve të ZVRPP
  - Prod 2: Rikonstruksion i ambjenteve te ZVRPP
  - Prod. 3: Zyra të pajisuara me pajisje elektronike

Tabela nr. 2 *Ne 000/ leke*

BUXHETI 2015		
Përshkrimi	**Buxheti 2015**	
	Të ardhura	**Shpenzime**
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	1,468,181	
Shpenzime personeli		711,513
Shpenzime korrente		200,640
Investime		526,665
Fondi rezervë (2% e të ardhurave)		29,364
Total	**1,468,181**	**1,468,181**
Teprica (1)-(2)		**0**

Tabela nr. 3

BUXHETI I VITIT 2015

Në 000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2015
I	**TOTALI I TË ARDHURAVE**	**1,468,181**
1	**Të ardhura jotatimore**	1,468,181
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,468,181
II	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**1,468,181**
1	**Shpenzime personeli**	**711,513**
	Paga	585,119
	Kontribute për sigurime shoqërore	97,138
	Fondi i veçantë i pagave	29,256
2	**Shpenzime operative**	**200,640**
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	200,640
3	**Shpenzime kapitale, nga të cilat:**	**526,665**
	Investime kapitale të brendshme	526,665
4	**Fondi rezervë**	**29,364**
	Fondi rezervë	29,364
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0

VENDIM
Nr. 953, datë 29.12.2014

PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ligj", ligji nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".
2. "TVSH/tatimi", tatimi mbi vlerën e shtuar në kuptim të ligjit.
3. "Përjashtim", përjashtimi nga TVSH-ja sipas kuptimit të ligjit;
4. "OJF", organizatë jofitimprurëse sipas kuptimit të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse".
5. "Zbritja e TVSH-së", e drejta për të zbritur TVSH-në për furnizimet e marra sipas kuptimit të ligjit.

Neni 2
Kriteret për zbatimin e përjashtimit për organizatat jofitimprurëse

Në zbatim të nenit 51, shkronjat "ë", "f", "i", "j", "k", përjashtohen nga TVSH-ja nëse plotësojnë kriteret dhe procedurën sipas këtij vendimi furnizimet e mëposhtme të kryera nga organizatat jofitimprurëse:

1. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me ndihmën dhe asistencën sociale, përfshirë veprimet që kryejnë shtëpitë e kujdesit për të moshuarit;

2. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve;

3. Furnizimi i shërbimeve të caktuara, të lidhura ngushtë me ushtrimin e sportit ose të edukimit fizik, që u ofrohen personave që marrin pjesë në ushtrimin e sportit apo të edukimit fizik;

4. Furnizimi i shërbimeve të caktuara kulturore dhe edukative, si dhe mallrave që lidhen ngushtësisht me to.

II. Kriteret për vlerësimin e qëllimit jofitimprurës të organizatës

Këto furnizime me karakter shoqëror, edukativ, kulturor, sportiv përjashtohen nga TVSH-ja kur kryhen nga organizma publikë apo nga organizata pa qëllim fitimi me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim nga TVSH-ja, me kusht që çmimet e furnizimeve që ofron organizata jofitimprurëse të jenë më të ulëta se ato që ofrohen për furnizime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së, me qëllim që të mos sjellë shtrembërim të konkurrencës.

Zbatimi i përjashtimit nga TVSH-ja kërkon të plotësohen tri kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Organet drejtuese të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës.

2. Veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë, duke marrë në konsideratë të ardhurat përkatëse, duhet të kenë epërsi të ardhurat nga veprimtaria joekonomike e organizatës.

3. Furnizimet që kryhen nga organizatat jofitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë sektorin tregtar fitimprurës. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, e kryer prej këtyre organizatave për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse, për të cilën janë krijuar, të arkëtuara gjatë vitit kalendarik, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës.

Nocioni i "të ardhurave të përgjithshme" përmbledh të gjitha burimet financiare të organizatës, përfshirë të ardhurat nga furnizimet dhe subvencionet e shfrytëzimit.

III. Organizmat që përfshihen sipas formës së organizimit të tyre

Organizmat që përfitojnë nga ky përjashtim kur plotësojnë kriteret e sipërpërmendura për veprimtarinë ekonomike që ato kryejnë janë:

-shoqatat me interes të përgjithshëm të organizuara në një formë, të tillë si organizatat politike, sindikaliste, profesionale, filozofike ose fetare, shoqatat kulturore, social-kulturore ose sportive, shoqatat folklorike etj;

-organizatat e krijuara sipas ligjit "Për organizatat jofitimprurëse", të cilat veprojnë pa qëllime fitimi, të tilla si fondacione, grupime të ndërvarura, komitete të ndryshme.

Këto organizata jofitimprurëse, që veprojnë në këtë mënyrë, përjashtohen për shërbimet me karakter social, edukativ, kulturor apo sportiv, si dhe për furnizimet e mallrave që u ofrojnë me çmime të reduktuara kryesisht anëtarëve të tyre por edhe të tjerëve, si pjesë e aktivitetit dytësor të tyre të kryer në funksion të qëllimit të tyre jofitimprurës.

Organizatat pa qëllim fitimi nuk duhet të përdorin reklamat, të njohura si praktika të përdorura për arsye tregtare, të cilat u drejtohen personave joanëtarë për të reklamuar ose për të bërë të njohur veprimtarinë e organizatës. Nëse ato reklamojnë veprimtarinë e tyre, atëherë furnizimet e tyre nuk përfitojnë nga ky përjashtim.

Në kuadër të furnizimit të shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, cilido qoftë personi juridik, ent publik, shoqatë, ndërmarrje, përjashtohen furnizimet e kryera nga institucionet që kujdesen për fëmijët e moshës deri në tre vjeç të cilat që në gjuhën e përditshme njihen "çerdhe".

IV. Për zbritshmërinë e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse që përfitojnë nga përjashtimi prej TVSH-së për furnizimet që ofrojnë në kuadër të veprimtarisë së tyre ekonomike, nuk kanë të drejtë të zbresin TVSH-në për mallrat dhe shërbimet e blera për qëllime të furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja.

V. Detyrimi për deklaratën e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike, si veprimtari dytësore të tyre, edhe kur përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së sipas këtij vendimi detyrohen të bëjnë deklarimet për TVSH-në në afatet dhe formën që përcaktohet në ligj. Në deklaratën e TVSH-së do të deklarohen vetëm furnizimet e kryera në kuadër të veprimtarisë ekonomike si shitje dhe blerje të përjashtuara nga TVSH-ja.

VI. Nëse ndonjëri nga tri kriteret e përmendura në pikën II nuk plotësohet, atëherë furnizimet që kryen organizata nuk përfitojnë nga përjashtimi.

VII. Përfitojnë nga përjashtimi organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, duke plotësuar të njëjtat kushte dhe kritere si personat fizikë dhe juridikë që kanë qëllime fitimi.

VIII. Organizatat, që përfitojnë nga përjashtimi për të paguar TVSH sipas këtij vendimi, përfitojnë gjithashtu nga përjashtimi i TVSH-së në import për mallrat në funksion të veprimtarisë së tyre jofitimprurëse.

Neni 3

Procedura për aplikimin e përjashtimit nga organizatat jofitimprurëse

1. Organizata jofitimprurëse, e cila kryen veprimtari ekonomike si veprimtari dytësore të saj dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 1, të këtij vendimi, që të aplikojë përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që kryen, detyrohet të kryejë procedurat e mëposhtme:

Paraqet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar dokumentet e mëposhtme:

a) Vendimin e gjykatës (fotokopje e noterizuar);

b) Statutin e organizatës jofitimprurëse dhe kontratën e themelimit;

c) Një deklaratë në të cilën deklaron të listuara të gjitha shërbimet dhe mallrat që furnizon për anëtarët e saj ose për persona të tretë së bashku me çmimet që organizata aplikon për secilin furnizim;

ç) Një deklaratë ku shpreh misionin dhe qëllimin e OJF-së, si dhe identifikon programet kryesore të veprimtarisë;

d) Një deklaratë ku të deklarohet dhe të identifikohet kategoria e personave, grupeve në nevojë, të cilëve u shërben;

dh) Një deklaratë ku të specifikojë burimet e financimit të organizatës sipas zërave, përfshirë edhe të ardhurat e realizuara ose të pritshme nga veprimtaria ekonomike.

Në këtë deklaratë, organizata duhet të deklarojë në përqindje të përafërt të pjesës që zë ose pritet të zërë veprimtaria ekonomike e organizatës në raport me atë joekonomike. Kjo deklaratë kërkohet si në rastin kur organizata është regjistruar rishtas dhe nuk ka kryer më parë veprimtari ekonomike edhe në rastin kur ka kryer veprimtari bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara në organin tatimor.

2. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar organizata ngre një grup pune (me 2 deri 3 punonjës), i cili shqyrton rastin bazuar në dokumentacionin e paraqitur, situatën që paraqet organizata, historikun e saj (nëse ka) si dhe çdo të dhënë tjetër që disponon.

3. Bazuar në rezultatet e verifikimit, kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 2, të këtij vendimi, brenda 25 ditëve pune, grupi i punës i paraqet një raport drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i propozuar miratimin e përjashtimit nga TVSH-ja për furnizimet që kryen organizata.

4. Nëse gjykohet e nevojshme mund të kryhet edhe verifikim në vend i veprimtarisë së organizatës për llojet e furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve të kryera dhe çmimet që aplikon për secilin furnizim. Edhe nëse verifikimi nuk kryhet paraprakisht ai mund të kryhet në çdo kohë prej autoritetit tatimor.

5. Në përfundim të procedurës, jo më vonë se 5 ditë pune, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lëshon autoizimin për përjashtimin nga TVSH-ja. Nëse autorizimi refuzohet, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve jep arsyet, për të cilat përjashtimi nga TVSH-ja nuk mund të aplikohet prej organizatës.

6. Lëshimi i autorizimit për përjashtim nga TVSH-ja është i vlefshëm për 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kritere si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

Për organizatat jofitimprurëse që regjistrohen

për herë të parë, autorizimi i përjashtimit nga TVSH-ja është i vlefshëm për 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kritere si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

7. Në rast se konstatohet se kushtet kanë ndryshuar më parë se afati i përcaktuar në pikën 6, të këtij neni, atëherë Drejtoria Rajonale Tatimore në çdo kohë ka të drejtë të rishqyrtojë përjashtimin nga TVSH-ja.

8. Nuk i nënshtrohen procedurës sipas këtij neni organizatat jofitimprurëse të cilat nuk kryejnë veprimtari ekonomike në kuadër të veprimtarisë jofitimprurëse dhe në përputhje me nenin 3, të ligjit, konsiderohen persona të patatueshëm për TVSH-në. Këta persona nuk regjistrohen për TVSH-në.

Gjithashtu, nuk i nënshtrohen kësaj procedure organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë veprimtari ekonomike të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit, si p.sh. shërbime shëndetësore, arsimore etj, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore.

Neni 4

Manifestimet e kryera nga organizatat jofitimprurëse për qëllime bamirësie ose mbështetje të shtresave në nevojë

1. Në zbatim në shkronjës "l", të nenit 51, të ligjit, furnizimi i shërbimeve dhe mallrave të kryera nga organizatat jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave përjashtohet nga TVSH-ja, në raste të manifestimeve ose organizimeve për mbledhje fondesh ekskluzivisht për qëllime bamirësie ose në funksion të përmbushjes së qëllimit të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, përjashtohen nga TVSH-ja nëse numri i këtyre manifesimeve ose organizmave nuk kalon 5 (pesë) të tilla në vit. Nëse organizohen më shumë manifestime të tilla, përjashtimi nga TVSH-ja aplikohet për të ardhurat e mbledhura vetëm për pesë manifestime.

Megjithatë pavarësisht nga numri, përjashtimi nuk aplikohet nëse organizimi i këtyre manifestimeve me pagesë dhe të hapura për publikun ka karakter të shpeshtë.

2. Përjashtimi nuk aplikohet për furnizimet e kryera nga personat fizikë ose juridikë tregtarë edhe nëse janë të autorizuar nga organizatorët e manifestimit, që të ushtrojnë për llogarinë e tyre disa veprimtari gjatë zhvillimit të manifestimit, të tilla si shitje produktesh të ndryshme, shfrytëzimi i stendave, bareve etj.

Neni 5

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Në zbatim të pikës 2 të nenit 55 të ligjit, personat e tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën të zgjedhin të aplikojnë dhe paguajnë TVSH për furnizimin e qiradhënies së ndërtesës duke e trajtuar atë jo si furnizim të përjashtuar, por si furnizim të tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së 20%.

2. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që japin me qira ndërtesa (ambiente) për banim.

3. E drejta e zgjedhjes zbatohet për ndërtesa që qiramarrësit i përdorin për nevojat e veprimtarive të tyre të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të TVSH-së, si veprimtari të tatueshme, ose të përjashtuara nga TVSH-ja, si dhe për veprimtaritë që ndodhen jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

4. Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1, të këtij neni, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përveç nëse qiramarrësi është një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e qirasë të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga qiradhënësi dhe pranimi i saj nga qiramarrësi.

5. Në rastin kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron qiradhënësin e ardhshëm që në deklaratën për zgjedhjen të përcaktojë, të identifikojë qartë ndërtesën (ambientet) /ndërtesat për t'u përdorur për veprimtari qiradhënieje të tatueshme.

6. Ndryshimi i qiramarrësit ose veprimtarisë së tij nuk cenon vlefshmërinë e zgjedhjes, me kusht që kontrata e re e qiradhënies, nëse kërkohet një e tille, e lidhur me një qiramarrës tjetër të përmbajë klauzolën që tregon se zgjedhja e aplikimit të TVSH-së është ushtruar nga qiradhënësi. Në rastin kur qiramarrësi i ri, një person i patatueshëm ose i përjashtuar nuk e

pranon zgjedhjen, atëherë e drejta e zgjedhjes për të aplikuar TVSH-në e humb fuqinë e saj dhe nuk mund të ushtrohet për ambientet përkatëse.

7. Në rastin kur autoriteti tatimor konstaton një situatë abuzimi ose mashtrimi, atëherë kjo përbën një arsye të forte për të rrëzuar zgjedhjen e aplikuar prej qiradhënësit.

8. Personat e tatueshëm që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes duhet ta ushtrojnë atë në përputhje me këto kritere, si dhe modalitetet dhe rregullat e përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të këtij vendimi.

Neni 6

Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur më parë një deklaratë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku deklaron se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm. Kjo deklaratë e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për të futur në regjimin normal të TVSH-së, veprimtarinë e tij të dhënies me qira të ndërtesës, përmban të dhënat identifikuese për çdo ndërtesë të dhënë me qira, si dhe të dhënat e personit qiramarrës (emri, NIPT-i, adresa etj).

2. Për aplikimin e së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Personi i tatueshëm qiradhënës duhet të depozitojë, përveç deklaratës edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës së qirasë nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm.

3. Në rast se qiradhënësi kryen furnizim qiradhënieje për subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, qiradhënia trajtohet si furnizim i tatueshëm, vetëm në rast se në kontratën e qiradhënies, qiramarrësi është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH për qiranë. Në këtë rast, qiradhënësi duhet t'i bashkëlidhë deklaratës me shkrim edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm. Në këtë rast, qiramarrësi nuk mund të heqë dorë nga fakti që të paguajë TVSH për qiranë të paktën deri në përfundim të afatit të kontratës së qirasë.

Shembuj të qiradhënies për veprimtari të përjashtuar ose jashtë fushës së TVSH-së, ku qiradhënësi pavarësisht nga dëshira e shfaqur për të zbatuar zgjedhjen e TVSH-së, e ushtron të drejtën pasi ka rënë dakord me qiramarrësin:

Palët bien dakord paraprakisht për zbatimin e TVSH-së ose jo:

- të qiradhënies së një ndërtese për t'u përdorur si zyrë ku qiramarrës është një bashki që e përdor për pritjen e komunitetit të zonës, pra për një veprimtari të patatueshme me TVSH;
- të qiradhënies së një ndërtese (ambienti) për t'u përdorur si zyrë e dhënë me qira një zyre përfaqësimi, për nevoja të veprimtarisë së saj.

4. Në ndërtesat ose grupet e ndërtesave, ku përfshihen ndërtesa (ambiente) për të cilat qiradhënësi zgjedh të trajtojë qiradhënien e tyre si të tatueshme, por edhe ndërtesa (ambiente) të tjera për banim, e drejta e zgjedhjes nuk shtrihet te ndërtesat për banim, por zbatohet për të gjitha ndërtesat e tjera sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Me grup ndërtesash kuptohet jo vetëm një grup ndërtesash që kanë qenë objekt i të njëjtit studim të terrenit, leje ndërtimi ose programi ndërtimi, të realizuar në një terren që i përket të njëjtit person, por edhe dy apo më shumë ndërtesave të ndërtuara në të njëjtin terren.

5. Zgjedhja nis ditën e parë të muajit në të cilin ajo formulohet. Pas fillimit të ushtrimit, zgjedhja zbatohet për aq kohë sa nuk ka qenë objekt ndërprerjeje.

Neni 7

E drejta e zbritjes kur ushtrohet zgjedhja

1. Në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për çdo ndërtesë ose grup ndërtesash që janë përfshirë për t'u trajtuar si të tatueshme ose për çdo ndërtesë ose grup - ndërtesash të cilat i jep me qira si të përjashtuara nga TVSH-ja, qiradhënësit duhet të evidentojnë veçmas zbritjet e TVSH-së për secilën nga ndërtesat ose grup - ndërtesat.

2. Gjithashtu, qiradhënësit që përveç veprimtarisë së qiradhënies ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet t'i evidentojnë veçmas shpenzimet për secilën kategori të veprimtarisë.

3. Në rastin kur ndërtesa ose grupi i ndërtesave, për të cilin është kërkuar zgjedhja, përfshin ndërtesa (ambiente) për të cilat është ushtruar e drejta e zgjedhjes për t'i trajtuar të tatueshme me TVSH, në përputhje me dispozitat e ligjit, si dhe ndërtesa (ambiente) për të cilat nuk ushtrohet ose nuk është e lejuar të ushtrohet e drejta e zgjedhjes si ambiente për banim ose ambiente të dhëna me qira për nevojat e veprimtarisë së marrësve të patatueshëm ose të përjashtuar nga TVSH-ja të cilët në kontratën e qirasë nuk kanë formuluar shprehimisht të drejtën e zgjedhjes ose ambientet për përdorim profesional të cilat ende nuk janë dhënë realisht me qira (për to e drejta e zgjedhjes nuk mund të prezumohet për sa kohë që, sipas ligjit, qiradhënia mbi 2 muaj është furnizim i përjashtuar), TVSH-ja zbritet vetëm për tërësinë e ambienteve të përfshira realisht nga e drejta e zgjedhjes së TVSH-së.

4. Në lidhje me ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së, kjo zbritje lejohet për ndërtesën/at, të cilat edhe nëse nuk janë dhënë efektivisht me qira, por qiradhënësi, i cili i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe nëpërmjet elementeve objektive, vërteton se ai e jep me qira ambientin. Për këtë qëllim, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

-Kontrata të lidhura nga qiradhënësi apo çdo qasje tjetër ligjore të ndërmarrë prej tij dhe që vërteton përpjekjet e tij për të kërkuar qiramarrës për ndërtesat, ambientet për përdorim profesional të cilat kanë mbetur të lira (vakante);

-Ndërtesat, të cilat nuk janë ende objekt i një kontrate qiraje ose të një premtimi për qiradhënie në momentin e formulimit të zgjedhjes, duhet të përbëjnë një pjesë të vogël të tërësisë së ndërtesës ose ambienteve për përdorim profesional të ndërtesës në fjalë. Në çdo rast, ky kusht konsiderohet i përmbushur në rast se mungesa e qiradhënies së këtyre ambienteve që zënë një pjesë të vogël të ndërtesës justifikohet nga rrethanat ekonomike të pavarura nga vullneti i qiradhënësit, si p.sh.: fillimi i veprimtarisë së qiramarrësit, konjuktura të tregut imobiliar, fatkeqësi etj., të kësaj natyre.

5. Nuk kërkohet të bëhet rregullim i TVSH-së së zbritshme në situatat kur gjatë kohëzgjatjes së zgjedhjes konstatohet një mosdhënie me qira e përkohshme e ndërtesës, e justifikuar saktësisht nga rrethana ekonomike që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e qiradhënësit. I tillë është rasti kur, për arsye të ndryshimit të qiramarrësit, gjatë periudhës në të cilën qiradhënësi kryen përpjekjet e nevojshme për gjetjen e një qiramarrësi të ri.

6. Nëse qiradhënësi ndodhet në një situatë ku ambientet mbeten të lira për një kohë të gjatë, më shumë se një vit, pra e drejta e zgjedhjes pavarësisht dëshirës së personit të tatueshëm nuk mund të ushtrohet ose nëse veprimtaria e qiradhënies së ndërtesës së personit të tatueshëm ndërpritet, ose si pasojë e refuzimit të rinovimit të kontratës, ose për shkak të pushimit të efekteve të zgjedhjes, ose heqjes dorë prej saj, atëherë personi i tatueshëm duhet të procedojë me rregullimin e TVSH-së së zbritur më parë, nëse ndërprerja e transaksioneve të tatueshme ndodh para fillimit të vitit të nëntë pas vitit kur fillon e drejta e zbritjes. Rregullimi i TVSH-së përkon me shumën e TVSH-së të zbritur më parë, e cila zvogëlohet me një të dhjetën për çdo vit, pas datës në të cilën ka përfunduar ndërtesa.

7. Në rastin kur zgjedhja përfundon ose periudha për të cilën ushtrohet zgjedhja është më e shkurtër se afati për të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes së TVSH-së për pasurinë e paluajtshme, përfundimi i zgjedhjes sjell për pasojë detyrimin për rregullimin e TVSH-së së zbritur fillimisht nga personi i tatueshëm, nëse është rasti.

Neni 8

Përcaktimi i listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe procedurat e përjashtimeve e të kritereve përkatëse

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, makineritë dhe pajisjet që janë direkt të lidhura me investimin të kryera prej personave të tatueshëm të cilët:

a) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv pavarësisht nga vlera e investimit;

c) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit

në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;

ç) i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre;

d) në zbatim të pikës 41, të nenit 56 të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja importimi i makinerive bujqësore.

2. Importimi i makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importuesi është vetë personi i tatueshëm që realizon investimin ose përdor makinerinë ose pajisjen. Personat e tatueshëm, që importojnë makineri dhe pajisje për shitje, nuk janë subjekte përfituese të përjashtimit nga TVSH-ja, me përjashtim të tatimpaguesve që importojnë makineri bujqësore sipas shkronjës "e", të pikës 1, të këtij neni.

3. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe makineritë bujqësore është e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Personat e tatueshëm të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të cilët importojnë makineri dhe pajisje për të përfituar përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar, duhet të pajisen me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja nga autoriteti doganor. Për marrjen e këtij autorizimi, subjektet duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dokumentet, si më poshtë vijon:

4.1 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit e barabartë ose mbi 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është e barabartë ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.2 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e përpunimit aktiv. Verifikimi nëse ka ose jo autorizimin e lëshuar nga autoriteti doganor si tatimpagues në regjimin e përpunimit aktiv kryhet brenda strukturave doganore;

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për të gjithë kohëzgjatjen e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.3 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të ekstraktit të QKR-së, ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e agrobiznesit;

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin dhe kohëzgjatjen e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj;

4.4 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogla dhe ushtron aktivitet prodhues;

c) kopje të ekstraktit të QKR-së;

ç) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese që do të importohen dhe për periudhën e instalimit.

4.5 Në rastin e importit të makinave bujqësore, siç përcaktohet në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

Në rastin kur është fermer:

a) një kërkesë me shkrim, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore së cilës i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it me të cilën fermeri është pajisur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila tregon se importuesi është fermer;

b) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të tokës.

c) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinave që do të importohen dhe për periudhën e importimit.

Në rastin e tatimpaguesve të tjerë:

a) asnjë kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm;

c) kopje të ekstraktit të QKR-së;

ç) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive bujqësore që do të importohen.

4.6 Importimet e makinerive e të pajisjeve të kryera në përputhje me pikat 38 dhe 41, të nenit 56, të ligjit, subjekt i këtij vendimi, të bëra me ndërmjetësimin e kompanive *leasing* janë subjekt i përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Subjektet përfituese duhet të paraqesin në doganë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Respektivisht sipas kategorisë, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në pikat 4.1; 4.2; 4.3, 4.4 e 4.5 të këtij neni.

b) Kopje të kontratës me kompaninë *leasing*

5. Me plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, autoriteti doganor e pajis personin e tatueshëm me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, në të cilin përcaktohet edhe dega doganore mbikëqyrëse. Nëse administrata doganore nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, autorizimi konsiderohet i dhënë. Një kopje e autorizimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPD-ja hap një regjistër të veçantë për importet që kryhen nga tatimpaguesit importues. Për çdo import të makinerive e të pajisjeve, personat e tatueshëm duhet të paraqesin kërkesat e parashtruara në këtë vendim për t'u pajisur me autorizim përjashtimi.

Neni 9

Përcaktimi i kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv janë personat e tatueshëm që kryejnë aktivitet të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në fushën e përpunimit aktiv, sipas përcaktimeve në "Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë". Nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

2. Për zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja në import sipas këtij neni, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e

agrobiznesit janë subjektet fizike ose juridike, që merren me prodhimin ose përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, të akuakulturës, peshkimit dhe pyjeve, si dhe prodhimin e përpunimin e imputeve bujqësore, si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide dhe medikamente veterinare:

2.1 Kategoritë kryesore të agrobiznesit janë:

a) kultivimi dhe prodhimi i produkteve bujqësore bazë, të tilla si të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale që vijnë direkt nga fusha apo stalla dhe që janë të papërpunuara, si p.sh.: frutat, perimet, patatet, drithërat, ullinjtë, mishi, peshku, qumështi, vezët, mjalti;

b) përpunimi i të gjitha produkteve bujqësore, të përmendura në shkronjën "a", të pikës 2.1, të këtij vendimi, të tilla si: lëngjet, kompostot, mielli, buka, vaji i ullirit, sallamrat, proshutat, peshku i përpunuar, të gjitha nënproduktet e qumështit etj.;

c) kultivimi, prodhimi apo përpunimi i produkteve pyjore, të tilla si: bimët dekorative, bimët aromatike-mjekësore, kërpudhat etj.;

ç) prodhimi dhe përpunimi i imputeve bujqësore, të tilla si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide;

d) mbarështimi i gjësë së gjallë, si: gjedhë, të imta, njëthundrakë, derra, shpendë, lepuj, bletë, kërmij, peshq, midhje.

Neni 10

Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, përcaktohen kategoritë e eksportuesve, si më poshtë:

a) Personat e tatueshëm eksportues me risk zero, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i) Vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën 100% të vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet;

ii) Kanë aktivitet eksportues mbi 1vit;

iii) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;

iv) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Këta persona të klasifikuar me risk zero rimbursohen automatikisht pa iu nënshtruar më parë analizës së riskut.

a) Personi i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv për përpunimin në Republikën e Shqipërisë me qëllim rieksportimin e mallrave joshqiptare, siç përcaktohet në Kodin Doganor.

b) Personi i tatueshëm që eksporton mallra shqiptare sipas kuptimit të "Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë, nëse vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 60% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;

2. Të gjithë personat e tatueshëm eksportues sipas pikës 1, të këtij vendimi, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut, përveç eksportuesve të përcaktuar në pikën 1, shkronja "a", të këtij vendimi që klasifikohen me risk zero.

3. Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 t ketij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.

Neni 11

Përcaktimi i kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)

1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 milionë (pesë milionë) lekë në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

2. Personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelerisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit.

Neni 12
Organet zbatuese

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Neni 13
Shfuqizime

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit", nr. 202, datë 9.4.2014, "Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve për eksportuesit për qëllim të rimbursimit të TVSH-së"; nr. 180, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kritereve përkatëse", të ndryshuar"; nr. 178, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e procedurave, kritereve, llojit dhe sasisë së përjashtimeve nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në import dhe brenda vendit, për produktet hekur dhe çimento për ndërtimin e hidrocentraleve"; nr. 1058, datë 21.10.2009, "Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)", i ndryshuar; nr. 1679, datë 24.12.2008, "Për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik", dhe nr. 559, datë 16.8.2006, "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH, sh.a.", i ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 575, datë 31.12.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 15.01.2013 "MBI PROCEDURAT E PRODHIMIT, KODIMIT, STAMPIMIT, SHPËRNDARJES DHE MONITORIMIT TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE"

Në zbatim të ligjit nr. 10381, datë 24.02.2011, "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive "Sicpa Security Solutions S.A" e "Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.", për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emërtimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave", ministri i Financave dhe ministri i Shëndetësisë,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 2, datë 15.01.2013 "Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 16.1, fjalët "Pas datës 31dhjetor 2014", zëvendësohen me fjalët "Pas datës 31 dhjetor 2015".

2. Në pikën 16.2, fjalët "Pas datës 31dhjetor 2014", zëvendësohen me fjalët "Pas datës 31 dhjetor 2015".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 146 lekë